



Siguria fillon në shtëpi

Hulumtim për hartimin e strategjisë
së parë nationale
dhe të planit të veprimit
kundër dhunës në familje



Prishtinë, Kosovë 2008

Siguria fillon në shtëpi:

Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale
dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje

Nga Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-Mustafa për Rrjetin i Grupeve të Grave të Kosovës

Me ndihmën e Adelina Berishës, Mimoza Gashit, Dafina Beqirit dhe Nicole Slezak, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) pranë Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe me Iniciativën për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas si pjesë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PZHKB - UNDP)

© Agjencia për Barazi Gjinore, 2008.

Pikëpamja e paraqitur në këtë raport nuk korrespondon domosdoshmërisht me pikëpamjet e Qeverisë së Kosovës, të UNDP-së apo me ato të Qeverisë së Finlandës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ABGJ-në.

Ky hulumtim është përkrahur nga Agjencia për Barazi Gjinore, e cila gjendet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës (zbatuar nga Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas, e cila është në kuadër të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara – UNDP).

Dizajni, faqosja dhe shtypja nga Design House.

Publikuar nga Qeveria e Kosovës.

Përkthyer nga Zyra e Kryeministrit.

Reviduar dhe lekturuar nga CITS Translation.



**MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND**



Falënderim

Së pari, ekipi hulumtues i Rrjeti i Grupeve të Grave në Kosovë (RRGGK) do të donte të falënderojë qytetarët e Kosovës të cilët kanë ofruar kohën dhe mendimet e tyre për dhunën në familje. Shumë prej tyre kanë shprehur shpresën se të dhënat e tyre do të mund të nxisin qeverinë drejt një veprimi dhe se do të ushqenin ide të reja drejt planeve për uljen e dhunës në familje dhe se, në të njëjtën kohë, mund të përmirësonin kushtet e përgjithshme të jetesës të qytetarëve të Kosovës.

Gjatë procesit të hulumtimit, ne kemi pasur kënaqësinë e bashkëpunimit me ekipin e Iniciativa per Mbrotjen dhe Sigurine e Gruas (IMSG), duke involvuar Shqipe Krasniqin nga Agjencioni për Barazi Gjinore si dhe Nazlie Bala dhe Nita Luci e UNDP/IMSG. Ato, së bashku me Igballe Rogova nga RRGGK-ja përherë kanë ofruar inkurajimin dhe mbështetjen, për çka ne jemi shumë mirënjohe. Ne, poashtu, falënderojmë ekipin e UNFPA-së për financimin e hulumtimit kërkimor të mëparshëm të RRGGK mbi dhunën mbi baza gjinore dhe ndikimin e saj në shëndetin reprodukues të grave, që ka përbërë një themel të fortë prej të cilit është lansuar ky kërkim më i thelluar.

Përfaqësuesit e Shërbimit Policor të Kosovës, Departamenti për Mirëqenie Sociale, Ministria e Drejtësisë, Divizioni i Avokimit të Viktimateve dhe i Asistencës, Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore, Qendrat për Punë Sociale dhe Sekretariati i Sistemit Gjyqësor në Këshillin Juridik të Kosovës kanë siguruar depërtime të mprehta lidhur me çështjet me të cilat ata janë ballafaquar në përpjekjet e tyre për të mbrojtur viktimat dhe në ndjekjen e kryerësve të dhunës në familje. Ne i falënderojmë ata për rekondimet që kanë ofruar për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje. Poashtu jemi mirënjohej për përvojat e ofruara dhe rekondimet e siguruara nga shoqata e Pensionistëve, Shoqata e të Verbërve e Femrave, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Handikosi, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijën, Elysium, Liria, Medica Kosova, Qendra për Emancipim Social, Qendra për Rehabilitim për Viktimat e Torturës e Kosovës, Norma, Një për një, Partnerët e Kosovës, Shtëpi e Sigurt, Gjakova, UNICEF, Vita Jeta, Qendra e Mirëqenies e Grave.

Elmaze Gashi e ka rishikuar projektin e raportit dhe ka siguruar komente të çmueshme. Milva Ekonomia na ka ardhur në ndihmë me këshillat profesionale lidhur me zgjedhjen e modeleve dhe Enver Gashi i ka kontribuuar analizës statistikore të zbulimeve të studimit. Zbulimet e Nait Vrenezit, Safe House Gjakova, kanë siguruar mbështetjen e vazhdueshme gjatë procesit të analizimit dhe Aliriza Arënliu ka ofruar udhëzime për ekipin hulumtues lidhur me aspektet psikologjike të zhvillimit të intervistave.

Mendorim Rashiti dhe Bardhi Bakija së bashku me ekipin hulumtues të RRGGK-së kanë kaluar shumë ditë dhe netë duke inkuadruar të dhënat në SPSS në mënyrë që ne të mund t'i përgjigjeshim afateve. Në fund, përkushtimi dhe puna e zellshme e Shtepia e Sigurt-Gjakova, e ka bërë të mundshëm shtrirjen e hulumtimit anë e kënd Kosovës: Besa Salihu, Dardan Kryeziu, Sabrie Ahmeti, Genc Bajraktari, Lulkuqe Gashi, Vllaznim Bimbashi, Vezire Ukaj, Labinot Bala, Aferdita Demaj, Behar Halili, Besarta Murtezaj, Besart Rrecaj, Ardita Bahtiri, Kujtim Morina, Shpresa Petershoni, Senat Haliti, Besarta Trolli, Veton Shaqiri, Teuta Halimi, Valdet Plakolli, Bardha Gashi, Naim Telaku, Argjina Misini, Besart Gashi, Anita Sadikaj, Betim Selmanaj, Eliza Thana, Ylli Jashari, Drenusha Thaqi, Fidan Kalaja, Tringa Krasniqi, Ramiz Dukaj dhe të tjera të cilët nuk dëshironin të përmendeshin.

Akronime dhe Shkurtesa

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut
KEDKG	Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Kundër Grave
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
QPS	Qendra për Punë Sociale
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
BE	Bashkimi Evropian
DHBGJ	Dhuna mbi Baza Gjinore
SHSHF	Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
OPS	Objektet e Përkoħshme tē Sigurisë
KFOR	(NATO) Forca e Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SHPK	NJDHF Shërbimi Policor i Kosovës – Njësia kundër Dhunës Familjare
RRGGK	Rrjeti i Grupeve tē Grave tē Kosovës
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MD	Ministria e Drejtësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata joqeveritare
ZCGJ	Zyra për Çështje Gjinore e UNMIK-ut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (i referohet Misionit në Kosovë)
IPVQ	Institucionet e Përkoħshme tē Vetëqeverisjes në Kosovë
QMVP	Qendra për Mbrojtjen e Victimave dhe Parandalimin e Trafikimit
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit tē Përgjithshëm
ZSHS	Zyrtar për Shërbime Sociale
KB	Kombet e Bashkuara
QKBVNJ	Qendra e Kombeve tē Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
PZHKB	Programi për Zhvillim i Kombeve tē Bashkuara
FPKB	Fondi i Popullatës i Kombeve tē Bashkuara
KLRKB	Komisioni i Lartë për Refugjatë i Kombeve tē Bashkuara
FFKB	Fondi i Fëmijëve i Kombeve tē Bashkuara
FZHFKB	Fondi për Zhvillim i Grave i Kombeve tē Bashkuara
UNMIK	Mision i Kombeve tē Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencija për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve tē Bashkuara
DAVA	Divizioni i Avokimit tē Victimave dhe i Asistencës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
IMSG	Initiativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas
QMG	Qendra për Mirëqenie tē Grave

PËRMBAJTJA

Përbledhje e përgjithshme	1
Hyrje	3
Kaptulli 1. Perceptimi i qytetarëve lidhur me dhunën në familje: çka është keqtrajtim dhe në çfarë kushtesh ndodh ?	15
1. Perceptimi i qytetarëve lidhur me atë se çka e përbënë “dhunën në familje”	15
2. Dhuna midis partnerëve	17
3. Dhuna kundër fëmijëve	19
4. Format e perceptuara të dhunës kundër grupeve të tjera	21
5. Qëndrimet e qytetarëve ndaj keqtrajtuesve dhe marrëdhënieve keqtrajtuese	22
Kaptulli 2. Përhapja dhe format kryesore të dhunës në familje në Kosovë	25
1. Vështrim i përgjithshëm i dhunës në familje në Kosovë	25
2. Izolimi	31
3. Dhuna psikologjike	32
4. Dhuna fizike	34
5. Dhuna seksuale	36
6. Dhuna ekonomike	38
7. Kush janë viktimat? grupet demografike më së shumti të prekura nga dhuna në familje	38
8. Kush janë keqtrajtuesit? personat më të prirur për të kryer dhunën në familje	52
Kapitulli 3. Pasojat e dhunës në familje	55
1. Pasojat mbi personat të cilët vuajnë nga dhuna në familje	56
2. Pasojat mbi fëmijët dhe familjen	58
3. Pasojat mbi shoqërinë, duke përfshitë institucionet qeveritare	60
Kapitulli 4. Përgjigjja e qytetarëve: metodat të cilat i përdorin dhe i propozojnë qytetarët për përfundimin e dhunës ose për zvogëlimin e kushteve për ekzistimin e saj	63
1. Si e trajtojnë qytetarët dhunën dhe njohuritë e qytetarëve lidhur me ndihmën në dispozicion	63
2. Zvogëlimi i dhunës përmes parandalimit: perceptimet e qytetarëve për faktorët që i kontribuojnë dhunës dhe për mënyren e trajtimit të tyre	66
Kapitulli 5. Kufizimet sociale që i privojnë grupet e veçanta demografike në sferën private dhe publike, që potencialisht e rrisin dhunën në familje	71
1. Strukturat tradicionale të pushtetit brenda familjes	71
2. Dhuna mbi baza gjinore kundër fëmijëve, e bazuar në traditë,	73
3. Mungesa e qasjes ndaj shkollimit	74
4. Rolet gjinore diskriminuese dhe praktikat e punësimit	77
5. Diskriminimi në posedimin e pronësisë dhe trashëgimisë	79

Kapitulli 6. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale në trajtimin e dhunës në familje	81
1. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e viktimave	83
2. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për ndjekjen penale të kryerësve të dhunës	103
3. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për parandalimin e dhunës në familje	107
4. Përmirësiimi i reagimit të gjithëmbarshëm të qeverisë ndaj dhunës në familje	112
Rekomandimet	119
Punimet e cituara	124
Shtojca 1. Përbledhja e kërkimit paraprak mbi dhunën në familje në Kosovë	129
Shtojca 2. Instrumenti i anketës	131

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Të kuptuarit e përmasës, të grupeve demografike më së shumti të prekura, të reagimit ligjor dhe institucional dhe të perceptimeve lidhur me dhunën në familje në Kosovë janë thelbësore për planifikimin e një përgjigjeje qeveritare dhe joqeveritare për parandalimin e dhunës në të ardhmen, për mbrojtjen e viktimate dhe për ndjekjen penale të kryerësve të këtyre shkeljeve. Buxheti qeveritar dhe planet lidhur me dhunën në familje mund të janë më efikase nëse ato bazohen prej hulumtimit. Me qëllim të themelimit të një baze të fortë mbi të cilën mund të bazohet Plani kombëtar i veprimit i Kosovës kundër dhunës në familje, Rrjeti i Grupeve të Grave i Kosovës (RRGGK) ka zhvilluar një hulumtim lidhur me dhunën në familje në Kosovë. RRGGK-ja ka zbatuar një metodologji të përzier, që ka përfshirë mbledhjen e të dhënave statistikore nga institucionet përkatëse, rishqyrtimin e ligjit përkatës, të legjislacionit dhe të shërbimeve sociale në dispozicion; studimin e 1.256 grave dhe burrave të të gjitha moshave dhe grupeve etnike anë e kënd Kosovës; dhe studimin e përfaqësuesve të institucioneve kosovare, të organizatave relevante dhe të ekspertëve.

Kosova ka një numër të ligjeve të sofistikuara për të ndjekur penalisht kryerësit e dhunës në familje dhe për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Megjithëkëtë, kodi penal nuk e përkufizon dhunën në familje si krim. Tema nëse ky veprim do të mund të siguronte ndjekje penale më të mirë dhe më efikase kërkon debat të mëtejmë. Sot e kësaj dite vërehen probleme lidhur me zbatimin e Rregullores mbi dhunën në familje, siç janë vonesat në gjykata lidhur me lëshimin e urdhrit për mbrojtje. Vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës ndiqen penalisht në gjykata, dhe nuk ekzistojnë shënime mbi zbatimin e duhur të sanksioneve që reflektojnë seriozitetin e krimtit. Deri tani, janë regjistruar vetëm pak raste të ndjekjes penale për shkeljen e urdhrove të mbrojtës ose për krimet lidhur me lëndimet e lehta trupore të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare. Kur prokurori publik “është i gatshëm” të marrë rastet për hetime të mëtejme, përpjekjet e këtilla pengohen nga dosjet e paplota të dorëzuara nga policia, siç janë të dhënat mjekësore, të cilat mund të tregojnë lëndimet trupore.

Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare i Kosovës nuk është zbatuar plotësisht. Institucioni përgjegjës për zbatimin e tij, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), ka pasur kapacitete të kufizuara të burimeve njerëzore dhe financiare për të zbatuar plotësisht Ligjin, si dhe për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Së këndejmi, MPMS-ja është duke shfrytëzuar shërbimet e organizatave joqeveritare për sigurim të strehimit të viktimate, por financimi i këtyre OJQ-ve është mjaft i kufizuar. MPMS-ja mbulon vetëm 50 për qind të shpenzimeve të strehimoreve, duke mos përfshirë personelin ose shpenzimet operacionale. Legjislacioni ekzistues i ndihmës ligjore në Kosovë nuk i parasheh shprehimi viktimat e dhunës familjare si një kategori me të drejtën për përfaqësim dhe këshillim juridik falas. Avokatët e viktimate janë paraparë për t'u përkujdesur për të drejtat e viktimate, por aktualisht iu mungon kapaciteti i plotë për të bërë këtë. As qendrat shëndetësore e as ekspertët shëndetësorë nuk kanë regjistruar zyrtarisht rastet e dhunës në familje ose nuk e kanë raportuar krimin.

Për të përmirësuar përgjigjen multidisiplinare në ndihmën dhe në mbrojtjen e viktimate të dhunës në familje janë të nevojshëm mekanizmat shtetërorë dhe komunalë më të mirë të bashkërenditjes. Aktualisht nuk ekziston një informacion efikas ose shërbim mbështetës për viktimat e dhunës në familje. Linja telefonike DAVA funksionon në mënyrë sporadike dhe përgjigjja e policisë në thirrjet emergjente shpesh është e ngadalshme. Krijimi i një linje konfidenciale, funksionale dhe të papagesë të ndihmës 24 orëshe do të ishte ideal. Mbledhja institucionale e të dhënave dhe analiza e raporteve të dhunës në familje ka qenë sporadike, e

atypëratyshme dhe e pabashkërenditur. Mungesa e analizës së të dhënave dhe e monitorimit mund të ndikojë në gatishmërinë e autoriteteve për të trajtuar rastet e dhunës në familje, si dhe në ndarjen e mjeteve për trajtimin e dhunës në familje.

Studimi i 1.256 grave dhe burrave ka ilustruar se dhuna në familje ende përgjithësisht konsiderohet si diçka e turpshme në Kosovë, që mund të shpjegojë se përsë nuk është e raportuar në përmasat e saj reale. Përafërsisht 40 për qind e të anketuarve janë pajtuar se “Dhuna është një pjesë normale e cilësdo marrëdhënie, dhe shoqëria në përgjithësi, e pranon faktin se herë pas herë dhuna ndodh.” Pothuajse 20 për qind e të anketuarve janë pajtuar se “Ndonjëherë është në rregull që burri ta godas gruan e tij” dhe më shumë se një e treta kanë besuar se “është e natyrshme që dhuna fizike ndodh nganjëherë kur një çift grindet.” Në mënyrë habitëse, dy të tretat e të anketuarve janë pajtuar se “marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse ajo zhvillohet ndërmjet dy të rriturish të cilët janë të martuar.” Shumica e të anketuarve ia atribuojnë sjelljen e dhunshme papuniësisë (62.4 për qind) ose alkoolit (43 për qind), dhe besojnë se dhuna ka qenë “normale” ose e pranueshme në rrethana të tilla. Përpjekjet për ngritjen e vetëdijes duhet të çrrënjosin mitet e tilla, duke pasur për cak posaçërisht njerëzit me nivel të ulët të arsimimit, të papunët dhe gratë.

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përfunduar nëse dhuna është zvogëluar ose është rritur në Kosovë. Përafërsisht 43 për qind e të gjithë të anketuarve kanë përjetuar dhunë familjare; 46.4 për qind e të gjitha (100 për qind) të grave dhe 39.6 për qind e të gjithë meshkujve. Krahasuar me grupet e tjera demografike, gratë, njerëzit që jetojnë në zona rurale, të varfrit, të papunët, personat që marrin asistencën sociale dhe njerëzit me më pak se shkollimi i mesëm kanë pasur më shumë gjasa për përjetimin e dhunës. Sipas SHPK-së, 91.1 për qind e kryerësve të dhunës në familje kanë qenë meshkuj, kryesisht burra, dhe vetëm 8.9 për qind kanë qenë gra, edhe pse edhe anëtarë të tjerë të familjes, po ashtu kanë kryer dhunë.

Ekzistojnë të dhëna të shumta se dhuna në familje ndikon negativisht mbi individët duke i kontribuuar shtimit të problemeve shëndetësore, problemeve psikologjike, paaftësisë për t'u kujdesur për fëmijët dhe, madje, edhe vetëvrasjes ose vdekjes. Sidoqoftë, 14 për qind e të anketuarve nuk mund të gjenin një vend të vetëm, në të cilin dikush që vuani nga dhuna të mund të gjente ndihmën dhe vetëm pak prej tyre dinin lidhur me shërbimet e ofruara nga institucionet, që ilustron nevojën për një shtrirje më të gjerë në kuadër të komunitetit me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me ekzistimin e këtyre shërbimeve. Tani për tani, njerëzit që e përjetojnë dhunën ka më shumë gjasa të kërkojnë ndihmë nga anëtarët e familjes ose miqtë se sa nga institucionet. Më shumë se dhjetë për qind kanë thënë se nuk ekziston një rregullore kundër dhunës familjare në Kosovë, kurse 34.8 për qind nuk e kanë ditur nëse ekziston kjo rregullore. Përpjekjet në terren duhet të kenë cak njerëzit, të cilët potencialisht mund të ndihmojnë viktimat e dhunës pa përfshirjen e institacioneve.

Dhuna në familje shkakton shpenzime të mëdha për shoqërinë, duke përfshirë shpenzimet për kujdesin shëndetësor, policinë, ndjekjen penale, gjykimet, nivelet e arsimit dhe, së këndejmi, nivelet e punësimit, ditët e humbura të punës (që ndikon në Bruto Prodhimin Vendor - BPV), produktivitetin dhe asistencën sociale të viktimate. Qeveria mund t'i kontribuojë zvogëlimit të dhunës përmes sigurimit të kushteve themelore të jetesës (siç janë: uji, rryma); krijimit të vendeve të reja të punës; sigurimit të funksionimit më efikas dhe më efektiv të sistemit gjyqësor; zbatimit të ligjit ekzistues; sigurimit të qasjes më të mirë ndaj arsimimit, posaçërisht në zonat rurale dhe për femrën; zhvillimit të fushatave të ndërgjegjësimit duke vënë në cak personat më së shumti të rezistuar, kryerësit e dhunës, personat që mund të ndihmojnë viktimat dhe fëmijët; sjelljes së ngjarjeve kulturore e edukative në zonat rurale dhe duke e bërë këshillimin financiarisht dhe gjeografikisht më të qasshëm për viktimat, kryerësit e dhunës dhe familjet e tyre.

HYRJE

Dhuna në familje, gjithashtu e njojur si dhuna familjare, mund të përfshijë format psikologjike, fizike, seksuale, ekonomike dhe/ose format e tjera të dhunës që ndodhin brenda anëtarëve të një familjeje. Me gjasë, një përkufizim i njojur më gjërësish, por kufizues, është ai “i dhunës mes partnerëve intimë” apo dhuna në familje mes partnerëve. Në Kosovë, ligji e përkufizon fjalën “familjare” më gjërësish, duke marrë parasysh mënyra të ndryshme të jetesës dhe të njerëzve që banojnë së bashku në një shtëpi të vetme.¹ Së këndejmi, dhuna në familje mund të ndodh midis dajës dhe mbesës, vjehrrit dhe nuses ose dy partnerëve intimë të pamartuar që banojnë së bashku, e jo vetëm midis burrit dhe gruas. Format e dhunës në familje mund të ndryshojnë në varësi nga vendi, kultura, konteksti ose rr Ethanat, si dhe marrëdhëniet ndërfamiljare, duke e bërë kështu, të pamundur identifikimin e një listë të gjerë të krimeve të lidhura me dhunën në familje. Megjithëkëtë, aktet e dhunës në familje duhet të dënohen si shkelje e të drejtave të njeriut.

Krahas sigurimit të shëndetit dhe mirëqenies së gjithëmbarshme të qytetarëve kosovarë dhe zvogëlimit të shpenzimeve të qeverisë të lidhura me dhunën në familje,² Qeveria e Kosovës ka interesa të patjetërsueshme në zvogëlimin e dhunës në familje si pjesë e përpjekjeve të saja të vazhdueshme për të arritur Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe përparim në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). OZHM-të janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm në Kosovë për arsy se organizatat, siç është Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar e mbështesin këtë iniciativë.³ Synimet e OZHM-ve adresojnë çështje të ndryshme të zhvillimit njerëzor, duke përfshirë: varférinë, shëndetin, arsimimin, barazinë gjinore dhe mjedisin e qëndrueshëm.⁴ Nëse Kosova u tregon organizatave ndërkombëtare se ka përparuar në zbatimin e OZHM-ve, atëherë sigurimi i fonave do të jetë dukshëm më pak i komplikuar. Së këndejmi, “miratimi, përshtatja dhe mbikëqyrja e Objektivave zhvillimore të mijëvjeçarit janë një rrugë e sigurt jo vetëm për të rritur zhvillimin njerëzor në Kosovë, por po ashtu për të siguruar që popullata e Kosovës të mos ngec prapa në këtë përpjekje globale.”⁵

Një nga objektivat e OZHM-të, e cila meriton vëmendjen e veçantë të Qeverisë së Kosovës, është barazia gjinore dhe fuqizimi i grave. Ngaqë Qeveria e Kosovës është duke punuar drejt qëllimit afatgjatë të pranimit në BE, ajo duhet të adresojë çështjen e dhunës familjare kundër grave. Dhuna familjare negativisht ndikon mbi shëndetin e gruas në mënyra të ndryshme, duke përfshirë lëndimet fizike, çrregullimet gjinekologjike, problemet e shëndetit mendor dhe pasojat negative gjatë shtatzënise.⁶ Së këndejmi, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ‘derisa parandalimi dhe vetëdija mbi dhunën kundër grave të mos jetë integruar në të gjitha OZHM-të zhvillimi i qëndrueshëm do të vazhdojë të vuajë dhe

¹ Rregullorja e UNMIK-ut mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje.

² Për më shumë informacione lidhur me shpenzimet financiare të dhunës në familje dhe me ndikimin e saj në shëndetin e qytetarëve, shih kapitullin tre - pjesën e katërt.

³ Në OZHM përfshihen tetë Objektiva dhe tetëmbëdhjetë caqe për të cilat janë pajtuar 189 vende që t'i zbatojnë gjatë një periudhe 25 vjeçare (Raporti bazë i Kombeve të Bashkuara për Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit për Kosovën, “Ku do të jemi në vitin 2015?”, Mars 2004, 3). Falënderime të veçanta për Nicole Slezak, e cila ka ndihmuar në hulumtimin dhe përpilimin e kësaj pjese.

⁴ Po aty, 5.

⁵ Po aty, 4.

⁶ M. Ellsberg, “Dhuna kundër grave dhe Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit: Lehtësimi i qasjes së ndihmës për gratë,” Revistë ndërkombëtare e gjinekologjisë dhe e obstetrikës (*International Journal of Gynecology and Obstetrics*) (2006): 326. Shih po ashtu kapitullin tre.

synimet ambicioze, për të cilat është arritur pajtimi i bashkësisë ndërkombëtare, do të mbesin të paarritshme”, në bazë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë⁷

Dhuna kundër grave është identifikuar si një nga format e zakonshme të dhunës në familje dhe gratë në Kosovë përbëjnë shumicën dërmuese të viktimateve të dhunës në familje.⁸ Hulumtimet e mëherershme kanë sugjeruar se një nga tri gra përfjetojnë dhunën gjatë jetës së tyre.⁹ Sipas Këshillit të Evropës, dhuna në familje kundër grave e shkakton vdekjen dhe invaliditetin në mesin e grave të moshave prej 16 deri 44 në një shkallë më të lartë se sa lufta, kanceri ose aksidentet automobilistike.¹⁰ Në Portugali, për shembull, çdo muaj, më shumë se pesë gra vdesin nga shkaqet e drejtëpërdrejta ose të tërthorta të dhunës në familje.¹¹ Përkundër pasojave të argumentuara mirë, dhuna kundër grave mbetet forma më së paku e dukshme e dhunës e diskutuar dhe e adresuar nga qeveritë e ndryshme.¹²

Shpërfillja e zakonshme e dhunës në familje me gjasë është e lidhur me përkufizimet tradicionale të sigurisë, të cilat janë fokusuar më shumë në sigurinë ndërkombëtare se sa në sigurinë në nivel të shtetit, familjes ose posaçërisht atë individuale.¹³ Aktet ilegale, të cilat do të ndiqeshin penalisht sikur të kryheshin nga një i huaj, fqinji ose në një vend publik, shpesh nuk vërehen kur kryhen në fushën private, posaçërisht kur ato e kanë për cak gruan.¹⁴ Dhuna e përdorur kundër grupeve të rrezikuara, siç janë gra, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit krijon dhe përmban një pabarazi më të gjërë strukturale dhe institucionale që negativisht ndikon mbi qeverisjen demokratike. Andaj, dhuna duhet të pranohet si një çështje publike me qëllim që ajo të trajtohet nga perspektiva sociale, politike dhe ekonomike. Duke pasur parasysh ndikimin negativ të dhunës në familje mbi shoqërinë dhe institucionet,¹⁵ qeveria po ashtu ka interes të patjetërsueshëm për të garantuar kushtim më të madh të vëmendjes ndaj dhunës në familje, duke përfshirë këtu fokusimin më të madh në burimet njerëzore dhe në ato financiare.

Zhvillimi i një përgjigjeje qeveritare ndaj dhunës në familje, duke përfshirë strategjitetë dhe programet për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimateve dhe ndjekjen penale të kryerësve të dhunës, kërkon një të kuptuar të qartë të burimeve dhe shkaqeve të dhunës me qëllim të adresimit të tyre; njojuri mbi grupet demografike dhe gjeografike që më së shumti i shtrohen rrezikut të dhunës në familje dhe dhënie të informacioneve nga institucionet dhe organizatat kyçë që merren me dhunën në familje dhe pasojat e saj. Fatkeqësisht, Qeveria e

⁷ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Departamenti për çështje gjinore, të femrës dhe të shëndetit, “Adresimi i dhunës kundër grave dhe arritia e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit” (Gjenevë, Zvicër: Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2005), 28.

⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), “Reagimi ndaj incidenteve të dhunës në familje: Doracak për zyrtarët e shërbimeve sociale” (2006), 21. Shih po ashtu Raportin e RRGGK-së shkruar nga Nicole Farnsworth, *Hulumtim kërkimor mbi përmasën e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi i saj në shëndetin riprodhues të grave* (Prishtinë, Kosovë: RRGGK, 2008), që citon statistikat e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) se gratë janë viktima të dhunës në familje në më shumë se 90 për qind të rasteve.

⁹ Lori Heise, et al., “Drejt një fundi të dhunës kundër femrës,” *Raport i Popullatës*, Seritë L: Botimet në World Health, 11 (1999 Dhjet.), 1-43.

¹⁰ Për shembull, shih Asambljenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Rekomandimin 1582 (2002) I (1).

¹¹ Shih Qeveria e Portugalisë, Plani kombëtar kundër dhunës në familje 2003-2006, Rezolutë e Qeverisë portugeze, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 13 Maj 2003.

¹² Lidhur me mbizotërimin e dhunës kundër grave në Evropë dhe pasojat e saj, shih Rekomandimin 1450 (2000) të Këshillit të Evropës mbi Dhunën kundër grave në Evropë.

¹³ J. Ann Tickner, “Ju thjesht nuk e kuptoni: angazhimet e turbullta midis feministeve dhe teoricienëve të IR-së,” *International Studies Quarterly*, Vell. 41, nr. 4. (Dhjet. 1997), 613.

¹⁴ Lori Heise et al., “Një vështrim global mbi dhunën në baza gjinore,” Revistë ndërkombëtare e gjinekologjisë dhe obstetrikës. 78 Suppl 1:S5-14 (2002): 5.

¹⁵ Shih kapitullin tre. UNICEF po ashtu ka vërejtur se fokusimi nuk duhet të bëhet vetëm në trafikimin, por po ashtu, edhe në dhunën familjare. (Studim i RRGGK, Qershor 2008).

Kosovës ka pasur pak qasje ndaj informacionit të tillë. Si edhe gjetiu në botë, dhuna në familje është e vështirë për t'u matur ngaqë krimi mbetet i paraportuar dhe i paregjistruar. Mungesa e sipërpërmendur e vëmendjes në emër të qeverisë poashtu do të thotë se institucionet shpesh dështojnë që në mënyrë të qëndrueshme të mbledhin dhe të analizojnë të dhënrat lidhur me dhunën në familje.¹⁶

Duke pasur parasysh mungesën e informacionit adekuat dhe të tashëm lidhur me dhunën në familje në Kosovë, në prill të vitit 2008, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) është kontraktuar nga Iniciativa për Mbrojtjen Sigurinë e Gruas (IMSG), një projekt ky bashkëpunues midis Agjencionit për Barazi Gjinore dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PZHKB-UNDP), për të zhvilluar një hulumtim i cili do të siguronte një të kupuar të gjithëmbarshëm të dhunës në familje në Kosovë. Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë për të kriuar një themel të fortë mbi të cilin mund të bazohej Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës kundër dhunës në familje. Studimi është përqendruar në aktet e keqtrajtimit psikologjik, fizik, seksual dhe ekonomik që janë të drejtuara kundër grave/fëmijëve/të moshuarve, të hendikepuarve ose anëtarëve të tjerë të familjes nga partnerët intim të anëtarëve të familjes,” sipas kërkësave të IMSG Projekti ambicioz i hulumtimit ka synuar të adresojë objektivat e mëposhtme, të kërkuara nga IMSG:

1. Të identifikojë format e dhunës që zakonisht ndodhin në familje;
2. Të krijojë një pasqyre mbi perceptimet e qytetarëve lidhur me atë se cilat sjellje janë keqtrajtuese dhe në çfarë rrethanash;
3. Të hulumtohet se çfarë metodash përdorin qytetarët për të përfunduar dhunën ose për t'i zvogëluar rrethanat e ndodhjes së saj;
4. Të dokumentohen pasojat e dhunës në familje mbi gratë, familjen, fëmijët dhe shoqërinë si tërsi;
5. Të identifikojë qëndrimet e shoqërisë ndaj keqtrajtuesve dhe marrëdhënieve keqtrajtuese;
6. Të përcaktojë kufizimet sociale që i privojnë grupet e veçanta demografike ose gjeografike në sferën private ose në atë publike dhe
7. Të identifikojë zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për përballje me dhunën në familje.

Projekti i hulumtimit ka qenë kërkimi i parë i gjerë i faktorëve që i kontribuojnë dhunës në familje, përmasave të saj dhe reperkusioneve të kësaj dhune në Kosovë. Si i tillë, Raporti, i cili rezulton, siguron informacion shumë të vlefshëm për hartuesit e politikave, organizatat joqeveritare që merren me këtë çështje, hulumtuesit, donatorët dhe të tjerët të interesuar në krijimin e fushatave ose programeve që kanë për cak parandalimin e dhunës në të ardhmen, mbrojtjen më të mirë të viktimateve dhe ndjekjen penale të kryerësve të dhunës.

Ky kapitull hyrës fillon me përkufizimin e disa prej termave kyçë, që përdoren në raport. Pastaj, siguron një përbledhje të shkurtë të metodës së hulumtimit dhe i paraqet në hollësi disa nga kufizimet e hulumtimit. Ky kapitull përfundon me një përshkrim të strukturës së raportit.

¹⁶ Këshilli i Evropës, “Përbledhje e propozimit të planit të veprimit mbi dhunën kundër femrës” (1998).

1. Përkufizimet

Dhuna në familje ose dhuna familjare

Është zhvilluar një debat lidhur me dhunën në familje në kuptimin e konstatimit nëse shprehja “dhunë në familje” (“domestic violence”) i përfshin të gjitha format e dhunës që ndodhin në një ambient familjar (pra, keqtrajtimi i grave, fëmijëve, pleqve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara) ose është kufizuar në dhunën që kryhet brenda marrëdhënieς seksuale/martesore.¹⁷ Shprehja “dhuna familjare” (“domestic violence”) është parapëlqyer se i përgjigjet një shkalle më të gjerë të dhunës brenda familjes, por shpesh i mungon një fokusim më i ngushtë në grupe të veçanta që janë më të rrezikuarat ndaj dhunës, siç janë gratë dhe fëmijët. Së këndejmi, ky raport përdor përkufizimin e “dhunës në familje” që ekziston në ligjin në fuqi në Kosovë.¹⁸

Kodi Penal i Kosovës dhe Rregullorja mbi dhunën në familje (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12) jep përkufizime të ngjashme të “marrëdhënie familjare”.¹⁹ Marrëdhënia familjare është përkufizuar gjerësisht me qëllim të trajtimit të formave të përbashkëta të jetesës në Kosovë përmes të cekurit eksplisit të personave të cilët konsiderohen anëtarë të familjes në një bashkësi familjare. Bazuar në këtë përkufizim, njeriu mund të përcaktojë se cilët anëtarë të familjes në një bashkësi familjare janë viktima të dhunës në familje. Marrëdhënia familjare është përkufizuar si “një marrëdhënie midis dy personave”:

- (a)** Të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose të cilët bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa martesë;
- (b)** Të cilët e shfrytëzojnë së bashku bashkësinë primare familjare dhe të cilët janë të lidhur për nga gjaku, martesa ose adoptimi ose janë në marrëdhënie kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshëritë, fëmijët, vëllezërit e motrat, tezet e hallat, mbesat, nipat ose kushérinjtë apo
- (c)** Të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët.²⁰

Kështu, për shembull, aktet e “dhunës në familje” mund të ndodhin midis një daje e një mbese ose midis një të dashuri a një të dashure që jetojnë në të njëjtën bashkësi familjare. Në një rast të tillë, kryerësi i dhunës duhet të ndiqet penalisht në pajtim me ligjin në fuqi.

Kodi Penal i Kosovës nuk parasheh një përkufizim të veçantë të “dhunës në familje”, por i përkufizon veprat e ndryshme penale të cilat mund të kryhen në konteksttin e marrëdhënie familjare, siç janë: lëndimi i lehtë trupor; lëndimi i rëndë trupor; detyrimi; kërcënimi; heqja e paligjshme e lirisë; rrëmbimi i paligjshëm i fëmijës; keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës; shkelja e obligimeve familjare, siç është lënia e një anëtarë të familjes që nuk është në gjendje të kujdeset përveten e tij ose të saj në një situatë të rëndë;²¹ vjedhja;

¹⁷ Danilda dhe Leander për Operation Kvinnofrid, “Plagët më të këqija janë përbrenda: metodat e kundërveprimit ndaj dhunës kundër grave,” (Qershori, 1999).

¹⁸ Shih kapitullin gjashtë për një përkufizim të plotë.

¹⁹ Një marrëdhënie familjare është përkufizuar si “marrëdhënie midis dy personave [...] të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa martesë; të cilët e shfrytëzojnë së bashku ambientin familjar të përbashkët dhe të cilët janë të lidhur për nga gjaku, martesa ose adoptimi ose janë në marrëdhënie kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat e mbesat, vëllezërit e motrat, dajët e axhët, mbesat, nipat ose kushérinjtë ose të cilët janë prind të një fëmije të përbashkët.” Shih nenin 107 (24) të Rregullores së UNMIK-ut mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, nr. 2003/25.

²⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12, nen 1.1.

²¹ Neni 212 (1) thotë, “Kushdo që shkel rëndë obligimet familjare ligjore të tij ose të saj duke e lënë anëtarin e familjes i cili nuk është në gjendje të kujdeset përveten e tij ose të saj në situatë të rëndë.”

vjedhja e rëndë; përvetësimi ose marrja në posedim e pasurisë së paluajtshme; dëmtimi i pasurisë së paluajtshme; mashtrimi; dëmet e shkaktuara mbi të drejtën e personit ndaj pronës; krijimi i skllavërisë, i kushteve të ngashme me skllavërinë dhe i punës së detyrueshme; dhunimi (duke përfshi dhunën martesore); sulmi seksual; degradimi i integritetit seksual dhe keqtrajtimi i personave me çrregullime mendore ose emocionale apo i atyre me aftësi të kufizuara në marrëdhënien familjare. Duhet të theksohet se që nga janari i vitit 2003, veprat penale kundër integritetit seksual, siç është dhunimi, janë të zbatueshme ndaj të gjithë personave, duke përfshirë rastet kur kryerësi i veprës penale dhe viktima janë të martuar.²² Sipas Kodit Penal, të gjitha veprat e lartpërmendura penale duhet të konsiderohen si akte të dhunës në familje.²³

Pos Kodit Penal, Rregullorja mbi dhunën në familje jap një përkufizim të veprimeve ose të mungesës së veprimeve të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare si bazë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes në një procedurë gjyqësore civile.²⁴ Sipas Rregullores mbi dhunën në familje, veprimet e mëposhtme ose mungesa e veprimeve konsiderohet si bazë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse është kryer në kuadër të një marrëdhënieje familjare:

- (a) Shkaktimi i lëndimit trupor;
- (b) Aktet seksuale pa pajtim ose shfrytëzimi seksual;
- (c) Shkaktimi i frikës te personi tjetër lidhur me mirëqenien e tij ose të saj fizike, emocionale ose ekonomike;
- (d) Kidnapimi;
- (e) Shkaktimi i dëmit në pronë;
- (f) Kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër;
- (g) Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;
- (h) Largimi i dhunshëm i personit tjetër nga vendbanimi i përbashkët;
- (i) Ndalimi i personit tjetër nga hyrja ose lëshimi i vendbanimit të përbashkët apo
- (j) Angazhimi në një model të sjelljes me qëllim të degradimit të personit tjetër.²⁵

Ligji mbi qetësinë dhe rendin publik po kështu mund të zbatohet në mosmarrëveshjet familjare. Ai përfshin veprat e kundërvajtjes për personat të cilët prishin qetësinë publike përmes: sulmit fizik dhe keqtrajtimit të personit tjetër; pjesëmarrjes në përleshje; të qenit fyes; rrezikimit të sigurisë personale të tjetrit përmes kërcënimit me sulm fizik dhe prishjes së qetësisë përmes grindjes, britmave ose shkaktimit të përleshjes në vendin publik. Nëse këto akte janë kryer nën ndikimin e drogave ose të alkoolit, gjykata mund të shqiptojë masën mbrojtëse të trajtimit mjekësor për varësi nga droga ose alkoli.²⁶

²² Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/01 për ndryshimin e Ligjit në fuqi mbi veprat penale që përfshijnë dhunën seksuale, nenin 1.1 (1) dhe paragrafin 4 të preambulës së Rregullores.

²³ Shih OSBE dhe MPMS, Duke u përgjigjur ndaj incidenteve të dhunës familjare: *Doracak për zyrtarët e Shërbimit Social*, (Prishtinë: 2006), 24.

²⁴ Rregullorja mbi dhunën në familje kërkon që procedurat e parapara sipas Ligjit mbi Procedurën e Kontestimore të shfrytëzohen kur kerkohet ose lëshohet urdhri i mbrojtjes (shih nenet 6.3, 7.3, 8.4, 8.6, 9.4, 10.4, 10.6, 13.4, 13.6 dhe 18.2). Sidoqoftë, disa veprime, siç janë lëndimi i lehtë trupor, shkelja e urdhrit të mbrojtjes, aktet seksuale pa pajtim ose shfrytëzimi seksual, kidnapimi dhe dëmtimi i pronës së personit tjetër janë të cekura si vepra penale të lidhura me dhunën familjare kur kryhen në kuadër të një marrëdhënieje familjare dhe kërkojnë ndjekje penale sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) në pajtim me procedurën penale.

²⁵ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12, neni.1.2.

²⁶ Neni. 21, par.1

Dhuna në familje si formë e dhunës në baza gjinore

Dhuna në baza gjinore është një formë e dhunës që e ka cak personin për shkak të gjinisë së saj ose të tij. Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e Kombeve të Bashkuara e interpreton dhunën më baza gjinore si “dhunë e cila është e drejtuar kundër grave për shkak se ajo është grua ose ngaqë kjo ndikon mbi gruan në mënyrë disproporcionale [...] duke përfshirë aktet që shkaktojnë dëmtimin fizik, mendor ose seksual ose vuajtjen, kërcënimet me aktet e tillë, detyrimin dhe privimet e tjera të lirisë”²⁷ Dhuna në familje po ashtu konsiderohet një formë e dhunës në baza gjinore. Përmes këtij Raporti pranohet se dhuna në shtëpi e drejtuar në gratë dhe vajzat për shkak të gjinisë së tyre është një formë e dhunës në baza gjinore. Dhuna e drejtuar kundër djemve dhe burrave për shkak të gjinisë së tyre gjithashtu konsiderohet një formë e dhunës në baza gjinore.²⁸ Ngaqë hulumtimet në dispozicion në Kosovë tregojnë se caku më i shpeshtë i dhunës në familje janë gratë, pjesërisht për shkak të gjinisë së tyre,²⁹ ky Raport shpesh i referohet dhunës në familje kundër grave. Raporti po kështu i referohet dhunës në familje që në mënyrë specifike në shënjestër ka fëmijët, pleqtë, personat me aftësi të kufizuara ose grupet e tjera të veçanta demografike apo gjeografike.

Viktima ose të mbijetuarit

Termi “viktimi” është i prirë të përfshijë imazhet e individëve, posaçërisht të grave, më shumë si objekte se sa si subjekte. Portretimi i grave si objekte të pafuqishme të dhunës mund të homogenizojë gratë, të mohojë përvojat e tyre individuale jetësore dhe të shpërfillin anën e tyre njerëzore. Shpërfillja e potencialit së gruas për veprim mund të jetë shfuqizuese për rolin e saj. Së këndejmi, përkufizimi dhe trajtimi i grave si viktima mund të shpie deri tek varësia e tyre nga institucionet ose burrat e dhunshëm më parë se sa tek mbështetja e pavarësisë së tyre. Një term alternativ i përdorur nga disa aktivistë është “i/e mbijetuar” i dhunës në familje, që thekson potencialin e femrave dhe të të tjerëve, si dhe forcën në tejkalinin e situatave të dhunshme. Sidoqoftë, termi “të mbijetuar” mund t'u heq vëmendjen qeverive dhe donatorëve nga programet e mbështetjes financiare për personat të cilët kanë vuajtur nga dhuna; nëse ata kanë mbijetuar, (me fjalë të tjera, nuk janë viktima), atëherë përsë ata kanë nevojë për mbështetjen financiare, mund të pyesin mbështetësit financiarë. Derisa termi “të mbijetuarit” është i parapëlqyer kur kihen parasysh aktivitetet afatgjate institucionale dhe organizative dhe programet e reintegrimit, ky Raport shfrytëzon termin “viktimi” për të qenë në përputhje me përkufizimet aktuale të përdorura në ligjin në fuqi dhe në raportet në dispozicion.

2. Metodologjia

Ekipi hulumtues i RRGGK-së ka përdorur një metodologji të metodave të përziera,³⁰ të përbledhur në këtë pjesë. Së pari, RRGGK-ja ka zhvilluar një anketë anë e kënd Kosovës, të

²⁷ Rekomandimi i përgjithshëm 19 i KEDKG-së mbi dhunën kundër grave.

²⁸ Shih pjesën mbi dhunën kundër fëmijëve në kapitullin dy, i cili dëshmon dhunën në baza gjinore kundër djemve.

²⁹ Në kapitullin dy diskutohet mbizotërimi i dhunës që në shënjestër i ka gratë dhe grupet e tjera demografike. Shih kapitullin pesë, ku theksohet se si diskriminimi në baza gjinore kundër grave në Kosovë mund të ndikojë në pozitën e tyre sociale, duke përfshirë nivelin e tyre të arriturave në arsim dhe mundësitet për punësim. Praktikat diskriminuese në mënyrë potenciale mund të vënë gratë në pozita të vështira në të cilat dhuna në familje ka më shumë gjasaë të ndodh.

³⁰ Scott A. Murray dhe Lesley J.C. Graham kanë argumentuar se metodologja e metodës së përzier mund të jetë e dobishme për zhvillimin e kërkimeve në çështjet më pak të hulumtuara. Shih “Vlerësimi i bazuar në praktikat e nevojave shëndetësore: shfrytëzimi i katër metodave në një ambient të vogël” BMJ 310 (1995), 1443-1448.

1.256 personave të të gjitha moshave dhe grupeve etnike prej 28 prillit e deri më 7 maj të vitit 2008.³¹ Instrumenti i anketës ka përbajtbur pyetje specifike. Megjithëkëtë, shumica dërmuese e pyetjeve janë bërë si pyetje me përfundime të hapura në stilin e bashkëbisedimit me të mbijetuarin, i cili rrethonte përgjigjen apo përgjigjet më të përshtatshme.³² Po kështu është siguruar një kategori e shënjuar si “të tjera” me një opson për të shkruar një përgjigje alternative. Ekipi hulumtues ka zhvilluar një anketë testuese tri ditë para anketës së vërtetë. Instrumenti i anketës është përshtatur, ndërsa anketat testuese janë shpërfillur.

RRGGK-ja ka punësuar 35 anketues me së paku dy vite të përfunduara të arsimimit universitar në psikologji. Pastaj, RRGGK-ja ka organizuar një trajnim obligativ njëditor për t'u siguruar se ata ishin të njoftuar me mandatin e hulumtimit, instrumentin e anketimit, metodën e përgjedhjes së mostrave, procedurat e kontrollit dhe logistikën.³³ Anketuesit po ashtu kanë marrë pjesë në diskutimin e udhëhequr nga një profesor psikologje lidhur me atë se si duhet trajtuar situatat e ndryshme të cilat mund të lindin gjatë anketës, siç janë ato kur të anketuarit tregojnë shenja të traumës ose ato të ndërhyrjes së anëtarëve të familjes. Ekipi është udhëzuar për të përdorur metodën e ndjeshme të anketimit, përmes së cilës është mbrojtur siguria dhe mirëqenia sociale e të anketuarve.

RRGGK-ja është zotuar të veprojë në përputhje me standartet e larta etike të hulumtimit me qenie njerëzore. Në përgjithësi, anketat me të anketuarit meshkuj janë realizuar nga hulumtuesit meshkuj dhe anketat me të anketuarat gra - me hulumtuese gra. Anketuesit kanë përdorur formën e pëlqimit standard me gojë për të informuar të anketuarit lidhur me hulumtimin dhe lidhur me atë se si informacioni i marrë nga ta do të shfrytëzohet. RRGGK-ja është përpjekur të nxjerr maksimumin e përfitimeve pozitive të hulumtimit për të anketuarit (pra, shansin për të folur lidhur me përvojat personale, marrjen e informacionit lidhur me shërbimet në dispozicion, sigurimin e informacionit për Planin Kombëtar të Veprimit të Qeverisë kundër dhunës në familje).³⁴ Anketuesit janë udhëhequr në mënyrë joformale me një stil të bashkëbisedimit, i cili ka pasur për qëllim arritjen e maksimumit të rehatisë së të anketuarve. Konfidencialiteti është garantuar ashtu që shenjat e mundshme të identifikimit, siç janë adresa, qyteti dhe numri i telefonit janë mbajtur në një formular të veçantë nga anketuesit. Forma e kontaktimit për informacionin është përdorur vetëm për kontrollin e cilësisë dhe pastaj është hedhur.

Metoda rigoroze e përgjedhjes së mostrave është përdorur për të siguruar se studimi ka qenë përfaqësimtar, duke përfshirë:

- **Përfaqësimin gjeografik:** Numri i anketave të realizuara në secilën prej 29 komunave është përcaktuar në pajtim me përqindjen e përafertë të popullatës që ka jetuar në secilën komunë në vitin 2006.³⁵ Gjithsej, në anketë janë përfshirë 208 zona.³⁶

³¹ Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka vlerësar se popullata e Kosovës arrin numrin e 2.1 milionë (2,126,708) banorëve. Shih *Kosova sipas shifrave 2007* (Prishtinë: ESK, Prill 2008), 10. Të rriturit përbëjnë më shumë se 64 për qind të popullat[s (mosha 18 dhe përrmbi) (ESK, Gratë dhe burrat në Kosovë, Prishtinë: 2007, 3). Margjinat e gabimit për këtë model janë 1,257 për qind.

³² Instrumenti i anketimit gjendet në shtojcën dy.

³³ Profesor Nait Vrenezi dhe profesor Aliriza Arënliu kanë udhëhequr trajnimin.

³⁴ Për informacion të mëtejmë, ju lutem shikoni Formularin e deklarimit dhe të pajtimit (shtojca pesë), ku të gjithë hulumtuesit kanë lexuar dhe kanë marrë miratimin me gojë para fillimit të diskutimit.

³⁵ Kalkuluar sipas ESK, Atllasi statistikor 2008 (Prishtinë: ESK, Prill 2008). RRGGK-ja nuk ka anketuar personat që jetojnë në Novobërdë për shkak të situatës aty para zgjedhjeve në Serbi, gjë që ndikojë në pasigurinë e hulumtuesve të shkojnë atje. Gjithashtu, çfarëdo zbulimesh nga komuna e Novobërdës do të dëshmoheshin statistikisht të parëndësishme në kuadër të mostrës së madhe të përgjedhjes, ngaqë vetëm 0.19 për qind e popullatës banon atje.

- Përfaqësimin rural dhe urban: Në këtë mostër të përgjedhjes, 55.6 pér qind e të anketuarve kanë qenë nga zonat rurale dhe 44.4 pér qind nga zonat urbane.³⁷
- Të gjitha moshat mbi atë 18 vjeçare: i anketuari nga secila bashkësi familjare është zgjedhur sipas rastit në pajtim me teknikën e ditëlindjes më të afërt.³⁸ Afërsisht një e katërtë e të anketuarve (24.7 pér qind) kanë qenë të moshave prej 18 deri 25. Njerëzit e moshave prej 26 deri në 35 kanë përbërë 21.0 pér qind të mostrës, prej 36 deri në 45 kanë qenë 21.3 pér qind, prej 46 deri në 55 kanë qenë 17.4 pér qind, prej 56 deri në 65 vjeçare kanë qenë 9.2 pér qind dhe persona të moshave 66 e sipër kanë qenë 6.4 pér qind.³⁹
- Gjininë: Meshkujt dhe femrat janë zgjedhur sipas rastit në pajtim me teknikën e ditëlindjes më të afërt. Të anketuarat gra kanë përbërë 50.6 pér qind të mostrave të përgjedhura, kurse meshkujt - 49.4 pér qind.⁴⁰
- Përkatesinë etnike: Mostra ka përfshirë 82.3 pér qind të shqiptarëve, 7.8 pér qind të serbëve, 3.7 të romëve, ashkanlive ose egjiptasve, 1.9 pér qind të boshnjakëve, 1.8 pér qind të goranëve, 2.4 pér qind të turqve dhe “të tjerë” (0.1 pér qind). Me qëllim që t'i lidh konkluzat me grupet etnike, RRGGK-ja qëllimisht ka përfaqësuar më shumë në mostra qytetarët minoritarë.⁴¹

Kontrolli i cilësisë është kryer nga përfaqësuesit e RRGGK-së të cilët kanë kontrolluar anketat e kompletuara dhe i kanë verifikuar përmes telefonimit sipas rastit të 10 pér qind të të anketuarve. Gjashtë persona që nuk janë përfshirë në analizë e kanë inkuadruar informacionin sasior në SPSS 13.0 pér analizë të të dhënave. Hulumtuesi kryesor i RRGGK-së ka zhvilluar analizën iniciale dhe statisticienti e ka analizuar korrelacionin. Tre hulumtues, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në analizë, kanë inkuadruar informacionin cilësor, siç janë

Përqindja e anketave të zhvilluara në seilën komunë ka qenë si më poshtë: Leposaviq 1 pér qind, Zveçan 1.4 pér qind, Zubin Potok 0.8 pér qind, Mitrovicë 4.4 pér qind, Podujevë 5.3 pér qind, Vushtrri 3.9 pér qind, Skenderaj 3.1 pér qind, Istog 2.2 pér qind, Pejë 5.3 pér qind, Klinë 3.1 pér qind, Glogoc 2.3 pér qind, Obiliq 2.1 pér qind, Prishtinë 14.1 pér qind, Kamenicë 2.5 pér qind, Fushë Kosovë 1.5 pér qind, Gjilan 4.5 pér qind, Lipjan 3.4 pér qind, Malishevë 2.6 pér qind, Deçan 3.1 pér qind, Gjakovë 4.9 pér qind, Rahovec 2.1 pér qind, Suharekë 2.9 pér qind, Shtimje 1.1 pér qind, Ferizaj 5.4 pér qind, Viti 2.5 pér qind, Kaçanik 1.5 pér qind, Prizren 9.7 pér qind, Dragash 2.5 pér qind dhe Shtërpçë 0.6 pér qind.

³⁶ Anketat janë bërë së paku pesë shtëpi larg njëra-tjetrës në seilën prej zonave të numëruara.

³⁷ Anketa pér matjen e standardit jetësor në vitin 2000 e ka vlerësuar popullatën rurale në 60 pér qind. Për këtë hulumtim, si vendbanim rural është përkufizuar vendbanimi me më pak se 10.000 banorë, dhe urbane është përkufizuar me popullatë prej 10.000 e më shumë banorëve. Në mënyrë më të saktësuar, 45 pér qind e të anketuarve kanë qenë nga fshatrat (të përkufizuar si 1-5.000 banorë), 12 pér qind nga qytetet (5.000 – 10.000 banorë) dhe 43 pér qind nga qytetet më të mëdha (10.000 ose më shumë banorë). Popullata është vlerësuar nga Trimaks kartografija, “Kosova: Hartë Rrugore,” (Prishtinë, Kosovë).

³⁸ Sipas kësaj teknike, anketohet personi me ditëlindjen më të afërt me ditën në të cilën kryhet anketimi.

³⁹ Sipas ligjit, “fëmija” përkufizohet si person nën moshën 18 vjeçare (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), Rregullorja e UNMIK-ut nr. /2003/25, nen. 107, (21)). Ekipi hulumtues me qëllim nuk ka analizuar fëmijët pér shkak të ndjeshmërisë etike të përfshirë dhe trajnimit të domosdoshëm të kërkuar pér hulumtuesit. Megjithëkëtë, informacioni lidhur me dhunën në familje kundër fëmijëve mund të nxjerret nga intervistat e zhvilluara me të rriturit, siç e ilustrojnë pjesët e mëposhtme të këtij raporti.

⁴⁰ Sipas ESK-së, 51.2 pér qind e popullatës në Kosovë janë meshkuj dhe 48.8 pér qind femra (Gratë dhe burrat në Kosovë, 7).

⁴¹ Në relacion me këtë hulumtim, “mbimostër” do të thotë që RRGGK-ja ka anketuar më shumë njerëz nga grupet etnike minoritare se sa përqindja e popullatës që ata e përbëjnë. Për shembull, edhe pse serbët përbëjnë përafërsisht 5.3 pér qind të popullatës së Kosovës, ata kanë qenë të përgjedhur në 7.8 pér qind të mostrave. Sipas ESK-së, në vitin 2006 shqiptarët kanë përbërë përafërsisht 92 pér qind të popullatës, serbët 5.3 percent, romët 1.1 pér qind, 0.4 pér qind turqit dhe 1.2 pér qind të “tjerët” (Ndryshimet demografike të popullatës së Kosovës, 1948-2006).

anekdotat, citatet anonime dhe rekomandimet për qeverinë në një bazë të të dhënave të Microsoft Word ku janë koduar.

E dyta, RRGGK-ja ka përfshirë edhe një ekspert të çështjeve gjinore ligjore për të shqyrtuar ligjet përkatëse, legjislacionin dhe shërbimet sociale në dispozicion në lidhje me dhunën familjare. Ajo ka identifikuar zbrazëtitë ligjore dhe institucionale dhe i ka bërë rekomandimet për ndryshimin e legjislacionit dhe për aktivitetet institucionale me qëllim që më mirë të parandalohet dhuna, të mbrohen viktimat dhe të ndiqen penalisht kryerësit. Ajo, pastaj, ka hartuar pjesë të këtij raporti.

E treta, ekipi hulumtues i RRGGK-së ka intervistuar ose ka dërguar anketat tek 37 përfaqësues të institucioneve, organizatave dhe ekspertëve që merren me çështjen e dhunës në familje, duke filluar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), Departamenti për Mirëqenie Sociale (DMS), Qendrat për Punë Sociale (QPS), Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) Njësia kundër dhunës familjare, Ministria e Drejtësisë, Divizioni i Avokimit të Viktimave dhe i Asistencës (DAVA), Zyra e qarkut për ndihmë juridike, Sekretariati i sistemit gjyqësor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Shoqata e Pensionistëve, Shoqata e Grave të Verbra, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Qendra për Strehim të Grave dhe Fëmijëve, Qendra për Emancipim Social, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Handikosi, Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët, Elysium, Liria, Medica Kosova, Qendra për Rehabilitim të Viktimës së Torturës e Kosovës, Norma, Një për Një, Partnerët Kosova, Shtëpia e Sigurt Gjakova, UNICEF, Vita Jeta, Qendra për Mirëqenie e Grave.

Të gjitha gjetjet e hulumtimit janë përkthyer nga anëtarët e ekipit hulumtues të RRGGK-së nga gjuha shqipe ose serbe në gjuhën angleze. Hulumtuesi kryesor ka përpiluar raportin përfundimtar në gjuhën angleze. Raporti, pastaj, është përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe nga Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ). Në fund, të gjitha institucionet e lartpërmendura kanë patur mundësinë e kontrollimit të gabimeve në raportin përfundimtar dhe të sugjerimit të përmirësimeve. Në fund, ABGJ-ja dhe RRGGK-ja kanë organizuar në Prishtinë një grup fokus gjysmëditor me ekspertët dhe përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe institucioneve për të diskutuar rezultatet e hulumtimit dhe për të qartësuar rekomandimet e Raportit.

3. Kufizimet e hulumtimit

E para, ekipi i hulumtimit ka konstatuar se korniza e shkurtë kohore ka qenë sfiduese. Nëse hulumtuesit do të kishin më shumë kohë, kjo do t'u mundësonte shqyrtim më të hollësishëm të literaturës ekzistuese mbi dhunën në familje në nivel ndërkombëtar dhe formulim më të mirë të pyetjeve dhe rekomandimeve të hulumtimit. Përfaqësuesitë e institucioneve dhe të organizatave, të pyetur lidhur me këtë hulumtim, po ashtu kanë komentuar se më shumë kohë do t'iu mundësonte atyre të përgatisin përgjigje më të hollësishme. Në të ardhmen, organizatave, të cilat zhvillojnë hulumtimin me një fushëveprim ashtu të gjerë dhe me objektiva të shumëfishtë, duhet t'iu jepet më shumë kohë (pra, minimumi prej gjysmë viti deri në një vit).

E dyta, institucionet dhe organizatat ende nuk mbajnë statistika të gjithëmbarshme lidhur me grupet demografike të cilat janë më së shumti të prekura nga dhuna në familje në Kosovë.⁴² Të dhënat e pamjaftueshme e bëjnë të vështrirë përcaktimin e grupit që është më së shumti i rrezikuar ose identifikimin e zonave si shenjestër ose cak të financimit, siç

⁴² Ju lutem, shih kapitullin gjashtë për më shumë informacion lidhur me zbrazëtitë ligjore dhe institucionale të ndërlidhura me mbledhjen e të dhënave, hulumtimin dhe monitorimin e dhunës në familje në Kosovë.

diskutohet më vonë në këtë Raport. Më tej, mungesa e të dhënave të regjistrimit të tashëm të përgjithshëm e bënë gjithë hulumtimin sasior, siç është analiza e dhunës në familje në shtrirje anë e kënd Kosovës, të vështirë për planifikim dhe analizë të saktë.⁴³ Megjithëkëtë, rezultatet e paraqitura këtu janë indikative për të anketuarit e ndryshëm të analizuar dhe për zonat e studiuara gjeografike.

E treta, të dhënrat janë përkthyer nga gjuha shqipe dhe ajo serbe në gjuhën angleze e pastaj sërisht në gjuhën shqipe dhe atë serbe. RRGGK-ja ka shfrytëzuar “kontrollet e pjesëmarrësve” me përfaqësuesit e institucioneve dhe ka hulumtuar nga afër publikimin përfundimtar me qëllim të zvogëlimit të gabimeve nga përkthimi.⁴⁴ Prapëserapë, ekipi hulumtues e pranon se cilio përkthim është problematik ngaqë për disa fjalë të veçanta është vështirë të gjenden kuptimet e sakta në gjuhën tjetër. Ekipi paraprakisht kërkon falje për çfarëdo gabimesh që rezultojnë nga përkthimi.

4. Struktura e Raportit

Ky raport është i ndarë në gjashtë kapituj me pjesë të caktuara brenda këtyre kapitujve. Kapitulli i parë merret me perceptimet e qytetarëve për dhunën në familje, duke shtruar çështjen se çfarë sjelljesh i konsiderojnë qytetarët si keqtrajtuese dhe në çfarë rrethanash. Këto pjesë diskutojnë perceptimet e qytetarëve lidhur me atë se çfarë përbënë 1) dhunë në familje, 2) dhunë midis partnerëve, 3) dhunë kundër fëmijëve dhe 4) dhunë kundër grupeve të tjera (pra, pleqve, personave me nevoja të veçanta fizike ose psikike dhe minoriteteve seksuale). E pesta, i paraqet qëndrimet e qytetarëve ndaj keqtrajtuesve dhe marrëdhënieve keqtrajtuese.

Në kapitullin e dytë shqyrtohen format e ndryshme të dhunës në familje në Kosovë dhe shtrirja e tyre, duke përfshirë izolimin, dhunën psikologjike, dhunën fizike dhe dhunën ekonomike. Duke i nxjerrë të dhënrat nga statistikat ekzistuese dhe nga analizat e RRGGK-së në mbarë Kosovën. Po kështu, në këtë kapitull diskutohen grupet demografike dhe gjeografike më së shumti të prekura nga dhuna si dhe kryerësit e dhunës në familje.

Në kapitullin e tretë analizohen pasojat e dhunës në familje mbi 1) personat që vuajnë nga kjo dhunë, 2) familjet e tyre 3) fëmijët dhe 4) shoqërinë, duke përfshirë institucionet qeveritare.

Në kapitullin e katërt shqyrtohen reagimet e qytetarëve ndaj dhunës në familje, duke përfshirë metodat të cilat ata përdorin për të ndalur dhunën ose për të zvogëluar kushtet në të cilat ndodh ajo. Në kapitullin e pestë shqyrtohen mënyrat specifike se si qytetarët e trajtojnë dhunën në familje. E dyta, ky kapitull paraqet njojuritë e qytetarëve lidhur me programet e asistencës në dispozicion për personat që përfjetojnë dhunën. Kapitulli përfundon me rekondimet e qytetarëve lidhur me atë se si qeveria mund të parandalon dhunën në familje dhe të përmirësojë asistencën për njerëzit që përfjetojnë dhunën.

Kapitulli i pestë ka parasysh kufizimet sociale, të cilat mund t'i deprimojnë grupet e veçanta demografike në sferën publike dhe private, që potencialisht rrisin dhunën në

⁴³ Ngaqë shqiptarët në Kosovë kanë bojkotuar regjistrimin e përgjithshëm të kryer nga Qeveria e Serbisë në vitin 1991, nuk ka pasur regjistrim të përgjithshëm të popullatës që nga viti 1981. Popullata, me gjasë, ka lëvizur dhe ka ndryshuar në masë shumë të madhe që nga ajo kohë. ESK ka filluar përgatitjet për një regjistrim të përgjithshëm të popullatës me mbështetjen teknike dhe financiare të Bashkimit Evropian tri vite më parë, megjithëse data e regjistrimit të përgjithshëm të popullatës ende nuk është përcaktuar.

⁴⁴ “Kontrollet e pjesëmarrësve” i kontribuojnë validitetit, ngaqë të anketuarit i rishkojnë citatet të tyre, dhe saktësisë së rezultateve dhe rekondimeve. Për më shumë informacion lidhur me “kontrollet e pjesëmarrësve” shih M. B. Miles & A. M. Huberman, Analiza e të dhënave cilësore: *Një libër i burimeve të zgjeruara të të dhënave* (Thousand Oaks, CA: Sage, 1994).

familje. Kufizimet shpesh të ndërlidhura sociale, të identifikuara përmes këtij hulumtimi, përfshijnë 1) mungesën e qasjes ndaj arsimit; 2) martesën e hershme dhe kushtet e bashkësisë familjare; 3) rolet diskriminuese gjinore dhe praktikat e punësimit; 4) dhe strukturën e pushtetit brenda familjes.

Në kapitullin e gjashtë dhe të fundit trajtohen zbrazëtitë ligjore dhe institucionale gjatë trajtimit të dhunës në familje dhe paraqiten rekomandimet për përmirësimin e reagimit institucional. Në mënyrë më specifike, ky kapitull hulumton zbrazëtitë ligjore dhe institucionale të lidhura me: 1) mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje; 2) ndjekjen penale të kryerësve; 3) parandalimin e dhunës në familje dhe 4) përmirësimin e reagimit të përgjithshëm të qeverisë ndaj dhunës në familje. Raporti përfundon me rekomandime specifike për përmirësimin e aktiviteteve ligjore dhe të atyre institucionale ndaj dhunës në familje. Rekomandimet janë ndarë sipas agjencive të veçanta që janë përgjegjëse për trajtimin e secilit rekomandim.

Siguria fillon në shtëpi

KAPTULLI 1

PERCEPTIMI I QYTETARËVE LIDHUR ME DHUNËN NË FAMILJE: ÇKA ËSHTË KEQTRAJTIM DHE NË ÇFARË KUSHTESH NDODH?

Të kuptuarit se si qytetarët e përkufizojnë shprehjen “dhunë në familje”, cilat sjellje i konsiderojnë të dhunshme dhe nëse ata mendojnë se dhuna ka gjasë më shumë ose më pak të ndodh ose të jetë “e pranueshme” në rrethana të veçanta është informacion thelbsor për planifikimin e programeve kundrejt parandalimit të dhunës në familje. Më tej, përkufizimi i qytetarëve mund të ndihmojë në shpjegimin se përse dhuna mund të raportohet ose të mos raportohet tek institucionet, si dhe në shpjegimin e traditave ose të besimeve të cilat mund t'i parandalojnë njerëzit nga raportimi i dhunës. Të diturit se cili qytetar nga cili grup demografik ose gjeografik posedon besime të veçanta lidhur me dhunën, mund t'iu ndihmojë institacioneve për të përgatitur përgjigje drejt caqeve të caktuara lidhur me keqkuptimet e dhunës përmes fushatave të ndërgjegjësimit.

Ky kapitull bazohet në anketën e RRGGK-së në nivel të Kosovës të 1.256 qytetarëve me qëllim të diskutimit se cilat janë ato sjellje që qytetarët besojnë se përbëjnë “dhunën në familje”. Së dyti, në këtë kapitull shqyrtohen perceptimet e qytetarëve lidhur me dhunën midis partnerëve, duke përfshirë situatat në të cilat dhuna mund të konsiderohet të jetë ose të mos jetë e pranueshme. Së treti, përmes këtij kapitulli hulumtohen perceptimet e qytetarëve lidhur me dhunën kundër fëmijëve, si dhe faktin se çka është ajo që ata besojnë se e përbënë dhunën kundër fëmijëve. Së katërti, hulumton perceptimet e qytetarëve lidhur me dhunën kundër grupeve të tjera të veçanta. Së fundi, në këtë kapitull diskutohen qëndrimet e qytetarëve lidhur me keqtrajtuesit dhe marrëdhëni të keqtrajtuese. Përgjithësisht ky kapitull i shkurtër është bazë për kapitullin tjeter, përmes të cilit shqyrtohet shkalla e gjithëmbarashme e dhunës në familje në Kosovë.


1. Perceptimi i qytetarëve lidhur me atë se çka e përbënë “dhunën në familje”

Grafiku 1.1 në mënyrë të përbledhur paraqet nëse të anketuarit konsiderojnë se ndërveprimet e ndryshme “të cilat mund të ndodhin në familje” paraqesin dhunën. Më shumë se 90 për qind e të anketuarve kanë trajtuar si dhunë në familje ndërveprimet e mëposhtme: kërcënimin për lëndim të anëtarit tjeter të familjes; prekjen e anëtarit të familjes në një mënyrë seksuale pa pëlqimin e personit; shkatërrimin e orëndive ose thyerjen e enëve me qëllim; goditja me shuplakë, grushtimi apo shqelmosja nga i rrituri e anëtarit tjeter të familjes kur ata grinden. Më shumë se 85 për qind e të anketuarve kanë thënë se detyrimi i partnerit nga ana e partnerit tjeter të tij ose të saj për të bërë veprime seksuale, të cilat ai ose ajo nuk dëshiron t'i bëjë, dhe dënimini i fëmijës me rrahje me anë të rripit ose me shkop janë forma të dhunës. Përafërsisht 78 për qind e të anketuarve kanë thënë se të drejtuarit në mënyrë fyeze anëtarëve të familjes, sharja e ndonjë anëtarit të familjes dhe moslejimi i anëtarit të familjes për të punuar jashtë shtëpisë ka qenë një formë e dhunës. Afërsisht një e katërtë e të anketuarve nuk e kanë konsideruar dhunë “të qenë

i/e pabesë ose mashtrues ndaj partnerit". Duke ilustruar percepcionin e zakonshëm se tradhtia bashkëshortore nuk është dhunë, një grua ka komentuar se ajo ka kërkuar shkurorëzimin jo për shkak të dhunës familjare, por për arsyen se ajo ka zbuluar se burri i saj po e mashtonte atë.¹

Më shumë se 70 për qind e të anketuarve kanë thënë se në dhunë janë përfshirë një anëtar familjeje që ka pasur para e i cili ka refuzuar t'i jap paratë një anëtar tjetër të familjes që është në nevojë për to dhe sjelljen e vendimeve për një anëtar tjetër të familjes pa e pyetur atë. Më shumë se 30 për qind e të anketuarve *nuk* do t'i konsideronin format e mëposhtme të ndërveprimeve si dhunë: moslejimin e anëtarit të familjes për të parë shokët ose shoqet apo të afërmit; të kritikuarit e një anëtarit të familjes gjatë gjithë kohës; partnerin i cili është së tepërmë xheloz ose dënimin e fëmijës duke e shuplakosur atë. Po ashtu, 48.2 për qind nuk e konsiderojnë kontrollimin se ku anëtarët e familjes mund të shkojnë ose të mos shkojnë si formë të dhunës. Derisa mendimi i grave dhe i burrave nuk dallon jashtëzakonisht shumë, më shumë gra se sa burra kanë qenë të prirura të konsiderojnë shumicën e këtyre ndërveprimeve si dhunë.

¹ Grua shqiptare, e shkurorëzuar, mosha 26-35 nga komuna e Kamenicës.




2. Dhuna midis partnerëve

Derisa shumica e të anketuarve (74.9 për qind) nuk është pajtuar me deklarimin se "Ndonjëherë është në rregull që burri të godas gruan e tij," përafërsisht 20 për qind e të anketuarve janë "pajtuar" ose "deri diku" janë pajtuar me këtë (shih grafikun 1.2). Të anketuarat gra, të anketuarit nga viset rurale, romët, ashkanalitë dhe egjiptasit pak kanë qenë më të prirur për t'u pajtuar me këtë deklaram. Një grua ka komentuar se "Nga dita e parë që jam martuar, jam grindur me burrin tim ... por është në rregull që gratë janë të nënçmuara dhe të rrahura nga burrat e tyre për arsy se nuk është diçka e pazakonshme."² Një grua tjetër ka thënë se "Ti, si grua, duhet të kuptosh burrin tënd. Ndonjëherë burrat

² Grua shqiptare, mosha 56-65, komuna e Gjakovës.

kanë probleme të mëdha dhe si grua ti nuk duhet ta bësh më shumë nervoz [të hidhëruar], por duhet të përpinqesh ta kuptosh atë.”³ Perceptimet mund të ndryshojnë ngaqë të anketuarit e moshës 45 vjeçare e sipër kanë qenë të prirur të pajtohen, derisa të anketuarit më të ri dhe njerëzit me nivele të larta të shkollimit kanë qenë të prirur për të mos u pajtuar.



Më shumë se një e treta e të anketuarve kanë besuar se “është e natyrshme që dhuna fizike të ndodh nganjëherë kur çifti grindet.” Pak më shumë gra dhe persona me të hyra më të ulëta janë pajtuar me këtë deklarim, derisa të anketuarit nga mjediset urbane dhe personat me diplomë universitare kanë qenë të prirur për të mos u pajtuar.⁴ Për shembull, një grua ka komentuar se “Nëse unë nuk e dëgjoj burrin tim ose kam sjellje të keqe, është normale të më rrah mua.”⁵ Shumë të anketuar kanë besuar se dhuna në familje është “e natyrshme” ose se “duhet të ndodh nganjëherë” nëse ndodh pasi dikush ka pirë alkool (43 për qind)⁶ ose për arsy se burri është i papunë (62.4 për qind). Një burrë ka deklaruar se “Gratë gjithmonë janë përgjegjëse për dhunën për arsy se se në ditët e sotme ato kanë liri të jashtëzakonshme dhe kanë kërkesa të skajshme dhe, së këndejmi, kur burri nuk mund t’i përbashkët e tyre për shkak të papunësisë, ai duhet t’a rrah gruan e vet.”⁷ Njerëzit e zonave rurale, me më pak se sa niveli universitar i arsimimit ose me nivel të

³ Grua shqiptare, moshë 36-45, komuna e Vushtrrisë.


⁴ Përafërsisht 37 për qind e të gjitha grave të anketuara janë pajtuar, krahasuar me 34 për qind të të gjithë meshkujve të anketuar. Në këtë korelacion, të hyra të ulëta do të thotë më pak se 800 euro të hyra totale për një bashkësi familjare nga të gjitha burimet në tre muaj.

⁵ Grua shqiptare, moshë 36-45 nga komuna e Pejës.

⁶ Njerëzit me nivel më të ulët të të hyrave ishin të prirur për t’u pajtuar. Pos nëse janë deklaruar ndryshtë, “të hyra të ulëta” do të thotë të hyra të bashkësisë familjare të respondentit nga të gjitha burimet, totali i të cilave është më pak se 600 euro në tre muaj.

⁷ Një shqiptar në moshë të mesme nga komuna e Mitrovicës. Ai i ka thënë hulumtuesit se është martuar me një grua serbe dhe më vonë e ka rrahur atë derisa policia nuk e ka arrestuar.

ulët të të hyrave kanë qenë të prirur më shumë ta kenë këtë percepccion se sa të tjerët. Njerëzit nga komunat e Obiliqit, Klinës dhe Malishevës po ashtu ishin të prirur të pajtohen se dhuna ndodh kur burrat janë të papunësuar, që e ilustron nevojën për ngritje të vetëdijes në këto zona lidhur me teknikat e zgjidhjes paqësore të mospajtimeve.



Dhuna seksuale është e prirur të mos njihet si dhunë familjare nëse ajo ndodh midis partnerëve që bashkëjetojnë. Siç shihet në grafiku 1.3, dy të tretat e të anketuarve janë pajtuar me deklarimin se "Marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse ndodh midis dy të rriturve të martuar," ndërsa një përqindje plotësuese prej 5.7 e të anketuarve nuk dinin si të përgjigjeshin.⁸ Intervistat e RRGGK-së me institucionet po ashtu kanë treguar se disa shërbyses civilë nuk e konsiderojnë dhunën seksuale si formë të dhunës kur ajo ndodh në kuadër të marrëdhënie familjare, edhe pse kjo është përkufizuar qartazi në Kodin Penal. Për shembull, një përkrahëse e e viktimave të dhunës i ka thënë RRGGK-së "Këtu në Kosovë, kjo është një çështje e ndjeshme për arsy se ju nuk mund të thoni se kjo (detyrimi i partnerit për të pasur marrëdhënie seksuale edhe pse ajo nuk e dëshiron këtë) është dhunë. Për arsy se kur ndodh brenda një çifti martesor, kjo tashmë nuk është dhunë... Në atë moment që akti seksual fillon, kjo nuk është dhunë, por dashuri."⁹ Duket qartë se janë të nevojshme fushatat e arsimimit lidhur me dhunimin martesor dhe dhunën seksuale midis partnerëve.¹⁰

3. Dhuna kundër fëmijëve

Pothuajse të gjithë të anketuarit janë pajtuar se "Fëmijët kanë nevojë të disiplinohen", por ata nuk janë pajtuar lidhur me atë se çfarë metodash duhet të shfrytëzohen. Përafërsisht

⁸ Të anketuarit në Prishtinë, Pejë dhe Prizren kanë qenë të prirur të mos pajtohen, me gjasë për shkak të fushatave të informacionit në këto zona.

⁹ Intervistë e RRGGK për *Hulumtimin kërkimor*, 2007.


¹⁰ Kapitulli gjashtë elaboron lidhur me këtë çështje.

gjysma e të anketuarve, më shumë gra se sa burra, janë pajtuar se “nganjëherë fëmija ka nevojë të rrihet me shuplaka (shih grafikun 1.4).”¹¹

Të anketuarit e papunë,¹² që jetonin në zona rurale, kanë pasur më shumë se katër anëtarë në bashkësinë e tyre familjare dhe/ose nën moshën 45 vjeçare ishin më të prirë për t'u pajtuar.¹³ Për të ilustruar perceptimet që i kontribuojnë diskriminimit në baza gjinore kundër djemve dhe vajzave, 41 për qind e grave dhe e burrave të anketuar kanë besuar se “djemptë duhet të kenë një disiplinë më të rreptë se sa vajzat për arsyet se kjo i bënë ata të fortë (grafiku 1.5)”, derisa 47.2 për qind ka thënë se “Vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë se sa djemptë në mënyrë që të jenë moralisht në rregull” (grafiku 1.6). Një përqindje pak më e vogël e grave të anketuara kanë besuar se vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë.¹⁴ Njerëzit të cilët ishin të papunë, që kishin arsimim më pak se nivel universitar, e që ishin nga Prizreni ose Peja dhe që ishin shqiptarë ishin të prirur të pajtohesin me deklarimin e parë. Njerëzit rural, të varfër dhe më pak të arsimuar ishin të prirur të pajtohen me deklarimin e dytë.¹⁵

Grafiku 1.4 Nganjehere femijes duhet t'i jepet ndonje shuplake

■ Te anketuarat femra ■ Te anketuarit meshkuj ■ te anketuarit femra dhe meshkuj



¹¹ Më shumë se gjysma e të anketuarave gra (53.4 për qind) janë pajtuar, derisa 40.1 për qind e burrave janë pajtuar.


¹² Të gjithë të anketuarit me të hyra totale të amvisërisë më pak se 700 euro në tre muaj nuk janë pajtuar.

¹³ Të anketuarit burra - shqiptarë, serbë- që kanë pasur arsimim më të lartë se sa shkolla e mesme dhe/ose me të hyra të ulëta kanë qenë të prirur për t'u pajtuar se shuplakosja është një formë e dhunës, ndërsa të anketuarit nën moshën 35 vjeçare kanë qenë të prirur të besojnë se rrëhja me rrip ose me shkop është dhunë. Boshnjakët kanë qenë më pak të prirur për ta konsideruar atë si dhunë.


¹⁴ Në mesin e të gjitha grave të anketuara, 49.2 për qind janë pajtuar, krahasuar me 45.1 për qind të të gjithë burrave.

¹⁵ Më pak se shkollimi i mesëm.

Grafiku 1.5 Djemte duhet te kene discipline me te rrepte se sa vajzat sesep kjo i ben ata me te forte



Grafiku 1.6 Vajzat kane nevoje per me shume discipline per te qene moralisht ne rregull



4. Format e perceptuara të dhunës kundër grupeve të tjera

Sipas traditës, gratë e reja dhe gratë rishtazi të martuara marrin shumicën e përgjegjësive në bashkësinë familjare lidhur me përgatitjen e ushqimit dhe të pastrimin. Roli i tyre i pabarabartë në familje mund të konsiderohet një formë e diskriminimit dhe, në disa rrethana, edhe dhunë. Prapëseprapë, pak më pak se dy të tretat e të anketuarve janë pajtuar se “nga gratë e reja - nuset, pritet të kenë më shumë përgjegjësi për pastrimin dhe përgatitjen e ushqimit se sa nga anëtarët e tjerë të familjes.” Njerëzit që jetojnë në zonat rurale, (posaçërisht në komunat e Glogovcit, Skenderajt dhe të Fushë Kosovës), me nivel më

të ulët se sa ai universitar, dhe/ose me të hyra të ulëta kanë qenë të prirur të pajtohen.¹⁶ Është interesant të ceket se gratë kanë qenë të prirura të pajtohen më shumë me këtë deklarim se sa burrat, që tregon se gratë mund të zbatojnë praktika të mentalitetit diskriminatorek kundër grave të tjera.¹⁷ Njerëzit nën moshën 45 vjeçare kanë qenë të prirur të mos pajtohen, që tregon se perceptimet mund të ndryshojnë në mesin e brezave të ri.

Me relativisht pak shtëpi në dispozicion ose që mund të sigurohen për moshuarit në Kosovë dhe në pajtim me përbërjen tradicionale të njësive familjare, pleqtë janë të prirur të jetojnë me fëmijët e tyre ose me të afërmit e tjerë. Përafërsisht 40 për qind e të anketuarve kanë konsideruar të moshuarit barrë të familjes (36.8 për qind të femrave krahasuar me 39.9 për qind të meshkujve). Në mënyrë të pikëllueshme, të anketuarit e moshuar kanë qenë të prirur të pajtohen me këtë deklarim më shumë se sa të rinjtë.¹⁸ Nevojitet hulumtim i mëtejshmë lidhur me perceptimet e qytetarëve që kanë për të moshuarit.

Edhepse 87.2 për qind e të anketuarve nuk u pajtuan me këtë deklarimin se "Personat e hendikepuar duhet të rrinë brenda shtëpisë të tyre për arsy se ata e turpërojnë familjen", 9.1 për qind janë pajtuar me këtë.¹⁹ Gratë kanë qenë më të prirura për t'u pajtuar se sa burrat.²⁰ Po ashtu, njerëzit në zonat rurale dhe/ose me të hyra të ulëta kanë qenë më të prirur për t'u pajtuar. Përgjigjet e tyre mund të tregojnë se personat me aftësi të kufizuara janë të izoluar brenda familjeve të tyre, një çështje kjo që trajtohet më tej në kapitullin në vijim. Më shumë se gjysma e të anketuarve *nuk* kanë konsideruar se të ndihmuarit e një personi me aftësi të kufizuara për të vendosur se me kënd të martohet" është një formë e dhunës. Ky perceptim është brengosës ngaqë aktivistët kanë raportuar raste të personave me paaftësoi fizike dhe mendore që kanë qenë të detyruar të martohen kundër vullnetit të tyre, siç e ilustron kapitulli në vijim.

5. Qëndrimet e qytetarëve ndaj keqtrajtuesve dhe marrëdhënieve keqtrajtuese

Shumica e të anketuarve, 82.1 për qind e tyre, janë pajtuar se "nëse fqinjët e marrin vesh se një familje ka dhunë që ndodh brendapërbrenda saj, ata do ta konsideronin këtë të turpshme" (grafiku 1.7). Njerëzit me të hyra të ulëta dhe/ose të anketuarit turq kanë qenë të prirur të pajtohen me këtë më shumë se të tjerët.²¹ Shumica e të anketuarve (93 për qind) po ashtu janë pajtuar se "cilio burrë i cili godet gruan e tij duhet të turpërohet nga vetja e tij." Këto përgjigje tregojnë së pari se dhuna familjare përgjithësisht konsiderohet e turpshme ose moralisht e gabueshme dhe, e dyta, se njerëzit, së këndejmi, mund të mos jenë të prirur në raportimin e dhunës që ndodh brenda familjeve të tyre, për arsy se ata nuk dëshirojnë të janë të turpëruar në shoqërinë e fqinjëve të tyre.

¹⁶ Korrelacioni me të hyrat e ulëta ka qenë 800 euro ose më pak të totalit të ekonomisë familjare në tre muaj.

¹⁷ Përafërsisht 70 për qind e të gjitha grave janë pajtuar me këtë deklarim, krahasuar me 64 për qind të të gjithë meshkujve.


¹⁸ Njerëzit me më pak se arsimimi fillor po ashtu kanë qenë të prirur të pajtohen. Njerëzit nga Peja dhe Prishtina kanë qenë të prirur të mos pajto.

¹⁹ Tre për qind e të anketuarve janë përgjegjur "nuk e di".

²⁰ Përafërsisht 11 për qind e grave janë pajtuar krahasuar me 7.4 për qind të meshkujve.


²¹ Njerëzit në Pejë dhe Mitrovicë kanë qenë të prirur të mos pajtohen me këtë deklarim.

Grafiku 1.7 Nese fqinjet do ta dinin se po ndodh dhune ne nje familje, ata do ta konsideronina ate si te turpshme




Është me rëndësi të ceket se 38.9 për qind e të anketuarve janë pajtuar se “Dhuna është pjesë normale e cilësdo marrëdhënie dhe shoqëria, në përgjithësi, e pranon se dhuna ndodh nganjëherë” (grafiku 1.8). Dyzet e një për qind të burrave janë pajtuar me këtë deklarim, krahasuar me 37 për qind të grave. Njerëzit në zonat rurale dhe/ose me të hyra shumë të ulëta kanë qenë të prirur të pajtohen me këtë.²² Nëse qytetarët e konsiderojnë dhunën si diçka “normale”, atëherë ata mund të mos jenë të prirur për ta raportuar atë, gjë që pjesërisht mund të shpjegojë përsë dhuna është pak e raportuar.

Grafiku 1.8 Dhuna eshte pjesë normale e cdo marredhenieje, dhe shoqeria ne per gjithesi pranon se dhuna ndodh ndonjehere



²² Korrelacioni ka qenë me të anketuarit, totali i ekonomisë familjare të cilëve ka qenë më pak se 400 euro në tre muaj.

Prapëserapë, 91.6 për qind e të anketuarve kanë besuar se “kryerësit e dhunës në familje janë fajtor dhe se duhet të dënohen sipas ligjit.” Njerëzit nga zonat rurale dhe/ose të papunët kanë qenë pak më shumë të prirur për të mos u pajtuar me këtë deklarim, derisa njerëzit nga Peja dhe Prishtina në veçanti kanë qenë të prirur të pajtohen. Me gjasë kjo mund t’i atribuohet pjesërisht fushatave të shumta të ndërgjegjësimit të udhëhequra nga OJQ-të në këto dy qytete. Çuditërisht, 60 për qind e të anketuarve kanë besuar se “Nëse ekziston dhuna brenda një familjeje, gruaja duhet të shkojë në një strehimore ose te familja e saj, derisa burri duhet të rrijë në shtëpi derisa çështja të mos zgjidhet” (grafiku 1.9). Deklarimi i dytë duket se i kundërvihet besimit gjërësisht të përqafuar se kryerësit e dhunës duhet të dënohen. Në të njëjtën kohë, ai ilustron supozimin e zakonshëm se prona duhet të kontrollohet nga burri, praktikë kjo e zakonshme diskriminuese në Kosovë që shkel ligjin ekzistues të familjes.²³



Në përfundim, qytetarët, përgjithësisht, ende e konsiderojnë dhunën në familje të turpshme, që mund të ketë kuptimin se njerëzit nuk janë të prirur për ta raportuar atë. Derisa shumica e njerëzve besojnë se keqtrajtuesit duhet të dënohen, shumë të tjerë, në të njëjtën kohë, mendojnë se dhuna në familje është pjesë normale e cilësdo marrëdhënie, e pranuar nga shoqëria, dhe se alkoolizmi dhe papunësia në veçanti e arsyetojnë dhunën. Njerëzve posaçërisht iu ka munguar njohuria për dhunimin martesor dhe dhunën seksuale midis partnerëve. Përpjekjet e ndërgjegjësimit duhet të zhveshin mitet e tillë, duke pasur në shënjestër njerëzit në zonat rurale, me nivele më të ulëta të arsimimit, të papunët dhe, posaçërisht, të varfrit.

²³ Çështja e posedimit të pronës diskutohet më tej në kapitullin e pestë.

KAPITULLI 2

PËRHAPJA DHE FORMAT KRYESORE TË DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË

Ngaqë individët e ndryshëm janë të prirur në mënyra të ndryshme të përkufizojnë dhunën në familje, siç e ka ilustruar kapitulli i fundit, RRGGK-ja e ka bazuar përkufizimin e saj lidhur me atë se çfarë e përbënë dhunën familjare në ligjin ekzistues në Kosovë, duke përfshirë Kodin Penal, Ligjin mbi qetësinë dhe rendin publik dhe Rregulloren mbi dhunën në familje.¹ Duke shfrytëzuar përkufizimet e tillë si orientim, në këtë kapitull shqyrtohet përhapja e secilës formë të dhunës bazuar në statistikat ekzistuese, hulumtimet e mëhershme dhe në anketën mbarëkosovare të RRGGK-së. Ky kapitull në fillim siguron një vështrim të përgjithshëm mbi përmasën e dhunës në familje në Kosovë. Pastaj hulumton përhapjen e formave kryesore të dhunës në Kosovë, duke përfshirë izolinin, (pjesa e dytë), dhunën psikologjike (pjesa e tretë), dhunën fizike (pjesa e katërt), dhunën seksuale (pjesa e pestë) dhe dhunën ekonomike (pjesa e gjashtë). Në këtë kapitull pastaj shtjellohet se cili grup demografik ka qenë më së shumti i prekur nga dhuna në familje (pjesa e shtatë) dhe cilët persona janë më së shumti të prirur për të kryer dhunë në familje (pjesa e tetë). Të kuptuarit e përhapjes së formave të ndryshme të dhunës, e grupeve demografike më së shumti të prekura nga dhuna, si dhe e kryerësve më të prirur të dhunës mund të jetë i dobishëm në planifikimin e programeve të parandalimit dhe të mbrojtjes më të fokusuar të viktimateve dhe në ndjekjen penale të kryerësve të dhunës.

1. Vështrim i përgjithshëm i dhunës në familje në Kosovë

Tabela 2.1 tregon numrin e rasteve të dhunës në familje të raportuar tek institucionet dhe organizatat për çdo vit. SHPK-ja ka regjistruar shumicën e rasteve: 7.660 raste që nga viti 2002.² Institucionet e tjera kanë regjistruar më pak raste për arsy se jo të gjitha viktimat kanë marrë ndihmën nga DAVA dhe DMS. Institucionet shëndetësore ende nuk kanë regjistruar numrin e pacientëve, të cilët tregojnë simptoma të dhunës në familje.³ Sidoqoftë, gjatë intervistave të zhvilluara në vitin 2007 me RRGGK-në, 13 gjinekologë kanë thënë se ata kanë parë përafërsisht prej 819 deri në 1.372 raste të dhunës në familje gjatë praktikës së tyre. Vetëm pesë gjinekologë nuk kanë parë asnjëherë një grua e cila ka përjetuar dhunën në familje.⁴

¹ Shih hyrjen dhe kapitullin gjashtë për më shumë informacion lidhur me këto ligje.

² Të dhënat nga vitet 2002-2004 nga SHPK, "Paraqitura tabelore e punës në gjashëmujorin e parë / 2007" e dhënë te RRGGK-ja në vjeshtë të vitit 2007. Vitet 2005-2007 nga SHPK-ja, analizë e RRGGK-ja, qershor, 2008.

³ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 17.

⁴ Po aty.

Tabela 2.1. Numri i rasteve të dhunës në familje të reportuara sipas viteve dhe sipas burimeve të ndryshme⁵

Burimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Totali
SHPK			1273	1251	1318	1370	1371	1077		7660
DAVA ⁶				314	414	592	703	645	(qer.) 252	2920
MPMS/DMS ⁷					223	380	438	170	(qer.) 92	1303
QMFG	1886	2425	1485	2259						8055

Marrë së bashku, tabela e ilustron se të gjitha institucionet kanë treguar një rritje të qëndrueshme në numrin e raportimeve të dhunës në familje deri në vitin 2007, kur numri i raportimeve bie. Megjithëkëtë, të dhënrat statistikore të mbledhura nga institucionet nuk duhet të interpretohen si ilustruese të përmasës së gjithëmbarshme të dhunës në familje në Kosovë. Ngaqë të gjitha rastet nuk janë të reportuara në institacione, një rritje ose rënje në *numrin e raporteve* nuk do të thotë domosdoshmërisht se dhuna në familje është rritur ose është zvogëluar në shoqëri. Për shembull, një rritje në raportim me gjasë mund t'i atribuohet fushatave të ndërgjegjësimit, që i kanë inkurajuar njerëzit të lironë nga situatat e dhunës, shpalljes së legjislacionit të duhur kundër dhunës në familje ose krijimit të mekanizmave mbrojtës dhe të asistencës për viktimat të cilat i kanë bërë ata të ndjehen më të sigurt lidhur me raportimin e dhunës. Kjo nuk do të thotë *më shumë raste* të dhunës në familje, por më parë ka kuptimin se *më shumë njerëz e raportojnë atë*. Siç e ka komentuar një zyrtare e SHPK-së "Dhuna në familje po ashtu ka ndodhur në të kaluarën, por është trajtuar më shumë si çështje private se sa si një vepër penale."⁸ Ajo duket se besonte që situata ishte në ndryshim e sipër dhe se më shumë njerëz vinin për të reportuar dhunën.

Sidoqoftë, përfaqësuesit e OJQ-ve dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës besojnë se dhuna në familje vazhdon të mos jetë e reportuar plotësisht tek institucionet.⁹ Një aktivist ia ka atribuuar rënien e numrit të raportimeve të dhunës në familje në vitin 2007 mungesës së përgjegjës institucionale ndaj ankesave të përparshme; fakti se aq shumë raportime të dhunës ende ishin të pazgjidhura nga sistemi i drejtësisë¹⁰ i ka zmbrapsur njerëzit nga raportimi i dhunës, ngaqë nuk kanë besuar se nga kjo mund të ketë ndonjë të mirë.¹¹ Siç e ka ilustruar kapitulli i fundit, shumë qytetarë ende e konsiderojnë dhunën familjare të turpshme dhe çështja ende diskutohet rrallë në

"Shumë shpesh ato nuk konsiderojnë se janë viktima të dhunës familjare ... Ose vetëm për shkak të turpit nuk e deklarojnë dhunën."

– Një grua serbe, mosha prej 46-55, Shtërpce

⁵ Ngaqë institucionet shpesh ndihmojnë të njëjtit njerëz, totalitet nga të gjitha institucionet nuk duhet të shtohen së bashku.

⁶ Meqë njësia është themeluar në vitin 2002, të dhënrat statistikore janë në dispozicion vetëm nga viti 2003 (DAVA, anketa e RRGGK-së, qershor 2008).

⁷ MPMS/DMS, anketa e RRGGK-së, qershor 2008.

⁸ Anketë e SHPK-së, RRGGK-së, qershor, 2008.

⁹ Shih, OSBE dhe Doracaku për shërbime sociale i MPMS, *Raport vjetor 2002* Prishtinë: QMFG, 2003).

¹⁰ Shih kapitullin e gjashtë përmë shumë informacion lidhur me zvarritjen në përpunimin e raporteve të dhunës në familje

¹¹ Koment i bërë një përfaqësuesi/e të RRGGK-së, 2008.

sferën publike.¹² Hulumtimi i mëhershëm ka sugjeruar se raportimi i pjesërishëm mund të jetë rezultat i qëndrimit kulturor i cili dhunën e konsideron çështje private;¹³ i rrugëve jozyrtare të zgjidhjes së mospajtimeve;¹⁴ hezitimit në mesin e personelit të institucioneve për të intervenuar në mosmarrëveshjet private dhe përpjekjes së grave për të shmanjur *turpin* personal ose familjar".¹⁵ Gratë po ashtu mund të hezitojnë për të raportuar dhunën pér arsy se ato i shtrohen rrezikut nga hakmarrja nga kryerësit e dhunës, humbja e fëmijëve të tyre dhe mbetja e tyre tek anëtarët e tjerë të familjes¹⁶, si dhe përzënia nga shtëpitë e tyre. Disa njerëz janë të pavetëdijshëm se jeta pa dhunë është e mundshme dhe e perceptojnë dhunën si pjesë normale të cilësdo marrëdhënie.¹⁷

Gjatë anketës së saj në mbarë Kosovën, RRGGK-ja ka gjetur dëshmi se shumë kosovarë nuk e raportojnë ose nuk do ta raportonin dhunën në familje. Afërsisht 40 pér qind e të anketuarve, të cilët kanë pérjetuar dhunën, kanë thënë se askujt nuk i kanë treguar pér të. Derisa përafërsisht 40 pér qind i ka treguar pér të anëtarit tjetër të familjes dhe 16.7 pér qind një miku, vetëm pak prej tyre i kanë treguar policisë, psikologëve ose psikiatërve. Pesëmbëdhjetë pér qind e të gjithë të anketuarve kanë thënë se nëse dhuna do t'i ndodhte atyre, ata kurrë nuk do ta raportonin atë.¹⁸ Rastet e paraportuara asnijëherë nuk janë dokumentuar nga institucionet, që rezulton në raportimin e pjesërishëm të përmasës së gjithëmbarshme të dhunës në Kosovë.

Duke pasur parasysh raportimin e pjesërishëm tek institucionet, hulumtuesit kanë vlerësuar mbizotërimin e dhunës në familje. Tabela 2.2 krahason rezultatet e hulumtimit të tyre.

¹² Renate Weber dhe Nicole Watson, ed., *Gruaja 2000: Një hulumtim lidhur me statusin e të drejtave të grave në Evropën Qendrore dhe Juglindore* dhe në shtetet së voni të pavarura (Vjenë:Federata Ndërkombëtare e Helsinkit, 2000), 515 dhe QMGF, *Raport vjetor 2002*, 19. Të anketuarit e anketës së Medica Mondiale Kosova kanë thënë se diskutimi i dhunës kundër grave ka qenë tabu, por megjithëkëtë ata dëshironin që çështja të diskutohet në mënyrë më publike (Medica Mondiale Kosova nga Flutura Zajmi, *Stop dhunës: Rezultatet e një ankete të bërrë në Gjakovë*, Medica Mondiale Kosova, 2000).

¹³ QMGF, *Raport vjetor 2003*, 22.

¹⁴ Fondi i fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF), *Analizë e situatës së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (Kosovë: UNICEF, 2004), 70.

¹⁵ QMGF, *Raport vjetor 2003*, 27 dhe Fondi pér Zhvillim pér Gratë i Kombeve të Bashkuara (UNIFEM) nga Rachel Wareham, *Pa vend të sigurt: Një vlerësim mbi dhunën kundër grave në Kosovë* (Prishtinë: UNIFEM, 2000), 44.

¹⁶ UNICEF, *Analizë e situatës*, 70. UNICEF-i ka raportuar se "Në situatat kur një nënë përcaktohet pér të braktisur një marrëdhënie keqtrajtuese, ekziston gjasa e madhe se ajo do ta humb qasjen ndaj fëmijëve të saj të cilët do të mbeten përgjegjësi e familjes së babait."

¹⁷ QMGF, *Raport vjetor 2003*.

¹⁸ Më shumë se gjysma e 51 grave të intervistuara pér *Hulumtimin kërkimor* të RRGGK nuk i kanë raportuar përfjetimet e tyre më të fundit të dhunës në polici.

Tabela 2.2 Vlerësimet e shkallës së dhunës në familje në Kosovë nga burime të ndryshme

Burimi	Mostra	Viti	Shkalla
QMGF	Të gjithë klientët anë e kënd Kosovës, të cilëve u është dhënë ndihma psikologjike ose fizike nga QMGF(n=6437)	1995-2000	47.6%
QMG Hulumtim	Përqindja e të gjitha grave që kanë raportuar përjetimin e dhunës familjare (n=226)	1997-1998	36% ¹⁹
Medica Kosova	Analizë në komunën e Gjakovës (përqindja e mostrave që kanë përjetuar dhunën në familjet e tyre) (n=440)	2000	21%
Medica Kosova	Analizë në komunën e Gjakovës (përqindja e mostrave që e njohin një grua e cila e ka përjetuar dhunën në familjen e saj) (n=440)	2000	28%
UNIFEM	Të anketuarit shqiptarë në Kosovë të analizuar anë e kënd Kosovës (n=216)	2000	23%
QMG	Përqindja e të gjitha grave me partnerë që kanë raportuar përjetimin e dhunës në familje (n=212)	2001 - 2002	34%
Zëri i Grave Voice of Women	Analizë anë e kënd Kosovës që paraqet grupet e ndryshme etnike, respondentët që kanë parë ose dëgjuar grindje ose dhunë në rrethinën e tyre (n=1338)	2004	46%
Zëri i Grave Voice of Women	Anketa anë e kënd Kosovës që paraqet grupet e ndryshme etnike – të anketuarit që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje (n=1338)	2004	12%

Burimi: RRGGK, Hulumtim shpjegues mbi shkallën e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimin e saj në shëndetin riprodhues të grave, 2008.

Nga viti 1995 deri në vitin 2000, QMGF-ja raportoi se pak më pak se gjysma e klientëve, të cilëve u është dhënë ndihma kanë përjetuar dhunën në familje.²⁰ Ndoshta kjo nuk është befasuese, ngaqë QMGF kryesisht është marrur me gratë dhe fëmijët që e përjetojnë dhunën nga anëtarët e familjes dhe/ose nga forcat serbe. Menjëherë pas luftës, UNIFEM-i ka intervistuar 213 gra shqiptare në Kosovë dhe 23 për qind prej tyre kanë përjetuar dhunën në familje.²¹ Po ashtu, në vitin 2000, studimi i Medica Mondiale Kosova i zhvilluar në komunën e Gjakovës ka treguar se 21 përqind e të anketuarve kanë përjetuar dhunën në familje dhe 28 për qind e kanë njohur gruan që ka përjetuar dhunën.²² Pas një ankete të 500 të anketuarve meshkuj dhe gra në Ferizaj në po atë vit, organizata e grave “Afrodita” ka konstatuar se 39 për qind janë pajtuar me deklarimin se “burrat rrahin gratë

¹⁹ Qendra për Mirëqenie e Grave (QMG), Mbizotërimi i dhunës në baza gjinore: Rezultatet preliminare nga një vlerësim në terren në nëntë fshatra të rajonit të Pejës, Kosovë, (Pejë: QMG, 2006), 6.

²⁰ QMGF ka intervistuar 6.437 klientë anë e kënd Kosovës midis viteve 1995 dhe 2000; 68 për qind kanë përjetuar një formë të dhunës, dhe 70 për qind e tyre kanë thënë se kryerësi i dhunës ishte anëtar i familjes së tyre (*Harta sociale mbi gruan e Kosovës 1995-2000 Interpretimi sociologjike*, Prishtinë: QMGF, 2004). QMGF ka sugjeruar se 70 për qind e 680 grave, të cilat kanë përjetuar dhunën gjatë luftës, kanë qenë shënjestra të anëtarëve të familjes.

²¹ UNIFEM, *Pa një vend të sigurt* 15. OSBE dhe MPMS kanë vlerësuar se vlerësimi i UNIFEM-it ka qenë një “vlerësim konservativ” “ngaçë Kosova nuk e kishte të krijuar kulturën e reportimit” (79).


²² Pothuajse 10 për qind kanë përjetuar dhunën fizike në familje, 5 për qind dhunën seksuale dhe 117 njerëz dhunën psikologjike. Medica ka besuar se të anketuarit mund të mos e kenë zbuluar përjetimin e dhunës si rezultat i frikës “së rrënjosur thellë” nga të folurit hapur lidhur me dhunën në familje. Rezultatet nuk mund të gjeneralizohen ngaçë mostra nuk ka qenë reprezentative (*Ndal dhunën*).

e tyre.”²³ Një anketë me përfshirjen më të gjerë, Zëri i Grave (*Voice of Women*), në vitin 2004, i ka pyetur 1.338 gra anë e kënd Kosovës nëse dhuna në familje ka ndodhur në rrithinën e tyre; 46 për qind është përgjigjur në mënyrë pohuese dhe 12 pér qind kanë qenë dëshmitare të keqtrajtimit fizik të gruas nga burri.²⁴

Në vitin 2008, RRGGK-ja ka zhvilluar hulumtimin e parë në nivel të Kosovës në çështjen e dhunës në familje, duke anketuar 1.256 qytetarë. Madje edhe në intervistat e llojit një me një, qytetarët mund të mos ndjehen rehat kur zbulojnë se kanë përjetuar dhunën në familje ose mund ta interpretojnë dhunën në familje në mënyra të ndryshme. Së këndejmi, RRGGK-ja ka shtruar pyetje të ndryshme pér të mbledhur informacionin lidhur me përjetimet e qytetarëve. Së pari, hulumtuesit i kanë pyetur qytetarët se sa *besojnë* ata që është shkalla e dhunës në qytetet ose fshatrat e tyre.²⁵ Siç e ilustron grafiku 2.1, përafërsisht 20 pér qind e të anketuarve kanë thënë se dhuna në familje nuk ndodh në fshatin ose qytetin e tyre.

“E di... se në fshatin tim ekzistonë 3 deri në 4 familje të cilat vuajnë nga dhuna. Para dy ditësh, një plak e kishte rrahur gruan e tij. Ajo ishte e tëra e nxirosur nga shenjat e rrahjes. Në një familje tjetër, burri e rrah gruan e tij. Vëllezërit e tij e rrahin ate, poashtu. Para dy ditrësh, kishte ardhur policia pér këtë rast.”

– Grua shqiptare, mosha 36-45, komuna e Prishtinës



Më shumë se 38 pér qind kanë thënë se dhuna ka ndodhur në më pak familje (një në 25 pér qind). Afërsisht nëntë përqind kanë besuar se dhuna ndodh prej një të katërtës deri


²³ Ciuar në Chris Corrin, “Rindërtimi postkonfliktuoz dhe analiza gjinore në Kosovë,” *Intervista ndërkombëtare feministë e politikave 3(1)* (Routledge, 2000) 94; dhe Cari Clark, “Dhuna në baza gjinore, Iniciativat e hulumtimit në ambientet e refugjatëve, PZHBV (personave të zhvendosur brenda vendit) dhe në ato postkonfliktuozë: Mësimet e nxjerra” (Dokumente pune nr. 17, Shëndeti riprodhues pér shoqërinë e refugjatëve, 2003).

²⁴ RRGGK dhe Ekipi i vendit i KB-së në Kosovë, *Zëri i grave*, (Prishtinë: Dëshjetor, 2004), 8-9.

²⁵ Pyetja është bazuar në supozimin se qytetarët do të vlerësonin më saktësisht përmasën e dhunës në fshatrat, qytezat ose qytetet e tyre se sa anë e kënd Kosovës, posaçërisht në qytetet e vogla. Prapë, vlerësimet janë të bazuara në percepcionet e qytetarëve dhe nuk duhet të konsiderohen indikative pér shkallën e vërtetë të dhunës.

te gjysma e familjeve dhe 2.2 për qind kanë thënë se ajo ndodh në një të katërtën deri në tri të katërtat e familjeve. Vetëm pak të anketuar kanë besuar se dhuna ndodh në secilën familje, që sugjeron se ka qenë më se e sigurt se dhuna ka ndodhur brenda 11 familjeve të tyre. Derisa meshkujt kanë qenë të prirur të përgjigjen “dhuna nuk ndodh”, më shumë gra kanë besuar se ajo ndodh në pak familje. Të anketuarit nga grupet etnike të boshnjakëve, romëve/ashkanlive/egjiptasve dhe goranëve kanë qenë të prirur të mendojnë se dhuna ka ndodhur në një të katërtën deri në gjysmën e familjeve në qytetet e tyre, që sugjeron një shkallë potencialisht më të lartë të dhunës në këto komunitete.


Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë parë anëtarët e familjes duke bërtitur në njëri-tjetrin në vitin e kaluar. Afërsisht një e treta ka dëgjuar “Zëra të lartë, thuajse dy anëtarë të familjes ishin duke goditur ose tërhequr njëri-tjetrin.” Sërisht, të anketuarit nga grupet minoritare shpesh kanë vlerësuar se dëgjojnë zëra të tillë çdo muaj derisa shqiptarët kanë qenë të prirur të vlerësojnë se ato i kanë dëgjuar 5-11 herë çdo vit. Trembëdhjetë për qind e të anketuarve kanë parë “Gruan e cila ka shenja thuajse dikush e ka goditur atë”. Siç e ilustron grafiku 2.2, përafërsisht 30 për qind e të anketuarve kanë njobur së paku një familje në të cilën ka ndodhur dhuna gjatë vitit të kaluar. Më shumë se një e katërtë ka njobur prej 1 deri në 5 familje, 3 për qind i kanë njobur 6 deri në dhjetë, 0.3 për qind ka njobur 11 deri në 20 familje dhe 1.1 për qind ka njobur më shumë se 11 familje. Shqiptarët kanë qenë më të prirur të njobin raste të tillë, 1 deri në 4 familje, derisa minoritetet nuk janë përgjigjur në pyetjen ose janë përgjigjur se nuk dinë.



Në fund, hulumtuesit kanë shtruar një varg pyetjesh për të konstatuar nëse vet të anketuarit kishin përjetuar ndonjëherë dhunën në familje. Për nga përshkrimi i formave të dhunës, (të nënvizuara me ligj) si ndërveprime të mundshme në familje, RRGGK-ja ka thjeshtësuar termin e “dhunës në familje” në gjuhën e përditshme me qëllim që të anketuarit të mund ta kuptojnë atë.²⁶ Kur janë marrë parasysh të gjitha format e

²⁶ Për shembull, derisa të anketuarit mund të thonë se ata asnjëherë nuk kanë përjetuar dhunën në familje, ata mund të thonë se kanë përjetuar akte specifike siç është ndalimi i tyre nga ana e familjes që të mos lëshojnë familjen në moshën e rritur. (izolimi), ose se janë rrahur me rrip ose me shkop.

dhunës, 43 për qind gjatë jetës së tyre kanë përjetuar dhunën në familje në një masë. Më shumë se 46 për qind e të gjitha grave kanë përjetuar dhunën në familje krasuar me 39.6 për qind e të gjithë meshkujve. Krasuar me grupet e tjera demografike, të anketuarat femra që kanë jetuar në zonat rurale të varfra²⁷ dhe/ose që kanë pasur më pak se sa arsimimi i mesëm shkollor, kanë qenë më të pritura për të përjetuar dhunën. Grafiku 2.3 e ilustron se sa shpesh të anketuarit vuajnë nga dhuna në familje. Prej 356 të anketuarve, të cilët i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, 51.7 për qind kanë qenë të lënduar nga anëtarët e familjes gati çdo vit, 21.3 për qind çdo vit, 12.1 për qind 1 deri në 5 herë në vit, 2.5 për qind çdo muaj, 2.8 për qind çdo javë dhe tre njerëz çdo ditë.



Si përfundim, 43 për qind e të anketuarve kanë përjetuar dhunën në familje në jetën e tyre, me më shumë gra që kanë përjetuar dhunën se sa meshkujt. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar nëse dhuna në familje është rritur apo është zvogëluar në Kosovë.²⁸ Vetëm përmes zhvillimit të anketave në nivel të Kosovës në mënyrë të rregullt, siç janë ato çdo pesë vite, institucionet dhe organizatat mund të mbikëqyrin ndryshimet në percepionet e njerëzve dhe mbizotërimin e dhunës në familje. Duke vepruar kështu, është thelbore që hulumtuesit t'i zbërthejnë shprehjet abstrakte siç është “dhuna në familje” në gjuhën e përditshme të njerëzve me qëllim që të matin sa më saktësisht përmasën e dhunës.

2. Izolimi²⁹

Një kategori potencialisht e zakonshme, edhe pse e paraportuar plotësisht, e dhunës në familje në Kosovë është izolimi. Doracaku i zyrtarëve të Shërbimit Social e përkufizon

²⁷ RRGGK ka konstatuar korrelacionin midis përfjetimit të dhunës dhe të hyrave të ulëta ose të qenit në asistencë sociale.

²⁸ Vetëm hulumtimi nga QMG et al. ka krasuar përmasën e dhunës në familje para dhe pas luftës, duke konstatuar një zbritje të lehtë nga 36 në 34 për qind. Për një diskutim të mëtejmë, shih QMG et al. dhe *Hulumtimi kërkimor* të RRGGK-së.

²⁹ Kjo pjesë nxjerret nga RRGGK, *Hulumtimi kërkimor*, 21.

izolimin si momente kur “kryerësit e dhunës bëjnë përpjekje për të kontrolluar ambientin e viktimës.”³⁰ Kontrollimi i një ambienti mund të përfshijë krimet e përmendura në Kodin Penal, duke përfshirë: kërcënimin, heqjen e paligjshme të lirisë, krijimin e skllavërissë, të kushteve të ngashme me skllavërinë dhe punën e detyruar. “Kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër” dhe “ndalimi i personit tjetër nga hyrja ose dalja prej një vendbanimi të përbashkët” po ashtu kanë baza për urdhren e mbrojtjes.³¹ Izolim mund të ketë kuptimin se një personi i është ndaluar lëshimi i shtëpisë, sjellja e vendimeve vetanake, i thirrjeve telefonike, ndërveprimi me anëtarët e tjerë të familjes ose me shokët ose qasja ndaj dokumenteve personale të identifikimit.³² Për shembull, një këshilltar i strehimit e ka përshkruar një rast të izolimit në Kosovë për RRGGK-në si më poshtë: “Gruaja mendonte lidhur me faktin se kur [...] vjehrra e saj mbyll derën e saj dhe merr çelësat, atëherë klienti duhet të marrë ujë dhe enë për urnim gjatë natës.”³³ Një grua tjetër i ka thënë RRGGK-së se “Unë kam qenë e izoluar në një dhomë dhe të tjerët (anëtarët e familjes) më urdhëronin mua se çfarë duhet të bëjë.” Më shumë se gjysma prej 31 grave të intervistuara nga RRGGK në vitin 2007, të cilat kanë përjetuar dhunë, kanë thënë se partneri i tyre i ka penguar ato nga vizitat e familjeve dhe të miqve të tyre në minimum çdo javë. Pak më pak se gjysma kanë thënë se partnerët e tyre i kanë dëgjuar ose mbikëqyrur bisedat e tyre telefonike. Ngashëm, mbi një e treta e grave që QMG et al. të intervistuara kanë qenë të “ndaluara nga pjesëmarrja në aktivitetet” jashtë shtëpisë dhe rrëth gjysma janë të “ndaluara nga vizitat e miqve ose të familjes.”³⁴

Relativisht pak të anketuar të një ankete të RRGGK-së në nivel të Kosovës në vitin 2008 kanë thënë se kanë përjetuar një formë të izolimit. Bazuar në rastet e raportuara, lëvizjet e meshkujve rrallë ose asnjëherë nuk janë kontrolluar krahasuar me ato të grave.³⁵ SHPK-ja ka pasur vetëm 14 raporte të heqjes së paligjshme të lirisë.³⁶ Në kontrast të plotë, vetëm në vitin 2003, QMFG ka raportuar asistencën për 76 raste.³⁷ Mungesa e raportimit mund të jetë për shkak se njerëzit nuk e konsiderojnë izolimin si një formë të dhunës ose nuk e konsiderojnë atë si mjaft serioze për ta raportuar te autoritetet.³⁸

3. Dhuna psikologjike³⁹

Dhuna psikologjike është një kategori më e gjerë e dhunës e cila mund të përfshijë izolimin. Në aktet e parapara me Kodin Penal, të cilat mund të konsiderohen lloje të dhunës psikologjike, përfshihen: detyrimi, kërcënimi, dhe heqja e paligjshme e lirisë. Bazat për urdhren e mbrojtjes përfshijnë angazhimin në një model të sjelljes me qëllim të degradimit të personit tjetër dhe shkaktimin e frikës te personi tjetër lidhur me mirëqenien e tij ose të saj fizike, emocionale ose ekonomike.⁴⁰ SHPK-ja ka vetëm raportime të keqtrajtimit psikologjik dhe 10 raporte të keqtrajtimit psikofizik nga viti 2006

³⁰ OSBE dhe MPMS, 14.

³¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12, nen 1.2(f), (i).

³² Koalicioni Ajdaho kundër dhunës seksuale dhe famijare, cituar në *Hulumtimin kërkimor* të RRGGK-së.

³³ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 23.

³⁴ QMFG et al., 23.

³⁵ Derisa 8.5 për qind e grave kanë thënë se lëvizja e tyre ka qenë e kontrolluar në moshën e pjekurisë, vetëm një për qind e meshkujve e ka thënë këtë. RRGGK nuk e përkufizon kontrollimin e lëvizjes në moshën e fëmijërisë (deri në moshën 18) si një formë të dhunës.

³⁶ SHPK, anketa e RRGGK-së, 2008.

³⁷ QMFG Vjetar(*Annual*) 2003, 23.

³⁸ Siç e ilustron kapitulli 1, më pak se gjysma e të anketuarve kanë konsideruar izolimin si një formë të dhunës.

³⁹ Kjo pjesë nxjerret nga RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 21. 21.

⁴⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12, nen 1.2.

deri në vitin 2007.⁴¹ Një zyrtar i shërbimeve sociale i ka shpjeguar RRGGK-së se “Ne kemi rrallë raste të dhunës psikologjike për arsy se dhuna psikologjike është më e fshehur.”⁴² Pjesëtarët e stafit që punojnë në strehimore të grave kanë vlerësuar se më shumë se 90 për qind të klientëve kanë treguar simptome të dhunës psikologjike, por pak nga ata që njojin kanë përjetuar dhunën psikologjike.⁴³ Njerëzit, po ashtu, mund të mos e konsiderojnë dhunën psikologjike krim mjافت të rëndë për ta raportuar. Në vitin 2007, RRGGK ka kërkuar nga përfaqësuesit e institucioneve të vlerësojnë numrin e rasteve që ata e kanë hasur në punën e tyre. Tabela 2.3 tregon rezultatet e RRGGK-së të bazuara në këto vlerësimë dhe statistikat ekzistuese të mbledhura nga institucionet.

Tabela 2.3 Numri i rasteve të dhunës psikologjike të raportuara nga burime të ndryshme

Burimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Total
SHPK – Keqtrajtimi psikologjik						47	24		71
SHPK – Keqtrajtimi psikofizik								10	10
SHPK– Kërcënim (neni. 161)						214	252	199	665
QMFG ⁴⁴	799	560	436	360					2155
QMG (personat jashtë strehimoreve të këshilluar lidhur me dhunën psikologjike)	97	430	373	407	77	91	45	80	1600
Katër strehimoret e tjera									1009
Avokimi i Viktimave									154-298
ZSHC (nga QMS-të)									112-244
Gjinekologë									1203-2442+

Burimi: Përshtatur nga RRGGK, Hulumtim kërkimor, 2008.

Një analizë në nivel të Kosovës e RRGGK-së ka konstatuar se 30 për qind e të anketuarve kanë përjetuar dhunën psikologjike nga anëtarët e familjes në jetën e tyre.⁴⁵ Përafërsisht dy herë më shumë gra se sa meshkuj e kanë vuajtur dhunën psikologjike. Në vitin e kaluar, 14.8 për qind e të anketuarve kanë thënë se në familjet e tyre iu është

⁴¹ SHPK, anketa e RRGGK-së, 2008. SHPK-ja po ashtu ka regjistruar 220 raste të grindeve, 174 raste të ngacmimit dhe një rast të rrezikimit të përgjithshëm që me gjasë mund të konsiderohet formë e dhunës psikologjike.

⁴² Intervistë me RRGGK, 2007 në RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

⁴³ Bisedat e RRGGK me personelin e strehimoreve (*Hulumtim kërkimor*) dhe QMFG, *Raport vjetor 2003*. Midis vitit 2000 dhe 2006, përafërsisht 90 për qind e 1.246 klientëve të Medica Kosova kanë vuajtur nga dhuna psikologjike (RRGGK, 21). QMG et al. ka konstatuar se një në katër gra kanë qenë verbalist të shpërdorura nga partnerët dhe një nga pesë të frikësuara(34).

⁴⁴ QMFG, *Vjetar 2003*, 24 dhe *Raport vjetor 2002*, 25.

⁴⁵ Dhuna psikologjike është përkufizuar se përfshin aktet e mëposhtme që ndodhin gjatë moshës së pjkurisë: të drejtuarit në mënyrë fyese, të qenët i sharë, të qenët përherë i urdhëruar nga anëtarët e familjes, të qenët i ndaluar nga takimi me shokët dhe të afërmit, lëvizja e kontrolluar, shkaktimi i ndjenjës së përhershme të fajit, marrja e vendimeve të rëndësishme pa e pyetur të anketuarin, kërcënimi me dëmtim, kërcënimi i njerëzve të dashur dhe kanosja me armë.

bërtitur, janë fyer ose i kanë bërë të ndjehen shumë keq.⁴⁶ Vetëm 2.5 për qind e të anketuarve kanë qenë të kërcënuar me armë.⁴⁷

4. Dhuna fizike⁴⁸

Sipas përkufizimeve të saktësuara në Kodin Penal, dhuna fizike mund të përfshijë lëndimin e lehtë trupor, lëndimin e rëndë trupor, keqtrajtimin ose braktisjen e fëmijës, kidnapimin, tentimin për vrasje, vrasjen dhe dhunën seksuale (të përshkruara në pjesën në vijim të këtij raporti.). Rregullorja kundër dhunës në familje përfshin shkaktimin e lëndimit trupor, veprimet seksuale pa pajtim ose eksplorimin seksual, kidnapimin dhe largimin e dhunshëm të personit tjetër nga vendbanimi i përbashkët. Sipas doracakut të ZSHS, lëndimi trupor përfshin “tërheqjen, shtyrjen, shuplakosjen, goditjen, shqelmosjen, grushtimin, shfrytëzimin e mjeteve ose të armëve” dhe “aktet e tjera të cilët mund të rezultojnë në frikë, lëndim ose vdekje.”⁴⁹ Viktimiduesit mund të përdorin poashtu shkatërrimin e pronës si një mjet të demonstrimit të forcës ose të kontrollit.⁵⁰

Tabela 2.4 ilustron numrin e rasteve të dhunës fizike të regjistruar nga institucione dhe organizata të ndryshme. Midis vitit 2000 dhe 2003, QMGF ka regjistruar 2.132 raste të “dhunës fizike,” kategori kjo e cila ka përfshirë edhe dhunën seksuale.⁵¹ Pos kësaj, QMGF ka raportuar 804 raste të “sulmit”.⁵² Në vitin 2003, dy gra të strehuara kanë vuajtur “prerjen e dhunshme të flokëve” ka shkruar QMGF, “një nga aktet më të rënda të “degradimit”.⁵³ Katër qendrat e tjera të strehimit kanë kombinuar strehimin e 429 grave dhe Medica Kosova ka ndihmuar 135 gra të cilat kanë përjetuar dhunën fizike, kryesisht nga burrat ose/dhe kunetërit e tyre.⁵⁴ QMG et al. ka konstatuar se 17 për qind e grave ka përjetuar dhunën fizike në familje para luftës krahasuar me 11 për qind pas saj.⁵⁵

⁴⁶ Për 10.3 për qind të të anketuarve, kjo ka ndodhur prej një deri në pesë herë vitin e kaluar. Tre për qind të raportuara çdo muaj, nëse jo edhe çdo javë ose çdo ditë. Njerëzit nga zonat urbane dhe njerëzit më të rinjë se mosha 45 vjeçare kanë qenë më të prirur të thonë se anëtarët e familjes e kanë bërë këtë. Të anketuarit, të cilët kanë raportuar përjetimin e dhunës psikologjike “çdo muaj”, kanë qenë të prirur të jenë gra ose/dhe të shkurorëzuara.

⁴⁷ Të anketuarit me nivele më të ulëta të edukimit (më pak se shkollimi fillor), të hyra të ulëta të ekonomisë familjare (më pak se 800 euro të totalit të të hyrave të ekonomisë familjare në tre muaj), shqiptarët dhe serbët kanë qenë më të të prirur të kenë qenë të kërcënuar me armë nga një anëtar i familjes.

⁴⁸ Kjo pjesë nxjerret nga RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 21.

⁴⁹ OSBE dhe MPMS, 13.

⁵⁰ Shih Qeveria e Portugalisë, pjesën për “Dhunën familjare”, 16-25.

⁵¹ Raporti total cek 2.223 raste, por numrat e paraqitur i shtojnë deri në 2.132.

⁵² Dhuna fizike ka përfshirë “keqtrajtimin e rëndë dhe të lehtë, lëndimet trupore dhe aktet e dhunës seksuale” (QMGF, *Vjetar 2003*, f. 23-24). Dallimi midis “dhunës fizike” dhe “sulmit fizik” ka qenë i paqartë.

⁵³ QMGF, *Vjetar 2003*, 68.

⁵⁴ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 24.

⁵⁵ Ngaqë ky hulumtim është bërë në rajonin e Pejës, nevojitet hulumtim i mëtejmë për të ardhur te përfundimi nëse dhuna fizike është rritur ose është zgogëluar anë e kënd Kosovës.

Tabela 2.4 Numri i rasteve të reportuara të dhunës fizike

Burimi	Kategoria	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Total
SHPK ⁵⁶	Largimi me dhunë i personit tjetër nga vendbanimi i përbashkët						16	12	28	
SHPK	Lëndim i rëndë trupor					5	21	14	40	
SHPK	Ndërprerja e palejueshme e shtatzënësë						1	1	2	
SHPK	Nxitja dhe të ndihmuarit në vetëvrasje					5	3	13	21	
SHPK	Lëndim i lehtë trupor					290	408	462	1160	
SHPK	Keqtrajtim ose braktisje e fëmijës					2	2	2	6	
SHPK	Vrasje					1	4	4	9	
SHPK	Tentimvrasje					4	3	6	13	
SHPK	Sulm					661	341	215	1217	
SHPK	Keqtrajtim fizik					17	83	24	124	
SHPK	Keqtrajtim psikofizik							10	10	
SHPK	Kërcënim me armë						9	4	13	
QMGF	Krimet e rënda (vrasje, tentimvrasje, vetëvrasje dhe tentim përvrasje) ⁵⁷	3	1	5	24					33
QMGF	Dhuna fizike	864	560	494	214					2132
QMG	Dhuna fizike				36	43	44	38		161
Katër strehim ore	Dhuna fizike									429

Në vitin 2007, RRGGK-ja po ashtu ka konstatuar se më shumë se dy të tretat e grave që vuajnë nga dhuna në shtëpi kanë qenë të shuplakosura, të goditura, të grushtuara, të shqelmuara, të kapura përfyti ose të rrahura. Objekte të caktuara janë përdorur rregullisht kundër dy të tretave të grave, siç janë rripat, druri, shkopi, degët, kabllot dhe armët e zjarrit. Rreth 40 përqind gjithashtu kanë thënë se dhuna kundër tyre shpesht ka përfshirë dhunën kundër fëmijëve.

Përafërsisht 18 përqind e të anketuarve në një anketë të RRGGK-së në vitin 2008 kurrë nuk ka përjetuar dhunë fizike, dhe tre të anketuar kanë thënë se ata e kanë përjetuar dhunën çdo ditë.⁵⁸ Njerëzit në zona rurale, me më pak se sa arsimimi i mesëm shkollor dhe/ose me të hyra të ulëta kanë qenë më të prirur përfjetimin e dhunës fizike.⁵⁹ Tridhjetë përqind e të anketuarve janë shuplakuar nga anëtarë i familjes në

⁵⁶ SHPK, RRGGK, analizë, 2008.

⁵⁷ QMGF, Vjetar2003, 24.

⁵⁸ Vetëm 1.3 përqind e të anketuarve kanë thënë se një anëtar i familjes fizikisht i ka keqtrajtuar vitin e kaluar. Personat e shkurorëzuar dhe/ose ata që marrin asistencën sociale kanë qenë të prirur të vlerësojnë se ata kanë përjetuar dhunën fizike çdo muaj. Dhuna fizike është definuar si: ndalim, nga ana e një anëtarë të familjes, të vizitave te mjeku kur anëtarët tjerë janë të sëmurë, shkatërrimi i enëve ose i orëndive me qëllim, shuplakimi i të anketuarit në moshë të pjekur, dhe/ose goditja, grushtimi ose shqelmosja. Derisa shuplakosja e fëmijëve është po ashtu një formë e dhunës, ajo nuk është përfshirë. Forma e zakonshme e disiplinës, duke përfshirë shuplakosjen, do të rriste në mënyrë drastike përqindjen e popullatës e cila ka përjetuar dhunën fizike.

⁵⁹ Familjet, të cilat kanë pasur të hyra të ekonomisë familjare në total më pak se 800 euro në tre muaj.

njëfarë mënyre gjatë jetës së tyre; pesë për qind kanë qenë të goditur, të grushtuar ose të shqelmuar nga një anëtar i rritur i familjes së tyre dhe 5.7 për qind kanë qenë të goditur me objekte, duke përfshirë shkopin, rripat ose thikat. Dhuna fizike po ashtu mund të përfshijë pengimin e vizitës së anëtarit të familjes tek mjeku dhe përafërsisht dy për qind e të anketuarve kanë thënë se familja e tyre nuk i ka lejuar ata për të kërkuar kujdesin mjekësor kur ata kanë qenë të sëmurë.

5. Dhuna seksuale

Dhuna seksuale është një formë e dhunës fizike që meriton konsiderata të veçanta. Kodi Penal qartë thotë se secili prej akteve të mëposhtme pa pajtim (duke përfshirë ato nën trysni dhe të detyruara) kur kryhen brenda marrëdhënieς familjare janë krimet: sulmi seksual, degradimi i integritetit seksual dhe shpërdorimi seksual i personave me çrrregullime ose paaftësi mentale apo emocionale.⁶⁰ Më tej, siç e shpjegon doracaku i ZSHS:

Nëse njëri nga personat është nën moshën 16 ose 18 vjeçare dhe fëmijë, ose fëmijë i birësuar, fëmijë i burrit ose i gruas, nip ose mbesë, nip ose mbesë e personit tjetër, gjithmonë supozohet se ata nuk mund të pajtohen dhe, së këndejmi, aktiviteti seksual përbënë shpërdorim në të gjitha rrëthanat. Shpërdorimi seksual përfshin sjelljet siç janë fërkimi, thithja e organit seksual të mashkullit, thithja e organit seksual të femrës, dhe/ose depërtimi vaginal. Mund të përfshijë, poashtu, eksplorimin përmes detyrimit të personit tjetër që të bëhen fotografi të natyrës seksuale ose përmes detyrimit të personit tjetër në prostitucion.⁶¹

Doracaku vazhdon tutje në përkufizimin e “dhunimeve dëmtuese” si akte të cilat përfshijnë si dhunën fizike ashtu edhe atë seksuale dhe “seksin e detyruar obsesiv” që përfshin kryerësit të cilët kërkojnë “një numër të jashtëzakonshëm të marrëdhënieve seksuale” ose “seksin si formë e sjelljes sadistike, brutale dhe perverse.”⁶² Pa pëlqimin “aktiv” të personit, të gjitha aktet e lartpërmendura konsiderohen krimet. Megjithëkëtë, ajo që është e re për Kosovën është ideja se aktet seksuale pa pajtim, që ndodhin brenda një marrëdhënieje familjare midis dy partnerëve, mund të konsiderohen dhunë. Siç është përmendur, dy të tretat e të anketuarve të një ankete të RRGGK-së janë pajtuar se “marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë dhunë nëse ajo ndodh midis dy të rriturve të cilët janë të martuar.” Kjo mund të shpjegojë se përse dhuna seksuale raportohet rrallë.

Siç e ilustron tabela 2.5, vetëm tri raste të sulmit seksual, një rast i dhunimit dhe një rast i incestit, janë raportuar në SHPK-së si akte të dhunës në familje.⁶³ Prapë, tri strehimore kanë raportuar t’iu kenë dhënë ndihmë gjithsej 66 grave që kanë përjetuar dhunën seksuale dhe dhjetë rasteve të incestit.⁶⁴ Vetëm QMGF ka ndihmuar 58 persona

⁶⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/01 Ndryshimi i ligjit në fuqi mbi veprat penale që involvojnë dhunën seksuale, nen 1.1 (1) dhe 4 i preambulës së Rregullores.

⁶¹ OSBE dhe MPMS 13.

⁶² Po aty.

⁶³ Derisa SHPK-ja dhe policia e UNMIK-ut kanë regjistruar më shumë raste të sulmit seksual, dhunimit, dhe përpjekjes për dhunim, nuk është dokumentuar ose bërë e qartë nëse këto kanë ndodhur në kuadër të marrëdhënieς familjare.

⁶⁴ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 26.

të cilët kanë përjetuar incestin. Mjekët po ashtu kanë hasur në raste të dhunës seksuale në familje. Për shembull, një gjinekolog rikujton trajtimin e një pacienteje, burri i së cilës i ka fikur cigaret në gjenitalet e gruas.⁶⁵

Tabela 2.5 Përmasa e dhunës seksuale në kuadër të marrëdhënies familjare sipas burimeve të ndryshme

Burimi	Kategoria/klasa	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Totali
SHPK ⁶⁶	Sulm seksual						2	0	1	3
SHPK	Dhunim							0	1	1
SHPK	Incest							0	1	1
QMGF	Rastet e ndihmuara të incestit	13	20	10	15					58
UNIFEM-i	Dhunim nga personat e njojur (n = 213)									18%

Vetëm 2.5 për qind e të anketuarve në një anketë të RRGGK-së në shtrirje të Kosovës kanë thënë se ata kanë përjetuar dhunën seksuale, siç është prekja e pjesëve intime të trupit të një anëtar i familjes në mënyrën siç nuk dëshiron ai anëtar, partneri i cili iu bënë trysni atyre për të pasur marrëdhënie seksuale kur ata nuk kanë dëshiruar ta bëjnë këtë, ose kur një anëtar i familjes i detyron ato të bëjnë veprime seksuale të cilat nuk kanë dashur t'i bëjnë. Më shumë gra (3.5 për qind) se sa meshkuj (1.3 për qind) kanë përjetuar dhunën seksuale. Një grua ka komentuar: "Burri im mund të ketë seks me mua kurdoherë që ai dëshiron, pa më pyetur."⁶⁷ Njerëzit në asistencë sociale kanë qenë më të prirur që të kenë përjetuar dhunën seksuale. Dhuna seksuale është pothuajse me siguri më e zakonshme, por të anketuarit kanë qenë të pritur të hezitojnë në diskutimin e çështjeve të tilla personale me hulumtuesit.

UNIFEM-i, që ka kaluar më shumë kohë në ndërtimin e besimit me gratë, ka kërkuar nga gratë që të plotësojnë një pyetësor anonim. Rrjedhimisht, 18 për qind e të anketuarve kanë raportuar dhunim nga burra shqiptar që i njojin. Në mesin e tyre, 53 për qind kanë qenë të dhunuara nga partnerët e tyre ose një anëtar i familjes.⁶⁸ QMG et al. ka konstatuar se 8 për qind e grave të martuara kanë përjetuar detyrimin seksual para luftës dhe 6 për qind pas luftës.⁶⁹ Në mesin e grave, të cilat kanë përjetuar dhunën nga partnerët, pothuajse gjysma para luftës dhe afërsisht 40 për qind pas luftës kanë thënë se partnerët e tyre kanë dëshiruar të kenë seks pas keqtrajtimit të tyre.

Në një studim të përparshëm të RRGGK-së, në të cilin këshilluesit e besuar kanë zhvilluar intervista të hollësishme me 31 femra për të cilat dihet se e përjetojnë dhunën, afërsisht tri e katërtë ka thënë se partnerët e tyre i kanë detyruar ato të kenë seks.⁷⁰ Një grua rikujton: "Partneri im, ish burri, ka qenë agresiv, kur unë nuk kam dëshiruar marrëdhënie seksuale. Duhej ta bëja atë për arsy se, nëse nuk do ta bëja, ai më godiste ose sillte femra të tjera në shtëpi që t'iu shërbejë unë." Nga një mostër më e gjerë e 51

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ SHP, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁶⁷ Grua e martuar shqiptare, mosha 45 vjeçare nga komuna e Gjilanit.

⁶⁸ UNIFEM, 37. Prej tyre, 53 për qind kanë qenë të martuara dhe të dhunuara nga partnerët e tyre (burri ose i dashuri) ose anëtar i familjes, 26 për qind kanë qenë të pamartuara dhe 21 për qind kanë qenë të veja ose të ndara (edhe pse nuk ka qenë e qartë nëse dhunimi është kryer para ose pasi ato janë bërë të veja ose kanë qenë të ndara).

⁶⁹ QMG et al., 6. Inkuadruar pas luftës prej shtatorit 2001 deri në gusht 2002.

⁷⁰ Prej grave, 7 kanë qenë të detyruara "çdo javë" dhe 10 "çdo muaj" (RRGGK, *Hulumtim kërkimor*).

grave në atë studim, gjysma kanë qenë të detyruara të kryejnë veprime seksuale “të cilat ato nuk i kanë dashur”. Prapë, vetëm dy gra kanë besuar se kanë përjetuar sulm seksual. Kjo ilustron se si gratë mund të mos e dinë se seksi i detyruar është dhunë martesore, gjë që iu kontribuon raportimit jo të plotë të dhunës seksuale në Kosovë. RRGGK ka raportuar se “krenaria, frika nga izolimi social dhe mungesa e alternativave, po ashtu, mund të parandalojë gratë nga paraqitja e tyre.”⁷¹

6. Dhuna ekonomike

Dhuna ekonomike ndodh kur një shpërdorues shfrytëzon mjetet financiare për të ushtruar pushtet mbi anëtarin tjeter të familjes.⁷² Dhuna ekonomike mund të përfshijë kryerësin: i cili nuk lejon personin të punojë për përfitim ekonomik; i cili refuzon të punojë dhe të kontribuojë në buxhetin familjar; i cili nuk ndihmon në mbështetjen financiare të familjes ose i cili refuzon për të ndarë të hollat me partnerin për shpenzimet e ekonomisë familjare.⁷³ Sipas Kodit Penal, shkelja e obligimeve familjare, siç është lënia e një anëtarit të familjes të paaftë për t'u kujdesur për vvetvenen në një situatë të rëndë mund të interpretohet si formë e dhunës ekonomike. Shkaktimi i dëmit në pronë ose moslejimi i pjesës së pasurisë së personit po ashtu mund të konsiderohen forma të shpërdorimit ekonomik.⁷⁴ Mospajtimet lidhur me atë se si të shpenzohen mjetet financiare familjare gjithashtu mund të shpjinë tek dhuna fizike.⁷⁵

SHPK-ja ka regjistruar vetëm 10 raste të dëmtimit të pronës, 1 të braktisjes së një personi të paaftë, dhe 11 raste të shkeljes së obligimeve familjare brenda marrëdhënies familjare midis viteve 2005 dhe 2007.⁷⁶ Institucionet e tjera nuk kanë regjistruar raste të dhunës ekonomike, por tri strehimore i kanë ndihmuar 135 gra të cilat kanë vuajtur dhunën ekonomike në vitin 2007.⁷⁷ Afërsisht 15 për qind e të anketuarve në një anketë RRGGK-së në nivel të Kosovës kurrë nuk kanë përjetuar dhunën ekonomike, siç është ajo e anëtarit të familjes i cili ka pasur para që nuk i ka dhënë për diçka që i anketuari vërtet ka pasur nevojë ose kur një anëtar i familjes nuk i lejon të anketuarit për të punuar jashtë shtëpisë për para në moshë të pjekurisë (theksi në pyetjet fillestare). Duket mjaft interesant se pak më shumë meshkuj (15.1 për qind) se sa gra (13.7 për qind) kanë thënë se kanë përjetuar dhunën ekonomike. Krahasuar me grupet e tjera demografike, të anketuarit nga zonat rurale, me më pak se sa arsimimi i mesëm shkollor, të cilët kanë qenë të papunë, dhe/ose kanë pasur ekonomi familjare me më pak të hyra se sa 600 euro kanë qenë më të prirur për të përjetuar dhunën ekonomike.

7. Kush janë viktimat? Grupet demografike më së shumti të prekura nga dhuna në familje

Konstatimi se cilat grupe demografike dhe gjeografike janë në rrezikun më të madh të dhunës në familje është thelbor në planifikimin e projekteve të fokusuara për ndërgjegjësim dhe për masat parandaluese të dhunës në familje. Më tej, një të kuptuar më i mirë i grupeve më së shumti të prekura nga dhuna mund t'i ndihmojë

⁷¹ Po aty.

⁷² OSBE dhe MPMS, 14.

⁷³ Koalicioni Ajdaho kundër dhunës seksuale në familje.

⁷⁴ 5 përqind e respondentëve kanë thënë se një anëtar i familjes ka shkatërruar ndonjëherë orenditë ose thyer enët me qëllim.

⁷⁵ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 26.

⁷⁶ SHPK, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁷⁷ RRGGK, *Hulumtim kërkimor* 26.

institucioneve për të zhvilluar programe më të mira për ndihmën njerëzve, si dhe ndihmën për të arsyetuar dhe siguruar buxhete vjetore për plotësimin e nevojave të këtyre grupeve të veçanta. Derisa njerëzit e të gjitha gjinive, etnicitetave, moshave, statuseve martesore, gjendjeve ekonomike dhe zonave gjeografike kanë përjetuar dhunën në familje në Kosovë,⁷⁸ të dhënat e mbledhura nga institucionet dhe rezultatet e një ankete të RRGGK-së në nivel të Kosovës, sugjerojnë se qytetarët kosovarë që më së shumti janë të rrezikuar nga dhuna janë si më poshtë:

- **Gratë:** Sipas të dhënavë të SHPK-së nga viti 2005 deri 2007, 79 për qind e të gjitha viktimate të dhunës në familje kanë qenë gra, derisa 21 për qind kanë qenë meshkuj.⁷⁹
- **Njerëzit nga zonat rurale:** Derisa pak institucione e kanë pohuar këtë informacion, të anketuarit që kanë përjetuar dhunën familjare dhe klientët e strehimoreve kryesisht kanë qenë nga zonat rurale.⁸⁰
- **Njerëzit më pak të arsimuar:** 20 për qind e viktimate që të anketuarit i kanë njojur nuk e kanë pasur të kryer shkollimin fillor, 17.2 për qind e kanë kryer shkollën fillore dhe 34.4 për qind kishin vijuar shkollën e mesme. Vetëm 6.6 për qind kanë shkuar në universitet.⁸¹ Nga të anketuarit që vet e kanë përjetuar dhunën familjare, shumica e tyre kanë pasur shkollim më të ulët se ai i mesëm.
- **Të papunët:** Ngaqë njerëzit me nivelet e ulëta të arsimimit janë të prirur të janë të papunë në përqindje më të larta se sa njerëzit me arsimim më të avancuar,⁸² rrjedhon se nëse viktimat janë me arsimim të ulët ato po ashtu mund të janë të prirura të janë të papunë.⁸³ Afërsisht 19 për qind e të anketuarve që ishin të vetëdijshëm se po e përjetonin dhunën kanë qenë të punësuar, 2.6 për qind bujq dhe 61.6 për qind të papunësuar.
- **Njerëzit ekonomikisht të varfër dhe shpesh në asistencë sociale:** Dhuna ka prirje të ndodh në familjet të cilat janë nuk janë mirë ekonomikisht⁸⁴ dhe që janë shpesh në asistencë sociale të qeverisë.⁸⁵

⁷⁸ Duke krahasuar burime të ndryshme, RRGGK ka treguar se disa grupe të grave duket se janë në rrezik më të madh. (*RRGGK, Hulumtim kërkimor*).

⁷⁹ Anketat e RRGGK-së dhe statistikat e SHPK-së. Sipas Partners Kosovo, dhuna kundër grave ka qenë Iloji “më i zakonshëm” i dhunës të cilin ata e kanë hasur në punën e tyre (Analizë e RRGGK, 2008).

⁸⁰ Anketë e RRGGK-së, 2008. QMGF ka vlerësuar se 82 për qind e klientëve të saj të dhunës në familje nga viti 2000 deri në vitin 2003 kanë qenë nga zonat rurale. (*Vjetar, 2003*, 29 dhe *Raport vjetor 2002*, 41). QMG ka regjistruar se 72 për qind e klientëve kanë qenë nga zonat rurale (*Hulumtim kërkimor*, 18).


⁸¹ Për 21.8 për qind të rasteve, të anketuarit nuk kanë ditur. Në studimin e saj të vitit 2007, RRGGK-ja ka konstatuar “një korrelacion të fortë negativ midis nivelit të arsimimit të përfunduar dhe asaj nëse ato kanë përjetuar dhunën gjatë shtatzënisë” (*Hulumtim kërkimor*, 18).

⁸² ESK ka raportuar në vitin 2003 dhe 2004 se gjysma e njerëzve me më pak se sa arsimimin e mesëm të lartë kanë qenë të papunë krahasuar me 11 për qind të njerëzve me arsimim të lartë. (*2004 Statistikat e tregut të punës, 26*).

⁸³ 92 për qind e klientëve të QMGF kanë qenë të papunë (*Vjetar 2003*, 31). Së bashku, tri strehimore të tjera kanë regjistruar 70 për qind të klientëve të vet si të papunë, 21 për qind të punësuar dhe 9 për qind bujq. Nga 51 gra që kanë përjetuar dhunën në familje të intervistuara nga RRGGK në vitin 2007, 71 për qind e tyre kanë qenë të papuna dhe ekonomikisht të varura nga bashkëshortët e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes. (*Hulumtim kërkimor*, 19).

⁸⁴ Në vitin 2007, RRGGK ka raportuar se gjysma e klientëve të QMG kanë ardhur nga familjet me kushte jetese “shumë e varfër”, 37 për qind me kushte jetese “të varfra” dhe 12 për qind me kushte jetese “të mesme” (*Hulumtim kërkimor*, 19). 8 për qind e grave që kanë përjetuar dhunën, të intervistuara nga RRGGK në vitin 2007, kanë vlerësuar se të hyrat e ekonomisë së tyre familjare nga të gjitha burimet për secilin muaj kanë arritur totalin

- Shqiptarët:** Ngaqë shqiptarët përbëjnë shumicën e popullatës së Kosovës, me gjasë nuk është befasuese se shumica e viktimate të dhunës në familje kanë qenë shqiptarë. Megjithëkëtë, dhuna në familje ndodh në të gjitha grupet etnike. Sipas të dhënave të SHPK-së dhe siç e ilustron Grafiku 2.4,⁸⁶ shumica kanë qenë shqiptarë (82.9 për qind). Vetëm mbi 9 për qind kanë qenë serbë, 3.7 për qind romë ose ashkali, 2.3 për qind boshnjak, 0.4 për qind turq, 0.4 për qind goranë dhe 1.1 për qind të tjerë. Ende duhet të bëhen hulumtime të mëtejme në komunitetet pakicë për një kuptueshmëri më të gjithanshme, ngaqë viktimat nga këto zona mund të kenë qasje të kufizuar në shërbimet nëse iu mungojnë materialet e përkthyera dhe, së këndejmi, në të kuptuarit e mjeteve financiare në dispozicion për ta.



- Nga rajoni i Prishtinës:** Siç e ilustron grafiku 2.5, shumica e raportimeve të dhunës familjare janë bërë në rajonin e Prishtinës. Megjithëkëtë, dhuna në familje është raportuar në të gjitha rajonet, në të gjashtat, dhe duket se numri i raportimeve korrespondon në përgjithësi me vlerësimet e popullatës në secilën zonë.⁸⁷ Së këndejmi, përqindja më e madhe e popullatës jeton në rajonin e Prishtinës dhe, rrjedhimisht, nuk është befasuese se dhuna në familje raportohet më së shpeshti në Prishtinë. RRGGK po


prej 200 eurosh ose më pak. Analiza e RRGGK-së në vitin 2008 ka konstatuar korelacionin midis personave të cilët përjetojnë dhunën dhe të hyrave të ulëta.

⁸⁵ RRGGK ka konstatuar një korrelacion midis të anketuarve që kanë përjetuar dhunën dhe atyre në asistencë sociale (analizë, 2008). ESK ka konstatuar në vitin 2004 se 61 për qind e familjeve kosovare kanë pasur të hyra totali i të cilave ka qenë më pak se 200 euro për muaj. Banka Botërore ka konstatuar se 12 për qind e popullatës mbijeton në kushte të varfërisë së skajshme me më pak se 0.92 euro në ditë dhe gjysma e popullatës ia del me 1.79 euro në ditë (cituar në RRGGK nga Lynne Alice, *Monitorimi i zbatimit të Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, Prishtinë: RRGGK 2007, 7).

⁸⁶ Burim i diagramit: Krijuar nga RRGGK, bazuar në Sektorin për hulumtim të statistikave të dhunës në familje të SHPK-së.

⁸⁷ Sipas ESK-ës, përafërsisht 15 për qind e popullatës së Kosovës jeton në komunën e Prishtinës, 10 për qind në Prizren, 5.11 për qind në Pejë, 5.31 për qind në Mitrovicë, 4.46 për qind në Gjilan dhe 5.44 për qind në Ferizaj (Kalkulim i RRGGK me informacionin e nxjerrur nga ESK, *Atlasi statistikor*).

ashtu ka konstatuar një korrelacion midis të anketuarve, cilët kanë përjetuar dhunën në familje edhe në komunën e Podujevës dhe të Fushë Kosovës, që mund të tregojë se dhuna ndodh më shumë në ato zona, megjithëse ka nevojë për një hulumtim të mëtejmë.



Burimi: Krijuar nga RRGGK. Bazuar në Sektorin për hulumtimin e statistikave të dhunës në familje të SHPK-së

Ndërsa kemi parasysh këto rezultate, njeriu duhet të jetë tejet i kujdeshëm në nxjerrjen e përfundimeve të shpejta lidhur me profilin e viktimës. Këto rezultate nuk duhet të përdoren për të sugjeruar se dhuna nuk ndodh në grupet e tjera gjeografike ose demografike, ngaqë dhuna mundet dhe ka prekur njerëzit e të gjitha grupeve. Në vend të kësaj, rezultatet kanë kuptimin për t'i ndihmuar qeverisë që në të ardhmen të vë në shënjestër aktivitetet parandaluese për grupet e veçanta, si dhe në programet e mbrojtjes.

Një shqyrtim i faktit se si dhuna ndikon mbi grupet e tjera të veçanta, posaçërisht mbi fëmijët, mbi njerëzit me nevoja të veçanta dhe mbi të moshuarit, mund të jetë po ashtu i dobishëm për qeverinë në planifikimin e fushatave të arsimimit sipas caqeve të caktuara dhe programeve për mbrojtje më të mirë të grupeve të veçanta të njerëzve. Bazuar në informacionin e tillë, qeveria mund të përfitojë nga burimet, aftësitë dhe përvojat e OJQ-ve dhe institucioneve në lidhje me grupet e veçanta të qytetarëve.

Dhuna kundër grave

Duke pasur parasysh se gratë kanë më shumë prirje të jenë viktima të dhunës se sa meshkujt,⁸⁸ kjo pjesë hulumton se si dhuna në familje ka ndikuar mbi grupet e veçanta të grave ose grave në fazë të jetës së tyre, duke hulumtuar në mënyrë specifike

⁸⁸ RRGGK-ja ka konstatuar korelacionin midis atyre që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë dhe të qenit femër.

dhunën kundër nuseve që ndikon në shëndetin riprodhues të tyre, në gratë shtatzëna dhe gratë që kanë përjetuar dhunën seksuale gjatë luftës.

Së pari, gratë e reja e posaçërisht nuset janë përgjegjëse për kujdesin ndaj amvisërisë: pastrimin, përgatitjen e ushqimit dhe shërbimin e mysafirëve. Tradicionalisht, ato i kanë mbajtur përgjegjësitë e tillë deri në ardhjen e nuses së re në familje ose derisa kanë lindur fëmijën e tyre të parë. Si pjesë e traditës, nusja e zë pozitën më të ulët në vendimmarrje në familje. Trajtimi i nuses nga familjet e tjera mund të konsiderohet një formë e dhunës psikologjike, edhe pse kjo rrallë është diskutuar publikisht. Dhuna fizike kundër nuses po ashtu ekziston, edhe pse ajo rrallë raportohet. Për shembull, një grua e analizuar shqiptare e moshës së mesme ka thënë se në fillim kur ishte martuar ka përjetuar dhunën nga e gjithë familja e burrit. Ndonjëherë ata e kanë shuplakosur, por ajo “gjithmonë” ka përjetuar dhunën psikologjike për arsyen se ajo ka jetuar “me kunetërit e saj dhe vjehrrin e vjehrrën, ka thënë ajo..⁸⁹ Edhe pse ndryshimet sociale posaçërisht në zonat urbane ndonjëherë kanë pasur kuptimin se *nuset* kanë më shumë liri, veçanërisht nëse ato jetojnë pavarësisht prej vjeherrve të tyre, dhuna ende ekziston. Në vitin 2006 dhe 2007, SHPK-ja ka regjistruar 25 raste kur vjehrrit dhe 66 raste kur vjehrrat kanë kryer dhunën kundër nuseve.⁹⁰ 14 gra (dhe asnjë mashkull) të anketuar nga RRGGK-ja kanë përjetuar dhunën nga vjehrrit e tyre dhe 27 gra (dhe asnjë mashkull) nga vjehrrat e tyre. Edh pse më pak e zakonshme, SHPK ka regjistruar dy raste të dhunës kundër burrave të rinj.

E dyta, kërkimi i mëhershëm ka ilustruar se në Kosovë është shkelur e drejta e grave për të vendosur “nëse, kur dhe sa shpesh” duan të mbesin shtatzëna, sipas përkufizimi të shëndetit riprodhues të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.⁹¹ Siç i ka thënë një grua RRGGK-së në vitin 2007, “unë duhet të bisedoj me burrin tim lidhur me atë [kontracepcionin], [por] do të kisha qenë e rrahur nga ai çdo natë.” Gratë kanë raportuar të qenët nën trysni nga burrat e tyre, kunetërit dhe vjehrrit, si dhe nga anëtarët e tjerë të familjes që të kenë më shumë djem.⁹² Në mesin e të anketuarve të RRGGK-së në vitin 2008, të cilët kanë pasur fëmijë, 11.8 për qind e grave dhe 5.7 për qind e burrave kanë thënë se mbi ta është ushtruar trysni që të kenë më shumë fëmijë sa ata kanë dashur. Para së gjithash, është ushtruar trysni mbi gratë nga partnerët e tyre ose vjehrrit e tyre për të pasur më shumë fëmijë, derisa mbi meshkujt është ushtruar trysni nga prindërit e tyre dhe ndonjëherë nga partnerët e tyre.

⁸⁹ Një grua e anketuar nga Peja ka përcjellur një rast tjetër kur dhuna ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve midis nuses dhe vjehrrës së saj. Kjo ka ndikuar mbi konfliktin midis bashkëshortëve dhe, si rezultat i kësaj, nusja e ka thirrur policinë që kishte arrestuar keqtrajtuesin (anketë e RRGGK-së, 2008).

⁹⁰ Analizë e SHPK-së, RRGGK-së, 2008.

⁹¹ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 28.

⁹² Nga të anketuarit, të cilët kishin fëmijë, 6.2 për qind e tyre ndonjëherë ka treguar se ata është dashur të kenë më shumë fëmijë se sa kanë dashur. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve, mbi të cilët është ushtruar trysni, kanë qenë gra. Mbi të anketuarit është ushtruar trysni nga partnerët e tyre (50.7 për qind), prindërit (16.4 për qind), vjeherritë (20.5 për qind) dhe anëtarët e tjerë të familjes (4.1 për qind). Shih po ashtu, RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 28.

Gratë që kanë përjetuar dhunën i kanë treguar RRGGK-së se ato ishin penguar në pranimin e kujdesit shëndetësor për shumë arsyë që lëvizin prej thashethemeve e deri te feja, xhelozia e burrave të tyre dhe mungesa e mjeteve financare:

“Ata frikoheshin se unë mund t’i tregoja dikujt se si më trajtonin mua.”

“Burri im nuk besonte se isha e sëmurë dhe ai nuk më dërgonte te mjeku për arsyë se gjëja e parë për të ka qenë sigurimi i parave për të dal jashtë gjatë gjithë natës dhe për të krijuar probleme në shtëpi, si dhe për të shprehur dhunën kundër fëmijëve dhe meje kur ai kthehet në shtëpi.”

“Burri im gjithmonë besonte se shkoja për të vizitë mjekësore vetëm për ta parë mjekun dhe për të treguar veten.”

“Vjehrri im më ka thënë: ‘Gruaja e cila viziton doktorin nuk është grua.’”

“Papunësia, ata nuk kishin para. Unë isha e re dhe kur iu kam thënë se kisha dhembje, vjehrra ime më pat thënë: ‘E njëjtë gjë më ka ndodhur mua por do të kalojë dhe mos i thuaj kujt për këtë se është turp.’”

“Pas vdekjes së burrit tim, unë kisha nevojë të shkoja te gjinekologu, por ka qenë e vështirë për mua, për arsyë se thashethemet e njerëzve (dhe të tyre) se mund të jem shtatzënë, më kanë zbrapsur nga vizita e tillë”

Burimi: RRGGK, Hulumtim kërkimor, 29-30

E treta, në kundërshtim me hulumtimin e përparmë në Kosovë që ka sugjeruar se gratë shtatzëna kurrë nuk i nënshtrohen dhunës,⁹³ RRGGK-ja ka gjetur shumë fakte se dhuna kundër grave shtatzëna me të vërtetë ndodh dhe se gratë që tashmë jetojnë në situata të dhunshme të familjes janë posaçërisht në rrezik të dhunës gjatë shtatzënisë.⁹⁴ Mjekët kanë raportuar raste të femrave shtatzëna të hospitalizuara nga lëndimet që kanë rezultuar nga dhuna, të të qenit të detyruara të shërbejnë si prostituta dhe të përpjekjeve për vetëvrasje pas dhunës psikologjike.⁹⁵ Pos kësaj, strehimoret e kanë ndihmuar një numër të madh të grave të reja të cilat janë dëbuar nga shtëpitë e tyre kur prindërit e kanë mësuar se ato janë shtatzëna jashtë martesës, një akt i identifikuar ky në Rregulloren kundër dhunës në familje. Gratë në Kosovë gjithashtu janë parandaluar nga

⁹³ Shih, për shembull, Vlora Basha dhe Inge Hutter për UNFPA, Qendra për kërkime të popullatës e Groningenit dhe raportin e Index Kosova, *Shtatzënia dhe planifikimi i familjes në Kosovë: Studim kualitativ* (Prishtinë: Dhjetor, 2006), 26. Shumica e pjesëmarrësve në grupet e tyre të fokusit janë pajtuar se “Shtatzënia gjithmonë është respektuar në kulturën e Kosovës,” dhe kanë përfunduar se “Gruaja shtatzënë trajtohet si fragjile dhe secili anëtar i familjes për rreth saj është më dashamirës. Ajo, po ashtu, fiton më shumë respekt.”

⁹⁴ RRGGK ka konstatuar se nga 47 gra shtatzëna që ndonjëherë kanë përjetuar dhunë në jetën e tyre, vetëm mbi gjashtë prej tyre nuk është ushtruar dhunë gjatë shtatzënise ose shtatzënive të shumëfishata. (28). Një grua ka vuajtur dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale gjatë secilës prej dhjetë shtatzënive të saj. QMG et al. po ashtu ka raportuar se 10.5 për qind e grave me partnerë të cilat i kanë intervistuar kanë qenë të “rrahura” gjatë shtatzënisë. (28).

⁹⁵ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 28.

marrja e kujdesit mjekësor, posaçërisht kujdesi shëndetësor riprodhues, për arsyen se anëtarët e familjes nuk do ta lejonin këtë, se burrat ishin xheloz, se ata duhej të mbronin nderin e familjes, për arsyen fetare dhe/ose për shkak të mungesës së mjeteve financiare.⁹⁶

Një analizë e RRGGK-së në shtrirje të Kosovës më tej ka vërtetuar këto gjetje të mëparshme të kërkimit. Gratë e anketuara kanë thënë se kanë përjetuar format e mëposhtme të dhunës derisa kanë qenë shtatzëna: sharje, fyerja, të qenët i urdhëruar për të shërbyer gjatë gjithë kohës, izolim prej miqve dhe të afërmve, kontroll i lëvizjeve, parandalim i vizitave të mjekut kur kanë qenë të sëmura, kërcënim, shuplakosje, të detyruara të kenë seks kur ato nuk kanë dëshiruar dhe detyrim për të bërë veprime seksuale të cilat ato nuk i kanë dëshiruar.

E katërta, një formë rrallë e diskutuar e dhunës në familje ka vënë në shenjë gratë kosovare që kanë përjetuar dhunën seksuale gjatë luftës.⁹⁷ Derisa ekziston një dokumentacion i paktë, aktivistët kanë raportuar se disa gra, të cilat kanë qenë të dhunuara nga forcat serbe gjatë luftës, kanë përjetuar izolimin, dhunën psikologjike e, madje, edhe atë fizike nga anëtarët e tyre të familjes. Medica Kosova, për shembull, ka vlerësuar se 90 për qind të femrave viktima të dhunimit të luftës, të cilat ato i kanë ndihmuar, nuk iu është dhënë mbështetje emocionale nga familjet e tyre.⁹⁸ Medica Kosova është detyruar të gjejë strehim për një grua të re të dëbuar nga shtëpia nga familja e saj për shkak të turpit derisa ajo ka lindur dhe ka gjetur prindër adoptues për fëmijën. Qendra për Rehabilitim për Viktimat e Torturës e Kosovës (QRVT) ka folur për një rast tjetër kur burri ka përdorur dhunën fizike dhe psikologjike kundër gruas së tij për arsyen se ai ka besuar se ajo ka dëshiruar të ketë marrëdhënie seksuale me forcat serbe të cilat e kishin dhunuar ate.⁹⁹ Një qasje psikosomatike dhe një dokumentim më i mirë i pacientëve i ndihmuar nga qendrat për punë sociale dhe personeli shëndetësor mund të siguronte informacion lidhur me përmasën e këtij fenomeni.

Dhuna kundër fëmijëve

Asnjë hulumtim, për të cilin dihet, nuk ka hulumtuar nga afër dhunën kundër fëmijëve në Kosovë. Derisa raporti i UNICEF-it, *Analizë e situatës së fëmijëve dhe grave në Kosovë* diskuton shkurtimisht çështjen, ky raport nuk siguron kurrfarë të dhënat të reja.¹⁰⁰ Në vitin 2008, as UNICEF-i e as Rrjeti i Veprimit i të Rinjve nuk kanë pasur hulumtim lidhur me përmasën e dhunës kundër fëmijëve, por përfaqësuesit e tyre theksojnë se dhuna kundër fëmijëve ekziston në Kosovë.¹⁰¹ Sipas Rrjetit të Veprimit të të Rinjve, një nga brengat më së shumti të shprehura në takimet e tyre ka qenë detyrimi, nga ana e prindërve, i të rinjve për të ndërprerë shkollimin e tyre dhe kryerja e punëve të rënda

⁹⁶ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 29-30.

⁹⁷ Derisa nuk ekzistojnë të dhëna konkrete për shkak të raportimit jo të plotë, vlerësimet e mëhershme lidhur me numrin e grave të dhunuara gjatë luftës kanë lëvizur prej 10 deri 45 mijë. Shih Michele Hynes dhe Barbara Lopes Cardozo, "Dhuna seksuale kundër grave në ambientet e refugjatëve" Revistë mbi shëndetin e grave dhe mjekësia në baza gjinore 9. nr. 8, (2000), 819-824, cituar nga QMG et al., 12; Corrin, "Situata post-konfliktuese në Kosovë," 93; dhe QMFG, *Vjetar 2003*, 136.

⁹⁸ Medica Kosova, bisedë telefonike, korrik 2008.

⁹⁹ KRCT, anketë e RRGGK-së, Prishtinë.

¹⁰⁰ UNICEF, *Analizë e situatës së fëmijëve dhe grave në Kosovë*, (Prishtinë: UNICEF Kosovë, 2004), 70-71.

¹⁰¹ Rrjeti i të Rinjëve i Kosovës dhe UNICEF-i, anketë e RRGGK-së, 2008. Rrjeti i të Rinjëve i Kosovës, një ombrellë e organizatave të të rinjëve, ka qenë në proces të finalizimit të raportit i cili heton shkallën në të cilën barazia gjinore është inkorporuar në Planin kombëtar të veprimit për rininë. Ata kanë përfunduar se Plani nuk e adreson barazinë gjinore dhe kanë bërë rekomandime të cilat duhet të inkuadrohen në Plan.

fizike, të paligjshme për disa nga anëtarët, të cilët nuk ishin të moshës madhore. Ata kanë vlerësuar se vetëm 10 për qind e rasteve të dhunës në familje janë të raportuara për arsy se shumë familje ende kanë struktura patriarchale vendimmarrëse dhe, rrjedhimisht, anëtarët e rinj të familjes janë të penguar në raportimin e dhunës. Kështu, SHPK-ja ka regjistruar vetëm 125 raste të dhunës kundër fëmijëve nga viti 2005 deri në vitin 2006.¹⁰²


Dhuna kundër fëmijëve është e vështirë të matet për arsy se njerëzit janë të prirur për ta përkufizuar dhunën në mënyra të ndryshme, siç e ilustron kapitulli i fundit. Derisa një person mund ta konsiderojë shuplakosjen dhunë, personi tjetër mund të mos e konsideroj këtë si dhunë. Së këndejmi, RRGGK-ja ka pyetur së pari të anketuarit se çfarë lloje të akteve ata kanë përdorur (ose do të përdornin nëse do kishin fëmijë) për të disiplinuar fëmijët e tyre, dhe, së dyti, nëse ata kanë përjetuar akte të dhunës në fëmijërinë e tyre. Grafiku 2.6 tregon llojet e disiplinimit që i kanë përdorur të anketuarit për të dënuar fëmijët e tyre: 19.4 për qind e të anketuarve i kanë rrahur me shuplaka fëmijët e tyre (125 gra krahasuar me 72 meshkuj), 2.5 për qind i kanë rrahur ata me rrip ose me shkop (16 gra krahasuar me 9 meshkuj) dhe 1.3 për qind “i kanë rrahur” fëmijët e tyre (katër meshkuj dhe nëntë gra). Njerëzit me nivel universitar të arsimimit kanë qenë më pak të prirur për të dënuar fëmijët e tyre me përdorimin e duarve, rripave, shkopinjve, derisa këto forma të dënimit kanë pasur prirje më shumë të përdoren nga njerëzit të cilët kanë qenë të papunë, që kanë pasur të hyra të ulëta, që kanë pasur më shumë fëmijë dhe/ose kanë jetuar në qytete ose qyteza (posaçërisht komuna e Obiliqit). Megjithëkëtë, metodat e dënimit duket të jenë në ndryshim e sipër; të anketuarit me moshën 46 vjeçare e më të vjetër kanë qenë deri diku më të prirur për të dënuar fëmijët e tyre me anë të shuplakosje, rripit ose shkopit se sa brezat e ri.¹⁰³

¹⁰² Për shembull, një zyrtar i SHPK-së ka thënë se ata e kanë ndihmuar një djalë të vogël të cilin njerka e tij e kishte keqpërdorur. Babai i djalit e kishte bërë një shtrat dhe një vend për te për të ngrënë dhe e kishte izoluar ate në kulmin e shtëpisë.


¹⁰³ Gjysma e të anketuarve kanë parë prindërit të shuplakosin fëmijët e tyre.

Grafiku 2.6 Si dënuhen fëmijët


■ Femradhe Mëshkuj te anketuar ■ Të anketuarit mëshkuj ■ Të anketuarat femra



Me qëllim që të përcaktohet shkalla, në të cilën të anketuarit kanë trajtuar fëmijët meshkuj dhe gra në mënyrë të ndryshme, ata janë pyetur se si i kanë dënuar vajzat dhe si i kanë dënuar djemtë. Përafërsisht 10 për qind e tyre kanë thënë se vajzat dhe djemtë kanë qenë të dënuar në mënyra të ndryshme. Duket interesante të thuhet se të anketuarit nuk janë pajtuar lidhur me atë se i kanë trajtuar ndryshtë, siç e ilustron grafiku 2.7. Rreth gjysma e këtyre të anketuarve kanë thënë se vajzat janë dënuar më pak se sa djemtë, derisa afërsisht gjysma tjetër ka thënë se vajzat kanë qenë të dënuara më ashpër se sa djemtë. Derisa 8 syresh kanë thënë se djemtë janë rrahur, 6 të anketuar të tjerë kanë thënë se vajzat janë rrahur.



Pastaj, të anketuarit janë pyetur se kur kanë qenë fëmijë si janë dënuar ata zakonisht nga prindërit e tyre nëse ata janë sjellur keq. Dhjetë për qind e të gjitha grave, 19 për qind e të gjithë burrave dhe 14.2 për qind e të gjithë të anketuarve kanë përjetuar dhunën fizike në fëmijërinë e tyre, duke përfshirë të rrahjen, grushtimin, shqelmosjen ose goditjen me shkop a rrip. Pos kësaj, 27.2 për qind e të anketuarve kanë qenë të shuplakosur nga anëtarë i familjes gjatë fëmijërisë së tyre. Siç e tregon grafiku 2.8, më shumë gra (213) se sa burra (135) kanë thënë se ata nuk kanë qenë të dënuar fare. Shumica e të anketuarve (31.8 për qind) kanë thënë se prindërit i kanë shpullosur. Vetëm 1.1 për qind e të anketuarve kanë thënë se kanë qenë të rrahur. Pak më pak se 5 për qind e tyre kanë qenë rrahur me rrip ose me shkop.



Kur merren parasysh përvojat e fëmijërisë të të anketuarve, është interesant të vërehet se një përqindje e ngashme e grave dhe e burrave kanë përfjetuar dhunën fizike gjatë jetës së tyre për arsy se djemtë kanë qenë përafërsisht tri herë më të prirur se sa vajzat të jenë të dënuar me anë të mjeteve të dhunshme. Për shembull, një burrë në moshë të mesme ka rikujtuar se si babai dhe njerka e tij e kanë rrahur derisa e kanë detyruar të braktis shkollimin në një moshë të re në mënyrë që ai të mund të fitonte para për familjen e tij.¹⁰⁴ Të anketuarit që kanë jetuar në Skenderaj, Klinë dhe Fushë Kosovë kanë qenë më të prirur të përjetojnë dhunën në fëmijërinë e tyre. Njerëzit në moshën 25 vjeçare e sipër kanë qenë më të prirur për të përfjetuar dhunën, që mund të tregojë një ndryshim në llojet e dënimit të përdorur nga prindërit.

Si përfundim, dhuna kundër fëmijëve mund të ndodh në shkallë të ngashme ose madje edhe më të lartë se sa dhuna kundër partnerëve. Sidoqoftë, mund të jetë e rrallë, nëse ndonjëherë nuk raportohet fare, për arsy se fëmijët, për shkak të moshës së tyre, nuk kanë njohuri ose qasje ndaj ndihmës. Hulumtimet plotësuese mbi dhunën kundër fëmijëve janë të nevojshme. Edhe pse stilet e disiplinës mund të ndryshojnë me një gjeneratë të re të prindërve, fushatat e ndërgjegjësimit mund të shërbijnë për të zhveshur mitet që vajzat dhe djemtë duhet të disiplinojnë në mënyra të ndryshme. Emisione të bisedave dhe fushata të arsimimit prindëror mund të tregojnë se disiplina e

“[Kur kam qenë fëmijë,] një kusheri i afërm tentoi të më dhunoj. Ai më kapi, më zhveshi, ndërsa unë fillova të qaj dhe të mos dorëzohem; nuk e di as vet se si kam ikur.”

– Një grua e strehuar – viktimi e dhunës, cituar nga RRGK-ja, studimi hulumtues

¹⁰⁴ Një burrë i martuar serb i moshës 46-55 nga komuna e Zubin Potokut. Partners Kosova po ashtu janë marrë me rastet e dhunës kundër fëmijëve. (anketë e RRGK-së, 2008).

barabartë dhe posaçërisht e padhunshme mund të përmirësojë zhvillimin e fëmijës si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Meqë fëmijët mund të kenë vështirësi në komunikimin e rasteve të dhunës ose në qasjen ndaj shërbimeve të ndihmës, arsimimi lidhur me dhunën duhet të përfshihet në shkollat fillore dhe të mesme me shembuj, informacione të lehta për t'u kuptuar në mënyrë që fëmijët të mësojnë se ku mund të gjejnë ndihmën nëse ajo iu nevojitet. Duhet të përkrahen linjat e ndihmës me staf të trajnuar për fëmijë pér të raportuar raste të dhunës. Shkollat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e rasteve të tilla dhe në ofrimin e asistencës e të mbrojtjes ndaj këtij grupi posaçërisht të ndjeshëm të qytetarëve.

Dhuna kundër të moshuarve

Edhe pse më pak e zakonshme, ekzistojnë raportime të vjehërrve e të vjehrave të moshuara që kanë përjetuar dhunën nga nuset ose burrat e rinj të martuar. Një grua e anketuar ka thënë se vjehrri i saj ka përjetuar dhunë psikologjike nga gruaja e djalit të saj më të ri. Në këtë aspekt, SHPK-ja ka regjistruar tri raste të dhëndurëve që kanë ushtruar dhunën kundër vjehërrve të tyre. Një zyrtar i SHPK-së po ashtu ka treguar pér një grua plakë e cila ishte nxjerrur me dhunë jashtë shtëpisë nga djali i saj, në mesin e "shumë" rasteve të tjera,¹⁰⁵ dhe një AV ka rikujtuar rastin e një gruaja në të tetëdhjetat që ecte e zbathur përafërsisht 50 kilometra pér të shkuar te stacioni i policisë pér të kërkuar ndihmë.¹⁰⁶ Një i anketuar ka përshkruar situatën e një dajës së tij si më poshtë:

(Ai) nuk ka familje të tij, por ka jetuar me vëllanë e vet. Ai është në moshën 78 vjeçare dhe përjeton dhunën nga fëmijët e vëllait të tij. (Ata janë të moshës 18-20 vjeçare.) Ata e marrin pensionin e tij. Ata e shfrytëzojnë pronën e tij. Ata e tërheqin, a rrahin ate. Plaku vjen pér t'u ankuar te familja jonë shumë shpesh. Ai pyeste se ku mund të kërkonte ndihmë, por nuk dinte se ku të shkonte. Ai nuk mund ta lëshonte fshatin. Do të ishte shumë mirë pér të gjetur një vend të sigurt pér të ku mund të rrinte, një strehimore pér pleqtë.

Të anketuarit e moshuar kanë thënë se kanë përjetuar format e mëposhtme të dhunës në moshën e tyre të vjetër: thirrje me emra fyes, (7 të anketuar), sharje (10), urdhërim gjatë gjithë kohës (20), moslejim pér të vizituar miqtë ose të afërmit (11), të kontrolluar se ku munden e ku nuk munden të shkojnë (13), të detyruar të ndjehen fajtor gjatë gjithë kohës (8), të tjerët i kanë marrë vendimet e rëndësishme pér ta pa i pyetur fare ata (11), refuzim parash pér diçka që kanë pasur nevojë (11), nuk iu është lejuar të punojnë (8), nuk iu është lejuar të shkojnë te mjeku kur kanë qenë të sëmurë (5), të kërcënuar se do të lëndohen (2), të kërcënuar me armë (2), prona e tyre me qëllim është shkatërruar (6), janë shuplakosur (6), janë goditur, shqelmosur ose grushtuar (3), janë prekur seksualisht në një mënyrë në të cilën ata nuk kanë dashur të janë të prekur (3), të detyruar të kenë marrëdhënie seksuale atëherë kur nuk kanë dashur (4), dhe janë shtrënguar të bëjnë veprime seksuale të cilat nuk kanë dashur t'i bëjnë. Ka nevojë pér hulumtim të mëtejmë pér të dokumentuar shkallën e dhunës të ushtruar kundër pleqve.

¹⁰⁵ Partners Kosova ka ndihmuar në ndërmjetësimin e rasteve të dhunës kundër të moshuarve (anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁰⁶ Avokimi i Viktimave (AV) në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008.

Dhuna kundër persona me nevoja të veçanta

Në pajtim me Ligjin kundër diskriminimit, njerëzve me nevoja të veçanta fizike dhe psikologjike u është garantuar qasja e barabartë ndaj arsimimit, punësimit dhe vendeve publike.¹⁰⁷ Megjithëkëtë, gratë dhe fëmijët, që kanë nevoja të veçanta, konsiderohet se janë në rrezik të veçantë të dhunës në familje.¹⁰⁸ Prapëserapë, kërkimet e hollësishme duhet të hulumtojnë mbizotërimin e dhunës në familje kundër njerëzve me aftësi të kufizuara në Kosovë, ku SHPK-ja ka regjistruar një rast të vetëm të braktisjes dhe të keqtrajtimit të personit me aftësi të kufizuar.¹⁰⁹ Ngaqë familjet shpesh i izolojnë njerëzit me nevoja të veçanta për shkak të turpit (një formë e dhunës në vetvete) identifikimi i shkallës së dhunës në Kosovë është sfidues. Një përfaqësues i Handikos-it, Prishtinë, ka thënë: "Ka raste kur njerëzit me paaftësi fizike nuk lejohen të dalin nga shtëpia për shkak të turpit. ... Familjet zakonisht i fshehin nga të tjerët." Izolimi mund të ketë kuptimin e rasteve kur fëmijët me nevoja të veçanta nuk kanë qasje ndaj arsimimit. Sipas UNICEF-it, vetëm 16 për qind e fëmijëve me nevoja të veçanta shkojnë në shkollat e rregullta dhe kjo ndikon mbi aftësinë e tyre për të gjetur punësim dhe i bënë ekonomikisht të varur nga të tjerët.¹¹⁰

Intervistat me përfaqësuesit e organizatave që i ndihmojnë njerëzit me nevoja të veçanta si Handikos-i dhe Shoqata e Grave të Verbra tregojnë se dhuna është mjaft mbizotëruese. Përfaqësuesit kanë hasur një numër të madh rastesh të dhunës, posaçërisht kundër grave dhe fëmijëve.¹¹¹ Ata kanë raportuar raste të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale në marrëdhëni të familjave. Në Prizren, përfaqësuesja e Handikos-it ka raportuar se më shumë se 50 për qind e 1.022 njerëzve të regjistruar deri në vitin 2007 kanë përjetuar dhunën në familje, zakonisht dhunën psikologjike.¹¹² "Çdo javë" ajo ka hasur në rastet kur njerëzit me nevoja të veçanta në mënyrë të pandërprerë janë kritikuar nga anëtarët e tjerë të familjes, iu janë drejtuar në mënyrë fyeze, janë sharë, izoluar, janë shtrënguar të ndjehen fajtor gjithë kohën, për ta janë marrë vendimet pa pëlqimin e tyre, pensionet e tyre janë harxhuar nga anëtarët e tjerë të familjes ose kanë qenë të kërcënuar se do të largohen nga shtëpitë e tyre. Handikos-i iu ka ndihmuar të gjejnë strehim njerëzve të dëbuar nga shtëpitë e

"Dhuna ka ndodhur për arsy e paaftësisë mendore të gruas. Burri i saj e kishte përdorur dhunën fizike kundër saj. Rasti i është raportuar policisë dhe situata duket të jetë kohët e fundit më e qetë. Qeveria ka nevojë të jetë më e kujdeshme për... rastet e njerëzve me probleme psikologjike, për t'iu siguroj atyre kushte më të mira jetësore."

– Një grua në mezomoshë nga Peja

¹⁰⁷ Kuvendi i Kosovës, Ligji kundër diskriminimit, nr. 2004/3, kap I, nen. 2(a) thotë, "Parim i trajtimit të barabartë do të thotë se nuk duhet të ketë diskriminim të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë kundër cilitdo person ose personave, bazuar në gjininë, moshën, statusin martesor, gjuhën, paaftësinë mentale ose fizike, orientimin seksual, përkatësinë ose bindjen politike, grupin etnik, kombësinë, fenë ose besimin, origjinën sociale, pronën, lindjen ose çfarëdo statusi tjetër."

¹⁰⁸ Këshilli i Evropës, (KE) Propozim i planit të veprimit mbi "Dhunën kundër grave në Evropë" (1998).

¹⁰⁹ SHPK, anketa e RRGGK-së, 2008.

¹¹⁰ UNICEF, Analizë e situatës, 75.

¹¹¹ Handikos-i është OJQ me degët e saj të vendosura anë e kënd Kosovës. Që nga vitet 1990-të, organizata ka punuar për të regjistruar njerëzit me aftësi të kufizuara dhe ofron një shumësi programe të arsimuese, sportive dhe terapeutike. Handikos-i ka degën e zyrës së saj të gruas dhe një numër zyrash të degëve të udhëhequra nga gratë që i kushtojnë në mënyrë të veçantë vëmendje nevojave të grave dhe të fëmijëve. Për më shumë informacion, kontaktoni RRGGK-në.

¹¹² Dhuna psikologjike dhe ekonomike kanë qenë më e zakonshme se sa dhuna fizike, ka thënë ajo.

tyre prej anëtarëve të familjes. Një zyrtar i SHPK-së nga Prizreni ka komentuar: "Familjet janë shumë të dhunshme ndaj [njerëzve me paaftësi mendore]. Ka shumë raste."¹¹³

Në Prishtinë, Handikos-i ka vlerësuar se përafërsisht 20 për qind e 600 anëtarave gra kanë qenë viktima të dhunës psikologjike. Ata kanë hasur edhe në raste të tjera të dhunës ekonomike, kur të hyrat e tyre nga OJQ-të ose qeveria janë shfrytëzuar nga anëtarët e familjeve të tyre. Disa familje i kanë martuar femrat e reja ma aftësi të kufizuara pér njerëz të moshuar ose kundër vullnetit të tyre. Disa burra kanë jetuar me gra të hendikepuara, por ligjërisht kanë refuzuar të martohen, kanë thënë përfaqësuesit. Në situatat e tilla, gruaja nuk ka pasur të drejta ligjore mbi pronën; mashkulli mund të martonte një grua tjetër; dhe, herë pas herë, ato janë shfrytëzuar vetëm pér lindje të fëmijëve. "Ata po ashtu shfrytëzojnë gruan me aftësi të kufizuara, duke u martuar me to vetëm pér të lindur fëmijë dhe pastaj duke mos iu lejuar të kujdesen pér fëmijët e tyre pér arsy se burrat tashmë kishin qenë të martuar me një grua tjetër", kanë thënë përfaqësuesit e Handikos-it.¹¹⁴ "Ka raste kur fëmijët nuk e kanë ditur se një grua me aftësi të kufizuara ka qenë nëna e tyre." Të paprona siç ishin, nëse ato dëshironin ta lëshojnë shtëpinë, atëherë mund të humbnin kujdestarinë ndaj fëmijëve të tyre. Përfaqësuesit e Shoqatës së Grave të Verbra po ashtu kanë thënë se kanë hasur çdo ditë njerëz të verbër të cilët familjet i kishin izoluar, kishin sjellur vendime pér ta pa i pyetur dhe kishin refuzuar t'iu jepnin para kur këta kishin nevojë pér to.

Për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore fizike dhe psikologjike, njerëzit me aftësi të kufizuara mund të kenë probleme me komunikimin, vështirësi fizike në raportimin e dhunës ose në arritjen e qasjes ndaj shërbimeve të ndihmës. Përfaqësuesit e Handikos-it kanë rekomanduar zbatimin e ligjit të tashëm dhe sigurimin se njerëzit me aftësi të kufizuara të kenë qasje në të drejtat e barabarta, duke përfshirë trashëgiminë e pronës, qasjen e barabartë në arsimimin, mundësitet pér punësim; kjo ndoshta do të mund të bëhej përmes stimulimeve tativore pér biznese, përfaqësimit në qeveri dhe infrastrukturës, e cila iu mundëson qarkullimin e lirë (pra, qasjen e karrocës invalidore në të gjitha objektet). Ata, po ashtu, kanë rekomanduar që strehimi pér personat me aftësi të kufizuara të vihet në dispozicion. Mbledhja e mëtejme e të dhënavë lidhur me shkallën e dhunës dhe veçanërisht nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara mund t'i ndihmojnë OJQ-të dhe qeverinë që më mirë të planifikojnë programet e asistencës.

Dhuna kundër njerëzve pér shkak të orientimit të tyre seksual

Rrallëherë e diskutuar më parë, dhuna kundër minoriteteve seksuale publikisht është diskutuar vetëm kohët e fundit.¹¹⁵ Edhe pse Ligji kundër diskriminimit shprehimisht i përmend minoritetet seksuale si kategori të mbrojtura,¹¹⁶ sipas organizatës Elysium, personat të cilët identifikohen si homoseksual shpesh përfjetojnë dhunën psikologjike në familje. Një përfaqësues i saj ka siguruar shembullin e një të riu, familja e të cilët pandërprerë ka ushtruar trysni mbi të që ai të martohet. Si rezultat i kësaj, ai ka qenë i detyruar të braktis familjen e tij. Edhe nëse familjet e tyre nuk e dinë orientimin e tyre seksual, anëtarët e familjes mund të bisedojnë negativisht lidhur me homoseksualitetin dhe t'i ofendojnë ata, ka thënë një përfaqësues i Elysium-it. Disa homoseksualë po ashtu përfjetojnë dhunën fizike kur familjet e tyre kuptojnë orientimin e tyre seksual.¹¹⁷ Një aktiviste tjetër, e cila është marrë me

¹¹³ SHPK-ja në Prizren, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹¹⁴ Handikos Prishtina, anketë e RRGGK-së, Qershori, 2008.

¹¹⁵ Një film i prodhuar nga Crossing Bridges, *Përtej ylberit*, paraqet përvojat e homoseksualëve në Kosovë (2007).

Premiera e shfaqjes së filmit në Kosovë është shoqëruar nga një debat lidhur me çështjen.

¹¹⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji kundër diskriminimit, nr..2004/3, kap. I, nen 2(a).

¹¹⁷ Elysium dhe Qendra pér Emancipimin e Grave, anketa e RRGGK-së, 2008.

këtë çështje, ka thënë se homoseksualët, familjet e të cilëve i detyrojnë ata të martohen kundër vullnetit të tyre përjetojnë dhunë seksuale nga partnerët e tyre. Ata përjetojnë dhunën ekonomike nëse ata refuzojnë të martohen për arsyen se familjet e tyre nuk e ndajnë pronën me ta. Ajo ka folur për një të ri, i cili ka qenë dëbuar nga shtëpia e familjes së tij dhe e ka përjetuar dhunën e vazhdueshme fizike nga vëllai i tij. Për një kohë të shkurtë, ai ka qenë i pastrehë dhe, si rezultat i kësaj, ka qenë i detyruar të ndërpresë shkollimin. Pasi është strehuar nga Qendra për Emancipim Social, ai e ka siguruar azilin në Shtetet e Bashkuara. Ata kanë theksuar nevojën përfushata të arsimimit se dhuna kundër anëtarëve homoseksualë të familjes është dhunë e ndjekur penalisht sipas ligjit.

8. Kush janë kegtrajtuesit? Personat më të prirur për të kryer dhunën në familje

Në përgjithësi, institucionet kanë kultivuar më shumë informacion mbi viktimat se sa përkryerësit e dhunës. Prapë, informacioni mbi kryerësit e dhunës dhe arsyet pse ata përdorin dhunën është thelbor për qeverinë dhe OJQ-të për të planifikuar programet me objektiva të caktuara dhe efikase të parandalimit dhe të rehabilitimit. I vetmi përfundim i qartë i cili mund të nxjerret nga të dhënat ekzistuese është se ekziston tendenca që kryerësit e dhunës të janë meshkuj. Sipas të dhënave të SHPK-së nga viti 2006 deri 2007, 91.1 për qind e kryerësve të dhunës në familje kanë qenë meshkuj dhe vetëm 8.9 për qind kanë qenë gra. Nga kryerësit e dhunës, 81.9 për qind kanë qenë shqiptarë, 9.9 për qind serbë, 0.7 për qind turq, 1.9 për qind boshnjak, 3.8 për qind romë/ashkanli, 0.4 për qind goranë dhe 1.5 për qind “të tjere”. Në këtë drejtim, ekziston nevoja e një regjistrimi të përgjithshëm të popullsisë dhe e një hulumtimi të hollësishëm në mënyrë që saktësish të përfundohet nëse dhuna është më e pranishme në ndonjë grup të veçantë etnik.

Tetëdhjetë e tetë për qind e grave të interviewuara nga RRGGK-ja në vitin 2007 kanë përjetuar dhunën nga duart e një partneri intim ose të ish-burrit, 10 për qind kanë përjetuar dhunën nga anëtarët e tjerë të familjes dhe 1 për qind nga fëmija i vet.¹¹⁸ Tetëdhjetë e dy për qind kanë jetuar me keqtrajtuesit e tyre në kohën e ushtrimit të dhunës, 80 për qind kanë qenë të lënduara përpara nga i njëjti keqtrajtues dhe 91 për qind kanë përjetuar dhunën nga i njëjti keqtrajtues shumë herë në vitin paraprak. Në mënyrë të ngashme, sipas të dhënave të SHPK-së, nga viti 2006 dhe 2007, burrat, në masë të madhe, kanë qenë kategoria më e prirur e personave që kanë kryer dhunën në familje, duke përbërë më shumë se 56 për qind të kryerësve të dhunës.¹¹⁹


Kryerësit e dhunës kundër personave të njohur për të anketuarit e RRGGK-së në vitin 2008, kryesisht kanë qenë partnerët meshkuj.¹²⁰ Në mesin e 362 të anketuarve, të cilët janë përgjigjur se kush ka kryer dhunë kundër tyre, shumica, (58 për qind) ka përjetuar dhunën nga etërit e tyre dhe 40.9 për qind nga nënat e tyre (grafiku 2.9). Vlen të theksohet se të

¹¹⁸ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 19.

¹¹⁹ Nga 2.430 marrëdhënie të regjistrueshme nga SHPK-ja në vitin 2006 dhe 2007, marrëdhëni e tjera midis kryerësve të dhunës dhe viktimate të regjistrueshme nga SHPK-ja: babai i dhëndrit / nuses, njerku, jetimi, njerka/jetimi, tezja/halla/ nipi, gjyshi/nipi, daja/axha/ mbesa, nëna/e bija, kunata, babai/ e bija/djali, partnerët në bashkëjetesë, ish- burri, vjehrri/ nusja, babai/e bija, nëna/djali, kunata/kunati, vjehrri/nusja, babai/daja(axha), motra/vëllai, vëllai/vëllai, prindit/fëmija, burri, gjyshja/gjyshi/dhëndëri, motra, kunata/kunata, tezja(halla)/mbesa, kushëriri/kushëriri, i, e fejuara. nipi/mbesa dhe kombinimet tjera të marrëdhënieve të sipërpermendura. Regjistrimi nuk e qarteson se kush është ka kryer dhunën në këto relacione.

¹²⁰ Sërisht, gratë viktima të dhunës në familje të njoitura nga të anketuarit kanë qenë shumë më të prirura se sa meshkujt për të përjetuar dhunën nga partnerët e tyre; derisa 221 gra kanë vuajtur nga dhuna prej burrave të tyre, vetëm 20 burra kanë vuajtur dhunën nga gratë e tyre. Kryerësit e tjerë të dhunës kundër personave të njoitur nga të anketuarit kanë përfshirë baballarët, vëllezërit dhe kunetërit, bijtë, nënët, vjehrrat, vjehrrit dhe bjiat, midis të tjerash.

anketuarit meshkuj kanë qenë më shumë se dyfishi dhe pothuajse kanë pasur dy herë gjasa më shumë se të anketuarat femra që të përjetojnë dhunë nga etërit e tyre. Gratë dhe burrat gjithashtu kanë përjetuar dhunën nga vëllezërit e tyre (15.5 për qind). Të anketuarit (17.4 për qind) kanë përjetuar dhunën edhe nga partnerët e tyre. Sërisht, gratë kanë qenë më shumë se nëntë herë më të prirura për të përjetuar dhunën nga partnerët e tyre se sa burrat. Kryerësit e tjerë të dhunës kanë qenë vjehrrat, kunetërit, kunatat, motrat, axhët, dajët dhe njerkët, midis të tjerash (pra, kushërinjtë, gjyshet, gjyshat dhe vajzat).



Kërkimet gjetiu në botë kanë sugjeruar se alkoolizmi dhe narkomania mund të rrisin gjasën për ndodhjen e dhunës.¹²¹ Së këndejmi, disa qeveri kërkojnë nga institucionet, siç janë policia dhe punëtorët socialë, të mirëmbajnë të dhënat mbi shkallën në të cilën alkooli dhe drogat janë të përfshira në mosmarrëveshjet familjare.¹²² Ngaqë institucionet nuk e kanë mbledhur këtë informacion në një bazë të të dhënave në Kosovë, është e vështirë të dihet saktësisht shkalla në të cilën kryerësit dhunës ose viktimat e dhunës në familje mund të kenë përdorur alkoolin dhe/ose drogat. Sidoqoftë, shumë të anketuar të RRGGK-së ia atribuojnë dhunën alkoolit. Për shembull, një grua e cila ishte shkurorëzuar nga burri i saj ka thënë se ka përjetuar dhunën psikologjike, fizike dhe ekonomike. Burri i saj, i cili ka qenë një alkoolik, e ka rrahur atë.¹²³ Një grua tjetër ka thënë: "Ish-partneri im më ka rrahur me rrip, por unë nuk e konsideroj këtë dhunë në familje për arsy se ne nuk

¹²¹ Lidhur me alkoolin, shih, për shembull, B. Ollett, "Alkooli dhe krimi: Një perspektivë e ndihmës përgruan: Shkaqet e dhunës familjare" *Nga problemet te zgjidhjet, Punime të konferencës mbi alkoolin dhe krimin, si dhe veprimet kundër alkoolit*, Uells, (1994); B.M. Quigley dhe K.E. Leonard, "Alkooli dhe vazhdimi i agresionit të hershem martesor," *Alkoolizmi: Kërkim klinik dhe eksperimental*, Vell. 24(7) (Shoqata e Kërkimit mbi Alkoolin, 2000), 1003-1010; H.R. White dhe P-H Chen, "Problemet e pirjes së alkoolit dhe dhuna midis partnerëve intim," *Revistë mbi studimin e alkoolit*, 63 (2002), 205–214.

¹²² Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, kjo është praktikë standarde dhe është e inkuadruar në format standarde institucionale, duke përfshirë format e shfrytëzuara nga strehimoret e OJQ-ve të mbështetura plotësisht ose pjesërisht nga qeveria.

¹²³ Grua serbe, mosha 36-45 nga komuna e Shtërpces.

kemi qenë të martuar. Ai ka pirë shumë. Ai nuk ka pasur kufi në pije dhe unë kam qenë viktimi e dhunës fizike dhe psikologjike.”¹²⁴

Personat që kanë përjetuar dhunën po kështu mund të kenë më shumë gjasa që edhe të kryejnë dhunën. Burrat, të cilët kanë përjetuar dhunën gjatë fëmijërisë së tyre ose gjatë luftës,¹²⁵ mund të përdorin dhunën kundër anëtarëve të familjes. Gratë mund të kryejnë dhunë kundër burrave të tyre të cilët në mënyrë të përsëritur i kanë keqtrajtuar ato. Për shembull, një ZSHS e ka përshkruar një rast:

Pas grindjes që ata kanë pasur në prani të fëmijëve të tyre, gruaja ishte duke e përgatitur drekën dhe burri i saj grindej me të. Ajo nuk dinte se çfarë të bënte dhe, kështu, e kishte goditur me thikë në këmbë. Rasti ishte raportuar në polici, dhe gruaja ishte burgosur në kohëzgjatje prej tre muajsh me një vit lirim me kusht. Ajo ka qenë viktimi e dhunës në familje më herët. Burri i saj ka qenë i dhunshëm me të, por ajo kurrë nuk e ka thirrur policinë. Gruaja ka qenë e maltretuar nga burri deri në pikën sa kocka e nofullës së saj ishte thyer.¹²⁶

Në vendet e tjera, “sindroma e grave të dëmtuara nga rrahja” ose “sindroma e personave të dëmtuar nga rrahja”, ku dhuna e përsëritur e çon viktimin të përdorë dhunë ndaj të tjerëve është shfrytëzuar në mbrojtjen ligjore të personave, zakonisht të grave, të akuzuara për krimë siç janë sulmi fizik ose vrasja..¹²⁷

Hulumtimet e zhvilluara gjetiu po ashtu kanë sugjeruar se fëmijët e keqtrajtuar kanë më shumë gjasa të kryejnë dhunë sesa ata që nuk kanë përjetuar dhunë. Një i anketuar në anketën e RRGGK-së ka përshkruar një rast të tillë: “Fqinji im, i cili tash është rrëth moshës 37 vjeçare, ka qenë i rrahur nga babai dhe vëllai i tij. Tash ai ka probleme psikologjike dhe shëndetësore. Policia kishin ardhur dhe e kishin marrë vëllanë. Babai i tij kishte vdekur, por ai (fqinji) është shumë i rrezikshëm për fëmijët e tjerë.”¹²⁸ Në Kosovë nuk ekziston një hulumtim longitudinal nëse fëmijët e keqtrajtuar janë më shumë ose më pak të prirur për të kryer dhunën se sa fëmijët e tjerë, por në të ardhmen profesionistët e trajnuar mund ta bëjnë një hulumtim të tillë.¹²⁹

¹²⁴ Grua serbe, mosha 46–55 nga komuna e Mitrovicës. Një burrë tjetër ka thënë se ai e dinte një rast në të cilin “Dhuna ndodhë për arsy se burri i saj e pinte alkoolin. Ai e kishte zakon ta përdorte dhunën mbi të. Gruaja e tij e ka raportuar dhunën në polici dhe pas kësaj burri i saj e ka ndryshuar pozitivisht sjelljen e tij.” (Burrë shqiptar, mosha 18-25 nga Peja).

¹²⁵ Mary Ann Liebert, “Gruaja, lufta dhe dhuna: Duke mbijetuar dhunën” *Revistë mbi shëndetin e gruas*, Vëll. 17, Nr. 5 (2008), 793.

¹²⁶ ZSHS, Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008. Ky rast po ashtu duket se ilustron pabarazinë në një sistem i cili e ka dënuar gruan për dhunën që ajo e ka kryer, por jo mashkullin, edhe pse të dytë kanë kryer krimë.

¹²⁷ Një varg i gjatë i literaturës dhe i debatit është në dispozicion lidhur me sindromin e personave të dëmtuar nga dhuna dhe posaçërisht të grave të dëmtuara nga dhuna. Shih, për shembull, D. L. Roth dhe E. M. Coles, “Sindromi i grave të dëmtuara nga dhuna: analizë konceptuale e statusit të tij përbashkët çregullimeve mendore të MDS,” *Mjekësia dhe ligji*. Vëll. 14(7-8) (1995), 641-658.

¹²⁸ Grua shqiptare, mosha 56-66 nga komuna e Lipjanit.

¹²⁹ Hulumtuesit duhet të jenë me kualifikim të lartë dhe të kalojnë nëpër një proces të rishikimit për kërkim me genie njerëzore për t'u siguruar se kërkimi i tyre do të minimizojë ose jo dëmin tek personat të cilët i studiojnë. Fatkeqësisht, Kosova tash nuk ka një bord për rishikimin e praktikave të hulumtimeve, dhe hulumtimet e zhvilluara me qenjet njerëzore mund të jenë të dëmshme ose (ri)traumatizuese. Do të ishte e këshillueshme për qeverinë që menjëherë të themelojë një komision të tillë të rishikimit të përbërë nga trajnuesit, profesionistët pa paragjykime dhe me tregues të fuqishëm të zhvillimit të hulumtimeve cilësore për të rishikuar gjithë kërkimin e zhvilluar në Kosovë me genie njerëzore.

KAPITULLI 3

PASOJAT E DHUNËS NË FAMILJE

Ndikimi negativ i dhunës mbi njerëzit dhe posaçërisht mbi shëndetin psikologjik, fizik dhe riprodhues të femrës është dokumentuar mirë në nivel ndërkombëtar.¹ Që nga viti 1993, Raporti i Zhvillimit Botëror ka shprehur se dhuna ka qenë “shkak po aq serioz i vdekjes dhe i gjyqtimit në mesin e grave të moshës së riprodhimit sa edhe kanceri dhe një shkak më i madh i shëndetit të keq sa aksidentet e trafikut dhe malaria së bashku.”² Asambleja e Shëndetit Botëror e ka shpallur dhunën prioritet shëndetësor publik në vitin 1996, pas së cilës Organizata Botërore e Shëndetësisë ka analizuar dhe ka raportuar implikimet shëndetësore të formave të ndryshme të dhunës, duke përfshirë edhe dhunën në familje.³

Një kohë të gjatë pas mjekimit të menjëhershëm ose afatshkurtër të lëndimeve të dhunës familjare, dhuna mund t'i kontribuojë problemeve kronike shëndetësore. Pas studimit të tyre në Amerikën Latine dhe Karaibe, Morrison, Ellsberg dhe Bott kanë konstatuar se “lëndimet – përpara të konsideruara si pasojat më të zakonshme të dhunës – përfaqësojnë vetëm majën e ajsbergut, dhe se dhuna në mënyrë të duhur është e konceptualizuar më shumë si faktor rreziku për problemet shëndetësore se sa gjendje shëndetësore vetveti.”⁴ Kërkimet e mëherdhme anë e kënd botës kanë ilustruar se si dhuna mund të ndikojë në shkaktimin e dhembjes akute dhe kronike;⁵ në sindromin e dhembjes kronike të lukthit;⁶ sistemet gastrointestinale, muskulore, riprodhuese dhe urinare.;⁷ në gjendjet e shtypjes së lartë të gjakut⁸ dhe në ato psikologjike.⁹ Dhuna seksuale, qoftë kur ndodh ose kur nuk ndodh në marrëdhëni familjare, mund t'i kontribuojë dhembjes kronike të komblikut, tumoreve dhe shterpësisë; dhembjes gjatë menstruacioneve ose marrëdhënieks seksuale, sëmundjeve inflamatore të komblikut; disfunkcioneve seksuale; infeksioneve të traktit urinar; tajimit vaginal, gjakderdhjes ose infekzionit;¹⁰ sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, duke përfshirë SIDA-në (HIV);¹¹ dhe shtatzënësë së padëshirueshme..¹² Mekanizmat e viktimave për përballimin e dhunës në familje mund të përfshijnë hidhërimin, ankthin, tërheqjen emocionale, mohimin, impulsivitetin, agresivitetin, frikën, çregullimin e stresit post-traumatik, trembjen,

¹ Shih, QMG et al., 10. Dy paragrafet e para të nxjerra nga RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 34.

² Cituar në QMG et al., 10.

³ E. Krug, J. Mercy, L. Dahlberg, A. Zwi, “Raporti botëror mbi dhunën dhe shëndetin,” *The Lancet*, Vëll. 360, Iss. 9339, pp. 1083 – 1088.

⁴ “Adresimi i dhunës në baza gjinore në rajonin Lationo-amerikan dhe Karabian: Vështrim kritik i intervenimeve,” cituar në QMG et al.

⁵ Grisso, Wishner, Schwarz, dhe Weene 1991; Mullerman Lenaghan, dhe Pakieser, 1996; Varvaro dhe Laska 1993. Goldberg dhe Tomlanovich 1984; Campbell, Snow-Jones, Dienemann, Kub, Schollenberger, O’Campo, Gielen, dhe Wynne 2002; Coker, Smith, Bethea, King, dhe McKeown, 2000, cituar në QMG et al., 10.

⁶ Drossman, Leserman, Nachman, Li, Gluck, Toomey, Mitchell 1990; Leserman, Li, Drossman, Hu, 1998, cituar në QMG et al., 11.

⁷ Martinez, Garcia-Linares, dhe Pico-Alfons 2003, cituar në QMG et al., 10.

⁸ Rodriguez 1989; Coker et al. 2000; Letourneau, Holmes, Chasedunn-Roark 1999, cituar QMG et al., 11.

⁹ Coker 2000, cituar në QMG et al., 10.

¹⁰ Campbell et al. 2002, cituar QMG et al., 11.

¹¹ Campbell et al. 2002; Watts dhe Zimmerman 2002, cituar QMG et al., 11.

¹² Campbell 2002; Watts & Zimmerman, 2002, cituar QMG et al., 11.

tejvigilencën, çrregullimet në të ushqyer, çrregullime në fjetje, shpërdorimin e substancave, depresionin dhe, madje, edhe vetëvrasjen.¹³

Përkundër ndikimit negativ të dhunës, të dokumentuar bindshëm, shtetet i kanë kushtuar dhunës në familje krahasimisht më pak vëmendje se sa problemeve të tjera shëndetësore, me gjasë për shkak të percepionit të sipërpërmendur se dhuna në familje është një çështje më shumë private se sa publike. Sidoqoftë, siç do ta demonstrojë ky kapitull, shëndeti i dobët, i cili rezulton prej kësaj çështjeje ‘private’, mund të ndikojë negativisht mbi shoqërinë e gjerë. Pasojat e dhunës në familje mbi individin, familjen dhe shoqërinë në Kosovë më herët pak janë marrë parasysh. Të kuptuarit e pasojave të dhunës mund t’iu ndihmojë institucioneve të zhvillojnë programet me qëllim të trajtimit të këtyre pasojave. Drejt arritjes qëllimi, ky kapitull bazohet në literatura ekzistuese ndërkombëtare, si dhe në rezultatet fillestare në Kosovë me qëllim të shqyrtimit të pasojave të dhunës në familje mbi personat të cilët kanë përjetuar dhunën në Kosovë (pjesa e parë), fëmijët dhe familjet e tyre (pjesa e dytë), dhe shoqërinë si tërësi, duke përfshirë institucionet (pjesa e tretë).

1. Pasojat për personat që vuajnë nga dhuna në familje

Një nga pasojat më të qarta të dhunës në familje është shëndeti i dobët. RRGGK-ja ka zhvilluar hulumtimin e parë të hollësishëm lidhur me atë se si dhuna mbi baza gjinore ka ndikuar mbi shëndetin riprodhues të grave në vitin 2007. Pas intervistave të hollësishme me gratë, të cilat kanë përjetuar dhunën mbi baza gjinore, para së gjithash në marrëdhëni familjare, 80 për qind e tyre ka raportuar probleme që janë drejtpërdrejtë rezultat i dhunës. Gratë kanë përjetuar një bollëk të problemeve shëndetësore, duke përfshirë vendet e mavjosura nëpër trup, migrena/kokëdhembjet, hipertension (shtypje e lartë e gjakut) nervozë, frikë, lëndime trupore, sytë dhe fytyrë të mavjosur; depresion; pavetëdije (një person nuk ka qenë i vetëdijshëm tri ditë); krah të thyer, probleme me veshkat; gjakderdhje të vazhdueshme; lëndime të kokës; paaftësi për t’u koncentruar ose punuar; pagjumësi; vetrespekt të ulët; dhembje të trupit dhe të gjoksit; mungesë të imunitetit ndaj sëmundjeve; anemi, tentativa për

Gratë kosovare të cilat e kanë përjetuar dhunën në familje të intervistuara nga RRGGK në vitin 2007 kanë përshkruar një numër të madh të problemeve shëndetësore:

“[E kam pas krahun të thyer, jam lënduar me thikë dhe shpesh një numër i madh hematomësh kanë mbuluar gjithë trupin tim.”

“E kam pasur fytyrën të deformuar, të mavjosur dhe sy e buzë tëënjtura nga goditjet.”

“[Kisha një dështim] në muajin e tretë të shtatzanisë. Burri më ka rrahur. Ai më ka grushtuar në stomak dhe gjatë tri ditëve më ka rrjedhur gjak dhe pas kësaj mjekët më kanë thënë se kisha një dështim.”


“Nga shqelmosja [e abdomenit tim] që e kam përjetuar, kam pasur një abortim spontan për arsy se burri im nuk besonte se beba ishte e tij.”

Burim: RRGGK, Hulumtim kërkimor, 41

¹³ “Ndikimi i dhunës në familje mbi viktimat,” Jo i vëtmuar (Not Alone), faqja e internetit (Notalone.com Inc,) <http://www.enotalone.com/article/10003.html>

vetëvrasje; dhimbje të shpinës; probleme të frysëmarrjes, brinjë të thyera, dhembje të gjoksit, lemjë kronike; shurdhësi e rezultuar nga lëndimi i veshit; diabet; cikël të çrregullt menstrual; marramendje; gastrtit; urrejtje; probleme të dëgjimit; lëndime të ekstremiteteve; lëndime me thikë, humbje të dëshirës për të jetuar; shtypje të ulët të gjakut; dështime; sulme të panikut; gjurmë, panik, djersitje; sëmundje të gjëndrës tiroide; rraskapitje dhe traumë.¹⁴ Më tej, 77 për qind e profesionistëve që punojnë në QMS, DAVA, SHPK dhe mjekët klinik kanë parë gra me shëndet të dobët që ka rezultuar nga dhuna.¹⁵

Siq e ilustron grafiku 3.1, 358 të anketuar të një ankete të RRGGK-së në shtrirje të Kosovës, që kanë njojur personin i cili ka përjetuar dhunën në familje, kanë thënë se në pasojat negative të dhunës mbi atë person kanë përfshirë: lëndimet (të përjetuara nga 196 persona të njojur); çështjet e shëndetit psikologjik, siq eshtë pagjumësia, frika e përhershme dhe faji (163); paaftësia për t'u kujdesur për vetveten (24); paaftësia për t'u kujdesur për fëmijët (22); paaftësia për të punuar, ndikimi mbi situatën ekonomike të personit (19); ndërprerja e shkollimit (13); përpjekja për vetëvrasje (5); të menduarit për vetëvrasjen (4); problemet familjare(4); vetizolimi ose sjellja asociale (4); shkurorëzimi (2); dhe problemet e tjera shëndetësore. Një i anketuar ka njojur personin i cili ka vdekur si rezultat i dhunës në familje.



Të anketuarit që vet kanë përjetuar dhunën, kanë thënë se dhuna ka shkaktuar: probleme psikologjike (54 të anketuar), lëndime (41), paaftësi për t'u kujdesur për fëmijët (10), përpjekje për vetëvrasje (7), paaftësi për t'u kujdesur për vetveten (5), ndërprerje të shkollimit (5), mendime mbi vetëvrasjen (2), dhe shkurorëzim. Dyzet e nëntë të anketuar kanë pasur probleme shëndetësore që kanë rezultuar nga dhuna në familje, duke përfshirë

¹⁴ Cekur në grafikone të RGK-së, *Hulumtim kërkimor*, 39. Doracaku për ZSHS mbi dhunën familjare. Cek një numër të madh të simptomave fizike të dhunës familjare, që mund të shfrytëzohen për të identifikuar viktimat e dhunës.

Përfshihen ato të sipërpërmendurat si dhe prerjet dhe ndrydhjet, prerjet e vetshkaktuara, dhembja e përgjithshme ose psikogjene, dëmtimet e anusit dhe iritimët e lëkuriës (OSBE dhe MPMS, 15).

¹⁵ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 34.

depresionin, kokëdhembjet, shtypjen e lartë të gjakut, hidhërimin, frikën e përhershme, mavjosjen e pjesëve të trupit, dështimet në shtatzëni dhe lëndime të tjera. Megjithëkëtë, prej 54 të anketuarve, të cilët kanë raportuar se kanë marrë lëndime të rënda trupore, vetëm 38.9 për qind kanë shkuar te mjeku. Dy të anketuar nuk kanë shkuar te mjeku për arsy se kryerësi i dhunës fizikisht i ka penguar. Një hulumtim i mëparshëm i RRGGK-së po ashtu ka treguar se gratë, të cilat përjetojnë dhunën, zakonisht janë të parandaluara nga kërkimi i ndihmës mjekësore.¹⁶ Problemet shëndetësore mund të përkeqësohen nga mungesa e qasjes ndaj ndihmës mjekësore nga ana e viktimës për shkak të lokacionit gjeografik në zonat rurale ose për shkak të varësisë financiare nga ndonjë anëtar tjetër i familjes ose shpërdoruesit. Kujdesi i vonuar mjekësor ose lëndimet e trajtuara mund t'i u lejojnë problemeve shëndetësore të përkeqësohen me kohën, me çka, në të vërtetë, e gjymtojnë më tej viktimin.

Problemet psikologjike dhe shëndetësore që rezultojnë nga dhuna mund të shpiejnë deri te mungesat ditore në punë,¹⁷ mungesa e produktivitetit dhe krijimi i problemeve ekonomike. Siç ceket më tej në kapitullin 5, dhuna në familje po ashtu mund të ndikojë në aftësinë e personit për të kontribuuar në vendimmarrjen brenda familjes; të anketuarit, të cilët kanë përjetuar dhunën në familje, e kanë pasur të vështirë të diskutojnë me anëtarët e tjerë të familjes gjërat të cilat kanë qenë të rëndësishme për ta.¹⁸ Mungesë e forcës vendimmarrëse do të thotë, për shembull, se viktimat janë nën trysninë që të kenë më shumë fëmijë se sa ata dëshirojnë të kenë.¹⁹

2. Pasojat mbi fëmijët dhe familjen²⁰

Pos përjetimit të pasojave të ngashme për shëndetin e tyre psikologjik dhe fizik si të rriturit, zhvillimi i fëmijës dhe kushtet e jetës, po ashtu, mund të ndikohen negativisht nga dhuna në familje. Të anketuarit që kanë përjetuar dhunën në familje gjatë fëmijërisë së tyre kanë qenë më pak të prirur të arrijnë një nivel të arsimimit universitar se sa personat të cilët nuk kanë përjetuar dhunën.²¹ Ngaqë të arriturat arsimore ndikojnë në shanset e punësimit,²² ata kanë qenë, po ashtu, më të prirur të jenë të papunë dhe të kenë të hyra të ulëta të ekonomisë familjare në jetën e tyre të mëvonshme. Të anketuarit që kanë qenë të dënuar me shkop ose me rrip në fëmijërinë e tyre, e kanë pasur të vështirë të diskutojnë çështjet e rëndësishme për ta me anëtarët e tjerë të familjes, që potencialisht i ka kontribuuar mungesës së fuqisë vendimmarrëse brenda familjeve të tyre.

Personat të cilët kanë përjetuar dhunën në fëmijërinë e tyre gjithashtu kanë qenë më të prirur për të përjetuar dhunën gjatë jetës së tyre më shumë se sa të anketuarit e tjerë. Për shembull, një plakë e ka përshkruar dhunën që ajo e ka përjetuar si fëmijë, e cila ka vazhduar pas martesës së saj. Gruaja e ka konsideruar “normale” që burri i saj ta rräh atë

¹⁶ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 29-32.

¹⁷ Këshilli këshillëdhënës kombëtar mbi dhunën kundër grave, Zyra e grave kundër dhunës, Departamenti i drejtësisë i SHBA, -ve “Përfundimi i dhunës kundër grave: Një agjendë për kombin.”

¹⁸ Në mënyrë të ngashme, të anketuarit anëtarët e familjeve të të cilëve iu kanë bërtitur atyre, i kanë fyer ata ose i kanë bërë të ndjehen shumë keq çdo muaj e kanë konsideruar të vështirë të flasin me anëtarët e tjerë të familjes për çështjet e rëndësishme.

¹⁹ Të anketuarit që kanë përjetuar dhunën fizike kanë qenë të prirur të kenë më shumë se tre fëmijë. RRGGK-ja po ashtu ka konstatuar se gratë të cilat përjetojnë dhunën fizike mund të jenë nën trysni të kenë më shumë fëmijë se sa ato dëshirojnë. (¹⁹ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 28).

²⁰ Mimoza Gashi i ka kontribuuar kërkimit dhe përpilimit të kësaj pjese.

²¹ Të anketuarit, anëtarët e familjeve të të cilëve me qëllim kanë shkatërruar orënditë ose enët gjatë fëmijërisë së tyre, kanë qenë të prirur të kenë arsimim më të ulët se sa shkollimi i mesëm.

²² Shih kapitullin pesë.

dhe që prindërit t'i rrahin fëmijët e tyre.²³ Fëmijët, të cilët janë dëshmitarë të dhunës ose që e përjetojnë dhunën, mund të fillojnë të mendojnë se dhuna është metodë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose të konflikteve brenda familjeve.²⁴ Fëmijët më vonë mund të përdorin dhunën kundër partnerëve të tyre, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, duke kryer dhunë nga gjenerata në gjeneratë.²⁵ Në fakt, të anketuarit që kanë qenë fizikisht të dënuar në fëmijërinë e tyre (të shuplakosur, të rrahur me rrip ose me shkop) kanë qenë të prirur t'i dënojnë fëmijët e tyre në të njëjtën mënyrë. Fëmijët në shkollë ose në rrethinën e tyre mund të përjetojnë pasojat e dhunës në familje po ashtu përmes detyrimit nga fëmijët të cilët kanë qenë dëshmitarë të dhunës ose e kanë përjetuar dhunën.²⁶

Dhuna në familje gjithashtu mund të dëmtojë aftësinë e prindërve për të ushqyer fëmijët e tij ose të saj. Në shtëpitë, në të cilat ndodh dhuna në familje në SHBA, fëmijët janë fizikisht të të keqpërdorur dhe të neglizhuar në shkallën 15 herë më të lartë se sa mesatarja kombëtare.²⁷ Sipas UNICEF-it, "Pasojet në sjellje dhe ato psikologjike të zhvillimit në një familje të dhunshme mund të janë poaq rrënuese për fëmijët të cilët nuk janë vet drejtpërsëdrejti të shpërdoruar."²⁸ Nga të anketuarit e analizës, të cilët kanë përjetuar dhunën në shtëpi, afersisht 30 për qind (102 njerëz) kanë thënë se fëmijët e kanë parë ose dëgjuar dhunën. "Unë e kam parë dhunën duke ndodhur në familjen time," rikuhton një i ri.²⁹ "Kam qenë shumë i ri. Babai im e rrihte nënën time. Jam rritur me probleme. Kam qenë emocionalisht i lënduar kur i kam parë prindërit e mi që grindeshin ... Unë e kisha shprehi të qaja deri sa nuk ndjehesha më mirë." Fëmijët, të cilët janë dëshmitar të dhunës në familje, janë në rrezik më të madh të ankthit, depresionit, dhunës kundër të tjerëve, shpërdorimit të drogave, alkoolizmit, prostitucionit, kryerjes së krimeve seksuale dhe tentativave të vetëvrasjes,³⁰ sipas Haiman-it:

Lidhja emocionale e zhvillimit të fëmijës me një kujdestar primar në gjashtë vitet e para të jetës është shumë me rëndësi. Çrregullimi në këtë zhvillim mund të krijojë probleme në fëmijëri, adoleshencë dhe në jetën madhore. Këtu janë të përfshira sjelljet bazike për mirëqenien personale dhe ndprpersonale Janë të involvuara këtu fundamentet ose bazat e mirëqenies personale dhe ndërpersonale. Shembuj të kësaj janë: 1) aftësia për të kriuar marrëdhënie të thellë dhe të gjatë dashurie; 2) aftësia

²³ Grua e ve serbe, më e vjetër se 66 nga komuna e Zubin Potokut

²⁴ UNICEF Qendra për Kërkime Innocenti (Innocenti Research Centre), "Dhuna familjare kundër grave dhe vajzave." (Firencë, Itali: qershori 2000), 12.

²⁵ Dhuna familjare, Teoria e të mësuarit social. Shih po ashtu Janet Phillips, Parlamenti i Australisë, "Dhuna familjare në Australi – një vështrim i përgjithshëm i çështjeve," E-Brief: Online Only, 7 gusht 2003, azhurnuar në shtator 2006, http://www.aph.gov.au/library/intguide/SP/Dom_Violence.htm.

²⁶ Phillips.

²⁷ J. Osofsky, "Ndikimi i dhunës mbi fëmijët." *E ardhmja e fëmijëve: dhuna familjare dhe fëmijët* (1999) 9(3):33-49 in C. J. Newton, Dhuna familjare: Një vështrim i përgjithshëm" Gjejeni Counseling.com (përpëra i quajtur TherapistFinder.net) Revista mbi shëndetin mendor , shkurt, 2001. Në faqen e internetit :

<http://www.findcounseling.com/journal/domestic-violence/domestic-violence-effects.html>.

²⁸ Dhuna familjare kundër fëmijëve, http://www.unicef.org/sowc07/docs/sowc07_panel_2_1.pdf, 1.

²⁹ Grua shqiptare , mosha 18-25 nga komuna e Podujevës.

³⁰ P. Jaffe dhe M. Sudermann, "Dëshmitë e fëmijës për shpërdorimin e fëmijës: Kërkime dhe përgjigje të komunitetit," në Stith, S. dhe Straus, M., *Të kuptuarit e dhunës së partnerëve: Mbizotërimi, shkaqet, pasojet dhe zgjidhjet. Familjet në shërbimet fokale*, Vell. II. Minneapolis, MN: Këshilli kombëtar mbi marrëdhëniet familjare 1995; D.A., Wekerle, C., Reitzel, D. and Gough, R., "Strategjité e adresimit të dhunës në jetërat e rinisë në rrezik të madh.." Në Peled, E., Jaffe, P.G. and Edleson, J.L. (eds.), *Përfundimi i ciklit të dhunës:Përgjigjet e komunitetit ndaj fëmijëve dhe grave të dëmtuara*. New York: Sage Publications. 1995. Cituar në "Sigurojini faktet – Dhuna familjare dhe kujdesi shëndetësor," 2008 Fondi për parandalimin e Dhunës.

për të toleruar kënaqjen e papërsosur të nevojave personale; 3) qëndrimet dhe dëshirat për të bashkëpunuar me të tjerët dhe 4) motivimi për të mësuar dhe për të punuar.³¹

Një kërkim i mëhershëm i RRGGK-së me të rriturit si viktima të dhunës në familje në Kosovë, ka demonstruar ndikimin e dhunës në aftësinë e tyre për të kultivuar marrëdhëniet dashurore, ndërveprimin me njerëzit e tjerë, si dhe punën.³² Duket praktike për të sugjeruar se e njëjtë mund të jetë e vërtetë për fëmijët kosovarë të cilët përjetojnë dhunën. Shkurorëzimi dhe ndarja po ashtu mund të ndikojnë në zhvillimin e fëmijës..³³

Së këndejmi, dhuna në familje nuk duhet të trajtohet dhe nuk mund të trajtohet si një çështje e izoluar, private. Pasojat e dhunës në familje arrijnë përtej niveleve individuale të rrezikimit të sigurisë dhe të mirëqenies së fëmijës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes. Ngaqë fëmijët, të cilët janë të shpërdorur ose janë dëshmitarë të shpërdorimit mund të janë më të prirur për të përdorur dhunën kundër të tjerëve, duke përfshirë sulmin seksual dhe krimet e tjera, dhuna familjare poashtu mund të ndikojë mbi shoqërinë, ashtu siç e ilustron kapitulli në vijim. Një të kuptuar më i mirë i pasojave të dhunës mbi fëmijët dhe familjen mund t'iu mundësojë institucioneve për të përgatitur përgjigje më të mira për adresimin e pasojave të dhunës dhe potencialisht për parandalimin e dhunës në të ardhmen.

3. Pasojat mbi shoqërinë, duke përfshitë institucionet qeveritare

Pos ndikimit mbi fëmijët dhe familjen, dhuna familjare ka pasojat e saj edhe mbi shoqërinë. Siç ka shkruar Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit: "Derisa dhuna në baza gjinore shpesh zë vend në sferën private, ajo ka një ndikim të tërthortë, por dramatik, mbi sistemin e kujdesit shëndetësor të vendit dhe paraqet një barrë të rëndë në forcën punuese kombëtare."³⁴ Megjithëkëtë, me gjasë për shkak të interpretimeve të lartpërmendura të dhunës si çështje private, qeveritë rrallë e konsiderojnë dhunën si një çështje të shëndetit publik.³⁵

Dhuna në familje shkakton shpenzime për policinë, duke përfshirë kohën e kaluar në arrestim, përgjigjen në raportimet e dhunës në familje dhe hetimet.³⁶ Sistemi i drejtësisë e financon ndalimin e përkohshëm pas arrestimit, shpenzimet e burgosjes, ndjekjen penale dhe rastet gjyqësore. Programet e parandalimit dhe të mbrojtjes mund të përfshijnë shpenzime shtesë, duke përfshirë këtu shërbimet sociale siç janë strehimi për gra dhe fëmijë; programet e parandalimit dhe të avokimit; trajnimi i shkathtësive punuese për viktimat dhe programet trajnuese për shërbysesit e shërbimeve sociale, policinë, sistemin e drejtësisë dhe mediat. Sistemi shëndetësor siguron hapësirën e kujdesit emergjent, trajtimin mjekësor, hospitalizim dhe, ndonjëherë, këshillimin psikologjik. Dhuna në familje mund të ndikojë mbi ekonominë duke e zvogëluar pjesëmarrjen në tregun e punës, duke reduktuar

³¹ Peter Haiman, "Mbrojtja e zhvillimit emocional të fëmijës kur ndahen prindërit," Projekti natyror i fëmijëve (2007), në: http://www.naturalchild.org/guest/peter_haiman3.html.

³² RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 47-8.

³³ Menjëherë pas vdekjes së prindit ose të vëllait a motrës, studiuesit kanë konstatuar se shkaku më i madh i stresit për fëmijët është shkurorëzimi dhe ndarja martesore (James H. Humphrey, *Të ndihmuarit e fëmijëve në menaxhimin e stresit:Doracak për të rriturit*, 15-16). Sipas Humphrey, problemet midis prindërve mund të shkaktojnë stresin në mesin e fëmijëve.

³⁴ Faqja e internetit e KNSH, "Adresimi i dhunës në baza gjinore," në

http://www.theirc.org/media/www/addressing_genderbased_violence_1.html, qasur më 9 Dhjetor 2007.

³⁵ Lori Heise, "Shpërdorimi mbi baza gjinore: epidemi globale." *Cad. Saúde Pública* vol. 10 suppl. 1. Rio de Janeiro, 1994.

³⁶ Ky paragraf nxjerret nga Qendra e Kërkimeve Innocenti, UNICEF

produktivitetin në punë, duke kontribuuar mbi fitimet më të ulëta dhe duke zvogëluar thithjen e programeve të asistencës sociale. Fëmijët të cilët mësojnë dobët në shkollë si rezultat i dhunës dhe që duhet të përsërisin klasat i kushtojnë sistemit të arsimimit.³⁷ Dhuna në familje po ashtu mund të ndikojë mbi aftësitë e fëmijës për të mësuar, gjë që ndikon mbi punësimin në të ardhmen. Më tej, dhuna në familje mund ta gjerryej kapitalin social, të zvogëlojë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset demokratike, të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe negativisht të ndikojë në cilësinë e gjithëmbarshme të jetës.³⁸

Kur mblidhen të gjitha shpenzimet e lartpërmendura, kërkimet kanë dëshmuar se dhuna në familje mund t'i kushtojë vendit miliarda dollarë në vit. Në Kanada, Qendra për Kërkime mbi Dhunën kundër Grave dhe Fëmijëve ka llogaritur se shpenzimet që rezultojnë nga dhuna kriminale kundër grave kanë shënuar shumën vjetore prej 4.2 miliardë dollarësh.³⁹ Në mënyrë më të saktësuar, dhuna në familje iu kushton institucioneve që merren me shërbimet sociale dhe të arsimit 2.4 miliardë dollarë në vit, sistemit penal të drejtësisë 872 milionë, sistemit të punës dhe punësimit 577 milionë dhe institucioneve shëndetësore e mjekësore 408 milionë.⁴⁰ Qeveria ka mbuluar 87.5 për qind të këtyre shpenzimeve ose 3.7 miliardë në vit.

Nevojiten mbledhja më e mirë e të dhënave në emër të institucioneve dhe kërkimet e mëtejme për të llogaritur shpenzimet e dhunës në familjare në institucionet e Kosovës. Megjithëkëtë, duket e besueshme të sugjerohet se programet e tashme lidhur me dhunën në familje vërtet i kushtojnë Qeverisë së Kosovës dhe tatimpaguesve, siç janë trajnimet i siguruar për ZSHS-ët, zyrtarët e SHPK-së, gjykatësit dhe personelin e strehimoreve, financimi i Njësisë kundër dhunës në familje të SHPK-së; shpenzimet e hapësirës së emergjencës dhe të qendrave shëndetësore; përfshirja e QMS-ve në mbrojtjen e fëmijëve dhe viktimate të tjera të dhunës në familje; shpenzimet e DAVA-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë për dokumentimin dhe përpunimin e rasteve; shpenzimet procedurale siç është përkthimi, përfaqësimi i autorizuar, këshillimi ligjor dhe shpenzimet e tjera juridike; ndihma për viktimat; strehimi i viktimate; shpenzimet e arsimimit për fëmijët që përsërisin klasat dhe shpenzimet e asistencës sociale për personat e gjymtuar ose të paafëtë për të fituar para si rezultat i dhunës. Së këndejmi, dhuna në familje në Kosovë ndikon mbi buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës përgjithësisht. Siç ka përfunduar KNSH “Rëndësia e adresimit të dhunës në baza gjinore nuk është, së këndejmi, e lidhur vetëm me mirëqenien fizike dhe psikologjike të grave dhe të vajzave, por edhe me mirëqenien ekonomike dhe sociale të cilitdo komunitet ose komb të dhënë.”⁴¹

³⁷ Banka ndëramerikane e zhvillimit, për shembull, ka gjetur në Nikaragua se 63 për qind e fëmijëve që jetojnë në familje në të cilat gruaja përjeton dhunën kanë qenë përsëritës të klasave në shkollë. Më tej, ata kanë qenë të prirur të ndërpresin shkollimin e tyre në moshën 9 vjeçare krasuar me fëmijët e grave të cilët nuk kanë përjetuar dhunën e skajshme e të cilët kanë qenë të prirur të mos shkojnë në shkollë në moshën 12 Banka ndëramerikane e zhvillimit dhe Johns Hopkins University Press, “Tepër afér shtëpisë: Dhuna familjare në Amerikë,” Loerto Biehl, Andrew Morrison, 1999).

³⁸ Po aty.

³⁹ Këshilli kombëtar për parandalimin e krimít, *Siguria dhe kursimet: Parandalimi i krimít përmes zhvillimit social* (Kanada: Mars 1996), 2-3.

⁴⁰ Po ashtu në Australi, dhuna shkakton shpenzime për bashkësinë, siç janë ato ë drejtësisë lidhur me kryerësin e dhunës dhe trajtimin mjekësor të viktimës (Phillips).

⁴¹ Faqja e internetit e Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit (KNSH), “Adresimi i çështjeve të dhunës mbi baza gjinore” në http://www.theirc.org/media/www/addressing_genderbased_violence_1.html, qasur në vitin 2008.

KAPITULLI 4

REAGIMI I QYTETARËVE: METODAT TË CILAT I PËRDORIN DHE I PROPOZOJNË QYTETARËT PËR PËRFUNDIMIN E DHUNËS OSE PËR ZVOGËLIMIN E RRETHANAVE TË EKZISTIMIT TË SAJ

Ky kapitull nxjerr të dhënat e analizës së RRGGK-së në nivel të Kosovës me qëllim të identifikimit të metodave, të cilat qytetarët përdorin për të përfunduar dhunën ose për të zvogëluar pasojat e saj. Pas diskutimit se si qytetarët trajtojnë dhunën, ky kapitull siguron informacione lidhur me njohuritë e qytetarëve për programet e ndihmës në dispozicion. Pastaj, në të paraqiten perceptimet lidhur me faktorët, të cilët i kontribuojnë dhunës dhe në fund ideve të tyre lidhur me atë se si institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare munden t'i kontribuojnë zvogëlimit të dhunës në familje dhe pasojave të saj në Kosovë.

1. Si e trajtojnë qytetarët dhunën dhe njohuritë e qytetarëve lidhur me ndihmën në dispozicion

Të anketuarit para së gjithash e kanë ditur se përjetimi i dhunës mund të zvogëlohet përmes bisedës me anëtarët e tjerë të familjes ose me shokët. Shtatëdhjetë persona e kanë thirrur policinë, 63 janë shkurorëzuar, 51 kanë vizituar mjekun, 41 kanë vizituar psikologun ose psikiatrin dhe 35 kanë shkuar të jetojnë diku tjetër për një kohë të shkurtë. Më pak prej tyre kanë shkuar në strehimore, kanë qajtur, kanë dalur të shëtisin, kanë refuzuar të komunikojnë me kryerësin e dhunës ose kanë shpërqendruar vëmendjen e tyre përmes angazhimit në punë. Disa persona të njohur kanë pasur mënyra të pashëndetshme të përballimit të dhunës, siç është izolimi i vetvetes nga të tjerët. Në mënyrë brengosëse, tre të anketuar kanë thënë se njerëzit *nuk duhet* të bëjnë kurrgjë për të zvogëluar pasojat e dhunës; gratë duhet të pranojnë realitetin e dhunës në jetë dhe/ose t'iu nënshtrohen burrave të tyre me qëllim që të parandalojnë dhunën në të ardhmen, kanë thënë ata.

Derisa 18.3 për qind e të anketuarve që kanë përjetuar dhunën kanë thënë se asgjë nuk i ka bërë ata të ndjehen më mirë, 17 për qind kanë thënë se bisedimi me anëtarët e tjerë të familjes, 16.5 bisedimi me miqtë dhe 16.5 për qind angazhimi në çka do qoftë me duar të tyre, siç është qepja, iu ka ndihmuar atyre të ndjehen më mirë. Të anketuarit po ashtu kanë fjetur, kanë jetuar për një kohë të shkurtë diku tjetër, kanë qajtur, kanë biseduar me psikologun ose psikiatrin, e kanë dërguar kryerësin e dhunës në burg, janë shkurorëzuar, kanë dëgjuar muzikë, kanë lexuar ose kanë shkuar në shkollë. Afërsisht gjysma e të anketuarve nuk i kanë treguar askujt lidhur me dhunën të cilën ata e përjetonin. Një e treta i kanë folur për te një anëtar tjetër të familjes, 16.5 për qind i kanë treguar miqve të vet, dhe vetëm pak të anketuar iu kanë treguar policëve, mjekëve, psikologëve ose psikiatërve. Në përgjithësi, rezultatet e analizës tregojnë se njerëzit që e përjetojnë dhunën janë më të prirur të kërkojnë ndihmë nga anëtarët e familjes ose shokët se sa nga institucionet. Së këndejmi, përpjekjet për tejkalim të kufijve po ashtu duhet të kenë në shënjestër njerëzit të cilët potencialisht i ndihmojnë viktimat e dhunës.


Me qëllim të përcaktimit të njojurive të të anketuarve për ndihmën në dispozicion për viktimat e dhunës, RRGGK-ja gjithashtu ka pyetur të anketuarit nëse ata e dinin se ku mund të gjejë ndihmë personi nëse ai ose ajo po e përjetonte dhunën: përafërsisht dy të tretat e tyre kanë ditur se personi mund të marrë ndihmë nga policia.¹ Pesëmbëdhjetë për qind kanë thënë nga një anëtar tjetër i familjes dhe 2.3 për qind kanë thënë nga një shok. Është për t'u brengosur se vetëm 13.2 për qind e të anketuarve kanë përmendur Qendrat për Punë Sociale (QPS), 7.4 për qind organizatat joqeveritare ose strehimoret, 4.0 për qind përkrahësin e viktimës, 1.2 për qind psikologun ose psikiatrin dhe më pak se një për qind ka përmendur mjekun. Katërmbëdhjetë për qind e të anketuarve nuk kanë mundur të cekin një vend të vetëm ku dikush që vuan nga dhuna mund të merrte ndihmën dhe pak të anketuar kanë thënë se personi duhet të merret me dhunën brenda familjes. Kjo ilustron nevojën për tejkalim të kufijve të komunitetit dhe përpjekje për ndërgjegjësim me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me shërbimet në dispozicion nga institucionet.²

Raportimi i dobët i dhunës në institacione pjesërisht mund t'i atribuohet mungesës së vetëdijes lidhur me asistencën në dispozicion. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve e kanë ditur se ekziston Rregullorja kundër dhunës në familje në Kosovë (shih grafikun 4.1), por 10.6 për qind kanë thënë se Rregullorja e tillë nuk ekziston dhe 34.8 për qind nuk e kanë ditur nëse ajo ekziston ose jo. Njerëzit në komunat e Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Shtimes në veçanti nuk e kanë ditur se një Rregullore e tillë ekziston. Ndërgjegjësimi lidhur me Rregulloren duhet të ketë në shenjtëri posaçërisht ato komuna, gratë, njerëz me më pak se sa niveli i arsimimit të mesëm shkollor, të papunët, njerëzit me të hyra të ulëta, dhe grupet etnike serbe dhe gorane.³ Derisa 80 për qind e të anketuarve kanë thënë se ata do të shfrytëzonin ligjin nëse dhuna në familje do t'iu ndodhte atyre, 15 për qind nuk do të bënin këtë dhe 5 për qind nuk kanë ditur çka të thonë. Në grupet e veçanta më pak të pritura për të shfrytëzuar ligjin janë përfshirë gratë, personat me më pak se sa niveli i mesëm i arsimimit shkollor, individët me të hyra të vogla dhe njerëzit nga komunat e Gllogovcit, Fushë Kosovës dhe Deçanit. Të papunët dhe gjeneratat e reja (nën moshën 45 vjeçare) kanë genë më të prirur për të shfrytëzuar ligjin.

¹ Përafërsisht 16 për qind e të anketuarve kanë njojur personin i cili e ka shfrytëzuar asistencën në dispozicion nga institucionet. Në 85.8 për qind të këtyre rasteve ka ardhur policia dhe në 40.6 për qind personi e ka lëshuar shtëpinë e tij / të saj për të banuar diku tjetër. Në 19.8 për qind të rasteve, personi ka marrë ndihmë nga QPS, 11.1 për qind nga përkrahësit e viktimate, 13.9 për qind ndihmë tjetër ligjore dhe 10 për qind nga organizatat e grave ose strehimorja. Përafërsisht në gjysmën e rasteve, kryerësi i dhunës është arrestuar dhe e një e treta e rasteve kanë proceduar në gjykatë.

² Kapitulli 6 dhe rekomandimet elaborojnë mundësitet e ndërgjegjësimit.

³ Ka ekzistuar një korrelacion midis këtyre grupeve dhe përgjigjes “nuk e di”.

Grafiku 4.1 Rregullorja kunder hunes ne familje ekziston ne Kosove


Siq e ilustron grafiku 4.2, në arsyet që të anketuarit kanë dhënë lidhur me atë se pse nuk do të shfrytëzonin ligjin përfshihen: ata do të zgjidhnin problemet vet ose brenda familjeve të tyre (40.7 për qind); për shkak të turpit (19.2 për qind); policia nuk do të ndërmerre kurrfarë veprimi ose ligji nuk funksionon (10.7 për qind); gratë duhet të përbahen nga raportimi i dhunës (9 për qind); mungesa e besimit në policinë (6.2 për qind); raportimi i dhunës nuk ka kurrfarë zgjidhje afatgjate ose ata nuk do të kishin ku të shkonin pas raportimit të dhunës (4.0 për qind); ata do të rrinin për shkak të fëmijëve (2.3 për qind); ata do ta falnin kryerësin e dhunës (2.3 për qind); ose dhuna në familje më kurrë nuk do t'i ndodhte atyre. (2.3 për qind). Meshkujt kanë qenë më të prirur për t'u përgjigjur se do të zgjidhnin problemet vet. Së këndejmi, krahas ndërgjegjësimit lidhur me Rregulloren, fushatat plotësuese arsimuese duhet të trajtojnë çështjen e turpit, miteve se gratë duhet të durojnë dhunën dhe të qartësohet se opsjonet e ndihmës janë në dispozicion. Për gratë e martuara me burra keqtrajtues, është me rëndësi për t'u siguar se ato do ta ruanin kujdestarinë e fëmijëve të tyre dhe se opsjonet financiare janë të vëna në dispozicion përmibjetesën e tyre.⁴ Kjo është ilustruar nga një grua e anketuar respondente e cila ka thënë se burri i saj e rrihte. Ajo nuk kishte shkuar përvizitë te mjeku, por e konsideron si të dobishme dhe relaksuese për të biseduar me anëtarët e familjes. Ajo ka thënë se kurrë nuk do të thirrte policijnë për shkak të turpit dhe të fëmijëve të saj. "Unë do ta duroja dhunën... Nuk e di se sa shumë" ka thënë ajo. "Nuk dëshiroj t'i braktis fëmijët e mi. Edhe pse ai më rräh mua, ai nuk më rräh mua përvdekje. Atëherë do të ishte e arsyeshme të thërrasë

"Unë nuk do të shkoja në polici, për arsy se burri im do të më braktiste. Po ashtu unë do të turpëroja gjithë familjen time."

– Grua shqiptare, mosha 36-45, nga Deçani

⁴ Për më shumë informacion, shih kapitullin 6.

policinë.” Ajo ia atribuonte dhunën e burrit të saj situatës së keqe ekonomike.“Varfëria është arsyja e vetme pse dhuna ndodh në shoqërinë e Kosovës këto vite.” ka thënë ajo.⁵



2. Zvogëlimi i dhunës përmes parandalimit: Perceptimet e qytetarëve përfaktorët që i kontribuojnë dhunës dhe përmënyrën e trajtimit të tyre

Shumica dërmuese e të anketuarve ia ka atribuuar dhunën në familje kushteve të këqija ekonomike ose kushteve të këqija të jetesës. (55.3 përf qind), papunësisë (54.4 përf qind) dhe/ose varfërisë.⁶ Për shembull, një grua ia ka atribuuar dhunën, që ndodhë tek fqinjët e saj, papunësisë: “Djali jeton me babanë e tij, gruan e tij e cila është shtatzënë dhe me djalin e tyre njëvjeçar. Ai nuk ka pasur punë dhe, së këndejmi, ai i kërkonte para babait të tij. Por babai i tij nuk ia jepte paratë. Kështu, ... babai dhe djali kishin filluar të përllesheshin me njëri-tjetrin, vetëm përshtakët t'u papunës... derisa dikush nuk e kishte thirrur policinë.”


Siq e ilustron grafiku 4.3, faktorët e tjera të rëndësishëm që i kontribuojnë dhunës në familje, siç kanë besuar qytetarët, kanë qenë alkooli (20.5 përf qind), mosmarrëveshjet ose moskuptimet midis qifteve që bëhen tepër intensive (20.9 përf qind), trauma e patractuar nga lufta (17.2 përf qind) dhe mungesa e arsimimit (16.3 përf qind). Grupet që më së shumi janë të prirura t'ia atribuojnë dhunën kushteve të këqija ekonomike dhe mungesës së edukimit kanë qenë femra dhe burra nga Prishtina dhe Peja. Qytetarët po kështu kanë përmendur kulturën, mentalitetin ose traditën, xhelozinë e kryerësve të dhunës, hidhërimin, frustracionin, mosdurimin, sjelljen e keqe ose personalitetin e keq, drogat, martesën e hershme ose të padëshirueshme; situatën politike; qeverinë e korruptuar dhe të pakualifikuar (posaçërisht kur korrupsioni iu ka mundësuar kryerësve të dhunës të janë të lirë); amoralitetin; tradhtinë bashkëshortore; çrregullimet psikologjike në mesin e kryerësve të dhunës; ligjet joadekuante përmbytjen ose parandalimin; agresionin e mashkullit; mosrespektimin e ligjit; mosrespektimin e të drejtave të njeriut; marrëdhëniet e

⁵ Grua shqiptare, mosha 36–45 nga komuna e Prishtinës

⁶ Vërejtje: përqindja nuk e arrin totalin 100 përf qind përshtakët që i kontribuojnë dhunës. Derisa jo të gjitha këto çështje janë të ilustruara në grafikon, ato janë përmendur nga qytetarët në përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve të tjera.

pabarabarta të forcës midis grupeve të moshave dhe/ose gjinive;⁷ prostitucionin; ndryshimet e kohëve të fundit në Kosovë; familjet e mëdha që jetojnë bashkë pa hapësirën e mjaftueshme; problemet shëndetësore dhe mungesën e respektit përfenë. Vetëm pak të anketuar kanë thënë se sikur gruaja ta dinte vendin e saj në familje, dhuna nuk do të ndodhë. Meshkujt janë të prirur të mendojnë se mungesa e arsimimit dhe grindjet që bëhen tejet intensive i kanë kontribuuar dhunës. Njerëzit me më pak se sa niveli i mesëm i arsimimit shkollor dhe personat e papunë kanë besuar se papunësia ka qenë arsyje kryesore, ndërsa shumica e të anketuarve nën moshën 45 vjeçare ia kanë atribuuar dhunën gjendjes së keqe ekonomike.

Grafiku 4.3 Perceptimi i arsyses kryesore nga te anketuarit lidhur me ndodhjen e dhunes



⁷ "Pabarazia gjinore; gratë në shoqërinë tonë janë të shpërfillura dhe të pashtolluara mjaft; burrat janë më të fuqishëm," ka komentuar një burrë shqiptar me moshë 46-55 nga komuna e Klinës.

Identifikimi i shkaqeve potenciale të dhunës në familje mund të jetë i dobishëm për planifikimin e reagimeve më strategjike. Institucionet mund të mësojnë nga percepionet e qytetarëve në krijimin e fushatave të ndërgjegjësimit, si dhe në përgjigjet institucionale të parandalimit dhe të adresimit të dhunës në familje. Vërtet, qytetarët duket se i kanë bazuar rekomandimet e tyre për qeverinë mbi faktorët, të cilët ata i kanë identifikuar si faktorë që i kontribuojnë dhunës. Afërsisht gjysma e të anketuarve kanë thënë se qeveria mund të parandalonte dhe/ose të trajtonte çështjet e dhunës në familje përmes rritjes së punësimit për gratë, burrat dhe veçanërisht për të rinjtë. (pra, mbështetjen e krijimit të punëve të reja, krijimin e një strategie të punësimit për gratë në rrezik). Qytetarët fare qartë e kanë konsideruar krijimin e kushteve ekonomike dhe jetësore si vital. Mungesa e kushteve minimale të jetesës, siç janë 24 orë pa ujë ose rrymë mund të sprovojë durimin e njerëzve, të rris frustracionin dhe të pjellë grindjet. "Kur nuk ka ujë dhe rrymë, anëtarët e familjes bëhen të stresuar dhe mund të godasin ose të keqtrajtojnë njëri-tjetrin." ka thënë një aktivist.⁸ Përmes sigurimit të këtyre kushteve themelore, qeveria mund t'i kontribuojë mirëqenies së përgjithshme shëndetësore dhe psikologjike të qytetarëve derisa kështu potencialisht do të zvogëlonë dhunën në familje.

E dyta, 10.1 për qind e të anketuarve kanë rekomanduar që qeveria duhet të sigurojë qasje më të mirë në arsimim për gratë dhe burrat, duke përfshirë njerëzit në zonat rurale. Nivelet më të larta të arsimimit mund të përmirësojnë shanson e njerëzve në sigurimin e punësimit dhe, potencialisht, në zvogëlimin e dhunës në familje.⁹ Programi dhe plani shkollor në shkollat fillore dhe të mesme po ashtu mund të përfshijë më shumë informacione për dhunën në familje, edukatën seksuale dhe edukatën familjare, kanë thënë disa të anketuar. Të anketuarit gjithashtu kanë rekomanduar që qeveria të bëjë të mundshëm trajnimin profesional të lirë apo falas për grupet në rrezik, posaçërisht për gratë, që mund t'i ndihmonte punësimit dhe do të kontribuonte në zvogëlimin e dhunës.¹⁰

E treta, një numër i madh i të anketuarve kanë thënë se qeveria dhe organizatat joqeveritare kanë pasur nevojë të zhvillojnë fushata të edukimit duke pasur në shënjestër gratë dhe burrat si në zonat rurale, ashtu edhe në ato urbane. Qytetarët në zonat rurale posaçërisht kanë thënë se qeveria duhej të ishte më afër me njerëzit për adresimin e kësaj dhe të çështjeve të tjera. Ata kanë shprehur shpresën se përfaqësuesit e qeverisë duhet të vizitojnë zonat e tyre më shpesh, t'i shqyrtojnë më mirë nevojat e tyre dhe të sjellin ngjarje të ndërgjegjësimit kulturor në fshatrat e tyre. Sikur të kishte më shumë aktivitet social në dispozicion në fshatra, dhuna do të kishte më pak gjasë të ndodh, kanë thënë ata. Respondentët po kështu kanë sugjeruar shfrytëzimin e mediave për ndërgjegjësimin përmes serialeve televizive që përshkruajnë zgjidhjet për dhunën në familje lidhur me situatat e dhunshme, shpalljet e shërbimeve publike, emisione të bisedave dhe debate të publikuara.¹¹ Ata kanë rekomanduar organizimin e më shumë seminareve, trajnimeve dhe debateve mbi dhunën në familje, posaçërisht në zonat rurale, në zonat më të rezikuara nga

⁸ Anketa e RRGGK-së, qershori, 2008.

⁹ ESK ka treguar se njerëzit me nivele të larta të shkollimit kanë më shumë gjasa të janë të punësuar (2004, *Statistikat e tregut të punës*, 26). Rezultatet e kësaj analize kanë treguar se qytetarët me shkollim më të mirë, punësim dhe të hyra të përgjithshme familjare më të larta kanë qenë më pak të prirur të përfjetojnë dhunën (shih kapitullin 2).

¹⁰ Idetë për një trajnim të tillë profesional janë paraqitur në kapitullin 6.

¹¹ Një qytetar ka sugjeruar se personat të cilët konstatohen të janë fajtor në dhunën në familje duhet të identifikohen në media me emër e mbiemër me qëllim të parandalimit.

dhuna në familje dhe në shkolla.¹² Disa qytetarë kanë thënë përpjekjet e një shtrirjeje sa më të gjerë kanë pasur nevojë të inkurajojnë dhe të fuqizojnë gratë në raportimin e dhunës dhe për t'i pajisur ato me mbrojtjen adekuate me qëllim që të veprojnë asisoj. Qytetarët po ashtu kanë thënë se qeveria mund të financoonte organizatat joqeveritare që punojnë në këtë çështje, posaçërisht në fshatra.

E katërta, të anketuarit kanë identifikuar nevojën për të përpiluar, miratuar dhe zbatuar një ligj kundër dhunës në familje në Kosovë.¹³ Ata kanë thënë se ligji duhet t'i dënojë kryerësit e dhunës, të sigurojë mbrojtjen e shërbimeve mbështetëse si dhe përmirësimin e tyre për viktimat, dhe të ketë dënimë më të rrepta për kryerësit e dhunës (pra, Kodi Penal). Të anketuarit kanë thënë se policia duhet të punojë më shumë në hetimin e raportimeve të dhunës në familje dhe të përmirësojë teknikat e hetimit. Ata kanë kërkuar funksionim më efektiv dhe më efikas të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë zvogëlimin e nepotizmit, adresimin e mungesës së profesionalizmit, ndjekjen më të shpejtë penale të rasteve dhe gjykimet më të rrepta në dënimin e kryerësve të dhunës. Në mënyrë më të përgjithësuar, disa të anketuar kanë komentuar se qeveria është dashur të zbatojë ligjet ekzistuese lidhur me pronën, barazinë gjinore dhe dhunën në familje, si dhe të përmirësojë bashkëpunimin midis institucioneve në raportimin e rasteve dhe në zbatimin e ligjit.

E pesta, një numër i madh i të anketuarve kanë menduar se hapja e qendrave të këshillimit ose vënia më shumë në dispozicion e këshillimit financiarisht (pra, pa pagesë) dhe gjeografikisht për njerëzit në zonat urbane dhe rurale mund të ndihmonte në parandalimin ose në zvogëlimin e ndikimit negativ të dhunës.¹⁴ Qendrat e këshillimit mund të shërbejnë një numër të madh të qëllimeve, thonë ata, siç është ndërgjegjësimi lidhur me dhunën si dhe ofrimi i këshillimit për çiftet, viktimat, familjet dhe kryerësit e dhunës ose kryerësit potencial të dhunës. Më parë se sa themelimi i qendrave të reja të këshillimit, shumica e këtyre shërbimeve mund të sigurohen përmes institucioneve ekzistuese siç janë: qendrat për punë sociale, organizatat vendore joqeveritare dhe strehimoret.

E gjashta, të anketuarit kanë thënë se institucionet dhe organizatat duhet të sigurojnë asistencë më të mirë për viktimat e dhunës. Disa të anketuar kanë propozuar më shumë strehimore për viktimat e dhunës. Sidoqoftë, strehimoret ekzistuese rrallë janë të mbushura përtëj kapacitetit të tyre.¹⁵ Më parë se sa hapjen e strehimoreve të reja, do të ishte e këshillueshme për të mbështetur strehimoret ekzistuese të cilat kanë pas vetes vite të përvojës dhe të personelit të trajnuar, rekandim ky po ashtu i bërë nga disa qytetarë. Në mënyrë më të saktësuar, të anketuarit kanë thënë se asistenca për personat që vuajnë nga dhuna në familje përfshin: këshillimin e siguruar nga psikologët e fushës përkatëse, psikiatrit ose këshilluesit; këshillimin familjar; asistencën në gjetjen e punësimit; akomodimin e sigurt; qasjen pa pagesë ndaj kujdesit shëndetësor; qasjen ndaj arsimimit më të mirë; asistencën ligjore; ndihmën financiare për viktimat dhe familjet e tyre; asistencën nga policia dhe monitorimin në vazhdim (QMS) në ekonomitë familjare ku dhuna ka ndodhur deri sa situata nuk stabilizohet dhe zgjidhet. Qytetarët po ashtu kanë rekomanduar

¹² Shihni rekomandimet për zonat e sugjeruara që duhet të jenë në fokus të informacionit, bazuar në rezultatet e këtyre kërkimeve.

¹³ Trembëdhjetë për qind e të anketuarve kanë identifikuar këtë nevojë. Njëri prej tyre ka rekomanduar themelimin e një komisioni në qeveri, i cili do të merrej me çështjen e dhunës në familje, rekomandim ky i përpunuar në kapitullin 6.

¹⁴ Një i anketuar ka rekomanduar që këshillimi nga psikologët profesionalë të vihet në dispozicion në shkolla, që diskutohet në kapitullin 6.

¹⁵ RRGGK, intervista me strehimoret.

[Siguria fillon në shtëpi](#)

rithemelimin e programeve të rehabilitimit ose të qendrave për keqtrajtuesit, ide kjo e cila përpunohet më tutje në kapitullin gjashtë.

Duke ilustruar zhgënjin min e qytetarëve me qeverinë dhe frustacionin e përgjithshëm, afërsisht pesë për qind e të anketuarve nuk kanë besuar se qeveria mund të bëjë diçka për të parandaluar ose adresuar dhunën. Tre të anketuar kanë thënë se familjet duhet të merren me problemet e tyre vetanake.

KAPITULLI 5

KUFIZIMET SOCIALE QË I PRIVOJNË GRUPET E VEÇANTA DEMOGRAFIKE NË SFERËN PRIVATE DHE PUBLIKE DHE QË POTENCIALISHT E RRISIN DHUNËN NË FAMILJE

Teoretizimi ia ka atribuar dhunën në familje ose sjelljes individuale të ndonjë mashkulli (pra, psikopatologja dhe mungesa e kontrollit) ose pabarazive sociale (pra, familjes patriarkale dhe marrëdhënieve të pabarabarta gjinore). Megjithëkëtë, Heise ka argumentuar për një të kuptuar më të thjeshtë, multidimensional, që nuk merr parasysh vetëm individin apo shoqërinë, por ndërveprimin e “faktorëve të ndryshëm personal, situacional dhe sociokulturor” që i kontribuojnë dhunës.¹ Një të kuptuar i plotë i faktorëve potencialisht të ndërlidhur që i kontribuojnë dhunës në familje mund t’iu mundësojë institucioneve zhvillimin e programeve më të mira drejt parandalimit të dhunës në të ardhmen.

Derisa në kapitujt e përparmë janë diskutuar faktorët në nivel individual që mund t’i kontribuojnë dhunës në familje, ky kapitull shqyrton kufizimet e veçanta sociale në shoqërinë kosovare që mund të deprivojnë disa grupe demografike qoftë në sférën private (brenda shtëpisë të tyre), qoftë në sférën publike, që potencialisht i kontribuojnë dhunës në familje: strukturat tradicionale të pushtetit brenda familjes (pjesa e parë), diskriminimi në baza gjinore kundër fëmijëve sipas traditës (pjesa e dytë), mungesa e qasjes ndaj arsimimit (pjesa e tretë), rolet diskriminatore gjinore dhe praktikat e punësimit (pjesa e katërt), dhe diskriminimi në posedimin e pronësisë dhe trashëgimisë (pjesa e pestë). Është i nevojshëm një kërkim i mëtejshmë për të hulumtuar faktorët e tjerë potencial. Identifikimi i kufizimeve të tillë sociale krahas sjelljeve individuale mund t’ia bëjë të mundshme qeverisë adresimin e rrënës së shkaqeve të dhunës dhe, së këndejmi, edhe zvogëlimin e saj.

1. Strukturat tradicionale të pushtetit brenda familjes

Në Kosovë meshkujt ende janë të prirur të udhëheqin familjen² posaçërisht në familjet shqiptare.³ Burrat, dhe rrallë gratë, i marrin vendimet lidhur me blerjet e mëdha familjare dhe shkollimin e fëmijëve,⁴ siç e ilustron grafiku 5.1. Më shumë se gjysma e të anketuarve (52.9 për qind) kanë thënë se një anëtar mashkull i familjes ka marrur vendimet përmenyrën se si duhet të shpenzohen paratë e familjes për blerjet e mëdha, siç është makina


¹ Lori Heise, “Dhuna kundër grave: Një kornizë e integruar ekologjike,” *Dhuna kundër grave* 4 (1998), 262.

² Partners Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

³ RRGGK ka konstatuar korelacionin midis burrave që janë vendimmarrës dhe të anketuarve shqiptarë (anketë e RRGGK-së, 2008).

⁴ Në 43.8 për qind të familjeve, anëtarët meshkuj të familjes kanë vendosur lidhur me shkollimin e fëmijëve, krahasuar me vendimet e grave në 9.5 për qind të familjeve. Për shqiptarët, të anketuarit ruralë, dhe / ose ata që anë pasur familje të mëdha, meshkujt kanë pasur më shumë gjasa për të vendosur për shkollimin. Femrat vendimmarrëse lidhur me edukimin kanë qenë të prirura të jetojnë në komunën e Prishtinës. Dyzet e gjashtë përqind e të anketuarve kanë thënë se vendimet lidhur me shkollimin e fëmijëve janë marrë së bashku ose se secili fëmijë ka vendosur vet për veten e tij ose të saj.

e re ose orenditë.⁵ Vetëm 10.7 për qind e të anketuarve kanë thënë se femrat i marrin vendimet e mëdha financiare për familjen.⁶ Kur duhet të merret një vendim i rëndësishëm, anëtarë mashkull i familjes ka për të thënë fjalën e fundit në 60.5 për qind të familjeve të të anketuarve krahasuar me gratë me vetëm 10 për qind të familjeve.⁷ Gratë e anketuara po ashtu më shumë kanë pasur gjasë se sa burrat ta kenë "të vështirë" të flasin me anëtarët e familjes lidhur me gjérat të cilat kanë qenë të rëndësishme për to.⁸



Mungesa e pushtetit vendimmarrës mundet po ashtu të jetë një formë e dhunës psikologjike dhe ekonomike në veteve ashtu siç potencialisht mund të shpie te dhuna fizike.⁹ RRGJK-ja ka identifikuar relacionin midis personave të cilët kanë përjetuar dhunën

⁵ Anëtarët meshkuj të familjes kanë përfshirë vet të anketuarit meshkuj, burrin e një të anketuar grua, një baba, një vjehërr, një kunat, një vëlla, djalë ose axhë.

⁶ Të anketuarat gra që kanë qenë persona vendimmarrës kanë përfshitë një grua të të anketuarit mashkull, nënën, vjehrrën ose gjyshen. Të anketuarat gra, që kanë qenë të punësuara, dhe kanë pasur të hyra të larta po ashtu kanë qenë të pritura të kenë femra vendimmarrëse në familjet e tyre. Vetëm mbi një e treta e të anketuarve 36.4 për qind, shumë prej të cilëve kanë pasur nivele të larta të shkollimit dhe partnerë të punësuar, kanë thënë se vendimet e rëndësishme financiare janë bërë nga gratë dhe burrat së bashku. Të anketuarit e pamartuar, të ndarë ose të ve kanë pasur prirje të kenë femra vendimmarrëse, që mund të tregojë se gratë të zonja të familjes kanë më shumë pushtet vendimmarrës.

⁷ Vendimet e rëndësishme janë marrë së bashku në 29.5 të familjeve. Kur i anketuar ka pasur nivel të ulët të shkollimit ose ka qenë i papunësuar, gjasa ka qenë që vendimmarrës të jetë mashkulli.

⁸ Të anketuarit boshnjak dhe turq po ashtu kanë qenë të prirur ta kenë të vështirë, ndërsa serbët kanë qenë të prirur ta konsiderojnë këtë të lehtë. Njerëzit mbi moshën 55 vjeçare kanë qenë të prirur ta konsiderojnë të vështirë për të biseduar me partnerët e tyre lidhur me gjérat e rëndësishme për ta, derisa gjeneratat e reja e kanë pasur fare të lehtë. Njerëzit të cilët nuk e kanë kryer nivel universitar të shkollimit dhe / ose kanë qen të papunë po ashtu kanë qenë të prirur ta kenë këtë më të vështirë.

⁹ Nëse një anëtar i familjes ka diskutuar ose nuk është pajtuar me vendimmarrësin lidhur me vendimin e tij, në 5.2 percent të familjeve vendimmarrësi do të mishërohej, në 2.2 për qind të familjeve vendimmarrësi do të bërtiste dhe bënte zhurmë dhe në 1.3 për qind vendimmarrësi potencialisht do të dëmtonte fizikisht personin i cili nuk pajtohet. Vendimmarrësit të cilët janë hidhëruar dhe potencialisht i kanë dëmtuar të tjerët kanë qenë të prirur të jenë nga familjet me të hyra të ulëta.

dhe atyre të cilët e kanë pasur të vështirë të flasin me partnerin e tyre lidhur me gjërat e rëndësishme për ta Mungesa e vendimmarrjes brenda familjes mund t'i kontribuojë martesave të hershme, ndërprerjes së shkollimit, papunësisë dhe mungesës së fuqisë vendimmarrëse lidhur me numrin e fëmijëve që do të donte të kishte personi.

Mungesa e pushtetit vendimmarrës për gratë e reja mundet dhe ka rezultuar në martesa të hershme dhe potencialisht të padëshirueshme për disa gra kosovare. Për shembull, një grua shqiptare ka thënë se familja e saj dhe posaçërisht nëna e saj e ka rrahur ate shumë shpesh, e ka detyruar ate të ndërpresë shkollimin e aj dhe e ka aranzhuar martesën e saj kur ajo i ka pasur vetëm 16 vjet.¹⁰ Në përgjithësi, gratë janë të pritura të martohen më herët se sa meshkujt në Kosovë. ESK ka raportuar për vitin 2006 se mesatarja e moshës së martesës për gratë është 27 vjet, kurse 30 për burrat.¹¹ Në mënyrë të ngashme, 88.1 për qind e grave të anketuara nga RRGGK-ja janë martuar para moshës 26 vjeçare krahasuar me 58.1 për qind të burrave. Të gjithë, pos njërit prej 11 të anketuarve që kanë qenë të martuar para moshës 16 vjeçare, kanë qenë gra. Martesa e hershme dhe obligimet familjare mund të ndikojnë në nivelin e arsimimit të femrës dhe, së këndejmi, edhe mbi statusin ekonomik të saj.¹² Siç është ilustruar në kapitullin e dytë, njerëzit me nivele të ulëta të arsimimit dhe me status ekonomik të tillë janë më shumë në rrezik të dhunës se sa grupet e tjera demografike. Së këndejmi, adresimi i strukturave tradicionale të pushtetit dhe sigurimi i një roli më të madh për femrën në vendimmarrje brenda familjeve të tyre mund të kontribuojë në zvogëlimin e dhunës në familje në Kosovë.

2. Dhuna mbi baza gjinore kundër fëmijëve, e bazuar në traditë

Edhe pse Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve e Kombeve të Bashkuara është e zbatueshme në Kosovë, ka qenë e vështirë të zbatohen në praktikë të drejtat e garantuara me ligj. Janë vëzhguar praktikat diskriminuese, siç është trajtimi i parapëlqyer ndaj djemve kundrejt vajzave. Praktikat e zgjedhjes së gjinisë pas ultrazërit kanë treguar se disa gra parapëlqejnë djemtë para vajzave, posaçërisht pas një numri të madh të fëmijëve vajza.¹³ Me gjasë për shkak të praktikës së zgjedhjes së gjinisë, përqindja gjinore në disa vitet e fundit ka qenë 100 vajza dhe 109 djem.¹⁴ Trysnia sociale dhe familjare për të pasur fëmijë meshkuj ka ndikuar mbi disa vendime të femrave për të abortuar fetuset femërore.

Dhuna kundër fëmijëve për shkak të gjinisë së tyre po ashtu konsiderohet dhunë mbi baza gjinore.¹⁵ Në Kosovë, dhuna kundër fëmijëve vajza shihet si metodë e disiplinimit të vajzave për të qenë moralisht korrekte derisa dhuna kundër djemve konsiderohet se i bënë ata më të fortë..¹⁶ Këto pikëpamje mund të reflektojnë dhe edhe më tej të përjetësojnë stereotipet gjinore të të qenit “burrë” ose “grua” dhe të fuqizojnë strukturat tradicionale të pushtetit në familje.

¹⁰ Grua shqiptare, mosha 46-55 nga komuna e Gjakovës.

¹¹ ESK, *Kosova në shifra 2007*, Prishtinë: ESK, prill 2008.

¹² Shih pjesën tre lidhur me mungesën e qasje në shkollim.

¹³ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, Pjesa mbi dhunën në familje, rast studimor.

¹⁴ ESK, *Gratë dhe burrat në Kosovë*, 3.

¹⁵ Rekomandimet e përgjithshme të KEDKG 19 mbi dhunën kundër grave në <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/index.html>.

¹⁶ Shih kapitullin 1, pjesën tre.

3. Mungesa e qasjes ndaj shkollimit

Shkalla e analfabetizmit në mesin e grave në Kosovë është tri herë më e madhe se sa për meshkujt.¹⁷ Vajzat janë të prirura të lëshojnë shkollën në shkallë më të madhe se sa djemtë midis arsimimit fillor të obligueshëm dhe atij të mesëm.¹⁸ Derisa njeriu mund të shpresojë se situata është përmirësuar që nga viti 2000, ende 40.6 për qind e personave të moshës prej 18 deri në 25 vjet të anketuar përmes këtij kërkimi kanë pasur më pak se sa arsimimi i mesëm shkollor. Është brengosëse se 42 për qind e grave të reja të anketuara të moshës prej 18 deri 25 vjeç nuk e kanë kryer shkollën e mesme, krahasuar me 22.5 për qind të të anketuarve meshkuj. Të anketuarit që kanë jetuar në zona rurale kanë qenë të prirur të jenë më pak të shkolluar se sa personat në zonat urbane, shpesh duke e ndërprerë shkollimin e tyre për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Në zonat rurale, 48.8 për qind e të anketuarve nuk e kanë kryer shkollën e mesme, krahasuar me 30.3 për qind në zonat urbane. Si Enti Statistikor i Kosovës, ashtu edhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PZHKB-UNDP) kanë konstatuar se gruaja rurale është në mesin e grupeve me më së paku avantazhe në qasjen ndaj arsimit.¹⁹ Tri herë më shumë ka pasur analfabete gra se sa burra.²⁰ Derisa burrat në zonat rurale kanë pasur 10 vjet të shkollimit, si mesatare, gratë kanë pasur vetëm 8.

Kërkimet e mëhershme gjithashtu kanë konstatuar se grupet etnike të romëve, ashkanlive dhe egjiptasve (shpesh të referuar si RAE), po ashtu kanë nivele të ulëta të shkollimit. Shkalla e analfabetizmit midis RAE-ve ka qenë afërsisht 17 për qind në vitin 2003 krahasuar me më pak se gjashtë për qind për totalin e popullatës.²¹ Gratë e grupeve etnike RAE kanë qenë më tej me disavantazhe në qasjen e tyre ndaj arsimimit, me një shkallë analfabetizmi prej më shumë se 25 për qind krahasuar me 8 për qind të burrave të grupeve etnike RAE për totalin e popullatës. Mesatarisht, gratë e grupeve etnike RAE kanë pasur përafërsisht 5.5 vite të edukimit ndërsa burrat 8.

¹⁷ ESK, *Gratë dhe burrat në Kosovë*, 3.

¹⁸ Në shkollimin fillor obligativ shkalla e regjistrimit të vajzave në shkolla krahasuar me djemtë është 92.0 derisa në nivelin e shkollimit të mesëm shkalla bien në 79.0. Shih UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor, *Rinia – Një gjeneratë e re për Kosovën e re*, 2006. Të anketuarat gra të RRGGK-së kanë qenë të prirura të kenë nivele më të ulëta të shkollimit se sa të anketuarit meshkuj. Derisa 24.4 për qind e meshkujve më pak se sa shkollim të obligueshëm të mesëm, 56.4 për qind e grave kanë pasur më pak e sa shkollimi i mesëm. Më tej, 50.9 për qind e grave të anketuara kanë pasur shkollimin fillor arsimor, krahasuar me 19.2 për qind të meshkujve.


¹⁹ Sipas ESK, vetëm 17 për qind e grave rurale krahasuar me 67 për qind të meshkujve urbanë kanë përfunduar më shumë se sa shkollimi fillor në vitin 2003 (*Analizë demografike dhe shëndetësore në Kosovë*, 4). Regjistrimi përgjithshëm i popullatës do të përmirësonë saktësinë statistikore.

²⁰ UNDP, 119. ESK ka sugjeruar katër herë më shumë (*Kosova sipas shifrave 2005*, 21).

²¹ UNDP, 118, bazuar në të dhënat statistikore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. UNICEF po ashtu ka ardhur te përfundimi se pak vajza nga grupet etnike RAE regjistrohen (*Analizë e situatës*, 2).

Kur janë pyetur se përse e kanë ndërprerë shkollimin, një përqindje e ngjashme e grave dhe e burrave kanë cituar se nuk kanë dëshiruar të vazhdojnë, mungesën e financave, mungesën e sigurisë në vijimin e shkollimit dhe luftën ose kushtet politike si arsyen për ndërprerjen e shkollimit të tyre.²² Grafiku 5.2 i ilustron ngjashmëritë dhe dallimet midis burrave dhe grave lidhur me ate se përse e kanë ndërprerë shkollimin e tyre. Më shumë meshkuj e kanë ndërprerë shkollimin për arsyen se është dashur të punojnë me qëllim që të ndihmojnë familjet e tyre (76.1 për qind) se sa gra (23.9 për qind). Gratë kanë pasur më shumë disavantazhe se sa meshkujt në qasjen e tyre ndaj shkollimit për arsyen se shkollat kanë qenë tepër larg, familjet e tyre nuk e kanë konsideruar shkollimin të rëndësishëm për ta ose për vajzat e tyre ose ato kanë qenë nën trysni nga ndonjëri prej anëtarëve të familjes ose të partnerit për të ndërprerë shkollimin. Asnjë mashkull i vetëm nuk e ka ndërprerë shkollimin për shkak të martesës, por 31 gra të anketuara e kanë ndërprerë. Derisa 10 gra e kanë ndërprerë shkollimin për shkak të obligimeve familjare (pra, për t'u kujdesur për prindërit ose vëllezërit a motrat e veta të sëmura),, vetëm tre burra e kanë ndërprerë shkollimin e tyre për këtë arsyen. Është e qartë se rolet tradicionale gjinore të shoqërisë, ku femrat zakonisht e mirëmbajnë shtëpinë dhe kujdesen për familjen, ndikon në aftësinë e gruas për t'iu qasur shkollimit.

²² Kërkimet e tjera kanë sugjeruar se faktorët të cilët i kontribuojnë të arriturave të ulëta të arsimimit në të gruas në zona rurale përfshijnë largësinë nga shkolla, mungesën e sigurisë për të udhetuar në shkollë, mungesën e mjeteve financiare, “mentalitetin tradicional,” martesën e hershme dhe familjet të cilat dekurajojnë ato nga vazhdimi i shkollimit (Shih, analizë e vitit 2001 mbështetur nga Fondi për Veprim Urgjent; UNDP, 28; dhe Corrin, *Audit Gjinor*, 6). ESK po ashtu ka raportuar se “Familjet rurale i japin prioritet shkollimit të djemve, që ndikon mbi të arriturat arsimore të grave rurale” (*Analizë bujqësore e ekonomive familjare 2004*. Prishtinë: ESK, 2005, 12).



Të arriturat arsimore fare qartë ndikojnë mbi shanset e punësimit dhe mirëqenien ekonomike më vonë në jetë.²³ Njerëzit me nivele të larta të shkollimit janë më shumë të prirur për t'u punësuar në pozicione që paguhen me rroga mujore, derisa personat me nivele të ulëta të shkollimit janë të prirur tëjenë të papunësuar, të kenë rroga mujore nga më të ulëtat dhe/ose varen nga asistencë sociale e shtetit.²⁴ Rritja e të arriturave arsimore

²³ Në vitin 2003 dhe 2004, 50 për qind e njerëzve të cilët kanë pasur shkollim më të ulët se sa shkollimi i mesëm i ulët dhe 40 për qind e njerëzve me shkollim të lartë të mesëm kanë qenë të papunësuar krasuar me 11 për qind të njerëzve me shkollim të lartë (ESK, 2004 Të dhëna statistikore të tregut të punës, 26).

²⁴ Korrelacion i konstatuar bazuar në anketën e RRGGK-së, 2008.

për qytetarët është, së këndejmi, brenda interesave të qeverisë kundruall zbritjes së numrit të qytetarëve të varur nga asistenca sociale dhe rritja e aftësisë së popullatës për t'i kontribuuar produktivitetit dhe tatimeve. Më tej, angazhimet financiare, të domosdoshëm për përmirësimin e qasjes në shkollim, siç është financimi i transportit, librave dhe shpenzimet e tjera të ndërlidhura, mund të dëshmohen në masë të madhe më pak të shtrenjta se sa pagesat potenciale të mëvonshme gjatë gjithë jetës për asistencën sociale.

Të arriturat arsimore po ashtu mund të ndikojnë mbi shkallën në të cilën njerëzit i kontribuojnë vendimmarrjes brenda familjeve të tyre. Njerëzit me nivele më të larta të arsimimit janë të prirur të luajnë më shumë role të barabarta si persona vendimmarrës brenda familjeve të tyre,²⁵ derisa njerëzit me arsimim të mesëm shkollor ose më pak e kanë pasur të vështirë të bisedojnë me partnerët e tyre lidhur me çështjet e rëndësishme për ta. Personat e papunësuar kanë qenë të prirur për ta konstatuar të biseduarit me partnerët e tyre si mesatar ose të vështirë. Siç është diskutuar më herët, personat e tillë mund të jenë më shumë në rrezik të dhunës në familje.

Qeveria mund t'i ndihmojë gratë dhe burrat ruralë dhe urbanë për të kryer nivelet e larta të arsimimit përmes sigurimit që të gjithë qytetarët të kenë qasje ndaj shkollimit, sigurimit të transportit për studentët dhe furnizimit me pajimet shkollore. Fushatat e arsimimit dhe përpjekjet për aktivitete me komunitete në terren mund të vinin shkollat fillore dhe të mesme në shënjestër të mesazheve lidhur me rëndësinë e arsimimit të lartë dhe ndikimit që ai mund të ketë në statusin e punësimit dhe në nivelin e të ardhurave. Ngaqë disa qytetarë, posaçërisht gratë, janë të parandaluar nga familjet e tyre në vazhdimin e shkollimit të tyre, fushatat e mediave me njoftimet e shërbimeve publike mund të vinin në shënjestër prindërit me informacionin lidhur me atë se si arsimimi i lartë për gratë dhe burrat mund të përmirësojë situatën ekonomike të familjes në shtigje afatgjata kohore (pra, investimet në shkollim sot sigurojnë kthimin finanziar në të ardhmen). Duke përcjellur praktikat e mira të fushatave të mëhershme, spotet e mediave mund të përfshinin mesazhe nga pjesëtarë të famshëm të komunitetit, ikonat kulturore dhe historitë vendore të suksesshme lidhur me rëndësinë e shkollimit.²⁶

4. Rolet gjinore diskriminuese dhe praktikat e punësimit

Sipas roleve tradicionale gjinore, gratë kanë qenë të prirura të kryejnë punë që nuk është paguar brenda shtëpisë, siç është rritja e fëmijëve, kujdesi për të moshuarit ose anëtarët e paftë të familjes, përgatitja e ushqimit dhe pastrimi. Burrat kanë qenë të prirur të punojnë jashtë shtëpisë, duke fituar paratë për ekonominë familjare. Rolet gjinore tradicionale kanë lëvizur paksa nën qeverisjen e komunizmit, me sistemin operacional të kujdesit përfshirë dëshirat e më shumë shanse të punësimit për gratë dhe burrat në fabrikat e mëdha në pronësi të shtetit. Në të njëjtën kohë, shumë gra kanë pasur “barrën e dyfishtë” të punës jashtë shtëpisë gjatë ditës dhe punën brenda për të mirëmbajtur ekonominë familjare gjatë natës (pra, përgatitja e ushqimit dhe pastrimi). Lufta, shkatërrimi i fabrikave në pronësi të shtetit dhe privatizimi i ngadalshëm, si dhe procesi i investimit i kanë kontribuuar shkallës së lartë

²⁵ Me familjet ku të anketuarit kanë pasur nivel më të lartë të arsimimit vendimet lidhur me blerjet e mëdha kanë qenë të prirura të merren së bashku: duke përfshirë si meshkujt ashtu femrat (anketa e RRGGK-së, 2008).

²⁶ Për s shembull, fushata e udhëhequr nga shoqata Motrat Qiriazi në rajonin e Hasit dhe RRGGK-ja lidhur me dhunën në familje dhe barazinë gjinore. Informacion në dispozicion në www.womensnetwork.org ose sipas kërkesës nga info@womensnetwork.org.

të papunësisë në Kosovë që nga përfundimi i luftës.²⁷ Zuckermani dhe Greenbergu kanë vërejtur:

Zakonisht gratë kanë humbur punën në sektorin formal në vendet në tranzicion që kanë kaluar nëpër ndërtimin e pasluftës. Për shembull, në lëvizjen e njëkohshme nga industritë e vjetra në të rejet për të ndërtuar një ekonomi moderne dhe globale në Ballkan, gratë kanë qenë të parat të përjashtohen nga puna dhe të fundit të ripunësohen për shkak të pikëpamjes tradicionale se burrat janë kujdestarët kryesorë të familjes përkundër numrit në rritje të ekonomive familjare të udhëhequra nga femrat dhe të drejtat e barabarta të përcaktuara me kushtetutë.²⁸

Që nga përfundimi i luftës, rolet gjinore tradicionale, duke përfshirë normat sociale sipas të cilave burrat janë “mbajtësit e familjes”,²⁹ kanë pasur kuptimin e “dhënes së priorititetit në punësim për meshkujt” dhe të diskriminimit kundër grave. Trajtimi diskriminues në praktikat e punësimit mund të evidencohet, për shembull, nga fakti se më shumë se 70 për qind e grave që kanë më pak se sa shkollimi i mesëm i lartë kanë qenë të papunësuara krahasuar me 35 për qind të burrave me të njëjtin nivel të shkollimit në vitin 2004.³⁰ Së këndejmi, gratë kanë qenë më shumë të prekura nga papunësia se sa meshkujt. Sipas një vlerësimi, 61 për qind e grave dhe 32 për qind e burrave kanë qenë të papunë në vitin 2004.³¹

Ngjashëm me këtë, vetëm 16.4 për qind të grave të anketuara kanë qenë të punësuara në një vendpunim me pagesë, krahasuar me 42.3 për qind të burrave të anketuar. Arsyet e të qenit të papunë, të cilat i kanë dhënë të anketuarit, kanë përfshirë: ata kanë pasur punë për të bërë brenda shtëpisë (26.8 për qind); punë për të bërë jashtë shtëpisë (3.8 për qind); nuk kanë qenë në gjendje për të gjetur një punë (10.6 për qind); familja nuk i ka lejuar për të punuar (0.4 për qind); ende kanë qenë student (22.4 për qind); të pensionuar (17.5 për qind); ose të paaftë për të punuar (12.7 për qind). Më shumë se 40 për qind e grave nuk kanë punuar për arsy se ato është dashur të kujdesen për fëmijët ose shtëpinë krahasuar me vetëm 5.8 për qind të burrave.³² Përkundër Ligjit kundër diskriminimit, grupet e tjera po ashtu kanë qenë me disavantazhe lidhur me papunësinë, duke përfshirë njerëzit me nevoja të veçanta fizike dhe psikologjike.³³

Duke mos i kontribuuar të hyrave familjare, gratë dhe grupet e tjera me disavantazhe kanë qenë të prirura të kenë më pak pushtet vendimmarrës brenda familjeve. Vërtet, ka ekzistuar një korrelacion midis njerëzve që kanë qenë të papunë dhe atyre që e kanë konsideruar të vështirë për të biseduar me partnerët e tyre lidhur me gjërat të cilat kanë qenë të rëndësishme për ta. Më tej, varësia ekonomike mund t'i bëjë gratë të paafta

²⁷ Vlerësimi i Bankës Botërore për vitin 2001 lidhur me papunësinë ka qenë 70 për qind (*Vlerësimi i varfërisë në Kosovë, Nxitja e shanseve, sigurisë dhe pjesëmarrjes për të gjithë*). Vlerësimet e tjera lëvizin varësish nga bollëku i përkufizimeve të përdorura të “papunësisë” (RRGGK, *Hulumtim kërkimor*). ESK ka raportuar papunësinë afersisht 40 për qind në vitin 2004 (*Të dhëna statistikore të tregut të punës 2004*, 7).

²⁸ Elaine Zuckerman dhe Marcia E. Greenberg, “Dimensionet gjinore të rindërtimit të pasluftës.”

²⁹ Weber dhe Watson, 515.

³⁰ ESK, *2004 Të dhëna statistikore të tregut të punës 2004*, 26.

³¹ ESK, *2004 Të dhëna statistikore të tregut të punës*, 7. ESK më vënë e ka vlerësuar shkallën e papunësisë 33 për qind për meshkujt 60 për qind për gratë (*Gratë dhe burrat në Kosovë*, 2007).

³² Vetëm 8.7 për qind e meshkujve kanë punuar brenda ose jashtë shtëpisë, derisa një e trete e grave të anketuara e kanë kaluar kohën duke u kujdesur për fëmijët, kopshtin, mirëmbajtjen e shtëpisë dhe / ose kujdesin për kafshët e shtëpisë. Në përgjithësi, gratë dhe burrat në zonat rurale kanë qenë të prirur të mos punojnë për arsy se ata kanë pasur punë rrëth shtëpisë.

³³ Handikos Prizren, anketë e RRGGK-së, 2008.

për të mbijetuar pavarësisht dhe i vë ato para rrezikut të mbetjes pengje të dhunës së situatave të familjes.³⁴ Siguria ekonomike është thelbore për gratë me qëllim që të rris rolin e tyre vendimmarrës brenda familjeve të tyre, si dhe të zvogëlojë gjasat se ato mund të jenë të kufizuara brenda një jete të dhunshme të shtëpisë.

Themelimi i qendrave të mundshme të kujdesit përfundohet me qëllim që të lejonte grave më shumë përfundohet me qëllim që të kujdesit ditor mund t'i lironë nga organizohen në familjet nga gratë e atyre zonave. Qeveria po ashtu mund t'i lironë nga tatimet kompanitë e interesuara në punësimin e grave dhe të grupeve të tjera të marginalizuar. Me qëllim t'i ndërpërrohet së dhunës, Handikosi në Prizren, gjithashtu ka rekomanduar që qeveria të sigurojë shanse të punësimit dhe të shkollimit përfundohet me nevoja të veçanta. Sipas të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, ata duhet t'i sigurojnë që shkollimi obligator t'i përfundohet dhe njerëzit t'i mos jenë të diskriminuar në praktikat e punësimit, sipas përfaqësuesve të Handikos-it.³⁵

5. Diskriminimi në posedimin e pronësisë dhe trashëgimisë

Ngshtësisht e lidhur me pasigurinë ekonomike, që rezulton nga praktikat diskriminuese të punësimit, trashëgimia dhe posedimi i pronësisë në mënyrë tradicionale ka favorizuar meshkujt në Kosovë. Sipas Partners Kosova, burrat ende trashëgojnë shumicën e pronës nëse jo edhe në 99 të rasteve.³⁶ Përkundër mbrojtjes ligjore përfundohet me qëllim që të kujdesit ditor mund t'i lironë nga organizohen në familjet nga gratë e atyre zonave. Qeveria po ashtu mund t'i lironë nga tatimet kompanitë e interesuara në punësimin e grave dhe të grupeve të tjera të marginalizuar. Me qëllim t'i ndërpërrohet së dhunës, Handikosi në Prizren, gjithashtu ka rekomanduar që qeveria të sigurojë shanse të punësimit dhe të shkollimit përfundohet me nevoja të veçanta. Sipas të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, ata duhet t'i sigurojnë që shkollimi obligator t'i përfundohet dhe njerëzit t'i mos jenë të diskriminuar në praktikat e punësimit, sipas përfaqësuesve të Handikos-it.³⁵

Si përfundim, kufizimet sociale të diskutuara në këtë kapitull duket se janë të ndërlidhura. Pabarazitë në familje, mungesa e autoritetit vendimmarrës, trajtimi i pabarabartë në fëmijëri, qasja e mohuar ndaj shkollimit dhe, si rezultat, mungesa e shanseve të punësimit si dhe trajtimi i pabarabartë në praktikat e trashëgimisë mund t'i kontribuojnë dhunës në Kosovë, janë ngshtësisht të lidhura me pabarazitë gjinore të praktikave sociale dhe të traditës. Këto kufizime sociale janë të prirura të diskriminojnë kundër grave dhe, së këndejejmi, i vënë gratë para rrezikut më të madh të dhunës në familje.

³⁴ OSBE dhe MPMS, 14.

³⁵ Handikos Prizren, anketë e RRGGK-së, 2008.

³⁶ Partners Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

³⁷ RRGGK, *Monitorimi i implementimit*, dhe RRGGK, *Hulumtim kërkimor*

³⁸ RRGGK, *Monitorimi i implementimit*, 50.

³⁹ Raporti i Ombudspersonit.

⁴⁰ Shih, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, *Kërkim mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme* (Prishtinë: 2004), 11.

Praktikat diskriminuese kundër grave në Kosovë janë vëzhguar *de facto* si diskriminim i kundërvënë diskriminimit *de jure*, ngaqë barazia është e garantuar me legjislacionin e tashëm.⁴¹ Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit në Kosovë ka vërejtur në raportin e tij vjetor 2006 dhe 2007 për Kuvendin e Kosovës se gratë vazhdojnë të jenë të diskriminuara nga burrat si në sferën private, ashtu edhe në atë publike.⁴² Janë të nevojshme përpjekjet për të zbatuar ligjin dhe, që është edhe më me rëndësi, për të zhveshur mitet dhe për të dekurajuar praktikat diskriminuese të cilat e përjetësojnë pabarazinë dhe, së këndejmi, e rrisin gjasën e të ndodhurit të dhunës në familje. Krijimi i legjislacionit, i cili është i ndjeshëm ndaj pabarazive gjinore, mund t'i kontribuojë shërimi të praktikave diskriminuese dhe dhunës kundër grupeve të rrezikuara, duke përfshirë gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.

⁴¹ Institucionet e veçanta sociale dhe besimet në shumë kultura mund ta legjitimojnë dhunën kundër femrës (Shih KKEDKG).

⁴² Raporti i Ombudspersonit.

KAPITULLI 6

ZBRAZËTITË LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NË TRAJTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Bërja e shtetit përgjegjës për trajtimin e dhunës që ndodh në sferën private mbetet sfiduese.¹ Shteti dhe e drejta ndërkombëtare në përgjithësi kanë qenë të prirura për ta konsideruar dhunën në familje një “çështje private” më parë se sa një çështje të rëndësishme për sigurinë kombëtare.² Tradicionalisht, siguria kombëtare që involvon “agresorin e jashtëm” e ka tërhequr vëmendjen e vendimmarrësve më shumë se sa adresimi i çështjeve të sigurisë së brendshme, posaçërisht rreziqet për sigurinë e grave në fushën private.³ Prapë, kërkimet e mëhershme kanë sugjeruar se gratë janë më shumë të prirura për të qenë të lënduara nga dikush të cilin e njohin se sa nga të huajt, posaçërisht një i huaj ndërkombëtar.⁴ Së këndejmi, analistët kanë kritikuar pikëpamjet e ngushta të sigurisë dhe kanë argumentuar për një përkufizim më të gjerë, më gjithëpërfshirës.⁵

Është kritikuar si androcentrik fakti se shkeljet e parimeve të të drejtave të njeriut brenda ambienteve private (pra, shtëpive) iu mungon trajtimi për arsyen se përvojat e ndryshme jetësore mbeten të patrajuara, duke e bërë shpërndarjen e drejtësisë të pabarabartë në praktikë.⁶ Kur marrëdhëniet e pushtetit dhe një larmi e konteksteve kihen parasysh, të drejtat shpesh dështojnë në trajtimin e pabarazive të ndryshme strukturale.⁷ Injorimi i pabarazive të tillë dhe kushtet mund të shpiejnë në një situatë në të cilën të drejtat e barabarta riprodhojnë pabarazi dhe në të njëjtën kohë injorojnë kushtet e konteksteve, siç e ilustron kapitulli i fundit.⁸ Kur shtetet adresojnë dhunën nëpër shtëpitë, ata kanë nevojë të kenë parasysh pabarazitë dhe kushtet strukturale që ndikojnë në shpërndarjen e drejtësisë nga kontekstet e ndryshme.

Një numër i instrumenteve ndërkombëtare e ka përcaktuar përgjigjen ndaj dhunës në familje dhe në mënyrë specifike kundër grave në nivel ndërkombëtar. Në vitin 1979

¹ Margharet Schuler, “Ktheje botën së mbari” në Instituti për gra, ligj dhe zhvillim, Kërkimi vendit tonë: *funkcionimi i të drejtave të njeriut në përparim të femrës* (Uashington: Instituti për gra, ligj dhe zhvillim, 1993).

² Tickner, (1997) 613.

³ Në Kosovë, “tjetri” është përkufizuar përmes dallimeve etnike/kombëtare (pra, serb, shqiptar). Gjatë luftimeve midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, dhuna në familje mund të jetë parë si rrezik për çështjen kombëtare (Shih Julie Mertus, “gjinia në shërbim të shtetësisë kombëtare femërore në shoqërinë kosovare,” *Politikat sociale, Verë/Vjeshtë 1996, 261-277* dhe Julie Mertus, “Gratë në Kosovë: terrenet e kontestuara” në *Politikat gjinore në Ballkanin Perëndimor: Gratë dhe shoqëria në shtetet trashëguese të Jugosllavisë*. Bot. Sabrina P. Ramet. University Park: Penn State UP, 1999).

⁴ Heise, Ellsberg, dhe Gottemoeller 1999; Watts dhe Zimmerman 2002, cituar në QMG et al.

⁵ Për shembull, Tickner ka kritikuar teorinë marrëdhënieve tradicionale ndërkombëtare si “maskuliniste” (*Gjinia në marrëdhëniet ndërkombëtare*, New York: Columbia University Press, 1992)

⁶ H. Charlesworth dhe Ch. Chinkin, *Kufijtë e të drejtës ndërkombëtare: Analizë feministe*, kap. 7 (New York: Manchester University Press, 2000), 208-212.

⁷ Tony Evans, “Hyrje: pushteti, hegemonia dhe universalizimi i të drejtave të njeriut,” *Të drejtat e njeriut pas pesëdhjetë vitesh: Një rivlerësim*, Tony Evans (ed.), (Manchester, New York: Manchester University Press, 1998), 2, 16.

⁸ Ann Philips, “Multikulturalizmi, Universalizmi dhe pohimet e demokracisë” M Molyneux dhe S Razavi (botues *Drejtësia gjinore, zhvillimi dhe të drejtat* (2001), 117.

Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Kundër Gruas (KEDKG) i ka vënë bazat për përkufizimin e diskriminimit kundër grave dhe dhunës mbi baza gjinore. Deklarata e Vjenës mbi të Drejtat e Njeriut e vitit 1993 ka afirmuar të drejtat e grave si të drejta të njeriut dhe Platforma e Veprimit e Pekinit e vitit 1995 ka ripërsëritur përgjegjësitë e shtetit për luftimin e dhunës kundër grave. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) e vitit 2000 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë e ka përqendruar vëmendjen në dhunën kundër grave në operacionet paqeruajtëse si dhe gjatë konfliktit dhe situatave paskonfliktuze. Autoritetet e Kosovës po ashtu duhet të zbatojnë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës. Pos kësaj, Këshilli i Evropës ka miratuar rekomandimet drejt adresimit të dhunës në familje, siç është Rekomandimi (2000) 5 mbi mbrojtjen e grave kundër dhunës. Legjislacioni i familjes në Kosovë cek një numër të konventave ndërkontaktore të lartpërmendura, dhe autoritetet e Kosovës duhet të zbatojnë këto parime kur i përgjigjen rasteve të dhunës në familje.⁹

Legjislacioni mbi familjen në Kosovë dhe policia po ashtu janë përgjigjur ndaj kufizimeve të ndryshme sociale dhe pabarazive gjinore të cilat mund të deprivojnë gratë në sferën private dhe publike. Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjet siç janë Ligji mbi barazinë Gjinore, Ligji kundër diskriminimit, Ligji mbi familjen dhe shërbimet sociale dhe Ligji mbi të drejtën familjare. Këto ligje mund të konsiderohen gurë themele në promovimin dhe mbrojtjen e barazisë gjinore dhe të parimeve të mosdiskriminimit në Kosovë.¹⁰ Më tej, aktivitetet e parapara në Planin kombëtar të veprimit mbi arritjen e barazisë gjinore në Kosovë (2003) trajtonë çështje të lidhura me kufizimet ekonomike, politike, sociale dhe kulturore, të cilat mund të privojnë gratë nga të gjëzuarit e të drejtave të tyre në sferën publike. Kosova gjithashtu ka krijuar një numër të mekanizmave të barazisë gjinore siç parashihet me Ligjin mbi barazinë gjinore të Kosovës në nivel ministror dhe komunal.¹¹ Derisa mekanizmat e tillë janë relativisht të reja, kërkimi preliminar ka kritikuar pikat fokale ministrore dhe komunale lidhur me çështjet ligjore për mungesën e resurseve njerëzore e financiare, kapacitetin profesional dhe të kuptuarit e barazisë, që vazhdon të pengojë reagimet efikase të këtyre mekanizmave institucional.¹²

Në Kosovë, zbatimi i legjislacionit dhe zbatimi i ligjeve kanë qenë problematik dhe institucionet kosovare kanë luftuar për të mbështetur sundimin e ligjit. Autoritetet kosovare pothuajse në tërësi e kanë injoruar zbatimin e disa ligjeve siç është Ligji mbi barazinë gjinore dhe Ligji kundër diskriminimit.¹³ Trajtimet e ndryshme, të ndikuara nga diskriminimi kundër grave dhe fëmijëve, po ashtu kanë shkaktuar probleme në zbatimin e masave civile dhe penale, të parapara për të mbrojtur viktimat dhe për të ndjekur penalisht kryerësit e dhunës në familje.¹⁴

Në këtë kapitull vështrohen aktivitetet juridike dhe institucionale të autoriteteve të Kosovës ndaj rasteve të dhunës në familje. Për më tepër Kapitulli i identifikon zbrzetitë aktuale ligjore dhe institucionale në trajtimin e dhunës në familje në Kosovë me qëllim të

⁹ Kushtetuta e Kosovës cek konventat ndërkontaktore të cilat autoritetet duhet t'i zbatojnë në pjesën mbi liritë dhe të drejtat themelore, neni. 22. Në <http://www.kushtetutakosoves.info>, qasur në qershor 2008.

¹⁰ UNFPA, "Një rast studimor mbi dhunën në baza gjinore në Kosovë," (2004), 19.

¹¹ Shih Ligjin e Kosovës mbi barazinë gjinore, kap. mbi organet përgjegjëse për arritjen e barazisë dhe kompetencat e tyre.

¹² Ombudspersoni, "Raport vjetor i zëvendësit të Ombudspersonit në Kosovë 2006-2007," Pjesa mbi barazinë gjinore, 63-72. Shih po ashtu, RRGGK, *Monitorimi i implementimit*. UNIFEM-i po kështu ka analizuar funksionimin e këtyre mekanizmave në një Konferencën për mekanizmat e barazisë gjinore, Shtator 2005.

¹³ Ombudspersoni, Raporti vjetor, 16.

¹⁴ Shih pjesën mbi mbrojtjen më poshtë.

informimit të iniciativës së tashme të Qeverisë së Kosovës për përpilimin e Planit kombëtar të veprimit të Kosovës kundër dhunës në familje.¹⁵ Analizat dhe rekomandimet e paraqitura këtu janë të bazuara në të dhënrat në dispozicion nga institucionet kosovare dhe kërkimet e tashme. Së pari, lidhur me tri fushat e fokusit të Iniciativës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Gruas, ky kapitull shqyrton zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e viktimate (pjesa e parë), ndjekjen penale të kryerësve të dhunës (pjesa e dytë) dhe parandalimin e dhunës në familje (pjesa e tretë). Pjesa e katërt i bënë rekomandimet për përforcimin e reagimeve të gjithëmbarshme të qeverisë ndaj dhunës në familje, duke përfshirë mënyrat për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe monitorimin. Të gjitha pjesët përfshijnë rekomandime konkrete për secilin institucion lidhur me përmirësimin e reagimit të tij ndaj dhunës në familje.

1. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e viktimate të dhunës në familje

Kjo pjesë së pari shqyrton zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e viktimate të dhunës në familje. E dyta, përmes saj shqyrtohet reagimi institucional në mbrojtjen e viktimate, duke përfshirë bashkëpunimin midis institacioneve. E treta, në të ofrohen rekomandime të hollësishme drejt përmirësimit të reagimit institucional në mbrojtjen e viktimate.

1.1 Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e viktimate

Për të mbrojtur viktimat dhe për të ndjekur penalisht kryerësit e dhunës në familje, sipas ligjit në fuqi në Kosovë janë të parapara një numër i masave të së drejtës civile dhe penale. Rregullorja e UNMIK-ut r. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje parashev një varg masash si reagim ndaj nevojave të viktimate të dhunës në familje përmes ofrimit të mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të asistencës.¹⁶ Kjo Rregullore parashev një sërë urdhresh të mbrojtjes për të mbrojtur viktimin nga kryerësit e akteve të dhunës në familje¹⁷ dhe i bënë përgjegjës organet e zbatimit të ligjit (SHPK-në), përkrahësit e viktimate dhe nëpunësit e shërbimeve sociale (NSHS) për mbrojtjen e viktimate të dhunës në familje.¹⁸ Kodi Penal i Kosovës po ashtu përkufizon veprat e ndryshme penale të kryera në kuadër të dhunës në familje.¹⁹ Këto krime mund të hetohen dhe të ndiqen penalisht ex officio (sipas detyrës zyrtare) ose nga veprimi privat në varësi prej seriozitetit të krimít. Dhuna në familje per se nuk është e përkufizuar në kodin penal. Kur adresohen aktet e dhunës në familje, Kodi Penal i Kosovës cek veprat e ndryshme penale siç është lëndimi i lehtë trupor, lëndimet e rënda trupore, dhunimi dhe abuzimi seksual të kryera në kuadër të

¹⁵ Përpjekjet duhet të udhëhiqen nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe të mbështeten nga UNDP/SFIS .Rekomandimet e veçanta për këtë përpjekje janë paraqitur më vonë në kapitull.

¹⁶ Shih, për shembull, Ombudspersoni, *Ex Officio* Raport i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovo Raport lidhur me zbatimin e nenit 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, *Ex Officio* Regjistrimi nr. 1/06 (Nëntor 2006).

¹⁷ Rregullorja mbi dhunën në familje ofron tri lloje të urdhrale të mbrojtjes: Urdhrin e Mbrojtjes, Mbrojtjen Emergjente dhe Urdhërimi përkohshëm emergjent të mbrojtjes. Urdhrat e mbrojtjes dallojnë për nga masat dhe autoriteti i cili i zbaton. Disa nga masat janë: ndalimi i kryerësit të dhunës familjare qasjen në distancë të caktuar ose në vendin e punës.; ndalimi i kryerësit të dhunës për të hyrë ose për të qëndruar në vendbanimin e përbashkët me viktimin; urdhërimi i kryerësit për të lejuar viktimin për të shfrytëzuare vendbanimin e përbashkët nëse gjykata vlerëson se kjo nuk do të jetë kundër sigurisë dhe mirëqenies së viktimit; urdhri mbi konfiskimin e armëve; urdhri mbi kthimin e fëmijës tek viktima; ndalimi i posedimit çfarëdo pasurie qoftë nga viktima qoftë nga kryerësi i dhunës për një periudhë të caktuar të përkohshme të kohës (neni 2).

¹⁸ Po ashtu kriminalizon shkeljen e masave të urdhrit të mbrojtjes përmes kërkimit të gjobave për kryerësit e dhunës në familje (neni 16 i Rregullores mbi dhunën në familje).

¹⁹ Në mënyrë specifike, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

marrëdhënies familjare. Së këndejmi, për qëllimet e kodit penal, këto vepra penale mund të konsiderohen si akte specifike të dhunës në familje.²⁰

Përkufizimi i “dhunës në familje” në Kodin Penal dhe në Rregulloren mbi dhunën familjare është i njashëm. Përkufizimi më i gjerë akomodon mënyrat e përbashkëta të jetës në Kosovë përmes të cekurit eksplisit se cilët persona janë të përkufizuar si anëtarë të familjes dhe kanë të drejtë të kërkojnë urdhër për mbrojtje.²¹ Rregullorja mbi dhunën në familje ofron përkufizimin e dhunës në familje vetëm për qëllime të lëshimit të urdhrit të mbrojtjes duke përdorur procedurat e ligjit civil në gjykata.²² Për urdhrat e mbrojtjes, akte të dhunës në familje ose mungesë e tyre janë: shkaktimi i lëndimeve trupore; angazhimi i personit tjetër në akte seksuale pa pajtim ose eksplorimi seksual; shkaktimi i frikës te personi tjetër për mirëqenien e tij ose të saj fizike, emocionale ose ekonomike; kidnapimi; shkaktimi i dëmit në pronë; kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër; hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër; largimi me dhunë i personit nga vendi i tij i përbashkët i banimit; ndalimi i personit tjetër nga hyrja ose dalja nga prona e tij e zakonshme ose angazhimi në një model dhune me qëllim të degradimit të personit tjetër kur kryhen në kuadër të marrëdhënies familjare.²³ Ndarja e hollësishme, por edhe e ndërlikuar e mbrojtjes dhe e ndjekjes penale të akteve të dhunës në familje, ka shkaktuar vështirësi në zbatim (shih më poshtë).

Rregullorja mbi dhunën në familje parashev reagim ekspeditiv nga gjykatat në përgjigje ndaj nevojave të veçanta të viktimate të rrezikuara..²⁴ Rregullorja ofron bazat për lëshimin e llojeve të ndryshme të urdhrove të mbrojtjes kur kryerësi i dhunës familjare paraqet një kërcënim të pandërmjetëm ose të afërm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës.²⁵ Poashtu ofron mbrojtjen për dëshmitarët e dhunës, të cilët mund të janë të rrezikuar nga raportimi i saj.²⁶ Më tej, Rregullorja mbi dhunën në familje cek aktet e lëndimit të lehtë trupor, shkeljen e urdhrove të mbrojtjes, aktet seksuale pa pajtim ose shfrytëzimin seksual, kidnapimin dhe dëmtimin e pronës së personit tjetër si vepra të lidhura me dhunën në familje kur kryhen brenda marrëdhënies familjare dhe kërkojnë ndjekje penale sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).²⁷

Aftësia e zyrtarëve të SHPK-së për të mbrojtur viktimat është përmirësuar në mënyrë të dukshme që nga miratimi i Rregullores mbi dhunën në familje. Më herët, “policia ka intervenuar në rastet e dhunës familjare vetëm për të qetësuar situatën. Pastaj, ata i kanë

²⁰ Shih OSBE dhe MPMS, 24.

²¹ Shih hyrjen lidhur me përkufizimin e “marrëdhënies familjare”.

²² Rregullorja mbi dhunën në familje kërkon që procedurat e parapara me Ligjin mbi procedurën e kontestimore të përdoren kur kërkohet ose lëshohen urdhrat e mbrojtjes (shih nenen 6.3, 7.3, 8.4, 8.6, 9.4, 10.4, 10.6, 13.4, 13.6 dhe 18.2). Megjithëkëtë, disa nga aktet siç janë lëndimet e lehta trupore, shkelja e urdhrove të mbrojtjes, aktet seksuale jokonsensual ose eksplorimi seksual, kidnapimi, dëmtimi i pronës së personit tjetër janë të cekura si vepra penale të dhunës në familje kur kryhen në kuadër të marrëdhënies familjare dhe kërkojnë *ex officio* ndjekjen penale sipas procedurës penale.

²³ Neni 1.2 i Rregullores mbi dhunën në familje.

²⁴ Rregullorja mbi dhunën në familje kërkon që gjykata të lëshojë urdhrat e mbrojtjes në kohën e duhur.: brenda 24 orëve për një urdhër emergjent të mbrojtjes dhe brenda 15 ditëve për urdhrin e mbrojtjes nga kërkesa e bërë për urdhrin (neni 7 dhe 9 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12).

²⁵ Neni 2.1 (p), 6.3 (d), 8.1 (b), 10.1 (b) (c), 13.2 (b) (c), dhe 14.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12.

²⁶ Pak informacion ekziston në dispozicion lidhur me faktin nëse urdhrat e mbrojtjes i janë dhënë dëshmitarëve të dhunës. Megjithëkëtë, Rrjeti i të Rinjve i Kosovës ka vërejtur se disa të rinj nuk e raportojnë dhunën për arsy se janë të shqetësuar për reperkusionet ose pasojat. Qeveria ka nevojë për të siguruar konfidencialitetin e njerëzve, të cilët e raportojnë dhunën dhe për të siguruar se mekanizmat për t'i mbrojtur janë në funksion, duke përfshirë strehimin, nëse ata kanë nevojë, thonë ata (anketë e RRGGK-së, 2008).

²⁷ Neni 16 i Rregullores mbi dhunën në familje.

lënë njerëzit vet të merren me problemin,” ka thënë një përfaqësues i SHPK-së.²⁸ Që nga miratimi i Rregullores kundër Dhunës në Familje, institucionet e kanë trajtuar dhunën në familje më seriozisht, duke përfshirë veprat penale në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Mirëpo, përfaqësuesit e institacioneve që merren me dhunën në familje kanë thënë se ekzistojnë ende zbrazëti të shumta ligjore.²⁹ Për shembull, jo të gjitha veprat penale që mund të ndodhin në marrëdhënien familjare kanë qenë të përkufizuara në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.³⁰ “Është e vështirë të zbatohet në praktikë një ligj i cili nuk i dënon të gjitha aktet e dhunës në familje” ka thënë një përfaqësues i SHPK-së.³¹

SHPK-ja po ashtu ka hasur në probleme në zbatimin e nenit 13, që parashev urdhrat e mbrojtjes së përkohshme emergjente që duhet të jepen nga policia e UNMIK-ut. Derisa policia e UNMIK-ut t'i bartë kompetencat e saj te SHPK-ja, kjo kompetencë e veçantë ka mbetur e rezervuar për policinë e UNMIK-ut, edhe pse ata nuk mund të veprojnë dhe mundën vetëm të monitorojnë. Tash për tash, asnje institucion nuk mund të zbatojë këtë nen bazuar në ligjin ekzistues. Së këndejmi, një ligj i ri kundër dhunës në familje ka nevojë t'i jep SHPK-së kompetencia për të përcaktuar urdhrat e mbrojtjes emergjente për më gjatë se 48 orë, si një kompetencë që më parë është mbajtur nga UNMIK-u.³²

Edhe pse ligji penal dhe civil përfshijnë përcakttime të hollësishme të roleve dhe të përgjegjësive të agjencive të ndryshme për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje, zbatimi i këtyre dispozitave është dëshmuar i vështirë. Gjykatësit dhe prokurorët shpesh kanë dështuar në zbatimin korrekt të legjislacionit. Rasti i mëposhtëm, i siguruar nga një raport i kohëve të fundit të Misionit të OSBE-së në Kosovë,³³ ilustron problemet me zbatimin e duhur të Rregullores mbi dhunën në familje dhe Kodit Penal:

Në një rast në Ferizaj, më 20 nëntor 2006, Prokurori publik komunal ka lëshuar një raport policor të datës 3 nëntor 2006 që ka treguar se një burrë fizikisht e ka sulmuar gruan e tij dhe i ka shkaktuar lëndime trupore, duke kryer, kështu, krim i cili duhet të ndiqet penalisht *ex officio*. Sipas hetimeve të polisë, ka ekzistuar dhuna midis çiftit edhe para incidentit të fundit. Në vendimin e lëshimit, prokurori gabimisht e ka interpretuar legjislacionin e tashëm në fuqi dhe ka pohuar se të “**dyja palët kanë kryer “dhunë në familje”, një vepër penale kjo e cila nuk ekziston. Në të kundërtën, vendimi mbi lëshimin ka thënë se “(vepra penale e dhunës në familje) nuk është në mesin e veprave penale që ndiqen penalisht *ex officio*.**”

Në vend të ngarkimit të kryerësit të dhunës me krim të lëndimit trupor në pajtim me Kodin Penal³⁴ dhe të kërkimit të urdhrit të mbrojtjes si të paraparë me Rregulloren mbi dhunën në familje, ndjekja penale ka dështuar që në mënyrë korrekte të hetojë rastin dhe e ka lënë

²⁸ Sektori për hetimin e dhunës në familje dhe i keqtrajtimeve të fëmijëve në Drejtoren kundër krimeve të rënda të SHPK-së, anketë e RRGGK-së, 2008.

²⁹ SHP QMG, Medica Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

³⁰ SHPK, anketë e RRGGK-së, 2008. Për shembull, ajo dhe një zyrtar tjetër i SHPK-së kanë thënë se shqetësimet, dhuna e kombinuar fizike dhe psikologjike, dhe grindja nuk janë të cekura në mënyrë specifike. (anketë e RRGGK-së).

³¹ SHP, anketë e RRGGK-së 2008.

³² QPS, Prishtinë dhe DAVA, anketë e RRGGK-së 2008

³³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë,” (korrik 2007).

³⁴ Krimet, duke përfshirë shkaktimin e dëmit fizik personit përmes shkaktimit të lëndimit të lehtë ose të rëndë trupor dhe dëmtimit të përkohshëm të organit ose të një pjese të trupit të personit tjetër; zvogëlimi i aftësisë së personit për të punuar; deformimi i personit tjetër ose dëmtimi i shëndetit të personit tjetër kur kryhet brenda marrëdhënieς familjare konsiderohen krime të dënueshme me dënim deri tri vite burgim dhe duhet të ndiqen penalisht *ex officio* (shih nenin 153, 154 të Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës).

kryerësin e dhunës të lirë. Kërkimet e tjera në Kosovë në dispozicion mbi zbatimin e Rregullores mbi dhunën në familje dhe aktet e tjera ose mungesa e tyre kur janë kryer në kuadër të marrëdhënies familjare kanë treguar zbatim joadekuat ose të pjesërishtëm të legjislacionit.³⁵

Gjykatësit dhe prokurorët kanë raportuar vështirësi praktike në zbatimin e këtij legjislacioni, i cili ka dështuar në ofrimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë dhe viktimat e dhunës në familje kanë paraqitur ankesa tek Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës lidhur me dështimin e një numri të gjykatave komunale në zbatimin e neneve 7 dhe 9 të Rregullores lidhur me lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes emergjente.³⁶ Rregullorja mbi dhunën në familje parashev një numër të masave, të cilat mund të nxjerren kundër kryerësve të dhunës nga gjykatat. Sidoqoftë, në praktikë, masat e nxjerra nga gjykatat ose janë të kufizuara për nga natyra e tyre ose janë të përdorura nga gjykatësit për të lehtësuar pasojat e shkaktuara nga aktet e dhunës në familje. Në rastin e një kërkese për urdhër të mbrojtjes në Gjykatën Komunale në Leposaviq, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka raportuar se viktima ka kërkuar largimin e kryerësit të dhunës nga ambienti i përbashkët i jetesës. Gjykata ka vendosur të kundërtën, duke i urdhëruar viktimës të kthehet në vendbanimin e përbashkët dhe t'i lejohet të shoh TV.³⁷ Edhe pse QMS po ashtu ka rekomanduar largimin e kryerësit të dhunës, gjykata nuk ka marrë parasysh se si vendimi i saj mund të rrezikojë viktimën dhe sigurinë si dhe shëndetin e fëmijëve të saj. Në këtë rast të veçantë, urdhri i mbrojtjes është lëshuar për të pajtuar qiftin më parë se sa për të nxjerrë masat mbrojtëse të kërkuara nga viktima.

Në rastet e tjera të monitoruara nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës³⁸ dhe nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, gratë kryesish kanë kërkuar masa të parapara me nenin 2 (i) të Rregullores mbi dhunën në familje, që e urdhërojnë “kryerësin e dhunës të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë vendbanimin e përbashkët nga i padituri dhe pala e mbrojtur.” Burrat në Kosovë zakonisht i sanksionojnë gratë viktima të dhunës familjare për “mosbindje” me largim të tyre dhe, ndonjëherë, të fëmijëve të tyre nga vendbanimet e tyre të përbashkëta të jetesës.³⁹ Në këtë kuptim, urdhri i mbrojtjes i mundëson grave të kthehen në ekonominë e përbashkët familjare. Vendimi mbi vendosjen e serishme të qiftit në vendbanimin e përbashkët mund të shkaktojë rrezik për shëndetin dhe mirëqenien e viktimës dhe të fëmijëve të saj.

Për shembull, në rastin e parë nga Gjilani, nëna ka dëshiruar të kthehet në apartamentin e burrit të saj edhe pse ai e ka keqtrajtuar atë dhe foshnjën e tyre. Ngaqë mundësia e dhunës së mëtejme ka ekzistuar, kthimi në shtëpi nuk ka qenë në

³⁵ Shih OSBE dhe MPMS, 24

³⁶ Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës, në pajtim me nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit të Kosovës mund të kryejë *ex officio* hetime të institucioneve gjyqësore sipas iniciativës ëtij ose të saj nëse ekziston dyshimi se mund të kenë qenë shkelur të drejtat e njeriut.

³⁷ Po aty, f. 13.

³⁸ Institucioni i Ombudspersonit, *Ex Officio Raport*, 2006.

³⁹ Zakonisht gratë në Kosovë nuk kanë pronësi dhe as që e gjëzojnë të drejtën e trashëgimisë të paraparë me ligjin në fuqi. Është, së këndejmi, shumë e zakonshme që prona është e regjistruar në emrat e bashkëshortëve të tyre ose të anëtarëve të tjerë të familjes në familjen e gjërë (pra, babait ose gjyshit të burrit). Gratë, së këndejmi, me lehtësi mund të largohen nga prona e cila nuk posedohet ligjërisht dhe ky akt i formës së dhunës në familje shpesh shfrytëzohet nga kryerësit e dhunës si masë për të “disiplinuar” gratë dh fëmijët e tyre. Shih Ombudspersoni, “Raport vjetor i zëvendësitet të Ombudspersonit për Kuvendin e Kosovës 2006-2007”, pjesa mbi “Barazinë gjinore në Kosovë” 63-72.

interesin më të mirë të fëmijës. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e dytë (Gjilan) nëna ka kërkuar të kthehet në shtëpinë e burrit të saj me fëmijën përkundër faktit se burri, sipas pohimeve, ka kryer akte të dhunës fizike kundër tyre... gjykata...megjithëkëtë, ka vazhduar me seancën dhe ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes.⁴⁰

Në secilin prej rasteve të monitoruara nga Institucioni i Ombudspersonit, shumica e viktimateve dhe e fëmijëve tyre janë kthyer në shtëpitë e “burrage” të tyre pa një analizë në thellësi ose njohuri për aktet e mundshme të dhunës që mund të shkaktojnë rrezik për shëndetin dhe mirëqenien e viktimës.⁴¹ Edhe pse Rregulloja mbi Dhunën në Familje parashev që kryerëseve të dhunës mund të mos iu lejohet t’iu qasen viktimateve në një distancë të caktuar ose që të mbresin me viktiminë në banesën ose shtëpinë e përbashkët,⁴² gjykatat rrallë iu ofrojnë viktimateve këtë masë të paraparë.

Sipas Rregullores mbi dhunën në familje, anëtarë i familjes nuk mundet me forcë të largojë anëtarin tjetër të familjes nga vendi i përbashkët i banimit, por nëse viktima është në rrezik nga të vazhduarit e të jetuarit me kryrësin, Rregulloja nuk ofron asnjë alternativë tjetër.⁴³ Lëshimi i urdhërave mbrojtës, që përcaktojnë se kryerësi i dhunës dhe viktima e kanë të përbashkët të njëjtën shtëpi, i vënë viktimat para rrezikut. Një ZSHS ka thënë: “Viktima jeton nën trysninë dhe duhet të lëshojë atë vend për arsy se kryerësi nuk respekton urdhrin e mbrojtjes.” Më tej, policia shpesh dështon në intervenim dhe gjykatat rrallë ndërmarrin veprime kur thyhen urdhrat e mbrojtjes.⁴⁴

Masa të tjera, siç është urdhërimi i kryerësit për të paguar për qiranë e viktimës në një vend tjetër të banimit ose mbështetje për fëmijën, rrallë janë vërejtur.⁴⁵ Sipas një përfaqësuesi të DAVA-s, nëse gjykatat nuk kanë dëshmi se kryerësi i dhunës mund të sigurojë një pagesë të tillë për arsy se kryerësi nuk ka pasuri, pagë ose se është duke punuar pa kontratë, gjykata “nuk mund” ta shtyjë atë për ta bërë këtë.⁴⁶ Derisa kjo nuk është plotësisht e saktë, ngaqë ligji mbi ekzekutimin e përkufizon se si duhet të bëhen kalkulimet e tillë dhe sesi policia duhet të ekzekutojë vendimet e gjykatës, ndërsa sundimi i ligjit është i dobët në sigurimin e zbatimit.⁴⁷ Madje edhe atëherë kur gjykatat kanë urdhëruar se kryerësi duhet të paguajë mbështetjen ose alimentacionin, ky vendim është zbatuar shumë rrallë, kanë thënë disa të anketuar.⁴⁸

Po ashtu janë vëzhguar rastet e viktimateve që tërhiqen nga ndjekja penale e rasteve të dhunës në familje ose kërkuesat për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes. Në 39 raste të hetuara nga Institucioni i Ombudspersonit, viktimat kanë tërhequr gjashtë kërkesa për lëshimin e

⁴⁰ Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raport i rasteve të dhunës në familje në Kosovë,” (korrik, 2007).

⁴¹ Shih OSBE dhe MPMS, 24.

⁴² Neni 2 (c) dhe (f) i Rregullores mbi dhunën familje.

⁴³ Avokati i viktimës në Prishtinë, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁴⁴ ZSHS në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008 QMG po ashtu ka komentuar se urdhrat e mbrojtjes kanë kërkuar monitorim më të mirë për të siguruar mbrojtjen e viktimës prej kryerësit të dhunës (anketë e RRGGK-së, 2008). Përfaqësuesit DAVA-s kanë rekomanduar që shkelja e urdhreve të mbrojtjes të përfshijë sanksione më të ashpra në pajtim me kodin penal.

⁴⁵ DAVA po ashtu ka raportuar dykuptimësi në vendimet lidhur me alimentacionin.

⁴⁶ Analizë e RRGGK-së, 2008.

⁴⁷ Në këtë kuptim, fuqizimi i viktimateve dhe vënia në dispozicion e alternativave për ta është me rëndësi.

⁴⁸ Strehimorja Liria në Gjilan dhe SHPK-ja në Pejë, analizë e RRGGK-së, 2008. Një zyrtar i SHPK-së ka thënë se gjykatat duhet të jetë më e repte lidhur me posedimin e pronësise. Fëmijët kanë qenë të pashtëpi “shumë shpesh” ka thënë zyrtari, për arsy se shpërdoruesi nuk e ka paguar alimentacionin për fëmijët e tij dhe partnerin.

urdhrave të mbrojtjes.⁴⁹ Një numër i madh i të anketuarve të RRGGK-së kanë thënë se qiftet janë pajtuar dhe, së këndejmi, akuzat janë hedhur ose rasti është zgjedhur. Një burrë nga komuna e Skenderajt ka thënë: “Ka ardhur policia dhe rasti ka shkuar në gjykatë, por kryerësi i dhunës nuk është dënuar për arsy se ata [bashkëshortët] në fund, janë pajtuar.” Në një rast tjetër, fëmijët e kanë thirrur policinë dhe policia e ka arrestuar burrin. Ata, më vonë, e kanë liruar atë për arsy se ai i kishte premtuar gruas së tij se dhuna më kurrë nuk do të ndodh sërisht dhe ajo e kishte falur atë. Ombudspersoni ka sugjeruar që varësia e grave nga burrat e tyre ose nga familjet e burrave të tyre mund të ketë kuptimin se gratë nuk kërkojnë shkurorëzimin dhe mund të vazhdojnë të vuajnë dhunë nga dhuna në familje me kushtin “që të mos jenë të ndara nga fëmijët e tyre, që të mos bëhen barrë e familjeve të tyre ose, edhe më keq, që të mos ballafaqohen me rreziqet e panjohura të të qenit të detyruara të mbrojnë vetveten.”⁵⁰ Së këndejmi, madje edhe nëse ligji parashevë mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje, nëse ai nuk zbatohet, ai mbetet joefektiv në ofrimin e mbrojtjes.

Vonesat gjyqësore në përpunimin e rasteve, posaçërisht të lidhura me urdhrat e mbrojtjes, edhe më tej i kanë brejtur përpjekjet për të mbrojtur viktimën. Për shembull, Rregullorja mbi Dhunën në Familje iu lejon gjykatave për të ndaluar kontaktin ose për të saktësuar distancën midis viktimës dhe kryerësit të dhunës, por masat e tillë rrallë zbatohen për shkak të vonesave të lidhura me urdhrat e mbrojtjes dhe aktvendimeve alternative.⁵¹ Ngaqë rastet shpesh marrin dy ose tri vite për shqyrtim, sipas DAVA, aktet penale plotësuese ndodhin në ndërkokë. Së këndejmi, ekspeditiviteti, që bënë përpunimin e kërkësave për urdhrin e mbrojtjes nga gjykatat, është esencial me qëllim të mbrojtjes së viktimës nga dhuna në vazhdim.

Në raportin *Ex Officio* të ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit të Kosovës vihet në përfundim se gjykatësve përgjithësisht duket se iu mungon njohuria lidhur me përbajtjen e Rregullores mbi dhunën në familje, që i kontribuon vonesave.⁵² Gjykatësit janë vonuar në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, duke mos përbushur afatet e parapara me Rregulloren mbi dhunën në familje (15 ditë dhe 24 orë për të lëshuar urdhrat e mbrojtjes respektivisht urdhërin emergjent mbrojtës.) Në disa raste të lidhura me urdhrat e mbrojtjes, gjykatësve iu deshën deri në 11 muaj, derisa në rastet e urdhrit për mbrojtje emergjente gjykatave iu ka marrur ditë të tëra ose madje edhe disa muaj.⁵³ Mosrespektimi i afateve të parapara me ligjin në fuqi i vë viktimat para rrezikut të mëtejmë të përsëritjes ose të vazhdimit të dhunës, që potencialisht në mënyrë negative

“Policët bëjnë një punë shumë të mirë, por kur rastet shkojnë në gjykatë ato dështojnë. Përsë? Nuk e di... Para se gjykatat t'i fillojnë procedurat, rastet rrijnë një vit. Pasi të ketë kaluar një vit, ata na thërrasin, e thërrasin QPS-në. Gjatë asaj kohe, me gjasë, dhuna ka ndodhur sërisht.”

– Zyrtar i SHPK-së, Prizren

⁴⁹ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimorsi dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë*, Raport vlerësues mbi themelimin e Mekanizmave referues për viktimave e trafikimit të qenieve njerëzore, tetor 2007.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ DAVA, anketë e RRGGK-së, qershor, 2008.

⁵² Po aty.

⁵³ OSBE-ja ka vëzhguar në Raportin e saj mbi rastet e dunës në familje në Kosovë (korrik 2007) vonesa në lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. ZSHS-ët po ashtu kanë theksuar nevojën e sistemit të drejtësisë për të provuar rastet në kohën e duhur në mënyrë që mbrojtja e viktimave të jetë më efikase. (ZSHS në Ferizaj, analizë e RRGGK-së, 2008).

pastaj ndikon në shëndetin dhe mirëqenien e tyre, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren.⁵⁴

Të gjitha rastet, jo vetëm rastet e dhunës në familje, vuajnë nga vonesat. Departamenti statistikor i Sekretarisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka bërë një listë të faktorëve të ndryshëm që i kontribuojnë rasteve të pazgjidhura: legjislativi i paqartë; institucionet të cilat nuk i përbushin detyrat e tyre; mungesa e gjykatesve; distribuimi i dobët i gjykatesve nëpër gjykata; tepër pak prokuror; kushtet e dobëta të punës (pra, zyrat, teknologjia, transportimi, pagat e ulëta); paaftësia për të shpërndarë ftesat gjyqësore për shkak të adresave të paqarta; mungesa e dëshmitarëve; koha iracionalisht e humbur nga disa gjykates dhe zyrtarët gjyqësorë (pra, mungesa në gjykata për të përcjellur trajnime dhe seminare të ndryshme jo të domosdoshme); buxheti i kufizuar për plotësimin e personelit plotësues; dhe administrata e centralizuar.⁵⁵ Gjykatesit ia kanë atribuuar vonesat e tyre stërvngarkimit me rastet. Për shembull, në Prishtinë, edhe pse popullata është rritur substancialisht që nga përfundimi i luftës, qeveria nuk ka bërë ndarjet buxhetore (alokimet) për punësimin e gjykatesve plotësues.⁵⁶ Partners Kosova (OJQ lokale) ia kanë atribuuar zvarritjen e rasteve pagave të ulëta të gjykatesve, personelit tepër të pakët dhe joefikas, trajnimit joadekuat profesional dhe mosrespektimit të ligjit, i cili rregullon funksionimin e sistemit të drejtësisë.⁵⁷ Në kuadër të problemeve të tjera brenda sistemit të drejtësisë përfshihen shkathtësitë e dobëta të menaxhimit, administrata e dobët, mungesa e personelit të ri të arsimuar brenda dhe jashtë vendit dhe mungesa e njohurive lidhur me teknologjinë dhe shfrytëzimin e informacionit digital.⁵⁸

1.2 Përgjigja institucionale për mbrojtjen e viktimate

Ofrimi i rregullimit dhe i mbrojtjes ndaj viktimate të dhunës në familje mbetet një sfidë e vazhdueshme për qeveritë anë e kënd botës.⁵⁹ Këshilli i Evropës ka shprehur brengën lidhur me mungesën e njohurive në mesin e institucioneve në identifikimin adekuat të akteve të dhunës familjare dhe të formave të tjera të dhunës mbi baza gjinore.⁶⁰ Më tej, sigurimi i legjislativit të pashoqëruar me burimet adekuate (njerezore dhe financiare) ka shkaktuar mungesa në ndihmën dhe mbrojtjen. Siç e ka thënë Këshilli i Evropës:

Shtetet në përgjithësi kanë qenë të ngadalshme në njohjen apo në pranimin e shpenzimeve financiare dhe sociale pasojë e dhunës në baza gjinore (për shembull, në kuptimin e shpenzimeve të hetimit, shëndetit, strehimit shtëpiak dhe arsimimit), siç është parë, me varacionet në ligj dhe në sankzionet në dispozicion. Shpesh ka një

⁵⁴ Shih Propozimin e Planit të Veprimit të Këshillit të Evropës, 1998. Po ashtu, anketë e RRGGK-së, qershor 2008.

⁵⁵ Dokument i RRGGK-së 2008.

⁵⁶ Gjykates, koment i bërë për një përfaqësuesi të RRGGK-së.

⁵⁷ Një ZSHS ia ka atribuuar dështimin në zbatimin e ligjit mentalitetit dhe mungesës së profesionalitetit (po ashtu anketë e RRGGK-së, ZSHS në Mitrovicë, qershor, 2008).

⁵⁸ Gjykatat rrallë bashkëpunojnë me faktorët e tjerë të cilët mund të ndihmojnë dhe ta lehtësojnë punën e tyre, siç janë OJQ-të që merren me ligjin dhe zgjidhjen e konfliktit, sipas Partners Kosova. Ata kanë besuar se miratimi i Ligjit mbi ndërmjetësimin dhe involvimin e ndërmjetësuesve në gjykata për t'u marrë me disa raste mund të zgoglonë barrën e punës së gjykatesve. KMLDNJ dhe Departamenti statistikor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës po ashtu ka rekomanduar mekanizmin e ndërmjetësimit që duhet shfrytëzuar për zgjidhjen e disa rasteve (anketë e RRGGK-së 2008).

⁵⁹ Për shembull, Komisioni mbi eliminimin e diskriminimit kundër grave i KB-ve përshkruan dështimet e autoriteteve hungareze dhe uzbekistaneze për të ofruar rregullimin efikas dhe mekanizmat mbrojtës për viktimat e dhunës në familje (në <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/reports.htm>, e qasur në qershor 2008).

⁶⁰ Shih Propozimin e Planit të veprimit të Këshillit të Evropës, 1998.

pranim të vogël të nevojave dhe të drejtave të personave që e përjetojnë dhunën, pak mbështetje adekuate nga shumë organizata dhe mungesë mjetesh e pajimesh për ato grupe të specialistëve që përbëjnë kontributin kryesor për sigurimin e shërbimit relevant.⁶¹

Ligji në fuqi në Kosovë ofron mundësi për krijimin e një numri të madh të mekanizmave dhe kërkon nga një numër i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për t'u përgjigjur dhe për të ofruar mbrojtjen kundër dhunës në familje. Divizioni i Avokimit të Víktimës dhe i Asistencës (DAVA) i Ministrisë së Drejtësisë,⁶² Qendrat komunale për Punë Sociale (QPS) të Ministrisë së Punës dhe të Mirëgenies Sociale (MPMS),⁶³ dhe Njësitë kundër dhunës në familje të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) janë institucionet kryesore në Kosovë që i përgjigjen rasteve të dhunës në familje. Një numër i ligjeve qeverisin përgjegjësitë e punëtorëve socialë (ZSHS), të avokatëve të viktimate (AV) dhe të policisë në përgjigjen ndaj rasteve të dhunës në familje.⁶⁴ OJQ-të po ashtu janë të angazhuara në ofrimin e strehimit, këshillimit dhe formave të tjera të asistencës për viktimat e dhunës në familje. Rregullorja mbi Dhunën në Familje përfshin një përshkrim të hollësishëm të roleve dhe të përgjegjësive mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, duke përfshirë përgjegjësitë e organeve të zbatimit të ligjit (pra, policisë). Një pjesë specifike e përgjigjes në zbatimin e ligjit në mbrojtjen e rasteve të dhunës familjare është me vlerë. Më tej, Rregullorja mbi Dhunën në Familje nën vizon nevojën për bashkëpunim të ngushtë midis agjencive të ndryshme, siç janë QPS-të, AV-të dhe policia në ofrimin e mbrojtjes.

Edhe pse i vlerësuar si një legjislacion i komplikuar, megjithëkëtë, ligji në fuqi ka ndikuar praktikisht mbi rolet e agjencive të ndryshme dhe në profesionalitetin e tyre të përcaktuar me ligj.⁶⁵ Kërkimet kanë konstatuar një numër të dështimeve lidhur me përgjigjen institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, duke përfshirë: mungesën e kapaciteteve profesionale për të punuar me rastet sensitive të dhunës në familje dhe të dhunës mbi baza gjinore në përgjithësi; tepër pak policë të trajnuar mirë, profesional për përgjigjet ndaj dhunës në familje, posaçërisht në patrullimet e natës;⁶⁶ dështimi i shërbimeve sociale për të përfaqësuar interesat më të mira të fëmijëve në pajtim me ligjin me fuqi;⁶⁷ dështimi i gjyqësorit (pra, gjykatave) për të involvuar shërbimet sociale, madje

⁶¹ Këshilli i Evropës "Përbledhje e propozimit të Planit të veprimit mbi dhunën kundër grave," (1998).

62 Këshilli i Evropës i Drejtësisë së Procedurit të Punitive si Reparative mbi anëtarët kundrejt gruas, (1998).
62 Regullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e Përkoħsħem tē Procedurës Penale tē Kosovës nē nenen 81 dhe 82 përcakton avokatët e viktimate si institusjoni kyç përgjegjës pér ruajtjen e tē drejtave tē viktimate , posaċerisht tē viktimate tē akteve tē kryera nē kuadér tē marrédhénijs familjare.

⁶³ Një numër i ligjeve i udhëzojnë shërbimet sociale në ofrimin e mbrojtjes ndaj viktimate të dhunës në familje (pra, Ligji mbi shërbimet sociale dhe të familjes, Ligji mbi familjen, Rregullorja mbi dhunën në familje, etj.) Për shembull, Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare i Kuvendit të Kosovës nr. 2005/02-L17 parashtron bazat ligjore për rregullimin e shërbimeve për personat dhe familjet në nevojë përmes përkufizimit të personave në nevojë si viktima të dhunës në familje dhe të trafikimit njerëzor. Viktimat e dhunës në familje, së këndejmi, kanë të drejtë në mbrojtjen sociale duk përfshirë asistencën, këshillimin dhe asistencën materiale në rastet kur ekzistonjë burime të financimit për këtë (neni 1.4 dhe 2.10). Më tej, Ligji mbi familjen i Kosovës cek Qendrat për Punë Sociale si autoritetet të kujdestarisë për fëmijët në nevojë të mbrojtjes sociale (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/07 mbi nxjerrjen e ligjit mbi familjen i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/32, neni. 6, paragrafi 2).

⁶⁴ Për një përshkrim të holësishëm të ligjeve që rregullojnë përgjigjen në rastet e dhunës në familje si dhe rolet e përgjegjësítë e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, Shtoja 2 mbi Kornizën ligjore, 77-84.

⁶⁵ Raporti vjetor 2006-2007 i Ombudspersonit për Kuvendin e Kosovës, pjesa mbi "Barazinë gjinore" 62-72.

⁶⁶ Përfaqësuese e strehimores, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁶⁷ Për shembull, neni 6 i Ligjit mbi Familjen i Kuvendit të Kosovës parashtron bazat për organet administrative-komunale si kompetente për cështjet sociale. Më tej, neni 7 i Ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare nr. 02/L-17 i

edhe nëse kërkohen me ligj;⁶⁸ mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare për t'u përgjigjur në mënyrën e duhur ndaj rasteve që kanë nevojë për mbrojtjen; dështimi i avokatëve të viktimës për të ruajtur të drejtat e viktimës në pajtim me ligjin në fuqi;⁶⁹ dhe një mungesë e përgjigjes së bashkërenditur nga agjencionet kryesore përkatëse.⁷⁰

Përgjigja e parë e institucioneve kur ato thirren për të adresuar raportimet e dhunës familjare shpesh ka qenë të largohen gratë dhe, ndonjëherë, edhe fëmijët e tyre, nga shtëpitë dhe vendosja e tyre në strehimore derisa kryerësit e dhunës mbeteshin në shtëpi.⁷¹ Nga viti 2005 deri në vitin 2007, SHPK-ja ka arrestuar të dyshuarit në vetëm 30 për qind të rasteve dhe gjykatat kanë lëshuar urdhrat e mbrojtjes në vetëm 9.2 për qind të rasteve.⁷² Largimi i viktimateve nga shtëpitë e tyre dhe vendosja e tyre në strehimore i shfuqizon ato financiarisht dhe në aspektin shoqëror duke i vënë kështu në një disavantazh lidhur me të drejtat pronësore, potencialisht duke i ndarë ato nga fëmijët e tyre dhe duke i izoluar nga mekanizmat e mbështetjes natyrore, siç janë familja dhe miqtë.⁷³

Kur gratë largohen nga shtëpitë e tyre ose nxjerren me dhunë nga to, keqtrajtuesit shpesh marrin kujdestarinë e fëmijëve për arsy se gratë nuk mund të sigurojnë kujdesin financier për fëmijët.⁷⁴ Tradicionalisht, fëmijët shpesh mbeten me familjen e babait kur një çift ndahet.⁷⁵ Sipas dy ZSHS, kujdestaria mbi fëmijën ende nuk është adresuar në mënyrë adekuate brenda ligjit ekzistues. "Nëse një viktimë dëshiron të ketë fëmijët e saj me vete, ajo nuk ka mjaft shanse lidhur me atë se ku mund të shkojë ajo" kanë thënë ato.⁷⁶ Në rastet kur babai ka kryer dhunën, kjo mund t'i vë fëmijët në rrezik të dhunës së mëtejme.⁷⁷ Vendimi lidhur me atë se kujt duhet t'i jepet kujdestaria duhet të bazohet në të drejtat prindërore dhe vendimet duhet të kenë parasysh faktorë të ndryshëm, jo vetëm pasurinë

Kuvendit të Kosovës, i nxjerrur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/46 e caktioni organ administrativ komunal qendrën për punë sociale (cituar në Raportin mbi rastet e dhunës në familje të Misionit të OSBE-së, 2007, 11).

⁶⁸ Për shembull, "Një vështirim i sistemit penal të drejtësisë në Kosovë, 1 shtator 2000-28 shkurt 2001," Departamenti i të drejtave të njeriut dhe i sundimit të ligjit të misionit të OSBE-së në Kosovë , nen 6 dhe 7 mbi të Drejtat e viktimateve I dhe II, dhuna seksuale dhe dhuna brenda familjës.

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ Po aty. OJQ-të po ashtu shpesh janë ankuar se institucionet nuk i kanë respektuar saktësisht procedurat në pajtim me mandatet e tyre. Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

⁷¹ Liria, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁷² Derisa SHPK-ja nuk ka autorizime për të siguruar urdhrat emergjent të mbrojtjes (shih më poshtë) SHPK-ja, sidoqoftë, ka caktuar urdhra të tilla në 0.2 për qind të rasteve. Disa regjone i kanë arrestuar të dyshuarit më shpesh se sa të tjerat. Peja ka burgosur më shumë të dyshuar: 48 për qind rasteve të raportuara në atë rajon nga viti 2005 deri në vitin 2007. Prizreni ka burgosur 33 për qind, Mitrovica - 32 për qind, Prishtina - 26 për qind, Ferizaj - 26 për qind dhe Gjilani në vetëm 14 përqind të rasteve. Tetëdhjetë për qind e rasteve i janë referuar Avokatit të Viktimës, 64.9 - QPS-ve dhe 5.9 për qind tek ndonjë strehimore.

⁷³ Sipas "Liria", nuk ka mjaft masa për të mbrojtur gratë dhe për të siguruar se ato marrin pjesën e tyre të mjeteve apo pasurisë martesore.

⁷⁴ Shtëpi e sigurt Gjakova, anketë e RRGGK-së si dhe bisedë telefonike, 2008.

⁷⁵ Për shembull, një grua e re shqiptare nga komuna e Podujevës e ka përshkruar rastin e fqinjtit saj: "Burri e kishte zakon të rrihte gruan e tij, dhe madje edhe tash kur ata janë të shkurorëzuar ai nuk i lejon asaj t'i shoh fëmijët. Ajo nuk e ka këtë të drejtë. Gruaja i është ankuar institacioneve por ato nuk kanë bërë gjë. Tash, djali i saj është duke jetuar me ish-burrin e saj. Burri është rimartuar por po ashtu edhe kjo i shtrohet dhunës nga vjehrra dhe kunata e saj. Ata e rrabin shumë shpesh. Ne dëgjojmë zëra të këqij prej tyre." Jo vetëm që gruas që ka qenë viktimë nuk i është dhënë kujdestaria mbi fëmijën, por burri ka vazhduar të kryej dhunë për arsy se rasti nuk është ndjekur penalisht në mënyrën e duhur.

⁷⁶ ZSHS në, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁷⁷ Shtëpia e sigurt Gjakova, anketë e RRGGK-së dhe bisedë telefonike, 2008.

materiale.⁷⁸ Shkelja e të drejtës së vizitës së fëmijës po ashtu rrallë është dënuar dhe kërkon trajtim të mëtejshëm.⁷⁹

Një rast i përcjellur nga një polic i SHPK-së ka ilustruar shumë probleme të cilat i hasin institucionet në mbrojtjen e të drejtave të viktimës dhe në ofrimin e mbrojtjes:

Viktima ka pasur lëndime të rënda trupore, traumë, frikë. Ajo ka qenë shumë e frikuar për djalin e saj. Ajo ka qenë e frikuar se burri i saj do ta dëmtojë edhe ate. Meqë djali i saj ka qenë i vogël, ajo e kishte thirrur QPS-në. Ata kanë kërkuar që ne t'i marrim ata për arsy se nuk kanë pasur transport dhe, së këndejmi, ne kemi shkuar dhe e kemi marrë punëtorin social (por ju e dini se nuk është detyrë e SHPK-së dhe se ne nuk mund të shërbejmë si institucion transportues për institucionet e tjera. Ne kemi, po ashtu, mungesë makinash.). Pasi që QPS-ja ka marrë fëmijën, ata i kanë dhënë të drejtën prindërore keqtrajtuesit. Para këtij vendimi, ne i kemi dhënë QPS-së dhe gjykatës deklaratën e viktimës në të cilën viktima ka thënë “Unë dhe djali im kemi përjetuar dhunën fizike konstante nga burri im.” Avokati i viktimës është vonuar në dërgimin e dëshmisi së viktimës në gjykatë, po ashtu. Gjykata ka dënuar keqtrajtuesin me vetëm një muaj burgosje dhe ai është i lirë për të vendosur kur ai dëshiron të shkojë atje për ta vuajtur këtë muaj të dënimit. Viktima gjendet në strehimore ka tre vite dhe ajo nuk ka pasur asnjë mbështetje institucionale.

Polici ka thënë se viktimat nuk duhet të “mbyllen” në strehimore. Ligji duhet të funksionojë në mënyrën e duhur, duke iu dhënë viktimate pjesën e tyre të pasurisë dhe institucionet duhet të ofrojnë programe të reintegrimit.

Raportet e kohëve të fundit që rezultojnë nga monitorimi i rasteve të dhunës në familje në gjykata kanë treguar dështimin e shërbimeve sociale (QPS) për të mbrojtur të drejtat e viktimate kur kjo kërkohet me ligj.⁸⁰ QPS-të kanë dështuar për të dëshmuar në seanca kur është kërkuar nga gjykatat ose në disa raste kanë ofruar pikëpamje të kundërtat me shëndetin dhe sigurinë e viktimës.⁸¹ Për shembull, Sektori i monitorimit të sistemit ligjor i misionit të OSBE-së ka monitoruar një rast në gjykatën komunale të Gjilanit kur një nënë ka kërkuar mbrojtjen për vetveten dhe fëmijën e saj (të dytë viktima të dhunës familjare) dhe ka kërkuar kthimin e saj në shtëpinë e përbashkët me kryerësin e dhunës. QPS-të kanë dështuar për të qenë të pranishme në seanca gjyqësore, edhe pse gjykata në mënyrë të

⁷⁸ UNICEF ka rekomanduar që gjykatat të interpretojnë “interesin më të mirë të fëmijës” në mënyrë më të gjerë (Paraqitje e UNICEF-it para Komisionit për të Drejtat të Fëmijës në “Të flasësh, marrësh pjesë dhe të vendosësh – E drejt e fëmijës për të qenë i dëgjuar” Gjenevë, 15 shtator 2006, Pjesa e 8).

⁷⁹ Liria, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁸⁰ Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit i Misionit të OSBE-së në Kosovë, “Një vështrim i sistemit të drejtësisë penale në Kosovë, 1 shtator 2000-28 shkurt 2001,” Neni 6 dhe 7 mbi të Drejtat e Viktimës I dhe II, Dhuna seksuale dhe dhuna brenda familjare. Po ashtu shih Departamentin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, raporte mujore publike të Sektorit të monitorimit të sistemit ligjor (mars dhe gusht 2005).

⁸¹ Po aty.

rregullt i ka dërguar ftesat gjyqësore në QPS-të dhe gjykatësi ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes, madje edhe nëse kjo mund të rrezikojë shëndetin dhe mirëqenien e nënës pa e marrë parasysh QPS-të se çfarë do të ishte interes i më i mirë i fëmijës.⁸² Në rastet e tjera, ZSHS-të kanë thënë se gjykatat shpesh kanë dështuar për t'u dërguar ftesat gjyqësore ose se i kanë lënë ato jashtë procedurave gjyqësore.⁸³

OJQ-të gjithashtu janë ankuar lidhur me profesionalitetin e punës së personelit të QPS-ve që kanë qenë të prirura për t'i zgjidhur rastet përmes pajtimit dhe dërgimit të fëmijëve në shtëpitë e tyre keqtrajtuese.⁸⁴ Ombudspersoni ka raportuar se punëtorët socialë nuk i kanë marrë parasysh gjithmonë nevojat e viktimës për përfaqësim ligjor, asistencë mjekësore dhe asistencë psikologjike, por theksojnë pajtimin e çiftit bashkëshortor.⁸⁵ Për shembull, ZSHS i ka thënë RRGGK-së se "Ne nuk i mbështesim strehimoret dhe përpinqemi të mos përmendim ato si mundësi të parë për viktimin, për arsy se ne nuk përpinqemi t'i bëjmë gratë t'i braktisin shtëpitë e tyre."⁸⁶ Derisa në disa raste këshillimi familial është i mundur, në raste të tjera niveli i dhunës dhe gjasa e përsëritjes së dhunës mund të ketë kuptimin se "pajtimi familial" nuk është i mundur ose i parapëlqyer kur kihet parasysh siguria e viktimës. Inkurajimi i grave që të mbesin në situata të ambienteve të dhunshme mund t'i vë ato në rrezik të dhunës së vazhdueshme, lëndimit potencial si dhe t'i dekurajojë ato nga mbledhja e guximit për të raportuar dhunën sërisht.

Sipas strehimores Liria, edhe pse klientët shpesh kanë kërkuar urdhurat e mbrojtjes, institucionet rrallë e kanë ofruar ndihmën lidhur me sigurimin e urdhrit të mbrojtjes. Ndihma e tashme ligjore dhe legislative në Kosovë nuk i parasheh në mënyrë të saktësuar viktimat e dhunës në familja si kategori me të drejtë të këshillimit dhe të përfaqësimit ligjor pa pagesë. Ndihma ligjore tash nuk është në dispozicion për viktimat, por vetëm për personat me kushte të veçanta sociale.⁸⁷ Zyra e qarkut për ndihmë juridike, e themeluar në janar të vitit 2008, si një njësi e pavarur brenda qeverisë,⁸⁸ është përgjegjëse për kontraktimin e avokatëve, posaçërisht nga Oda e Avokatëve e Kosovës për të siguruar ndihmën ligjore falas në rastet kur klientët janë në asistencë sociale, janë të papunësuar ose nuk janë në gjendje për të paguar.⁸⁹ Zyra duhet ta përpunojë secilin rast, i cili kërkon shërbimet e saj, si dhe të shqyrtojë të gjitha ankesat lidhur me rastet penale, civile dhe administrative. Disa avokatë janë të specializuar dhe merren vetëm me dhunën në familje dhe Zyra përpinqet për të përzgjedhur avokatët e së njëjtës gjini si edhe klienti ose i lejon klientit për të zgjedhur avokatin vet sipas parapëlqimit të tij ose të saj.⁹⁰ Që nga qershori i vitit 2008, Zyra ka ndihmuar 122 raste, 25 prej të cilave kanë qenë të ndërlidhura me dhunën në familje. Nëpunësit e Zyrës po ashtu kanë siguruar informacion lidhur me

⁸² Po aty.

⁸³ ZSHS, anketë e RRGGK-së, 2008.

⁸⁴ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Divizioni i avokimit të viktimate dhe i asistencës "Raport i qendrave për punë sociale: Shërbimet sociale," Shkurt 2003.

⁸⁵ Raport vjetor 2006/2007 i zëvendësít të Ombudspersonit të Kosovës para Kuvendit të Kosovës, 16.

⁸⁶ Anketë e RRGGK-së, qershori 2008.

⁸⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 mbi Ndihmën Ligjore në Kosovë, nen 10.

⁸⁸ Sipas Rregullores mbi Ndihmën Juridike (2006/36), Njësia i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Kosovës. Ky është i gjithë informacioni i paraqitur këtu lidhur me njësinë nga një intervistë me zyrtarin ligjor, Zyra e Qarkut për Ndihmë Juridike, qershori 2008, Prishtinë.

⁸⁹ Për këto raste, avokatët janë të paguar nga Komisioni për Ndihmë Ligjore.

⁹⁰ Tash, Zyra ka 50 avokatë në Prishtinë, për mbulimin e rasteve anë e kënd Kosovës. Megjithëkëtë, ajo i ka vërejtur mungesat e prokurorëve, ngaqë vetëm një prokuror merret me të gjitha rastet e shkurorëzimeve në Prishtinë.

procedurat juridike dhe kanë këshilluar klientët lidhur me të drejtat e tyre ligjore.⁹¹ Përfaqësuesit kanë thënë se Zyra ka “bashkëpunim të mirë” me gjykatat dhe rastet me logon e Zyrës kanë prioritetin e vëmendjes. Ngaqë Zyra është e re, qytetarët dhe, madje, edhe institucionet mund të mos jenë të njoftuar me punën e saj.

Ligji në fuqi i Kosovës gjithashtu parasuhet që Divizioni për Avokim të Viktimate dhe Asistencë (DAVA) të mbron të drejtat e viktimit, posaçërisht të viktimit së dhunës në familje dhe dhunës mbi baza gjinore.⁹² Avokatët e Viktimate (AV-të) pritet të luajnë një rol aktiv në përfaqësimin e interesave të viktimit, dhe në këshillimin e viktimate për të drejtat e tyre. AV-të janë përgjegjës për mbledhjen e qëndrueshme të informacioneve dhe për përgatitjen e dokumentacionit lidhur me rastet. Megjithëkëtë, në ofrimin e mbështetjes gjatë rasteve të trafikimit dhe të dhunës seksuale, duke përfshirë edhe dhunën familjare, AV-të janë rrallë të pranishëm për rastet e të miturve ose kur janë prezent kanë luajtur një rol tejet pasiv.⁹³ Një AV ka thënë se “pengesa kryesore” kanë qenë burimet e pamjaftueshme të transportit, ushqimi dhe veshmbathja për rastet.⁹⁴ AV-të kanë raportuar se është dashur të përdorin para nga “xhepi i tyre” për të mbuluar nevojat bazike të viktimate.⁹⁵ Disa AV-të nuk kanë pasur njohuri të nevojshme në identifikimin e shenjave të dhunës familjare. Një AV i ka thënë intervistuesve të RRGGK-së se “Ne kemi një rast të një vajze 13 vjeçare, e cila ankohet se një njeri rreth të 60-tave e ka keqtrajtuar atë seksualisht, por ne ende nuk e dimë saktësish rrëfimin vërtetë për arsyen se mund të ketë ndodhur që vajza e ka bërë atë (ka pasur marrëdhënie seksuale) sipas vullnetit të saj.”⁹⁶ Këtu shihet qartë se avokati i viktimit nuk ka pasur njohuri për paligjshmérinë e keqtrajtimit seksual të të miturve. Kjo ndikon mbi nevojën për trajnimin e mëtejmë dhe rishikimin e vazhdueshëm të nivelit profesional të kryerjes së punëve të tyre nga Ministria e Drejtësisë.⁹⁷

Një komponentë tjetër e rëndësishme në ofrimin e mbrojtjes institucionale ndaj viktimit eshtë qasja ndaj kujdesit shëndetësor dhe informacionit pa pagesë. Me qëllim që të përgjigjen në mënyrë sensitive në rastet e dhunës familjare, Ministria e Shëndetësisë dhe Shkolla e Mjekësisë e Prishtinës kanë futur komponentën mbi “Dhunën kundër grave: dhuna seksuale dhe ajo mbi baza gjinore” në Modulin e tyre të shëndetit riprodhues të programit vendor për mjekët familjarë dhe motrat mjekësore.⁹⁸ Studimet kanë treguar se ekspertët për shëndetin e femrave mund të përdorin shkathtësitë dhe përvojat e tyre në mënyrë efikase në përmirësimin e statusit të shëndetit të komunitetit.⁹⁹ Në Kosovë më shumë ka gra se sa meshkuj që ofrojnë shërbimet shëndetësore.¹⁰⁰ Megjithëkëtë, personat që ofrojnë kujdesin shëndetësor mund të janë stigmatizues ose kanë të njëjtat paragjykime si edhe popullata në shkallë të gjerë. Kërkimet kanë treguar se personeli mjekësor shpesh takojnë

⁹¹ Derisa Zyra është e obliguar të bashkëpunojë me të gjitha organet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare sipas Rregullores mbi Ndihmën Juridike, një përfaqësues ka thënë se tejngarkesa me rastet i parandalon ata nga konsultimi i rregullt me Avokatët e Viktimate në masën sa do të donin ata.

⁹² Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Procedurën e Kodit të Përkohshëm Penal, nenet 81 dhe 82.

⁹³ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, dhe Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe sundim të ligjit i Misionit të OSBE-së në Kosovë, “Një vështrim i sistemit të drejtësisë penale në Kosovë, 1 shtator, 2000-28 shkurt 2001,” Neni 6 dhe 7 mbi të Drejtat e Viktimit I dhe II, Dhuna seksuale dhe dhuna brenda familjare.

⁹⁴ AV në Mitrovicë, analizë e RRGGK-së, 2008.

⁹⁵ AV në Ferizaj, analizë e RRGGK-së, 2008.

⁹⁶ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

⁹⁷ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raport i vlerësimit mbi mekanizmat e referimit për identifikim dhe ndihmë viktimate të trafikimit,” Pjesa mbi avokatët e viktimate.

⁹⁸ UNFPA, “Një rast studimor i dhunës mbi baza gjinoren Kosovë,” (2004), 13.

⁹⁹ Shih programin e qeverisë Portugeze.

¹⁰⁰ UNFPA, “Një rast studimor i dhunës mbi baza gjinore në Kosovë,” 19. Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

raste të keqtrajtimit në familje me lëndime të dukshme.¹⁰¹ Është për t'u brengosur, se më shumë se 50 për qind e mjekëve, të cilët kanë hasur raste të tilla, nuk kanë referuar dhe as nuk i kanë raportuar ato, përkundër obligimit të tyre ligjor për të vepruar në atë mënyrë.¹⁰²

Asnjë prej qendrave shëndetësore (private ose publike) nuk ka dokumentuar asnjë prej rasteve të dhunës në familje, në të cilat kanë hasur. Shkalla në të cilën këto qendra i referojnë rastet tek mekanizmat e duhur mbetet e pahulumtuar plotësisht. Edhe pse duket se ekziston vullneti i përgjithshëm nga personeli mjekësor për të ndihmuar viktimat në baza individuale,¹⁰³ është e nevojshme një përgjigje institucionale në identifikimin dhe referimin e duhur të keqtrajtimit në familje. Kujdesi i veçantë dhe protokollet specifike janë veçanërisht të nevojshme për trajtimin e viktimate të dhunës seksuale.¹⁰⁴

Një nga pengesat më serioze në mbrojtjen e viktimate të dhunës ose të personave që raportojnë rastet e dhunës në familje është mungesa e mbështetjes financiare nga qeveria. Nuk ekziston asfarë sistemi zyrtar i mbrojtjes së dëshmitarit ose viktimate të krimeve të dhunshme, të kryera në kuadër të marrëdhënieς familjare. E vetmja strehimore e udhëhequr nga qeveria Qendra e Përkohshme e Sigurisë merret vetëm me rastet “në rrezik të lartë” zakonisht të lidhura me trafikimin ose rastet politikisht të rëndësishme (pra, dhunën ndëretnike). Niveli i rrezikut përcaktohet nga SHPK-ja para sjelljes së viktimës në strehimore. Tash, viktimat e rritura dhe fëmijët e tyre që konsiderohen me rrezikshmëri të ulët ose të mesme merren e dërgohen në një nga gjashtë strehimoret joqeveritare të vendosura në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë ose Prizren. Fëmijët dërgohen në Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët, një strehimore që kohët e fundit është lokalizuar në

Mbyllja e strehimoreve, për shkak të mungesës së financimit, i ka vënë viktimat fëmijë dhe gra para rezikut të mëtejmë të dhunës, siç e ilustron ky rast i përshkruar nga një AV:

“Para një viti, unë duhet të mirresha me një rast, që kishte të bënte me pesë fëmijë që ishin braktisur nga prindërit e tyre. Nëna e tyre i kishte lënë ata që t’ia fillojë punës si këngëtarë në një bar. Babai i tyre kishte shkuar në Ulqin për të gjetur punë. Ngaqë ai nuk kishte mundur të gjejë punë, ai ishte kthyer dhe gjithë zemërimin e tij e kishte përdorur kundër fëmijëve të vet. Ai e rrihte vajzën e tij të më të madhe e cila ishte 12 vjeçare dhe më të renë, e cila i kishte vetëm 2 vjet. Fqinjët e kishin ftuar policinë dhe na kanë treguar neve për rastin. Ne e kemi thirrur QPS dhe pastaj i kemi strehuar në “Shpresa dhe Shtëpi” në Prizren, por tash është mbyllur ajo strehimore dhe ne nuk kemi një vend ku t’i dërgojmë fëmijët.”

¹⁰¹ RRGGK ka treguar se nga 37 gjinekologë të intervistuar, 13 kanë pohuar të kenë kaluar nga 819 deri në 1.372 raste të dhunës në familje gjatë praktikës së tyre. Nga 37 gjinekologë të intervistuar, vetëm pesë prej tyre nuk kanë parë asnijëherë grua e cila ka përfjetuar dhunën në familje (*Hulumtim kërkimor*).

¹⁰² Kodi i Përkohshëm Penal e konsideron vepër penale nëse një zyrtar ose një person përgjegjës nuk e raporton veprën penale të zbuluar gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, nëse një vepër e tillë është e dënueshme me burgim prej së paku tri vitesh dhe duhet të ndiqet penalisht *ex officio*, shih nenin 304 (2). Kodi Penal i Kosovës e konsideron lëndimin e lehtë dhe të rëndë trupor në kuadër të marrëdhënieς familjare krim të dënueshëm, i cili ka nevojë të ndiqet penalisht *ex officio*. Kodi Penal parashev që kryerësi i lëndimit të lehtë trupor mund të marrë minimum gjashtë muaj dhe maksimum tri vite burgim, derisa për dëmtimin e rëndë trupor dënimet lëvizin nga një deri në pesë vite të burgimit.

¹⁰³ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

¹⁰⁴ Medica Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

Prishtinë; lokacioni i saj tjetër ka qenë në Prizren dhe është detyruar të mbylljet në dhjetor të vitit 2007 për shkak të mungesës së fondeve.¹⁰⁵ Ligji në fuqi në Kosovë lejon sigurimin e shërbimeve sociale për t'u ofruar nga organizatat joqeveritare (OJQ-të), nëse ato janë të licencuara nga MPMS.¹⁰⁶ Të gjitha strehimoret sigurojnë banimin, ushqimin, rrobat, tualetin, kujdesin shëndetësor themelor, këshillimin, këshillimin ligjor, trajnimin e shkathtësive, ndërgjegjësimin për çështjet e ndryshme dhe shanset për edukim.¹⁰⁷ Disa iu ndihmojnë klientëve në sigurimin e punësimit pas lëshimit të strehimores. Strehimoret e OJQ-ve po ashtu kanë ngritur vetëdijen për dhunën familjare në komunitetet e tyre si dhe kanë mbushur zbrazëtitë e papërbushura nga institucionet.¹⁰⁸ Në vitin 2007, strehimoret që kanë ndihmuar viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës në baza gjinore kanë strehuar më shumë se 2.491 klientë në nevojë për mbrojtjen sociale.¹⁰⁹

Ngaqë shumica e strehimoreve janë themeluar menjëherë pas luftës dhe si përgjigje ndaj një nevoje urgjente për të mbrojtur viktimat nga dhuna e mëtejme,¹¹⁰ në dispozicion ka qenë një kohë minimale për shpënien më tej të kapacitetit të tyre institucional. Anëtarët e personelit të strehimit kanë përcjellur një numër të madh seminaresh të trajnimit një deri pesë ditore të siguruara nga organizatat ndërkombëtare mbi çështje të ndryshme siç është identifikimi i dhunës familjare, ndihma dhënë viktimate, avokimi, menaxhimi i rastit, dhe trafikimi, në mesin e çështjeve të tjera. Megjithëkëtë, pak anëtarë të personelit të strehimoreve kanë diplomuar në psikologji ose këshillim dhe, së këndejmi, iu mungon njojuria adekuate lidhur me rastet e duhura, sensitive të qasjes dhe të ndihmës që duhet dhënë viktimës së dhunës ose të traumës.¹¹¹

Një numër i vogël i këshilluesve, siç janë disa përfaqësues të institacioneve, janë të prirur ‘për të fajësuar viktimën’.¹¹² Për shembull, një këshillues ka thënë se “Gratë flasin shumë, i kontrollojnë burrat e tyre dhe, në këtë mënyrë, ato ndikojnë mbi burrat e tyre që ata të janë të dhunshëm kundrejt tyre.” Këshilluesit e strehimoreve, siç janë shërbyesit civilë që merren me dhunën në familje, fare qartë kanë pasur nevojë për kualifikime të mëtejme profesionale në këshillimin dhe mbikëqyrjen permanente nga psikologët e trajnuar, me përvojë, ose psikiatrit me qëllim që të shmanget retraumatizimi i viktimës.¹¹³

Edhe pse qeveria, duke përfshirë SHPK-në, AV-të dhe QPS-të, mbështetet në masë të madhe në shërbimet e strehimit për të siguruar viktimat dhe fëmijët e tyre, të gjitha

¹⁰⁵ Nuk ekzistojnë strehimore të veçanta për meshkuj ose për persona me aftësi të kufizuara, edhe pse ata mund të vendosen në strehimoret ekzistuese. Pak të anketuar kanë rekomanduar se duhet të themelohen strehimore të tilla. (Anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁰⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/46 mbi nxjerrjen e ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare e Kuvendit të Kosovës nr. 02/I-17, neni. 8 mbi rolin e sektorit joqeveritar thotë se OJQ-të mund të kontraktohen nga Departamenti i Shërbimeve Sociale (DSHS) për të ofruar shërbime sociale dhe familjare për personat në nevojë (pra, viktimat e dhunës në familje). Neni 2.2 thotë se DSHS duhet të orientojë dhe të këshillojë sektorin joqeveritar.

¹⁰⁷ Për më shumë informacion lidhur me strehimoret, përfunksionimin e tyre dhe bashkëpunimin me institucionet, shih RRKG, *Hulumtim kërkimor*, 60-64.

¹⁰⁸ UNFPA, “Një rast studimor i dhunës mbi baza gjinore në Kosovë,” (2005), 19.

¹⁰⁹ Shih Raportin e Vlerësimit mbi themelimin e Mekanizmave referues në Kosovë për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, të Misionit të OSBE-së në Kosovë, tetor 2007, pjesën mbi Mbrojtjen e viktimate të trafikimit.

¹¹⁰ Vetëm Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve (QMGF) ka strehuar gra dhe fëmijë para luftës.

¹¹¹ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 61.

¹¹² Po aty. William Ryan ka krijuar termin “fajësim i viktimës” në përshkrimin e tij në kuadër të teorive edukative që fajësojnë familjet minoritare me të hyra të ulëta në SHBA për mungesë të “kapitalit kulturor” lidhur me të qenët të suksesshëm në shkollë (*Fajësimi i viktimës*, Vintage Books, 1976).

¹¹³ RRGGK-ja ka siguruar rekomandime të qarta, të hollësishme për strehimoret në reportin saj paraprak (*Hulumtim kërkimor*, 61 dhe 69). Vlerësimi i nevojave të strehimoreve sipas RRGGK-përmban rekomandimet e mëtejme (dokument i brendshëm, 2007).

strehimoret kanë pasur vështirësi financiare. Për shkak të mungesës së financimit të shpenzimeve themelore operacionale, disa strehimore janë mbyllur periodikisht. Kjo ka ndikuar ndonjëherë për të i lënë viktimat, duke përfshirë edhe fëmijët, të pambrojtur dhe në një rast për të fjetur në stacion të policisë.¹¹⁴ Në vitin 2005, MPMS ka filluar të mbulojë 50 për qind të shpenzimeve të strehimoreve. Sidoqoftë, MPMS nuk do të mbështeste shpenzimet përkatëse, siç janë personeli dhe veprimet e caktuara (pra, qiraja, rryma, uji dhe telefoni). Më tej, marrëveshjet joafatgjata nuk e bëjnë të qartë se MPMS do të mbulojë shpenzimet e strehimoreve përtëj vitit 2008.¹¹⁵ Përfaqësuesit e qeverisë kanë argumentuar se mbulimi i plotë i shpenzimeve të OJQ-ve do të thoshte praktikisht se ato do të bëhen institucion qeveritare.¹¹⁶ Njëri duhet të vërejë se Ligji mbi shërbimet sociale dhe të familjes parashev procesin e licencimit të OJQ-ve si ofrues të shërbimeve dhe nuk e thotë se financimi i shërbimeve të strehimit i ofruar nga OJQ-të duhet të jetë i pjesërisht. OJQ-të duhet të kontraktohen për shërbimet të cilat i ofrojnë dhe të monitorohen nga MPMS si donator në zbatim. Mungesa e një sistemi qeveritar të mbrojtjes së dëshmitarit dhe numri i viktimateve i ndihmuar nga strehimoret deri sot ilustron nevojën për mbështetje financiare qeveritare të vazhdueshme për strehimoret e OJQ-ve.

Policët, AV-ët dhe QPS-të po ashtu kanë raportuar se mungesat në financim kanë ndikuar në kualitetin e asistencës të ofruar viktimateve. QPS-ve posaçërisht në mënyrë konsistente iu mungon buxheti adekuat për kryerjen e përgjegjësive të tyre.¹¹⁷ Një ZSHS ka komentuar:

QPS-ja tash është në një pozitë shumë të rëndë. Për shembull, ne nuk kemi para për kartela të telefonit. Kur vjen çështja te udhëtimi, ne nuk kemi automjete për të shkuar në një vend të caktuar dhe, së këndejmi, jemi të detyruar për të pritur derisa SHPK-ja të ketë kohë për të ardhur e për të na marrur. Neve na mungojnë gjërat themelore, gjë që na frenon që punën tonë të mos e bëjmë ashtu siç duhet. Këto gjëra duhet të ndryshojnë.¹¹⁸

QPS-të duhet të zbatojë përgjegjësitë e monitorimit, posaçërisht vizitat e rregullta të familjeve ku ka ndodhur dhuna në familje. Megjithëkëtë, pjesërisht për shkak të mungesës së mjeteve financiare, QPS-të gjithashtu kanë bërë përpjekje për të monitoruar familjet në të cilat dhuna është raportuar më herët ose në të cilat viktimat janë kthyer pas qëndrimit në strehimore. Punëtorët socialë po ashtu kanë thënë se ata nuk kanë pasur mbrojtjen adekuate për vizita në shtëpi dhe se, në përgjithësi, ka pasur një mungesë të mbrojtjes sociale për viktimat gjatë fazës së rehabilitimit dhe integrimit familjar.¹¹⁹ ZSHS-të kanë bërë kërkesë për kushte më të mira të punës, mbrojtje më të mirë gjatë vizitave në familje, paga më të mira dhe transport me qëllim që të kryhen detyrat e tyre të punës.¹²⁰

Koordinimi i gjithëmbashëm në mesin e organeve përgjegjëse për trajtimin e viktimës dhe për përcjelljen e rasteve, derisa ata nuk kërkojnë trajtim të mëtejmë, po ashtu

¹¹⁴ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 63.

¹¹⁵ RRGGK, Vlerësimi i nevojave të strehimoreve, 2007.

¹¹⁶ RRGGK, intervistë me përfaqësues të DMKS, 2008.

¹¹⁷ Po ashtu RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 2008.

¹¹⁸ Anketë e RRGGK-së, 2008.

¹¹⁹ Anketë e RRGGK-së, 2008.

¹²⁰ Anketë e RRGGK-së, 2008.

është ballafaquar me sfida.¹²¹ Për shembull, një zyrtar i SHPK-së ka thënë se gjykatat, pas sigurimit të urdhrit të mbrojtjes për viktimin, shpesh dështojnë në informimin e policisë.¹²² Një ndarje e paqartë e roleve për secilin institucion ndonjëherë ka pasur kuptimin e bllokimit, për shembull, në intervistimin e klientëve, dokumentimin e rasteve dhe mbajtjen e shënimeve. Mungesa e qartësisë po ashtu ka rezultuar në zbrazëti lidhur me faktin se cili institucion duhet të udhëheq në ofrimin e ndihmës ligjore, mbrojtjes ligjore dhe mbrojtjes.¹²³ Në qartësimin e roleve dhe të përgjegjësive të institacioneve të ndryshme për të mbrojtur viktimat nga dhuna në familje, Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës dhe UNDP kanë organizuar një Tryezë të Rrumbullakët mbi Dhunën në Familje në nëntor të vitit 2006. Gjatë diskutimit, ofruesit e shërbimeve kanë konstatuar një mungesë të një strukture të koordinimit qendror dhe komunal për të adresuar dhunën në familje. Në mesin e çështjeve të tjera, tryeza e rrumbullakët ka rezultuar në rekomandimin për të përpiluar Udhëzimin administrativ me qëllim të qartësimit të roleve dhe të përgjegjësive të agjencioneve të ndryshme.¹²⁴ Ofruesit e shërbimeve dhe institucionet e tjera të pranishme në tryezën e rrumbullakët, siç janë AV-ët, ZSHS-të dhe policia janë pajtuar të themelohet një grup punues për asistencë dhe mbrojtje për një forum të tipit të multiagjencionit në nivel qendror.¹²⁵ Deri tash, rekomandimet nuk janë iniciuar nga asnjeri prej institacioneve prezente në atë tryezë të rrumbullakët.

Përkundër mungesës së gjithëmbarshme të reagimit institucional, institucionet dhe organizatat që merren me dhunën në familje kanë ndërmarrë disa iniciativa për të qartësuar rolet dhe përgjegjësitë në nivel komunal. SHPK-ja, QPS-të, DAVA dhe strehimoret kanë formuar rrjete informative, të cilat takohen prej tri deri në dyndëdhjetë herë në vit, pavarësisht nga grupei.¹²⁶ Në Gjilan, Pejë dhe Prizren, takimet janë organizuar nga strehimoret, derisa në Prishtinë dhe Mitrovicë, takimet i ka organizuar Njësia për dhunën në familje e SHPK-së. Gjatë takimeve pjesëmarrësit koordinojnë përpjekjet e tyre, qartësojnë më tej rolet dhe përgjegjësitë, i diskutojnë mënyrat për të përmirësuar koordinimin, si dhe zgjidhjen e problemeve. Grupet kanë qenë një hap përpara drejt përmirësimit të koordinimit institucional.

Më tej, strehimoret kanë filluar përpjekjet për të themeluar një Koalicion kundër dhunës seksuale dhe asaj në familje në vitin 2007, një rrjet informal për koordinimin e aktivitetave parandaluese dhe i cili punon për të mbrojtur viktimat përmes një qasjeje të koordinuar. Iniciativa e këtillë ka përfshirë strehimoret, të cilat krijojnë standarde të tyre vetanake të punës, krahas standardeve të cilat duhet t'i respektojnë me qëllim që të mirëmbajnë licencën si ofrues të shërbimeve nga MPMS. Strehimoret po ashtu kanë krijuar një bazë të përbashkët të të dhënave për menaxhimin e rasteve, gjurmimin e të dhënave demografike të rasteve të ndihmuara dhe monitorimin e ndikimit të dhunës në shëndetin e klientëve.

¹²¹ One to One, Anketë e RRGGK-së, 2008. Një zyrtar i SHPK-së dhe ZSHS po ashtu kanë komentuar se ka ekzistuar nevoja për një bashkëpunim më të mirë midis institacioneve (anketë e RRGGK-së).

¹²² Anketë e RRGGK-së, 2008.

¹²³ Anketë e RRGGK-së, 2008.

¹²⁴ Raport i Ombudspersonit të Kosovës, Raport vjetor 2006/2007 për Kuvendin e Kosovës, 16.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Në Gjilan dhe Gjakovë, grupei quhet Rrjeti kundër Dhunës në familje derisa në Pejë quhet Takimi Multiagjencior për mbështetje të viktimate të dhunës në familje dhe në Prizren Takimi me Bashkëpunëtorët (RRGGK bisedë telefonike me strehimore, 2008). Disa grupe kanë qenë më aktive se sa të tjerat, me grupei e Prizrenit që takohen në baza mujore, me Pejën me takim tremujore dhe Gjilanin me takime dy deri ne katërmujore. Takimet në Prishtinë, dhe Mitrovicë kanë ndodhur më rrallë dhe fare që nga viti 2007. Në Pejë, përfaqësuesit e gjykatës, prokurorët, gjinekologët dhe mjekët po ashtu kanë vijuar takimet.

1.3 Rekomandimet për përmirësimin e përgjigjes institucionale për mbrojtjen e viktimës

Si përfundim, monitorimi nga Institucioni i Ombudspersonit ka treguar se gjykatat nuk i kushtojnë prioritetin e duhur rasteve të dhunës në familje.¹²⁷ Një faktor i rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes institucionale për viktimat e dhunës në familje është qasja ndaj drejtësisë dhe trajtimi i drejtë, duke përfshirë bashkëndjesinë dhe respektin për dinjitetin.¹²⁸ Viktimate duhet t'i u ofrohet qasja ndaj mekanizmave të drejtësisë dhe rregullimi i menjëherëshëm përmes procedurave formale dhe joformale, të cilat duhet të jenë ekspeditive, të ndershme, jo të shtrenjta dhe të arritshme.¹²⁹ Viktimat po ashtu duhet të informohen për të drejtat e tyre lidhur me kërkimin e rirregullimit përmes këtyre mekanizmave. Rastet e dhunës në familje, posaçërisht ato të lidhura me urdhurat e mbrojtjes, kujdestarinë mbi fëmijën, ndarjen e pasurive, dhe posedimit të pronës duhet ta kenë si prioritet vëmendjen e gjykatave. Shanset duhet të vihen në dispozicion për rishikim emergjent të rasteve me rrezik të lartë.¹³⁰

Më tej, Ombudspersoni ka rekomanduar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve për të trajtuar rastet e dhunës në familje.¹³¹ Përfaqësuesit e institacioneve po ashtu kanë rekomanduar gjatë intervistave që ministria e Drejtësisë të emërojë një prokuror të trajnuar, special, për të trajtuar vetëm rastet e dhunës në familje në secilën gjykatë, të rris pagat e prokurorëve me qëllim të parandalimit të korruptionit; të monitorojë funksionimin e gjykatave, të sigurojë pranimin më të shpejtë të shqyrimit të rasteve dhe të krijojë një departament për mbrojtjen e familjes brenda sistemit gjyqësor. Me qëllim që të shpejtojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve familjare dhe të tjerave, duhet të zhvillohen standarde për numrin e rasteve të cilat një gjykatës duhet t'i zgjidh brenda një muaji duke kalkular kohën e nevojshme për të zgjidhur një rast; ndërmjetësuesit duhet të përfshihen kurdo është e mundshme; duhet të punësohen më shumë gjykatës dhe personel tjeter; puna jashtë orarit të kompensohet; të rriten pagat e gjykatësve dhe të vihen në përdorim teknologji të reja.¹³² Pos kësaj, Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të ofrojë trajnime të rregullta për gjykatës lidhur me legjislacionin e dhunës, duke përfshirë burime penale dhe civile me qasje multidisciplinare.¹³³

Trajnimi i vazhdueshëm i AV-ve lidhur me ligjin në fuqi, dhunën mbi baza gjinore dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duhet të adresojnë kapacitetet e tyre të tashme profesionale. Është e rekomandueshme që, megjithëse AV-të janë të paraparë si një institucion në kuadër të Kodit Penal të tashëm për t'u kujdesur për të drejtat e viktimës, legjislacioni i ndihmës ligjore të ndryshohet me qëllim që të parashev përfaqësimin profesional ligjor të viktimës në gjykata. Këshilluesit sipas projektit të ndihmës ligjore në Kosovë duhet të punojnë në lidhje të ngushtë me AV-të në mandatin e tyre të mbrojtjes së të drejtave të viktimate. Kjo duhet të mbështesë qasjen e gjithëmbarshme ndaj drejtësisë

¹²⁷ Përfaqësuesit e strehimoreve po ashtu kanë komentuar se gjykatat nuk i konsiderojnë rastet e dhunës në familje prioritet (anketë e RRGGK-së 2008).

¹²⁸ Për shembull, Deklarata mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe të keqtrajtimit, miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34, e datës 29 nëntor 1985.

¹²⁹ Po aty.

¹³⁰ Safe House Gjakova, anketë e RRGGK-së, 2008. Ombudspersoni ka rekomanduar se gjykatat duhet t'i japid prioritet rasteve të dhunës në familje me qëllim të lëshimit të urdhrit të mbrojtjes në kohën e duhur.

¹³¹ Raport i Ombudspersonit. Këto rekomandime mbetet të zbatohen.

¹³² Departamenti i Statistikave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dokument i dhënë RRGGK-së.

¹³³ Një i anketuar tjetër ka rekomanduar hapjen e një kolegji mbi çështjet e mbrojtjes së familjes (për shembull shkuronëzimet, alimentacioni, kujdestarët e fëmijëve, adoptimi, dhuna në familje, të drejtat prindërore për fëmijët etj.).

nga ana e viktimës dhe të rrirregullojë padrejtësitë të cilat i kanë pësuar. AV-të po ashtu kanë nevojë për paga më të larta dhe siguri në punën e tyre, kanë thënë ata.¹³⁴

Ligji i cili përkufizon shërbimet sociale të mbrojtjes për personat në nevojë aktualisht nuk është duke u zbatuar plotësisht. MPMS, si institucion përgjegjës për implementimin e tij, ka kapacitete të kufizuara njëzore dhe financiare për të ushtruar plotësisht ligjin dhe dobët ka mbikëqyrur ofrimin e asistencës nga OJQ-të.¹³⁵ Me qëllim që plotësisht të zbatojë Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare të Kosovës, rekomandohet që Ministria të zhvillojë procedurat për licencimin e OJQ-ve, si të dhe të qartësojë procedurat e tashme për ndihmë. Për këtë qëllim, Ministria duhet të krijojë një grup punues për të qartësuar sigurimin e financimit të qëndrueshëm për OJQ-të në pajtim me Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare. Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, MPMS-ja gjithashtu mund të shtyjë përpara nismat e shoqërisë civile për hartimin e ligjit mbi donacionet e liruara nga tatimi për organizatat joprofitabile joqeveritare. Një mjedis më i mirë ligjor për donacionet financiare do të lehtësonë grumbullimin e fondeve për strehimore dhe për OJQ-të e tjera. OJQ-të nuk duhet të mbështeten vetëm në financimin qeveritar, por duhet të hulumtojnë financimin e komunitetit si një opsjon kur i zhvillojnë strategjitet me fokus financier kohor afatmesëm dhe afatgjatë.¹³⁶ Strategjitet duhet të përfshijnë objektivat e një mbrojtjeje më të gjerë me qëllim të hartimit të skemave të reintegrimit dhe të përcjelljes së viktimave. Një linjë e përhershme buxhetore duhet të themelohet për, së paku, mbështetje të pjesshme të OJQ-ve, në pajtim me udhëzimet e parashtruara në Ligjin mbi shërbimet sociale që i lejon shtetit të kontraktojë organet e pavarura për shërbime, të cilat shteti nuk mund t'i sigurojë.

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe MPMS duhet të kontraktojnë strehimoret e OJQ-ve në baza klient për klient për të ofruar mbrojtjen e rastit posaçërisht para dhe gjatë procedurës, ngaqë asnjë sistem tjetër mbrojtës i dëshmitarit nuk ekziston tash për tash. Çmimi standard për strehimin e secilit person mund të përcaktohet bazuar në strehimin e mëparshëm të klientëve.¹³⁷ Mbrotja duhet të ofrohet deri sa klientët të mos janë më në rrezik, mentalisht të qëndrueshëm, dhe të aftë për të zhvilluar programe afatgjata të reintegrimit së bashku me ZSHS-të. Ministritë e tjera duhet t'i kontribuojnë linjave specifike buxhetore për ndihmën ndaj viktimave, duke përfshirë arsimimin dhe trajnimin (MASHT),¹³⁸ kujdesin shëndetësor dhe këshillimin psikologjik profesional (Ministria e Shëndetësisë). Më tej, qeveria menjëherë duhet të ndajë fonde të mjaftueshme për QPS-të dhe DAVA, në mënyrë që këto të mund të kryejnë detyrat e tyre në pajtim me ligjin.¹³⁹ Një pjesë e barrës financiare të mirëmbajtjes së strehimoreve, QPS-ve dhe shërbimeve të

¹³⁴ AV, anketë e RRGKK-së, 2008.

¹³⁵ Shih RRGKK, *Hulumtim kërkimor*, 2008.

¹³⁶ Shih RRGKK, *Hulumtim kërkimor*. Po ashtu rekomanduar nga AV në Pejë, anketë e RRGKK-së, 2008.

¹³⁷ QMG e ka vlerësuar çmimin mesatar mujor për strehim për një person në 200 euro.

¹³⁸ Pos kësaj, MASHT duhet të sigurojë se viktimat dhe fëmijët e tyre kanë qasje në shkollë. Strehimoret kanë raportuar diskriminimin në disa shkolla kundër fëmijëve që banojnë në strehimore (diskutime me RRGKK-në). QPS-të po ashtu janë përgjegjëse për sigurimin e kujdesit të duhur për fëmijët të cilët kanë qenë në situatë të dhunës në familje, duke inkluadruar shanse të arsimimit, ndihmën adekuate financiare dhe kujdesin shëndetësor.

¹³⁹ Një zyrtar policor ka sugjerouar krijimin e linjave të veçanta buxhetore për mbrojtjen e viktimës, duke përfshirë një linjë të veçantë buxhetore për njësinë policore e cila merret me dhunën në familje (Zyrtar i SHPK-së në Mitrovicë, ankteë e RRGKK-së 2008).

tjera të viktimateve të dhunës me gjasë mund të viheshin mbi kryerësit e dhunës përmes gjobave.¹⁴⁰

MPMS dhe strehimoret, në bashkëpunim të ngushtë, poashtu duhet të zhvillojnë një program afatgjatë të reintegrimit për klientët pas qëndrimit të tyre në strehimore. Strehimoret e tipit të mbyllur mund të shfrytëzohen për rastet emergjente dhe me rrezik të lartë, derisa strehimoret e hapura mund të shfrytëzohen për programet afatgjata të reintegrimit.¹⁴¹ Klientëve duhet t'iu jepet shansi të vendosin se cili lloj i strehimores më së miri ua plotëson nevojat e tyre dhe strehimoret mund të bashkëpunojnë në transferimin e rasteve në strehimoren më të përshtatshme. Secili klient duhet të ketë një plan të hartuar të reintegrimit, që do t'iu ndihmojë atyre ta krijojnë së bashku me strehimoren dhe menaxherin e rastit të ZSHS-ës. Plani duhet të përfshijë masat alternative të jetesës të finançuara nga shteti në strehimin qeveritar për një periudhë të saktësuar të kohës, këshillimin në vazhdimësi nga psikologët profesional, shanset e trajnimit për punë dhe ndihmën lidhur me sigurimin e punësimit. Viktimate të dhunës duhet t'iu vihen në dispozicion më shumë trajnime për shkathtësítë vokacionale dhe ato të tjera, të dëshirueshme nga tregu i tashëm i punës.¹⁴² QPS-të dhe strehimoret duhet të bashkëpunojnë me qendrat për gjetjen e vendeve të punës dhe bizneset lokale për të sigruar punësimin në mënyrë që secili klient të mund të mbijetojë pavarësisht. ZSHS-të duhet të janë përgjegjëse për monitorimin e përparimit të klientëve si parakusht që klientët të pranojnë ndihmën e vazhdueshme financiare nga qeveria.

Në pajtim me ligjin në fuqi, MPMS duhet të mbikëqyrë dhe vlerësojë rregullisht profesionalitetin e QMS-ve dhe të personelit të strehimoreve që janë të kontraktuar për sigurim të shërbimit.¹⁴³ Në rastet kur profesionaliteti nuk është vlerësuar pozitivisht, duhet të ndërmerren masa disiplinore menjëherë, duke përfshirë punësimin dhe trajnimin e personelit të ri, kur kjo është e zbatueshme.¹⁴⁴ Të gjitha institucionet që punojnë drejtpërsëdrejti me klientët që kanë përjetuar dhunën, posaçërisht ZSHS-të dhe personeli i strehimores, po ashtu mund të përfitojnë substancialisht nga mbikëqyrja prej personelit të kualifikuar, të psikologëve me përvojë.¹⁴⁵ Në këtë drejtim, MPMS mund të térheq nga burimet në dispozicion nga Universiteti i Prishtinës dhe/ose të financojë shkollimin jashtë shtetit për të rindjtë e interesuar në arritjen e shkathtësive të avancuara dhe përvojave lidhur me mbikëqyrjen, bazuar në parakushtet kontraktuale se të rindjtë e tillë duhet t'i shërbejnë MPMS për një periudhë të caktuar kohe pas marrjes së kualifikimeve të tyre. Universiteti i Prishtinës, (Departamenti i Psikologjisë), mund të mbështes trajnimin e gjeneratave të ardhshme të psikologëve të kualifikuar për QPS-të dhe strehimoret.

Rekomandimi për të krijuar një grup punues të përgjigjes të multiagjencioneve për asistencë dhe mbrojte duhet të kihet parasysh në kohën kur hartohet Plani Kombëtar i Kosovës kundër Dhunës në Familje. Rolet, përgjegjësítë dhe procedurat për secilin agjencion që i ndihmon rastet dhe mekanizmat referues duhet të qartësohen më tej në hollësi, duke

¹⁴⁰ Një i intervistuar tjetër ka rekomanduar sigurimin e fonave për ndihmë viktimateve përmes konfiskimit të mijeteve me të cilat janë kryer veprat penale. Grupet punuese duhet të diskutojnë më tej se si duhet të kanalizohen gjobat, sa para duhet të menaxhohen dhe nga kush, duke specifikuar se si rekomandimet e tillë do të funksionin në praktikë.

¹⁴¹ SHPK në Prizren, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁴² QMG, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁴³ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë mbi vlerësimin e profesionalitetit në kryerjen e punës.

¹⁴⁴ Rekomanduar në RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 2008.

¹⁴⁵ ZSHS, anketë e RRGGK-së, 2008.

përfshirë bashkëpunimin qeveritar me OJQ-të dhe përgjigjen e tipit të multiagjencionit.¹⁴⁶ Grupi i propozuar mund të përcjellte praktikat e mira të Grupit të Drejtpërdrejtë të Asistencës për viktimat e trafikuara me qëllim të zhvillimit të udhëzimeve të politikës për të ndihmuarit e viktimateve. Grupi duhet të hartoje dhe të nënshkruajë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për të ndihmuarit dhe mbrojtjen e viktimateve të dhunës në familje. PSV-të janë një politikë e veprimit e nënshkruar nga agjencionet të mandatuara me ligj për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje (duke përfshirë OJQ-të që ofrojnë shërbimet përkatëse). PSV-të duhet të ofrojnë në hollësi qartësimin e roleve dhe të përgjegjësive të secilit agjencion. Do të ishte e këshillueshme që MPMS të udhëheq në hartimin e PSV-ve kur është fjalë për ndihmën ndaj fëmijëve në pajtim me ligjin në fuqi.¹⁴⁷ Kur është fjalë për format e tjera të dhunës në familje dhe viktimat e moshuara, udhëheqja i takon Ministrisë së Drejtësisë të përfaqësuar nga DAVA.¹⁴⁸ Grupi poashtu mund të zhvillojë udhëzimet për referim dhe doracakët për ndihmë në pajtim me procedurat e detajizuara në PSV-të. Pas kësaj, agjencionet mund të përdorin doracakët për të ofruar trajnim lidhur me referimin për AV-të, ZSHS-të, policinë, punëtorët shëndetësor dhe personelin e strehimoreve. Duke ndjekur praktikat më të mira të vendeve të tjera të botës.¹⁴⁹

PSV-të mund të përfshijnë një kapitull mbi referimin e viktimateve në komunitetet e tyre, si dhe analizimin e strategjive afatgjata dhe afatmesme për programet e ndihmës që do të fuqizonin viktimat. Strategjia e reintegrimit duhet të përfshijë planet për strehimin shtëpiak të përkohshëm (shtëpitë e bashkësive) dhe pakot e asistencës sociale¹⁵⁰ në komuna për viktimat që nuk janë në gjendje për t'u kthyer në shtëpi për shkak të rrezikut për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

SHPK-ja dhe QPS-të duhet të kërkojnë sipas ligjit ose PSV-ve të informojnë viktimat për të gjitha opsjonet në dispozicion. Viktimate duhet t'i u jepet shansi për të zgjedhur se cilin opsjon e parapëlqejnë, pa trysninë e zyrtarëve. Si çështje e protokollit, nga policia mund të kërcohët për të shpérndarë informacionin lidhur me ate se ku mund të marrin personat këshillimin ose asistencën pa pagesë dhe ate konfidenciale kurdo që ata arrijnë në vendin e thirrjes së dhunës në familje, duke përfshirë edhe rastet kur personat në vendin e dhunës e mohojnë zhvillimin ose ndodhjen e dhunës. SHPK-ja duhet të ketë udhëzime të saktësuara dhe procedura për vlerësimin e nivelit të rrezikut për viktiminë dhe, bazuar në atë vlerësim, të ofrojë mbrojtje plotësuese ose ta marrë në arrest kryerësin e dhunës. Hapësira plotësuese private, të ngashme me ato që tanimë ekzistonjë në disa stacione, duhet të krijohen në stacionet policore me qëllim të intervistimit konfidential të personave të cilët kanë përjetuar dhunën.¹⁵¹ Derisa marrin deklaratat, policia duhet të ketë parasysh

¹⁴⁶ DPMS anketë e RRGGK-së, 2008. Ata kanë rekomanduar përmirësimin e sistemit referues përmes një urdhërese administrative ose dokumentit të referimit.

¹⁴⁷ Ligji mbi shërbimet civile dhe sociale e përcakton Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale (MPMS) si udhëheqës në koordinimin e punës në mbrojtjen sociale në Kosovë, si dhe në mbikëqyrjen e mandatit të qendrave për punë sociale në mbrojtjen dhe ndihmën fëmijëve (neni 3).

¹⁴⁸ Ngashëm, Ministria e Drejtësisë është autoritet përgjegjës për mbrojtjen e viktimateve përmes Divizionit të avokimit të viktimës dhe asistencës (neni 81, 82 i Kodit të Procedurës së Përkohshme të Kodit Penal të Kosovës).

¹⁴⁹ Shih programin e qeverisë Portugeze.

¹⁵⁰ Lloji i ndihmës sociale të cilën punëtori social është i detyruar me ligj për ta siguruar është nënvizuar në Skemën e Asistencës Sociale (SAS) në Kosovë, në Ligjin nr. 2003/28. të Kuvendit të Kosovës, Bazuar në nenin 12 të Ligjit është e mundshme për MPMS për të marrë masa për sigurimin ad hoc dhe të menjëherëshëm të ndihmës dhe mbështetje për të përmbushur nevojat e jashtëzakonshme. Në një situatë emergjente, rasti i dhunës në familje mund të kualifikohet si një nevojë e jashtëzakonshme. Është përgjegjësi e QPS-së, si autoriteti i përcaktuar në nivel komunal, për të administruar sigurimin e mbështetjes për mbulimin e nevojave të jashtëzakonshme të personit në nevojë, cituar sipas MPMS dhe OSBE-së).

¹⁵¹ One to One, Zyrtar i SHPK-së dhe AV në Mitrovicë, anketë e RRGGK-së, 2008.

mirëqenien emocionale të viktimës.¹⁵² Viktimat nuk duhet të trajtohen si të dyshuar.¹⁵³ Viktimat duhet të intervistohen nga policët e të njëjtës gjini dhe në prani të AV-ve. Me qëllim të implementimit të duhur të procedurave të veprimit, institucionet siç janë MPMS, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë si dhe OJQ-të duhet të sigurojnë trajnimin e vazhdueshëm, mandator, të avancuar multidisiplinar për personelin lidhur me çështjet në vijim: rolet dhe përgjegjësitet e tyre në pajtim me ligjin në fuqi dhe standardet ndërkontaktore të tē drejtave të njeriut; dhuna në familje në Kosovë; praktikat sociale dhe kulturore të cilat mund të miratojnë sjelljet e dhunshme në shtëpi; njohja e symptomave të traumës; qasja sensitive në të ndihmuarit e viktimës dhe, në përgjithësi, barazia gjinore. Trajnimi duhet të bazohet në procedurat në dispozicion dhe doracakët për të ndihmuarit e klientëve të dhunës në familje. Institucionet mund të përfitojnë nga ekspertiza e OJQ-ve në ndërtimin e kapaciteteve të një sistemi gjyqësor si dhe organeve të tjera.¹⁵⁴

Ministria e Shëndetit duhet të jetë më proaktive dhe pjesë e mekanizmave referues të koordinimit për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimat e dhunës në familje, me gjasë si pjesë e PSV. Punëtorët shëndetësorë duhet të jenë të përgatitur dhe nga ta kërkohet të informojnë viktimat potenciale të dhunës lidhur me të drejtat e tyre dhe lidhur me ate se ku mund të kërkojnë ndihmën. Ekzaminimet mjekësore duhet të bëhen menjëherë pasi të jetë kryer dhuna dhe duhet të mbesin konfidenciale. Raportimet duhet të jenë të pa paragjykuara dhe të përshkruajnë lëndimet. Ministria duhet të involvohet në financimin e këshillimit profesional psikologjik për viktimat, shpërdoruesit dhe familjet e tyre, duke përfshirë ata persona që banojnë në strehimore.

Plani i Veprimit Kundër Dhunës në Familje i Kosovës duhet të parashev financimin për trajnimin e vazhdueshëm të personelit shëndetësor për ordinancat private dhe ato publike nën udhëheqjen e Ministrisë së Shëndetit. Trajnimi duhet të mbulojë përkufizimet e dhunës kundër femrës, ndikimet mbi gratë dhe mbi vajzat në mënyrë të specifikuar, shpenzimet e dhunës; si të bëhet identifikimi i shenjave të dhunës, nevojat e personave të përfshirë në dhunën dhe përgjigjet e duhura.¹⁵⁵ Punëtorët shëndetësor në ordinancat private dhe publike duhet të trajnohen në marrjen e anamnezave psikologjike dhe në zbatimin e tyre dhe në qasjen psikosomatike kur iu ndihmojnë klientëve, posaçërisht për trajnimet gjinekologjike dhe kur i trajtojnë viktimat e dhunës seksuale.¹⁵⁶ Një qasje e tillë do t'i u mundëson punëtorëve shëndetësorë të identifikojnë rastet e dhunës. Më tej, nga punëtorët e kujdesit shëndetësorë duhet të kërkohet të mbeten në nivelet më të larta të profesionalitetit e të konfidencialitetit në trajimin e të gjithë pacientëve. Kryerja profesionale e detyrës nga ana e tyre duhet të monitorohet nga afër nga Ministria e Shëndetit dhe punëtorët të cilët e shkelin kodin e konfidencialitetit ose janë të përfshirë në praktika të keqpërdorimit duhet të humbin licencën e tyre për punë në praktikë.

2. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për ndjekjen penale të kryerësve të dhunës

Pas përshkrimit të përgjigjeve institucionale dhe ligjore në ndjekjen penale të kryerësve të dhunës në familje, kjo pjesë propozon rekomandimet për përmirësimin e përgjigjes.

¹⁵² Po aty.

¹⁵³ Organizata One to One, anketë e RRGGK-së, qershor 2008.

¹⁵⁴ Rekomandime nga Partners Kosova, si dhe nga një numër i madh i qytetarëve.

¹⁵⁵ Shih Qeveria e Portugalisë.

¹⁵⁶ Medica Kosova dhe QMG, anketë e RRGGK-së, 2008.

2.1 Përgjigja ligjore dhe institucionale

Ndjekja penale efikase e kryerësve të dhunës është thelsore kur adresohen veprat penale të lidhura me dhunën në familje.¹⁵⁷ Ligji në fuqi në Kosovë ofron shumë shtigje për ndjekjen penale të dhunës në familje. Kodi i Përkoħshém Penal i Kosovës (Kodi penal), Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/01 e cila ndryshon Ligjin në fuqi mbi veprat penale të lidhura me dhunën seksuale (duke përfshirë edhe dhunimin martesor), Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje (Rregullorja mbi dhunën në familje) dhe Ligji mbi qetësinë dhe rendin publik përkufizojnë një numër të krimeve dhe të akteve ose të mungesës së tyre në kuadër të cilave hetohet dhe ndiqet penalisht dhuna në familje. Sanksionet lëvizin, bazuar në natyrën dhe seriozitetin e krimit, prej tre muaj deri 15 vite të burgosjes.¹⁵⁸

Vështruar nga perspektiva ligjore, një numër i dështimeve janë identifikuar në ndjekjen penale të kryerësve të dhunës dhe është ofruar irregullimi i viktimate të dhunës në familje. Siç është përmendur, Kodi penal i Kosovës nuk e ofron përkufizimin e dhunës në familje per se². Përkufizimi i “dhunës në familje” në Rregulloren mbi dhunën në familje, por jo edhe në Kodin Penal, ka shkaktuar vështirësi në zbatimin praktik të legjislacionit. Më tej, ekziston konfuzioni për shkak të një numri të madh të dispozitave për luftën kundër dhunës në familje brenda burimeve ligjore, civile dhe penale.

Edhe pse Kodi Penal siguron shtigje të ndryshme për ndjekjen penale të kryerësve të dhunës të veprave penale në marrëdhënien familjare, dënimet për krimet e tilli nuk janë duke u qeverisur në mënyrën e duhur në praktikë.¹⁵⁹ Numri i rasteve të dhunës seksuale dhe i dhunës në familje i papërpunuar në gjykata kur krahasohet me numrin e rasteve të dhunës në familje të reportuar dhe numrin e viktimate të strehuara është marginal.¹⁶⁰ Sipas të dhënave të SHPK-së, nga viti 2005 deri në vitin 2007, përafërsisht 2.1 për qind e rasteve të regjistruara të dhunës në familje janë lënë të lira pa baza dhe 1.3 për qind kanë qenë në hetim e sipër nga fundi i vitit.¹⁶¹

¹⁵⁷ Shih Qeveria e Portugalisë.

¹⁵⁸ Krimet e kryera në marrëdhënien familjare sipas Kodit Penal të Kosovës janë të cekura në kapitujt në kuadër të veprave penale kundër jetës dhe trupit; veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të personit; kundër integritetit seksual; veprat penale kundër martesës dhe familjes; veprat penale kundër pasurisë dhe kundër të drejtës ndërkombe. Disa nga krimet, kur kryhen në kuadër të marrëdhënies familjare janë: lëndimet e lehta dhe të rënda trupore (nenet 153 dhe 154); detyrimi (neni 160); kërcënim (Neni 161); heqja e paligjshme e lirisë (neni 162); dhunimi- duke përfshirë dhunimin martesor dhe sulmin seksual (neni 193, 195); degradimi i integritetit seksual të viktimit (neni 196); shpërdorimi seksual i personave me çregullime mendore ose emocionale ose me paaftësi në marrëdhënien familjare (neni 197); rrëmbimi i paligjshëm i fëmijës (neni 210); keqtrajtimi ose braktisja e fëmijës (neni 211); shkelja e obligimeve familjare (nenet 212, 213); themelimi i skllavërisë, i kushteve të ngashme me skllavërinë dhe i punës së detyrueshme (neni 137) dhe krimet kundër pronës kur kryhen në kuadër të marrëdhënies familjare duke përfshirë krimet e vjedhjes, të vjedhjes së rëndë, uzurpimit ose marrjes në posedim të pronës së luajtshme të viktimit, dëmtimi i pronës së luajtshme duke përfshirë mashtrimin si dhe dëmtimet e shkaktuara personit në të drejtën e tij mbi pronën. (nenet 252, 253, 257, 258, 260, 261 të Procedurës së Pérkoħshme të Kodit Penal të Kosovës, Rregullorja 2003/25).

¹⁵⁹ Përfaqësuesi i strehimores dhe i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, analizë e RRGGK-së, 2008.

¹⁶⁰ Shih të dhënat statistikore në kapitullin dy. Shih poashtu RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 2008.

¹⁶¹ Gjatë këtyre tri viteve, 3,610 raste kanë shkuar në gjykatën komunale, 69 në gjykatën e qarkut dhe 6 në gjykatën për kundërvajtje. 82 përqind të rasteve janë myllur pa baza, dhe 51 kanë qenë nën hetime. Situata duket se ishte në përmirësim. Derisa 4.2 përqind e rasteve janë liruar pa baza në vitin 2005, kjo është zvogëluar në 1.3 përqind të rasteve në vitin 2006 dhe vetëm 0.6 përqind të rasteve në vitin 2007. Nga rastet të cilat kanë shkuar në gjykatë, për të cilat respondentët e analizës kanë ditur rezultatin e rastit, vetëm një e treta e kryerësve kanë qenë të dënuar.

Më tej, nuk ka raportime të ndjekjes penale automatike të veprave penale të lëndimeve të lehta trupore të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare ose për shkeljet e urdhrave të mbrojtjes, siç parashihet me ligjin në fuqi.¹⁶² Në kohën e tashme, lëndimet e lehta trupore janë të prirura të mos konsiderohen seriozisht ose në pajtim me procedurën e gjykatës; së këndejimi, kryerësit e dhunës rrallë dënohen.¹⁶³ Në raportin e OSBE-së, policia ka pohuar se mungesa e ndjekjes penale ka ndodhur për shkak se ndonjëherë palët janë pajtuar ose prokurori publik nuk ka sjellur padi.¹⁶⁴ Siç e ka shpjeguar strehimorja Liria, gjatë 72 orëve që policia i ndalon të dyshuarit e dhunës në familje, ata e pyesin viktiminë nëse ata dëshirojnë të shkojnë më tej me paditë e tyre. Sipas Lirisë, gratë rrallë shkojnë më tutje me paditë e tyre, burrat lirohen dhe dhuna përsëritet, thanë përfaqësuesit e strehimores.

Sidoqoftë, ligji në fuqi nuk lejon prokurorin të tërhiqet nga ndjekja penale ose hetimi.¹⁶⁵ Në rastet e lëndimeve të lehta ose të rënda trupore (pra, kur dhuna është e dukshme fizikisht) ose kur urdhri i mbrojtjes ekziston, ndjekja penale duhet të jetë automatike.¹⁶⁶ Në rastet kur bëhet krimi, femrat as që duhet pyetur nëse dëshirojnë të ngritin padi; kryerësi duhet menjëherë të ndiqet penalisht.

Në rastet e kohëve të fundit të monitoruara nga OSBE-ja, prokurorët në gjykatat komunale në Pejë dhe Leposaviq kanë qenë të prirur të mos ndërmarrin ndjekjet penale sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) të veprës penale të dëmtimit fizik kur kryhet në kuadër të marrëdhënies familjare. Për shembull:

Në një rast para autoriteteteve të Pejës, në shkurt të vitit 2007, policia i ka ofruar prokurorisë një rast në lidhje me incidentet e dhunës në familje në të cilin një viktimë femër kishte përjetuar lëndime trupore të dukshme. Zyra e prokurorit publik nuk mund ta lokalizonte rastin në regjistrat e saj. Për pasojë, prokurori kurrë nuk e kishte hetuar ose ndjekur penalisht, një krim të mundshëm. Në vend të kësaj, Gjykata Komunale kishte lëshuar një urdhër të mbrojtjes kundër burrit.¹⁶⁷

“Një grua e ka thirrur policinë, duke thënë se burri i saj e ka rrahur atë. Ata kanë shkuar në stacion të policisë dhe atje burri i saj ka thënë se e rrah atë për arsy se ai dëshiron ta bëjë një gjë të tillë. Pas kësaj, ata janë bashkuar sërisht.”

**– Grua shqiptare, moshë 36-45,
Gjakovë**

¹⁶² OSBE dhe Raporti *Ex Officio i Ombudspersonit*.

¹⁶³ AV në Prizren, analizë e RRGGK-së, 2008.

¹⁶⁴ Një burrë shqiptar i moshës 26-35 nga komuna e Gjakovës ka thënë se familjet ndonjëherë i mëshehin kryerësit e dhunës. Një grua e re nga Peja e ka njohur një grua e cila e ka përjetuar dhunën, por familja e saj i lejonte ate t'i tregojë policisë se kush po e shpërdoronte ate.

¹⁶⁵ Neni 226 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) në mënyrë të qartë thotë se prokurori publik nuk mund të pezullojë hetimet për krimet e kryera në kuadër të marrëdhënies familjare. Më tej, krimi i dëmtimit të lehtë të trupit parashë burgosjen prej gjashtë muaj deri në tre vjet me një vit përtej limitit siç kërkohet me nenin 227 të KPPPK për t'u tërhequr nga ndjekja penale (cituar sipas Raportit mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë të OSBE-së, korrik, 2007), 18.

¹⁶⁶ Siç e kanë komentuar përfaqësuesit e organizatës Liria, nëse kryerësi i dhunës kryen një krim, gratë madje as që duhet të pyeten nëse ato duan të vazhdojmë me padinë, por kryerësi duhet të ndiqet penalisht menjëherë. (anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁶⁷ Raporti mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë i OSBE-së.

Dhe:

Në një rast të vitit 2004 të trajtuar nga autoritetet e Leposaviqit, që involonte dhunën në familje e cila kishte rezultuar në lëndime të qarta në fytyrën e gruas, rasti i dosjes policore ka qenë dërguar në prokurori. Sërisht, prokuroria asnjëherë nuk kishte iniciuar një hetim, ngaqë rasti kurrë nuk ka figuruar në regjistrin e prokurorisë.

Shembujt e mësipërm ilustrojnë mungesën e vullnetit të prokurorisë për të trajtuar krimet e kryera në kuadër të marrëdhënieve familjare, madje edhe në rastet e dhunës së dukshme fizike ngjashëm me krimet e kryera jashtë marrëdhënieve familjare. Në një rast tjetër, në Gjykatën komunale të Mitrovicës, prokurori publik nuk e ka hetuar raportin policor të një babai i cili, siç pohohet, e rrihte fëmijën e tij me shkop. Prokurori nuk e ka ndjekur penalisht kryerësin e pohuar të dhunës ngaqë dosja e dorëzuar nuk është kompletuar nga policia, duke i munguar rapporti mjekësor i cili mund të tregonte plagët trupore. Edhe pse policia nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, prokuroria është dashur të kryejë obligimet e tyre.¹⁶⁸ Një zyrtar i SHPK-së ka komentuar se prokurorët dhe gjykatësit, po ashtu, shpesh kanë injoruar raportimet e rasteve të dhunës në familje.¹⁶⁹

Korrupsioni brenda sistemit të drejtësisë është fajësuar për dënimin joadekuat të kryerësve të dhunës. Një i anketuar ka thënë se kryerësit e dhunës ndonjëherë paguajnë gjykatësit që t'ua ulin dënimet e tyre ose që të mos i dënojnë fare. Të tjerë kryerës të dhunës janë lënë të lirë për shkak të lidhjeve politike ose të afërmve të tyre.¹⁷⁰ Për shembull, një zyrtar i polisë ka raportuar rastin e një gjykatësi i cili i ka lejuar kryerësit të dhunës të kryejë dënimin e tij me burg kurdo që ai e dëshironte këtë.¹⁷¹ Sipas një përfaqësuesi të një strehimoreje, sistemi i drejtësisë ka nevojë të përmirësojë “transparencën” dhe “besueshmërinë” e tij me qëllim që të ndërtojë besimin te qytetarët.

Pos kësaj, klasifikimi joadekuat i krimeve të lidhura me dhunën në baza gjinore është hetuar në gjykata kur rastet ndiqen penalisht *ex officio*. Këto raste kanë rezultuar në dënimë më të lehta për kryerësit e dhunës.¹⁷² Një numër i madh i të anketuarve të RRGGK-së ka pëershkuar raste të cilat i dinin e në të cilat kryerësit e dhunës kanë qenë liruar me dënimë të lehta ose pa dënimë. Si rezultat i kësaj, dhuna shpesh ka vazduhar të ndodh.¹⁷³ Për shembull, një burrë shqiptar nga komuna e Gjakovës ka thënë se ai njeh një rast në të cilin “burri ka qenë i dënuar me 30 ditë”, por dhuna ka vazduhar pasi ai është liruar nga burgu për arsy se dënimini ka qenë shumë i lehtë.” Hetimi dhe ndjekja penale e duhur, që rezulton në dënimë më të larta, në pajtim me dënimet e parapara me ligjin në fuqi, mund të jenë të

¹⁶⁸ Neni 226 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPP) qartë thotë se prokurori publik nuk mund të pezullojë hetimet për krimet e kryera në kuadër të marrëdhënieve familjare. Më tej, krimi i dëmtimit të lehtë trupor parashev burgosjen prej gjashtë muaj deri në tre vjet me një vit përpërej limitit siç kërkohet me nenin 227 të KPPP për t'u tërhequr nga ndjekja penale (cituar sipas Raportit mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë të OSBE-së, korrik, 2007), 18.

¹⁶⁹ Zyrtar i SHPK-së në Prizren, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁷⁰ QMG, analizë e RRGGK-së, 2008. Ato kanë thënë se duhet të ketë “zero tolerance” për të gjitha rastet pa marrë parasysh të aférmit e tyre.”

¹⁷¹ Shih pjesën për mbrojtjen.

¹⁷² Shih Raportin e vlerësimit mbi Themelimin e Mekanizmave referues të Njësisë së Antitrafikimit të OSBE-së për identifikimin dhe ndihmën viktimate të trafikimit (2007) lidhur me ndjekjen penale të veprave penale të dhunës mbi baza gjinore. Një zyrtar i SHPK-së në Mitrovicë poashtu ka thënë se gjykata nuk i përcakton qartë dënimet në rastet e dhunës në familje (analizë e RRGGK-së).

¹⁷³ Analizë e RRGGK-së. Një respondent tjetër ka treguar një rast kur një burrë, i cili ka përdorur dhunën kundër gruas së tij, ka qenë i arrestuar nga policia. Ai është liruar, është kthye në shtëpi dhe e ka detyruar gruan e tij të jetojë me te.

dobishme në zvogëlimin e dhunës duke treguar se dhuna kundër grupeve më të rrezikuara është çështje e të drejtave të njeriut dhe jo një çështje private familjare.¹⁷⁴ “Gjykata duhet të zbatojë ligjin, të dënojë shpërdoruesit sipas akteve të tyre penale ... Ligji nuk duhet të fal” ka komentuar një zyrtar i SHPK-së. “Veprat penale duhet të gjykohen drejtë dhe rreptë”.¹⁷⁵

2.2 Rekomandimet për përgjigjen e përmirësuar institucionale ndaj ndjekjes penale

Qeveria duhet të udhëheq një grup punues të shqyrimit legjislativ për të trajtuar heqjen e vështirësive të tashme dhe të pjesëve të paqarta të legjislacionit ose aspekteve të ligjit që nuk janë në përputhje me fokusin e dhunës në familje si krim. Ndryshimi i ligjit penal me qëllim të inkorporimit të përkufizimit të kryerjes së akteve të dhunës në familje në pajtim me përkufizimin e Rregullores mbi dhunën në familje¹⁷⁶ duhet të merret parasysh gjatë shqyrimit legjislativ.¹⁷⁷ Raportimi i rregullt mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës në familje duhet të bëhet një obligim i Zyrës së propozuar të raportuesit kombëtar mbi dhunën në familje (shih pjesën 4.1 më poshtë). Vendimet lidhur me ndarjen e pasurisë dhe të alimentacionit po ashtu duhet të përkufizohen qartësisht me ligj dhe duhet të vendosen në gjykatë në pajtim me ligjin në fuqi.¹⁷⁸

Qeveria duhet të themelojë një program të trajnimit për personelin gjyqësor i cili do të kishte mundësi të mësimit brenda dhe jashtë vendit, duke nxjerrë përfitime nga praktikat e mira në vendet e tjera me qëllim që të zhvillojë më tej dhe të zbatojë ligjin.¹⁷⁹ Sistemi i drejtësisë, pastaj, mund të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të tij përmes punësimit të personelit të ri të arsimuar në vende me më shumë përvuja dhe sisteme më të avancuara gjyqësore. Personeli i cili punon në sistemin e drejtësisë duhet të përpinqet të zbatojë njohuritë e reja të mësuara nga trajnimet, posaçërisht ato lidhur me menaxhimin organizativ dhe administrativ gjyqësore. Ata posaçërisht kanë nevojë të përmirësojnë komunikimin midis të gjitha niveleve të këtij sistemi hierarkik si dhe me qytetarët. Programet e trajnimit mund të mësonin personelin lidhur me shkathtësitë e komunikimit, posaçërisht të komunikimit me qytetarët. OJQ-të e specializuara në ndërtimin e kapaciteteve po ashtu mund të ofrojnë trajnime të bazuara në përvojën dhe praktikat e shfrytëzuara në vendet me sisteme gjyqësore më të avancuara. Si pjesë e praktikave të punësimit, komisionet e punësimit duhet të përpinqen për të përmirësuar balancin gjinor midis gjykatësve, prokurorëve dhe pozitave të tjera të rëndësishme.

3. Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale për parandalimin e dhunës në familje

Kjo pjesë, së pari, shqyrton përgjigjen ligjore dhe institucionale në parandalimin e dhunës në familje. E dyta, ajo diskuton sesi informacioni dhe ndërgjegjësimi mund të shërbejnë për parandalimin e dhunës në të ardhmen. Ngaqë pak iniciativa kanë qenë marrë në emër të institacioneve për të parandaluar dhunën në familje, kjo pjesë përfshin më shumë rekomandime se sa analiza.

¹⁷⁴ Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe i Sundimit të Ligjit i Misionit të OSBE-së në Kosovë, “Një Vështrim i Sistemit Penal të Drejtësisë në Kosovë, 1 shtator 2000 - 28 shkurt 2001,” Nenet 6 dhe 7 mbi të Drejtat e Viktimës I dhe II, Dhuna seksuale dhe dhuna brenda-familjare.

¹⁷⁵ Zyrtar i SHPK-së në Mitrovicë, analizë e RRGGK-së, 2008.

¹⁷⁶ Rregullorja e UNMIKut nr. 2003/12 mbi Mbrotjen Kundër Dhunës në Familje, neni 1.

¹⁷⁷ Përfaqësuesit e SHPK-së poashtu kanë rekonduar që dhuna në familje të trajtohet si një vepër e veçantë penale në kuadër të Kodit Penal (intervista me RRGGK-së, 2008).

¹⁷⁸ ZSHS në Ferizaj dhe një zyrtar i SHPK-së në Pejë (anketë e RRGGK-së, 2008). Prona dokumentohet zakonisht në emër të burrit dhe ai rrallë e humb pronësinë (Medica Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁷⁹ Të gjitha rekomandimet në këtë paragraf janë të bëra nga Partners Kosova, anketë e RRGGK-së, qershor 2008.

3.1. Përgjigja ligjore dhe institucionale në parandalimin e dhunës në familje në Kosovë

Zbatimi i ligjeve ekzistuese mund të shërbejë për të zmbapsur qytetarët nga kryerja e dhunës në të ardhmen dhe, së këndejmi, të jetë një mekanizëm i përdorur për parandalimin e dhunës. Nëse kryerësit e dhunës dhe kryerësit potencial të dhunës kanë qenë të vetëdijshëm se dhuna do të dënohet në pajtim me ligjin, ata do të ishin më pak të prirur të kryejnë dhunën.¹⁸⁰ Disa qytetarë, AV-ët dhe zyrtarët e SHPK-së po ashtu kanë sugjeruar që ligji penal të ketë dënimë më të larta për dhunën e kryer brenda familjes me qëllim të parandalimit.¹⁸¹

Një ide tjetër e popullarizuar për parandalimin e dhunës në familje, e mbështetur nga profesionistët që merren me dhunën në familje dhe qytetarët të tjera, ka qenë krijimi i një programi rehabilitues për kryerësit e dhunës. Kosova vuan nga mungesa të rëndësishme të programeve apo qendrave të këshillimit për keqtrajtuesit e moshës madhore.¹⁸² Siç e ka komentuar Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët “është shumë e nevojshme për të pasur qendra të këshillimit për kryerësit e dhunës ngaqë në disa raste kryerësit e dhunës vet në një kohë në jetën e tyre janë viktima të dhunës në familje ose të traumave të tjera.”¹⁸³ Institucionet mund të bashkëpunojnë në zhvillimin e programeve në nivelin e komunitetit, me gjasë përmes QPS-ve ekzistuese, për të mbështetur burrat dhe recidivistet e tjera keqtrajtues, si dhe për të kërkuar mënyra për të krijuar grupe të ndihmës të komunitetit ose grupe të vetndihmës të tipit shoku-shokut për kryerësit e dhunës në familje.¹⁸⁴

Më tutje, një rekomandim ka qenë krijimi i strehimoreve për keqtrajtuesit, në mënyrë që, së këndejmi, ata të janë të larguar nga shtëpitë e tyre dhe për të marrë ndihmën psikologjike në vend të praktikës së zakonshme të tashme të vendosjes së grave dhe të fëmijëve në strehimore. Programet e tillë do ta parandalonin dhunën në të ardhmen duke adresuar rrënjet e shkaqeve të dhunës, siç është trauma, keqpërdorimi i drogave ose depresioni në mesin e shpërdoruesve. Ato mund të ishin posaçërisht të dobishme për personat të cilët kanë kryer dhunën në kohën sa kanë qenë nën ndikimin e alkoolit ose të drogave.¹⁸⁵ Programet, po ashtu, mund t'i kontribuojnë programeve të reintegrimit afatgjatë më të suksesshëm dhe ndihmës së monitorimit të rasteve. Një nen mund të shtohet në Ligjin mbi shërbimet sociale ose Kodin Penal për trajtimin mandator dhe rehabilitimin e kryerësve të dhunës, duke përfshirë këshillimin profesional.¹⁸⁶ Pastaj, Ministria e Drejtësisë mund të kërkonte si nga keqtrajtuesit, ashtu edhe nga familjet e tyre të pranojnë trajtimin psikologjik në pajtim me nevojat e tyre. Seanca mandatore javore ose mujore të këshillimit për

¹⁸⁰ Zyrtarët e SHPK-së dhe një numër i madh i qytetarëve kanë komentuar se zbatimi i Kodit Penal dhe dënim i kryerësve të dhunës do ta parandalonte dhunën në të ardhmen (anketë e RRGGK-së, 2008). Patrullimi i ambienteve ku kryerësit e dhunës janë liruar pas qëndrimeve të shkurta në burg dhe njoftimit mbi prezencën e SHPK-së, po ashtu mund t'i kontribuojnë parandalimit të dhunës.

¹⁸¹ AV në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁸² Misioni i OSBE-së në Kosovë, Raport mbi qendrat për punë sociale: shërbimet sociale, (shkurt 2003). Po ashtu, QMG, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁸³ Shpresë dhe shtëpi për fëmijët anketë e RRGGK-së, 2008. Një përfaqësues tjetër i strehimores ka komentuar se vetëm burgu mund të ketë “kundërefekt” dhe se këshillimi mund të jetë i parapëlqyer në disa raste.

¹⁸⁴ Qeveria mund t'i inkurajojë donatorët për të mbështetur bursat për udhëtime studimore me qëllim të mësimit nga programet e suksesshme gjetiu. Në përcaktimin e programeve të tillë, qeveria mund të nxjerrë përfitime nga shembujt e programeve të suksesshme (shih, për shembull, “Rezyme e raportit final e simpoziumit të dhunës kundër grave,” IQALUIT, Nunavut, Janar 18-20, 2006, 4,

http://www.gnsw.ca/women_violence/documents/SymposiumExecSummaryENG.pdf.

¹⁸⁵ Zyrtar i SHPK-së në Pejë (anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁸⁶ Grupi Punues i shqyrtimit legjislativ i propozuar mund ta diskutojë nga pikëpamja praktike se si ta zbatojë këtë në mënyrën më të mirë. Grupi po ashtu mund të ekzaminojë zbatueshmërinë e lirimt me kusht dhe funksionimin e tij në Kosovë.

kryerësit e dhunës duhet të udhëhiqen nga psikologët profesionalë. Ministria e Shëndetësisë mund të bashkëpunojë me faktorët e tjera përmes ofrimit të profesionistëve për programet e trajtimit të alkoolit, narkotikëve dhe rasteve psikopatologjike.¹⁸⁷

Në mënyrë të ngashme, duke pasur parasysh zbulimet se dhuna mund të jetë më e prirur të ndodh pas shpërdorimit të drogave ose traumës, Ministria e Shëndetësisë duhet të instalojë qendrat e rehabilitimit për personat që konsumojnë alkoolin, personat e varur nga drogat ose /dhe ata që vuajnë nga trauma. Sigurimi i këshillimit konfidencial nga grupet joqeveritare mund të jetë më shumë i mirëseardhur nga të mbijetuarit e traumës dhe kryerësit e mundshëm të dhunës se sa kërkimi i asistencës nga qendrat e rehabilitimit publik. Së këndejmi, Ministria mund të kontraktojë dhe/ose financiarisht të mbështesë OJQ-të e specializuara në trajtimin e traumave dhe stresit, që kanë profesionistë të trajnuar, me përvojë e të cilët ofrojnë shërbime cilësore siç janë Medica Kosova, qendra për Rehabilitim të Viktimate të Torturës e Kosovës, Një me Një (One to One). Ministria dhe QSP-të mund të përfitojnë nga resurset në dispozicion në Universitetin e Prishtinës, Departamenti i Psikologjisë, që kërkon nga studentët të përmbushin orët e praktike, shpesh vullnetarisht. Derisa studentët nuk janë të kualifikuar për të ofruar trajimin, ata mund të ndihmojnë në aspektet organizative të programeve të tilla, që shpesh konsumojnë shumë kohë. Në të njëjtën kohë, përmes përfshirjes së tyre ata mund të ndihmojnë më shumë nga këshillues shumë më të përvojshëm, që do t'i kontribuonte gjeneratave të ardhshme të këshilluesve për trajtimin e rasteve të tilla dhe në organizimin e programeve të ngashme.

Institucionet, në bashkëpunim me klinikat private dhe OJQ-të po ashtu mund të parandalojnë dhunën përmes ofrimit të këshillimit familjar dhe martesor. Një numër i madh i qytetarëve kanë theksuar nevojën për shërbime të arritshme, profesionale të këshillimit në nivel komunal, posaçërisht afér zonave rurale. Derisa shumë të anketuar kanë sugjeruar themelimin e gendrave të këshillimit, qeveria mund të shfrytëzonte strukturat ekzistuese siç janë QPS-të.¹⁸⁸ Aty, psikologët e trajnuar, të kualifikuar, mund të kishin hapësirat private ku mund të ofronin këshillim martesor dhe familjar. Këshilluesit duhet të përdorin anamnezat psiko-sociale për të identifikuar shkaqet e dhunës dhe për të ndihmuar në procesin e shërimit të kryerësve të dhunës.¹⁸⁹

Një mënyrë tjetër me anë të së cilës qeveria mund të ndihmonte në parandalimin e dhunës në familje është ajo përmes sigurimit se të gjithë qytetarët kanë qasje në nivelet më të larta të arsimimit. Sipas ligjit, qytetarët kosovarë janë të obliguar për të vijuar nëntë vite të arsimimit fillor.¹⁹⁰ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka përgjegjësinë për të siguruar se ky ligj zbatohet. Asistenca sociale dhe bursat për arsimim duhet të janë në dispozicion për gratë, të varfrit, grupet etnike RAE, personat me nevoja të veçanta, dhe grupet e tjera të rrezikuara me qëllim që të rritet niveli i tyre i arsimimit, me çka, së këndejmi, rritet mundësia për ta për të siguruar punë dhe për të zgjedhur gjasa se ata do të bëhen viktima të dhunës. Më tej, programet dhe planet shkollore duhet të përfshijnë çështje të lidhura me dhunën në familje dhe format e tjera të dhunës mbi baza gjinore.¹⁹¹

¹⁸⁷ Shtëpi e sigurtë, Gjakova, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁸⁸ ZSHS, Mitrovicë, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁸⁹ Medica Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

¹⁹⁰ Ligji mbi shkollimin fillor dhe të mesém në Kosovë, nr. 2002/2, neni 7 mbi shkollimin e obliguar.

¹⁹¹ Shqyrtimi i planeve dhe i programeve të tashme duhet të zhvillohet nga kjo perspektivë dhe pastaj duhet të bëhen rekomandimet për përfshirjen e çështjeve siç është ajo e dhunës në familje, çfarë përfshin ajo, dhe çfarë të bëhet nëse anëtarët e familjes përdorin dhunën.

Duke pasur parasysh se familjet me të hyra të ulëta dhe familjet me assistencë sociale janë në rrezik më të lartë të dhunës, MPMS mundtë parandalojë po ashtu dhunën përmes rritjes së sasisë së assistencës mujore sociale që ofrohet për familjet në nevojë. Më tej, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka nevojë urgjente për të inkurajuar investimet në krijimin e vendeve të punës përballë zvogëlimit të papunësisë dhe përmirësimit të kushteve themelore të jetesës së njerëzve. Personat në rrezik të dhunës duke përfshirë edhe ata që ekonomikisht janë të varur, gratë, fëmijët, dhe njerëzit me paaftësi duhet të jenë në shenjtër të trajnimeve në shkathtësitë e reja të dëshirueshme përmes zhvillimit të një tregut të punës në Kosovë. Taksat stimuluese dhe programet e veçanta të kredive mund të shfrytëzohen për të inkurajuar punëdhënësit për të punësuar personat në rrezik.

3.2 Informacioni dhe ndërgjegjësimi si instrumente të parandalimit të dhunës në familje

Edhe pse OJQ-të kanë udhëhequr një numër të madh të fushatave të informimit lidhur me dhunën në familje,¹⁹² qytetarëve ende iu mungojnë njohuritë lidhur me ligjin ekzistues, të drejtat e tyre dhe shërbimet që ata i kanë në dispozicion.¹⁹³ Në punën e tyre, përfaqësuesit e Partners Kosova kanë thënë se klientët shpesh ankohen se atyre iu ka munguar informacioni lidhur me ligjin ekzistues dhe legjislacionin lidhur me dhunën në familje, lidhur me atë se si zbatohet legjislacioni dhe se kujt duhet ata t'ia drejtojnë ankesat kur të drejtat e tyre nuk janë respektuar.¹⁹⁴ Qeveria e Kosovës ka ofruar mbështetje të kufizuar për fushatat e ndërgjegjësimit të cilat e informojnë popullatën e përgjithshme dhe viktimat lidhur me ndikimin e dhunës, shërbimet e tashme në dispozicion, dhe procedurat e referimit për ndihmë viktimate të dhunës në familje.¹⁹⁵ Shumica e fushatave kanë qenë të tipit ad hoc (të atypëratyshme), pa ndonjë publik të vënë në shenjestë ose mesazh të veçantë.

Me qëllim të parandalimit të dhunës së ardhshme në familje, qeveria dhe institucionet përkatëse duhet të mbështesin teknikisht dhe/ose financiarisht fushatat e ndërgjegjësimit për të edukuar qytetarët lidhur me ligjet ekzistuese dhe legjislacionin përkitazi me dhunën në familje, lidhur me atë se si ata mund të shfrytëzojnë këto ligje dhe se si qytetarët mund t'iu qasen këtyre institucioneve.¹⁹⁶ Fushatat e ardhshme duhet të shmangin termat abstrakt siç është “dhuna në familje” dhe “barazia gjinore” dhe në vend të tyre të qartësojnë termet e tilla me anë të një gjuhe të thjeshtë. Qytetarët po ashtu duhet të informohen lidhur me përkufizimin e “marrëdhëniej familjare” (pra, kush mund të kryejë akte të tilla), siç është e përkufizuar me ligj.¹⁹⁷ Fushatat duhet të zhveshin mitet sociale lidhur me dhunën kundër grave në veçanti. Në dizajnimin dhe zbatimin e fushatave të edukimit, qeveria duhet të përfitojë nga ekspertiza e OJQ-ve. Institucionet mund t'i kontraktojnë OJQ-të për të udhëhequr përpjekjet e ndërgjegjësimit bazuar në përvojën e tyre, në lidhje me grupet e vëna në shenjestë, dhe në gjurmimin e të dhënave në organizimin e fushatave të mëhershme. Informacioni duhet bashkërenditet nën udhëheqjen

¹⁹² Për shembull, RRGGK, QMG në Pejë, Liria në Gjilan, Shtëpi e sigurtë Gjakova, QMFG dhe Motrat Qiriazi, të gjitha kanë zhvilluar fushata të ndërgjegjësimit lidhur me dhunën në familje. QMG ka një fushatë vjetore të ditës së fjongos së bardhë (që simbolizon burrat kundër dhunës që ushtronhet ndaj gruas) që përfshin burrat dhe gratë nga komuniteti në prerjen dhe shpërndarjen e fjongove të bardha si dhe një marsh nëpër Pejë për të ngritur vetëdijen kundër dhunës në familje.

¹⁹³ Shih kapitullin një.

¹⁹⁴ Partners Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008. Qytetarët po ashtu kanë dyshuar nëse autoritetet do të zbatonin ligjin ekzistues.

¹⁹⁵ Po aty. Pjesa mbi përfshirjen sociale të viktimate duke përfshirë viktimat e dhunës në baza gjinore.

¹⁹⁶ Rekomandim nga një numër i madh qytetarësh, Partners Kosovo, QMFG, AV-të dhe ZSHS (anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁹⁷ AV në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008

e autoriteteve të Kosovës. Për shembull, institucionet kosovare mund të inkurajojnë donatorët ndërkombëtarë për të financuar vetëm fushatat e ndërgjegjësimit të identikuara në Planin kombëtar të veprimit kundër dhunës në familje dhe të organizuara me mesazhe dhe grupe të caktuara për të cilat është arritur pajtimi nga grupi drejtues, përgjigjes për mbikëqyrjen e zbatimit të planit. Fushatat duhet të janë kulturalisht sensitive dhe të sajuara për publikun lokal, dhe jo të janë të importuara nga jashtë Kosovës.¹⁹⁸ Ndërgjegjësimi duhet domosdoshmërisht të përfshijë mediat lokale dhe ato kombëtare.¹⁹⁹ Shpërndarja e informacionit duhet të shfrytëzojë një varg mediash të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ato në gjuhët e pakicave.²⁰⁰ Ndërgjegjësimi lidhur me Rregulloren e tashme të dhunës në familje ose mbi një ligji të ri i cili e zëvendëson atë, mbi Planin kombëtar të veprimit, atë se çka përfshin dhuna, dhe dënimet për keqtrajtuesit mund të mbrapsin kryerësit e dhunës nga përdorimi i dhunës.

Me qëllim që të familjarizojë qytetarët me institucionet relevante dhe shërbimet që ofrojnë ato, si dhe të ndërtojë besimin, përfaqësuesit institucionalë në nivel komunal mund të përfshihen drejtpërdrejtë në përpjekjet e ndërgjegjësimit. Grupet tashmë ekzistuese informale të formuara nga institucionet dhe strehimoret që punojnë në çështjet e dhunës në familje në nivel komunal mund të punojnë së bashku për një varg shërbimesh të komunitetit ose muajit kundër dhunës në familje, gjatë të cilit secili institucion do të udhëhiqte diskutimet publike dhe ligjëratat në shkolla, në shoqata të pensionistëve, në grupet e të rinjve, në ambientet rrethuese dhe hapësirat publike lidhur me shërbimet që i ofron secili institucion qytetarëve. Për shembull, SHPK-ja mund të bazohej në përpjekjet e saj të komunitetit policor për të udhëhequr ligjérata dhe debate publike në komunitet.²⁰¹ Që është e rëndësishme, përfaqësuesit e institucioneve duhet po ashtu të vizitojnë njerëzit në zonat rurale të cilat përbëjnë shumicën e popullatës dhe janë në mesin e grupeve më të rrezikuara të dhunës, por të cilët janë shpesh të shpërfillur nga institucionet dhe përpjekjet e tekalimit të kufijve të komunitetit.²⁰²

Ministritë duhet të ndajnë fonde vjetore, me qëllim që t'i përgjigjen nevojave të viktimateve për informacion dhe asistencë përmes hartimit dhe shpërndarjes së rregullt të pamfleteve me një gjuhë lehtësish të kuptueshme dhe informacion lidhur me atë se ku qytetarët mund të kërkojnë ndihmën. Të gjitha institucionet, duke përfshirë posaçërisht stacionet policore, qendrat shëndetësore, QPS-të, AV-ët, OJQ-të dhe gjykatat mund të shpërndajnë fletushka të këtilla. Policia, për shembull, mund t'i vë fletushkat e tillë në dispozicion kur viktimat arrijnë në vendin e lajmërimit së dhunës në familje. Punëtorët shëndetësorë, posaçërisht në dhomat e emergjencës, duhet të trajnohen për të identifikuar rastet e dhunës në familje dhe për të ofruar informacionin për ndihmën në dispozicion.

Autoritetet e Kosovës po ashtu duhet të zhvillojnë një shërbim efikas të informimit me një funksionim konsistent, 24 orësh, të papagesë, linjë të ndihmës në dispozicion në të cilën personat, miqtë ose anëtarët e familjes që përjetojnë dhunë mund të thërrasin për këshillim, asistencë ose referim konfidencial. Shumica e linjave të thirrjes për ndihmë në Kosovë udhëhiqen nga strehimoret e OJQ-ve për viktima të dhunës në familje, të cilat kanë

¹⁹⁸ Rekomandim i bërë nga një zyrtar i SHPK-së (anketë e RRGGK-së, 2008).

¹⁹⁹ QMG dhe qytetarët (anketë e RRGGK-së, 2008).

²⁰⁰ Shih programin e qeverisë Portugeze.

²⁰¹ Përfaqësuesit institucionalë kanë thënë se ka qenë e arritshme për institucionet për t'u përfshirë në përpjekjet e tillë të parandalimit (anketë e RRGGK-së). Organizata One to One ka rekomanduar që SHPK-ja të punësojë njerëz të trajnuar me përvojë të cilët po ashtu do të ishin më të përfshirë në një shtrirje sa më të gjërë (anketë e RRGGK-së 2008).

²⁰² Shih kapitullin dy.

financim të kufizuar qeveritar.²⁰³ Ato funksionojnë në mënyrë të çrregullt ose vetëm në disa rajone.²⁰⁴ SHPK-ja dhe DAVA po ashtu kanë linja të thirrjes për ndihmë. Megjithëkëtë, përgjigjja e policisë ndaj thirrjeve të dhunës në familje, shpesh është e ngadalshme.²⁰⁵ Linja e thirrjeve emergjente të DAVA përgjithësisht nuk është funksionale dhe rrallë përgjigjet dikush në të.²⁰⁶ Linjat e thirrjes për ndihmë të udhëhequra nga studentët e psikologjisë në Universitetin e Prishtinës fatkeqësisht kanë pushuar së vepruari për shkak të mungesës së financimit.²⁰⁷ Personelit të linjave të thirrjeve për ndihmë po ashtu i kanë munguar njohuritë lidhur me shërbimet në dispozicion dhe procedurën e tashme referuese në Kosovë.

Së këndejmi, qeveria duhet të sigurojë financimin konstant për funksionimin 24 orësh të linjave për thirrje telefonike emergjente në duart e profesionistëve të trajnuar me ndërrime rotative. Autoritetet duhet të vënë në dispozicion një buxhet shtesë për trajnimin e personelit të linjave të thirrjeve për ndihmë me qëllim të ofrimit të informacionit mbi shërbimet ekzistuese dhe ato referuese. Linjat e këtilla duhet të reklamohen mirë anë e kënd Kosovës. Duhet të bëhet një marrëveshje me Post-Telekomin e Kosovës për numrin i cili duhet të jetë i liruar nga pagesa për thirrësit. Këshilluesit e linjave të këtilla duhet të ofrojnë informacion lidhur me shërbimet në dispozicion për personat të cilët përfjetojnë dhunën si dhe informacionin e kontaktit për institucionet më të afërta ose organizatat ku thirrësit mund të kërkojnë ndihmën. Të gjitha thirrjet duhet të regjistrohen në një bazë të dhënat pa elemente identifikuese (pra, emra, numra telefoni ose adresa) me qëllim që të krijohet një përfytyrim për numrin e thirrjeve të bëra në këto linja emergjente, për shërbimet e ofruara dhe të dhënat e tjera statistikore.²⁰⁸ Këshilluesit të cilët përgjigjen në linjat e këtilla emergjente duhet të pajisen me formularët standard për dokumentimin e informacionit bazik lidhur me thirrjet dhe thirrësit, siç është gjinia, komuna, mosha dhe etnicitetit. Informacioni mund të përdoret më vonë për të arsyetur financimin e vazhdueshëm të linjave të thirrjes emergjente si dhe lidhur me faktin se çfarë niveli të përdorimit kanë ato linja si dhe për të monitoruar grupet demografike që përfjetojnë dhunën e cila nuk është e thënë që domosdoshmërisht të raportohet. Linjat e thirrjeve për ndihmë si shërbime të informacionit dhe të ndihmës mund t'i vënë institucionet më afër viktimate dhe ta rrisin raportimin e dhunës.

4. Përmirësimi i reagimit të gjithëmbarshëm të qeverisë ndaj dhunës në familje

Qeveria e Kosovës mund të adresojë rekomandimet e lartpërmendura për parandalimin, mbrojtjen dhe ndekjen penale përmes një reagimi të udhëzuar, të koordinuar dhe multidisciplinar ndaj dhunës në familje. Së pari, Qeveria e Kosovës duhet të jetë udhëheqëse në krijimin e një organi shtetëror të këshillimit të ekspertëve qeveritarë dhe joqeveritarë për të adresuar zbatueshmërinë e legjislativit dhe të mbrojtjes së viktimate të dhunës në familje. Ky organ duhet të merr parasysh praktikat diskriminuese të cilat mund ta pengojnë

²⁰³ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, dhe “Vlerësimi i nevojave për strehimore” i RRGGK-së “Raport i brendshëm” (2007).

²⁰⁴ Të gjitha strehimoret i kanë numrat në të cilët mund të thërrasin njerëzit 24 orë për ndihmë. Kur RRGGK-ja e ka thirrur linjën e emergjencave të AV-së në më shumë se pesë raste në vjeshtë të vitit 2007 dhe në mes të vitit 2008 askush nuk është përgjigjur.

²⁰⁵ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

²⁰⁶ Shih citatet e RRGGK-së nga rastet studimore të grave të strehuara me fëmijë (*Hulumtim kërkimor*).

²⁰⁷ Shih RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, Raport i vlerësimit mbi themelimin e mekanizmave të referimit për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, tetor 2007.

²⁰⁸ Me qëllim që të kenë shenjat e thirrësve që përsërisin thirrjet dhe numrin e rasteve, pyetja e shtuar nga këshilluesi mund të jetë: “a e keni thirrur ndonjëherë këtë linjë emergjente më parë? Nëse po, kur?” Megjithëkëtë, pyetjet duhet të bëhen vetëm nëse i anketuari është i sigurt dhe psikologjikisht i qëndrueshëm për përgjigjen e pyetjeve.

gëzimin e të drejtave të parapara me ligj. Organi shtetëror i këshillimit duhet të këshillojë Agjencinë për Barazi Gjinore të Kosovës mbi politikat dhe zhvillimet lidhur me legjislacionin mbi dhunën në familje, politikat dhe zbatimin e tyre efikas. Organi duhet të merr parasysh karakteristikat e dhunës në familje dhe profilet e viktimateve në Kosovë (pra, fëmijë, gra, të moshuar dhe persona me aftesi të kufizuara)²⁰⁹ me qëllim të hartimit të planeve dhe politikave qeveritare më efikase dhe më të informuara të veprimit. Me qëllim që të sigurojë mbështetjen më të lartë politike, Agjencia për Barazi Gjinore duhet të synojë që grapi të vendoset nën përgjegjësinë e Kryeministratit. Grupi duhet të përbëhet nga profesionistët e nivelit të lartë me kompetenca vendimmarrëse dhe ekspertët në fushat kundër dhunës në familje.

Nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore, ky organ duhet të përfshihet në hartimin e menjëhershëm të Planit kombëtar të veprimit kundër dhunës në familje.²¹⁰ Plani i veprimit duhet të përforcojë ndihmën dhe mbrojtjen për viktimat e dhunës në familje, të sigurojë drejtësinë lidhur me trajtimin e krimeve, si dhe të adresojë rrënjet e shkaqeve të dhunës, siç janë praktikat diskriminuese dhe ato tradicionale. Plani duhet ta bëjë këtë duke synuar parandalimin, Mbrojtjen dhe Ndjekjen penale efikase dhe një themel të gërshetuar të bashkërenditjes dhe të bashkëpunimit në nivelet më të larta qeveritare. Në Plan duhet të parashihet ndarja e qartë e objektivave, aktivitetave, të afateve kohore dhe e implikimeve buxhetore për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe për donatorët potencialë. Përfaqësuesit e institucioneve po ashtu kanë sugjeruar themelimin e një fondi special për Planin kombëtar të veprimit, prej të cilët institucionet të cilat mbrojnë viktimat mund të nxjerrin burime financiare. (pra, QPS-të, DAVA-ja dhe SHPK-ja).²¹¹ Linjat buxhetore duhet të jenë sipas prioriteteve në mënyrë që shpenzimet më urgjente të përballohen në fillim.

Plani duhet të bazohet në rezultatet dhe rekomandimet të vëna në dispozicion nga kërkimet mbi dhunën në familje në Kosovë, duke përfshirë këtë raport si analizen më të re dhe gjithëpërfshirëse të dhunës në familje në Kosovë. Edhe pse Plani do të kërkojë të adresojë dhunën kundër anëtarëve të ndryshëm të familjes në vendbanime familjare, Plani duhet të adresojë në mënyrë specifike dhunën kundër personave më të rrezikuar që janë cak i dhunës në familje (pra, gratë, fëmijët, personat me aftesi të kufizuara, si dhe qytetarët e zonave rurale dhe me ata të hyra të ulëta). Plani nuk duhet të ndahet nga planet e veprimit në dispozicion ose planet dhe politikat e tjera të hartuara (pra, Projektprogrami mbi barazinë gjinore i Kosovës, Projektplanit të veprimit të Kosovës dhe Strategjisë së luftimit të trafikimit me qeniet njerëzore, Planit kundër korruptionit etj.). Grupi punues i themeluar nga ABGJ-ja për të hartuar Planin kombëtar të veprimit duhet të jetë sa shumë përfshirës, duke përfshirë së paku përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të rëndësishme, të strehimoreve dhe të OJQ-ve me përvojë të cilat merren me këtë çështje. Procesi i këshillimit duhet të rezultojë në një plan të gjithanshëm dhe të gjithëmbarshëm duke siguruar

²⁰⁹ Më tej, ata duhet po ashtu të inkurajojnë hulumtimin studimor mbi dhunën në familje në Kosovë nga universitetet publike dhe private në Kosovë për të pajisur objektivat e studiuesve me qëllim që të mbështes hulumtimin empirik dhe intervenimet lidhur me informatat.

²¹⁰ Zyrtarëve komunalë për çështje gjinore mund t'i u jepen përgjegjësi të veçanta në Planin kombëtar të veprimit.

²¹¹ Përfaqësuesit e institucioneve të analizuara nga RRGGK-ja kanë rekomanduar që organet e mëposhtme të financojnë zbatimin e Planit kombëtar të veprimit: MPMS/DMS/QPS, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme/SHPK-ja MASHT (posaçërisht shkollimi i viktimateve), Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve dhe e Çështjeve Jorezidente, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Agjencia për Barazi Gjinore dhe Ministria për Punë të Brendshme. Disa të anketuar po ashtu kanë komentuar se strehimoret, USAID, UNICEF, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore mund të kontribuojnë.

kontributet nga të gjithë akterët e rëndësishëm, në mënyrë që kështu ata të kenë hisen e vet në zbatimin e planit.

Në objektivat e planit duhet të përfshijnë mes të tjerash, aksionet e qeverisë në gjurmimin e dhunës në katër nivele që synojnë parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale efikase. Së pari, rezultatet kanë nevojë të adresojnë çështjet strukturale të cilat e përjetësojnë dhunën me një fokus në zhvillimin e legjislacionit dhe të politikës. E dyta, nevojitet veprim për të nxitur edukimin përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimit të barazisë gjinore. E treta, qeveria duhet të garantojë që viktimat e dhunës në familje të kenë qasje në mbështetje dhe ndihmë të duhur. E katerta, kërkimet duhet të ndërmerren për të monitoruar dhe vlerësuar zhvillimet dhe për të shqyrtuar progresin.²¹² Plani i veprimi i Kosovës duhet të përqendrohet në objektivat specifike dhe rezultatet për të adresuar dhunën në familje duke marrë parasysh profilet e viktimave nga kërkimet në dispozicion dhe praktikat sociale diskriminuese.

Plani duhet të involvojë një mandat të qartë lidhur me atë se cili organ ose agjenci është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij. Një komision i përbërë prej përfaqësuesve nga të gjitha institucionet përkatëse duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të monitoronte zbatimin e këtij Plani. Agjencia për Barazi Gjinore duhet të sigurojë mbështetjen financiare për një raport vjetor të monitorimit lidhur me zbatimin e planit, që përfshin rekomandimet përrirregullimet si dhe për planin tjetër.²¹³ Në mënyrë plotësuese, qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë duhet të mbështesin kërkimet nga OJQ-të në përputhje me punën e cila është duke u zhvilluar në nivel kombëtar, e cila mund të shërbejë si një analizë e pavarur e përparimit institucional dhe të bëjë rekomandime drejt një reagimi më të mirë.

Qeveria e Kosovës duhet të formojë një grup punues legjislativ për të shqyrtuar kornizën ligjore për sigurimin e masave adekuate të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, posaçërisht gratë si shumica dërmuese e viktimave që kërkojnë urdhrat e mbrojtjes. Shqyrtimi duhet të synojë të zhvillojë udhëzime më të qarta ose të ndryshojë ligjet në mënyrë që viktimat të kenë qasje të lehtë në trajtim, gjyqësor dhe ndaj mbrojtjes në përgjithësi. Grupi punues duhet të largojë vështirësitë e tashme dhe pjesët e paqarta të legjislacionit ose aspekte të ligjit në shpërputhje me fokusin e dhunës në familje si krim. Në kodin penal para së gjithash duhet të adresohen ekzistanca e burimeve të ndryshme në ligjin civil dhe penal, që adresojnë rastet e dhunës në familje, si dhe mungesa e përkufizimit të dhunës në familje.²¹⁴

Regullorja mbi dhunën në familje duhet të miratohet si ligj nga Kuvendi i Kosovës me qëllim që të kemi një masë civile gjëresisht në dispozicion, të qasshme dhe efikase (e paraparë aktualisht me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12). Ligji duhet të vazhdojë të garantojë mbrojtjen, sigurinë dhe alternativat e banimit për të gjitha viktimat e dhunës në familje, me çka, kështu, ngritet aftësia e viktimës për të tejkaluar ose braktisur situatat e dhunshme.²¹⁵ Ligji duhet të bazohet në përbajtjen e Rregullores së tashme mbi dhunën në

²¹² Për shembull, Propozimi i planit të veprimit mbi dhunën kundër grave i Këshillit të Evropës, 1998.

²¹³ AV në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008.

²¹⁴ Për shembull, Komiteti për eliminimin të diskriminimit kundër grave në observacionet e tij përfundimtare mbi raportin shtetëror të Republikës së Moldavisë ka theksuar se dhuna në vendbanimet private, posaçërisht dhuna në familje kundër grave, është shkelje e të drejtave të njeriut dhe duhet të konsiderohet si e tillë. Komiteti, së këndejimi, i këshillon shtetet “të sigurojnë se dhuna e tillë përbënë krim të dënueshëm me ligjin penal, i cili ndiqet penalisht dhe dënohet me ashpërsinë dhe shpejtësinë e kërkuar (Raport i Komitetit mbi eliminimin e diskriminimit kundër grave, sesioni i 22-të dhe i 23-të, dok. i KB A/55/38, 17 gusht 2000, paragrafi 102. Cituar sipas Raportit mbi rastet e dhunës në familje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, korrik 2007).

²¹⁵ Shih propozimin e Planit të veprimit të Këshillit të Evropës, 1998.

familje, si dhe të qartësojë pjesët e paqarta në mënyrë që të mund të zbatohet plotësisht. Rregullorja mbi dhunën në familje ose ligji i ardhshëm duhet të zbatohet në mënyrë korrekte si një mjet i fuqizimit dhe jo i pajtimit. Nëse do të zbatohet në mënyrën e duhur, Rregullorja mbi dhunën në familje mund të sigurojë që viktimat e dhunës të banojnë ose mbresin në vendet e tyre të zakonshme të banimit, që mund të jetë një alternativë fuqizuese kundrejt vendosjes së viktimateve në strehimore për periudha të gjata të kohës dhe izolimit të tyre nga familjet e tyre dhe shoqëria. Nëse kthimi i viktimës në vendin e përbashkët të banimit nuk është i sigurt, duhet të vihet në dispozicion alternativat tjera, siç është urdhërimi i kryerësit të dhunës për të paguar qiranë. Ligji duhet t'i sigurojë viktimat që ato të fillojnë të marrin asistencën menjëherë, duke përfshirë masat e jetesës alternative të finançuara nga qeveria ku mund të jetojnë me fëmijët e tyre,²¹⁶ posaçërisht në rastet kur kryerësit e dhunës nuk mund të paguajnë.

4.1 Zbrazëtitë ligjore dhe institucionale lidhur me mbledhjen e të dhënave, kërkimin dhe monitorimin

Të dhënat joadekuate lidhur me praninë e dhunës në familje mund ta pengojnë gatishmërinë e autoriteteve për t'u marrë me çështjet e dhunës dhe t'i vështirësojnë përpjekjet e aktivistëve dhe të autoriteteve relevante për të siguruar burime për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje.²¹⁷ Kërkimet kanë treguar se mbledhja e të dhënave në Kosovë ka qenë sporadike, e atypëratyshme, joanalitike dhe i ka munguar përgjigjja e koordinuar.²¹⁸ Është jashtëzakonisht i rëndësishëm zbërthimi i të dhënave bazuar në krimet e kryera, si dhe në gjininë, etnicitetin, moshën dhe informacionet e tjera demografike lidhur me viktimen dhe keqtrajtuesin.²¹⁹ Qeveria mund të shfrytëzojë të dhënat e tillë si dhe informacionin lidhur me kushtet potenciale që shpiejnë drejt dhunës siç është alkooli, drogat ose papunësia për të disejnuar intervenimet në të ardhmen si dhe programet, duke përfshirë parandalimin, mbrojtjen dhe masat e ndjekjes penale. Ekziston po ashtu nevoja për kërkime me shpërdoruesit për analizimin e shkaqeve që i kontribuojnë dhunës dhe praktikave të mira për zvogëlimin e sjelljes së dhunshme.²²⁰ Rezultatet nga kërkimi i tillë mund të janë të dobishme në adresimin e rrënës së shkaqeve të dhunës dhe zhvillimin e programeve të rehabilitimit për kryerësit e dhunës që për veprat e kundërvajtjes mund të janë më efikase nga aspekti i shpenzimeve se sa burgosja, posaçërisht ajo për kundërvajtje.

Në ditët e sotme, ministritë e Kosovës kanë disa të dhëna empirike në dispozicion, por atyre iu mungon personeli i kualifikuar, profesional që kupton rëndësinë e të dhënave, mënyrën se si të analizohen ato ose si të shfrytëzohen për përmirësimin e përgjigjes institucionale.²²¹ DAVA ka vetëm të dhëna minimale në dispozicion lidhur me kryerësit e dhunës dhe viktimat. Përfaqësuesit kanë thënë se UNMIK-u, që përpëra ka mbajtur të gjitha kompetencat lidhur me drejtësinë, nuk ka lëvizur asnjë prej dosjeve të tij ose nuk e ka ndarë informacionin e tij me institucionet kosovare.²²² Pak kërkime kanë monitoruar rregullisht

²¹⁶ ZSHS në Ferizaj, anketë e RRGGK-së, 2008.

²¹⁷ Propizimi i Planit të Veprimt të Këshilit të Evropës mbi "Dhunën kundër grave në Evropë" (1998).

²¹⁸ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

²¹⁹ KMDLNJ poashtu ka vërejtur nevojën për kërkim të mëtejmë lidhur me shkallën e dhunës në familje (analizë e RRGGK-së, 2008).

²²⁰ Medica Kosova, analizë e RRGGK-së. Ata kanë rekomanduar që kjo të mbikqyret dhe financohet nga Ministria e Drejtësisë, me OJQ-të që kryejnë kërkimin.

²²¹ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*.

²²² DAVA, bisedë telefonike e RRGGK-së, 2008.

profesionalitetin e gjykatave lidhur me rastet e dhunës në familje.²²³ Në vitin 2007, DAVA ka filluar të zhvillojë një bazë të re të të dhënave për monitorimin e rasteve të cilat i ka ndihmuar.²²⁴ Megjithëkëtë, AV-ët mbledhin vetëm informacion të pjesërishëm lidhur me viktimat dhe tash nuk kanë asnjë formë për mbledhjen e informacionit lidhur me kryerësit dhunës. DAVA krijon raporte katërmujore me të dhëna statistikore, të cilat janë të shfrytëzuara gjatë punëtorive dhe fushatave, por të cilat, përndryshe, nuk i janë vënë në dispozicion publikut. Të dhënrat statistikore nuk janë të rapportuara në asnjë institucion tjeter qeveritar. Tash, DAVA është e aftë vetëm të ofrojë informacion lidhur me numrin total të rasteve të ndihmuara pa kurrrafë zërthimi demografik ose gjeografik.

Departamenti i statistikave i Këshillit Gjyqësor të Kosovës po ashtu nuk ka pasur në dispozicion të dhëna statistikore lidhur me rastet e dhunës në familje. Tash, të gjitha dokumentet mbahen në kopje të shkruara në letër dhe njeriut i duhet të kalojë nëpër secilin rast për të mbledhur informacionin. Para viteve '90-ta të shekullit të kaluar, gjykatat kanë qenë të obliguara për të mbushur një formular standard për secilin rast dhe Enti i Statistikave të Kosovës ka mirëmbajtur të gjitha të dhënrat mbi rastet gjyqësore, por kjo procedurë nuk është ndjekur më tutje.²²⁵ Para një viti, Agjencia Evropiane e Rindërtimit (AER) i ka investuar tre milionë dollarë në krimimin e një baze të të dhënave për përdorim nga gjykatat, por pak gjykata kanë poseduar kompjuter deri në këtë vit kur janë blerë 500 kompjuterë të ri. Vitin e ardhshëm, gjykatat planifikojnë për të instaluar një bazë të re të të dhënave.

Secili stacion i policisë ka një zyrtar përgjegjës për përfshirjen e të dhënave në bazën e të dhënave të SHPK-së, që përfshihet në rrjetin e të gjitha regjioneve. Sektori i hulumtimit të dhunës në familje në drejtoretin kundër krimeve të rënda ka një bazë të veçantë të të dhënave për rastet e dhunës në familje të themeluar në vitin 2005. Policët kanë formularë të veçantë për të dyshuarit e veprave penale, viktimat, ankesat dhe dëshmitarët. Sektori krijon raporte mujore, katërmujore, semestrale dhe vjetore me rezyme të përmbajtjeve, por informacioni nuk është i publikuar. Publiku mund të ketë qasje vetëm ndaj të dhënave statistikore përmes mediave. Tash, SHPK-ja nuk është përgjegjëse për raportimin e të dhënave statistikore në cilindo institucion, përvèç prokurorët dhe gjykatat në rastet që janë në shqyrtim e sipër. SHPK-ja duhet të zgjerojë bazën e tashme të të dhënave me qëllim që të përfshijë më shumë informacion lidhur me keqtrajtuesit, të cilët mund të ndihmojnë në identifikimin e nevojave të rehabilitimit (pra, trajtimin për alkoolizmin, shpërdorimin e drogave, trauma e luftës),²²⁶ si dhe në vënien në dispozicion të më shumë të dhënave demografike lidhur me viktimat dhe kryerësit e dhunës.

Linjat e thirrjeve emergjente po ashtu shfrytëzojnë formularët standard për të mbledhur informacionin për raportimin e rasteve individuale, që duhet të përpilohen brenda pesë ditëve të punës nga data e pranimit të ankesës.²²⁷ Informacioni pastaj dorëzohet në DM dhe futet në një bazë të të dhënave mbi dhunën në familje. Megjithëkëtë,

²²³ Në korrik të vitit 2007, Misioni i OSBE-së në Kosovë, i mandatuar për monitorimin e gjykatave brenda administratës së UNMIK-ut, ka lëshuar një raport gjithëpërfshirës mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë dhe sjelljen e sistemit gjyqësorë në atë drejtim. Raporti *Ex Officio i Ombudspersonit* lidhur me zbatimin e nentit 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje në Kosovë ka monitoruar profesionalitetin e gjykatësve (nëntor 2006).

²²⁴ DAVA, analizë e RRGGK-së, 2008. Tash, informacioni është i ruajtur në formën e shkruar dhe ate elektronike.

²²⁵ I gjithë informacioni në këtë paragraf është nga Departamenti i statistikave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anketë e RRGGK-së, 2008.

²²⁶ Medica Kosova, anketë e RRGGK-së, 2008.

²²⁷ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 56.

DMS-ja nuk ka qenë në gjendje për të përbushur kërkesat e thjeshta për të dhënat demografike nga kjo bazë e të dhënavë e bërë në vjeshtë të vitit 2007 dhe sërisht në qershori të vitit 2008. Përkundër kërkesave në Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare mbi mbledhjen e të dhënavë statistikore, publikimin dhe promovimin e kërkimit nga Institutit për Politikë Sociale, një kërkim i tillë ende nuk është publikuar ose nuk është publikisht në dispozicion. Një burim i brendshëm i RRGGK-së ka thënë se megjithëse instituti më herët e ka përgatitur raportin, kurse MPMS ka refuzuar për të ndarë fonde për publikimin e tij për shkak të mungesës së vullnetit politik. "Përfaqësuesit nuk kanë dashur të pranojnë shkallën e dhunës," i ka thënë një burim RRGGK-së.²²⁸

Kanë munguar procedurat e Ministrisë së Shëndetësisë për dokumentimin lidhur me të gjitha rastet. Pak klinika, madje, mbajnë të dhëna mbi pacientët, fakt ky që e bënë të vështirë trajtimin cilësor, duke përfshirë këtu pranimin e rasteve të përsëritura të dhunës në familje.²²⁹ RRGGK-ja ka rekomanduar që Ministria "të kërkojë nga të gjitha klinikat të dokumentojnë numrin e pacientëve të trajtuar për të gjitha sëmundjet, duke përfshirë simptomat e dhunës. Nga të gjitha klinikat, ato private dhe publike, duhet të kërkohet të raportojnë të gjitha rastet e trajtuar për monitorim më të madh të çështjeve serioze shëndetësore në Kosovë."²³⁰ Në përgjithësi, dokumentacioni i përmirësuar dhe analizat e ndikimit shëndetësor të dhunës në familje janë të nevojshme në Kosovë.²³¹

Shumica e të dhënavë të mbledhura nga institucionet e lartpëremendura përbajnjë kategori të ndryshme të informacionit dhe asnjë agjenci nuk është përgjegjëse për përpilimin dhe analizën e të dhënavë nga të gjitha institucionet. Pas një shqyrtimi të sistemeve të tashme të mbledhjes së të dhënavë në Kosovë, RRGGK-ja ka argumentuar se autoritetet duhet të marrin përgjegjësinë për sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare për të mbledhur dhe analizuar të dhënat në tërsëi.²³² Zbërthimi i të dhënavë nga grupet socio-demografike, si dhe analizat e rrënës së shkaqeve të dhunës dhe të ndikimit të saj mbi shoqërinë mund të shpiejnë deri te politikat dhe intervenimet më adekuate. Së këndejmi, autoritetet duhet të zhvillojnë analiza të rregullta dhe konsistente të të dhënavë dhe të monitorojnë raportet e dhunës në familje duke përdorur formularët e standardizuar për raportim me një zbërthim të hollësishëm të grupeve të ndryshme socio-demografike. Të dhënat në dispozicion mund të ndihmojnë kërkesat e ardhshme të institucioneve dhe të OJQ-ve për burime adekuate njerëzore dhe financiare për ndihmën e viktimateve.

Me qëllim që të përmirësojë mbledhjen e të dhënavë dhe monitorimin e dhunës në familje në Kosovë, qeveria duhet të caktojë një Raportues për Dhunën në Familje në Kosovë si një organ i pavarur i monitorimit për mbledhjen e të dhënavë, identifikimin e zbratzëtive institucionale dhe përpilimin e rekomandimeve për përmirësimin e qasjes së qeverisë. Të gjitha institucionet të cilat merren me trajimin e çështjeve të dhunës në familje duhet të dorëzojnë të dhënat statistikore vjetore me informacionet demografike në këtë zyrë, që mund të financohet me kontributet nga ministritë e shumëfishta.²³³ Përgjegjësia kryesore e

²²⁸ Cituar në RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 56.

²²⁹ RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, 60.

²³⁰ Po aty.

²³¹ Shtëpi e sigurtë Gjakova, anketë e RRGGK-së, 2008.

²³² RRGGK, *Hulumtim kërkimor*, kapitulli tre.

²³³ Zyra e Raportuesit kombëtar është sugjeruar për mbledhjen, analizimin dhe monitorimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë. Për sugjerime të mëtejme mbi rolet dhe përgjegjësitë e Raportuesit kombëtar, shih Raportin mbi themelimin e mekanizmave të referimit për viktimat e trafikuara, të Misionit të OSBE-së në Kosovë, tetor 2007, pjesa e Rekomandimeve.

saj do të ishte krijimi i raporteve vjetore mbi adresimin e dhunës në familje, parandalimin, mbrojtjen dhe objektivat e ndjekjes penale.

Pos kësaj, qeveria duhet të sigurojë mbështetjen financiare dhe/ose të inkurajojë donatorët ndërkombëtarë për të financuar organet, siç janë OIQ-të për të kryer monitorimin në vazhdim mbi shkallën e dhunës në familje në Kosovë, profesionalitetin e institucioneve në përgjigjen e tyre ndaj dhunës në familje dhe përpunimin e rasteve nëpër gjykata. Auditimi i pavarur mund t'i kontribuojë rritjes së besimit të qytetarëve në transparencën e institucioneve dhe të qeverisë, si dhe të ofrojë ekspertizë dhe ide të reja për përmirësimin konstant të shërbimeve të ofruara nga qeveria për qytetarët e saj. Në përfundim, një zyrtar i SHPK-së ka thënë:

Ky vërtet është një hulumtim i rëndësishëm [...] dhe unë e mbështes atë, por mendoj se institucionet qeveritare duhet të jenë më të angazhuara. Planet, siç është [Plani kombëtar i veprimit kundër dhunës në familje], nuk duhet të ekzistojnë vetëm sa për sy e faqe, por ato kanë nevojë të zbatohen, posaçërisht kur ne merremi me rastet e dhunës në familje. Ne të gjithë e dimë se nëse kemi familje të shëndetshme, do të kemi një shtet të shëndetshëm.²³⁴

²³⁴ Anketë e RRGGK-së, 2008.

PËRMBLEDHJE TË REKOMANDIMEVE

Për reformën ligjore dhe legislative:

- Të formojë një organ kombëtar ose grup të këshilltarëve me një varg profesionistësh të lartë dhe ekspertësh që do të jenë përgjegjës për luftën kundër dhunës në familje. Agjencia për Barazi Gjinore duhet të mbështes organin qeveritar të organit këshillues nën përgjegjësinë e Kryeministratit të Kosovës.
- Të hartojë dhe miratojë Planin kombëtar të veprimit kundër dhunës në familje me një mandat të qartë lidhur me atë se cili organ ose cila agjenci është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij.
- Të krijojë një grup punues legjislativ për të shqyrtuar kornizën ligjore me qëllim të sigurimit masave adekuate të mbrojtjes për viktimat. Shqyrtimi duhet të zhvillojë udhëzime të qarta mbi zbatimin ose ndryshimin e ligjeve në mënyrë që viktimat të kenë mundësi ndaj rirregullimit, kompensimit dhe mbrojtjes. Duhet të largojë vështirësitë e tashme dhe pjesët e paqarta të legjislacionit ose aspektet e ligjit që nuk janë në përputhje me fokusin e dhunës në familje si krim.
- Të hartojë dhe miratojë një ligj të gjithanshëm mbi dhunën në familje në vend të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje. Dhuna në familje duhet të konsiderohet një vepër penale dhe duhet të garantohen mbrojtja, siguria dhe alternativat e strehimit banesor ose shtëpiak për viktimat e dhunës në familje. Ligji duhet të bazohet në Rreguloren e UNMIK-ut nr. 2003/12 dhe qartësisht të përkufizojë rolet dhe përgjegjësitë e agjencive të mandatuara për zbatimin e Rregullores.
- Të përkufizojë më tej rolet dhe përgjegjësitë e secilës agjenci të përfshirë në mbrojtjen dhe ndjekjen penale përmes politikave dhe Procedurave standarde të veprimit.
- Të krijojë mekanizma ligjorë efikas mbi mbrojtjen e viktimës nga dhuna në familje përmes angazhimit të gjykatave që prioritet t'i kenë rastet e dhunës në familje.
- Të ndryshojë legjislacionin e ndihmës ligjore me qëllim të sigurimit të përfaqësimit ligjor profesional për viktimat në gjykata.
- Të përfundojë aktivitetet tanimë te nisura për hartimin e ligjit të ri mbi donacionet e liruara nga tatimi për organizatat joftimprurëse dhe joqeveritare.

Për të gjitha institucionet:

- Të krijojë një program mandator të rehabilitimit për keqtrajtuesit kur atyre iu jepet trajtimi profesional përmes adresimit të rrënjeve të shkaqeve, siç është trauma e fëmijërisë, trauma e luftës, papunësia, alkoolizmi ose sëmundjet e tjera të varësisë.
- Të sigurojë mbështetjen për strehimoret ekzistuese me shërbimet e mëposhtme: kujdesi adekuat psikologjik i ofruar nga profesionistët e kualifikuar, me përvojë; këshillimi familjar; ndihma në gjetjen e punësimit; strehimi i sigurt; kujdesi shëndetësor pa pagesë; shkollimi; trajnime të shkathtësive në punë; ndihma ligjore dhe monitorimi në vazhdimësi për t'u siguruar se situata është e qëndrueshme pas kthimit të tyre në shtëpi.
- Të krijojë një program afatgjatë të reintegrimit për viktimat e dhunës i cili iu siguron atyre dhe fëmijëve të tyre strehimin banesor të subvencionuar, trajnimet mbi bazën e shkathtësive, mbështetjen psikologjike dhe mbikëqyrjen në pajtim me një program të individualizuar, derisa ata të mund të mbijetojnë pavarësisht.

- Të sigurojë trajnime të papagesë ose të arritshme profesionale për grupet e rrezikuara, posaçërisht për gratë, të cilat mund t’iu ndihmonin atyre të sigurojnë punësimin dhe potencialisht të zvogëlojnë dhunën.
- Të sigurojë se të gjithë shërbyesit publikë të përfshirë në mbrojtjen e viktimave dhe në ndjekjen penale të kryerësve të dhunës, posaçërisht punëtorët socialë, pjesëtarët e policisë nga njësia e kundër dhunës në familje, avokatët e viktimave, prokurorët, gjykatësit, arsimtarët dhe punëtorët shëndetësorë të kenë aftësimë multidisplinare të vazhdueshme nga IGJK-ja mbi dhunën në familje, ligjin dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, praktikat sociale dhe kulturore të cilat mund t’ë mos i vënë re sjelljet e dhunshme dhe barazinë gjinore. Aftësimi duhet të bazohet në procedurat ekzistuese dhe manualet për ndihmën lidhur me klientët e dhunës në familje, mbështetjen e përgjegjës multiagjenciore dhe koordinimin. Aftësimet duhet të kenë komponentën gjinore.
- Të kryejë, së paku, rishikime vjetore dhe vlerësimë të cilësisë së kryerjes së punës të punëtorëve socialë, policëve, avokatëve të viktimave dhe gjykatësve. Të zhvillojë masa disiplinore për të siguruar se ata kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase si dhe masa për t’u siguruar që dëmtimi i mëtejmë i viktimave të jetë minimal.
- Të zhvillojë një shërbim efikas të informimit me linja funksionale, 24 orëshe, të papagesë të thirrjes për ndihmë në mënyrë që personat të cilët përfjetojnë dhunën të mund të thërrasin për këshillim konfidencial, asistencë dhe, sipas nevojës, edhe për referim. Të krijohet një linjë e përhershme buxhetore për të mbuluar shpenzimet e linjave për thirrje për ndihmë dhe aftësimin e personelit për ofrim të informacionit mbi shërbimet në dispozicion.
- Të organizojë bashkërisht fushata të ndërgjegjësimit publik dhe të aktiviteteve të kontaktimit të komuniteteve në terren lidhur me dhunën në familje, që: qartësojnë, me shprehje të thjeshta, të drejtat e qytetarëve në pajtim me ligjin; përkufizojnë se çka përfshin dhuna në familje, duke përfshirë posaçërisht dhunimin martesor; zhveshin mitet e identikuara përmes këtij kërkimi se rrethana të posaçme e bëjnë dhunën të lejueshme ose “të pranueshme” (duke përfshirë atë kundër grave, fëmijëve, minoritetëve seksuale dhe njerëzve me aftësi të kufizuara). Të involvojë ndihmën e mashkullit, si dhe atë të mediave, për shembull, përmes serialeve televizive, të cilat përmbajnë zgjidhje për situatat e dhunshme, njoftime të shërbimit publik, emisione të bisedave dhe debate të publikuara. Informimi duhet të ketë në shënjestër komunat e Fushë Kosovës, Skenderajit, Klinës, Lipjanit dhe Shtimes; gratë, njerëzit me përgatitje shkolllore më të ulët se sa ajo e mesme; të papunët; familjet me të hyra të ulëta dhe familjet ose miqtë e njerëzve që kanë përfjetuar dhunën me mesazhe lidhur me atë se si ata mund të ndihmojnë (pra, raportimi i dhunës, referimi i saj etj.)
- Të organizojë në zonat rurale programe të kontaktimit me komunitete në terren dhe iniciativa kulturore të cilat përfshijnë mesazhe lidhur me dhunën në familje. Shumica e popullatës banon në zonat rurale dhe qytetarët atje janë më të prirur t’i shtrohen rrezikut të dhunës, por kanë më pak qasje dhe njoħuri mbi ndihmën institucionale në dispozicion për ta.
- Të krijojë dhe të shpérndajë pamflete në stacionet policore, qendrat shëndetësore, QSP-të, organizatat lokale dhe gjykatat me informacion lehtësish të kuptueshëm lidhur me ligjin dhe shërbimet në dispozicion për viktimat dhe personat të cilët mund t’i ndihmojnë ata.

- Shfrytëzimi i emisioneve me biseda dhe i fushatave prindërore të edukimit për të mbështetur idenë se disiplina e barabartë dhe posaçërisht ajo e padhunshme mund të përmirësojë zhvillimin e fëmijëve, si për vajzat ashtu edhe për djemtë.
- Të zbatojë Ligjin kundër diskriminimit dhe të sigurojë se të gjithë qytetarët kanë qasje ndaj të drejtave të barabarta, duke përfshirë trashëgiminë e pronës, qasjen e barabartë në shkollim, përfaqësimin në qeveri dhe shanset e punësimit, me gjasë, ndoshta përmes stimulimeve tativore për bizneset.
- Të krijojë qendra të arritshme të kujdesit për fëmijët, në të cilat gratë mund të paguheshin për këtë punë e cila tash nuk paguhet që do t'i mundëson më shumë grave për të punuar.

Për SHPK-në:

- Të kërkojnë nga zyrtarët e policisë që t'i nënshtronen trajnimit të mëtejmë mbi interaksionin me njerëzit të cilët kanë përjetuar dhunën në familje dhe eliminimin e stereotipeve dhe paragjykimeve.
- Të sigurojnë qasjen kualitative përmes përfshirjes së zyrtarëve të lartë për monitorim të zyrtarëve së paku në baza vjetore.
- Të përmirësojnë teknikat policore të hetimit, posaçërisht në përgjigjet ndaj dhunës në familje.
- Të vënë më shumë theksin në largimin e kryerësve të dhunës nga shtëpitë e tyre (në vend të viktimate), posaçërisht në rastet kur viktimat kanë fëmijë të cilët mund të janë në rrezik.
- Të shfrytëzohen përpjekjet e tashme të policisë në komunitet për të shpërndarë informacionin lidhur me dhunën në familje.
- Të krijohen dhoma plotësuese private në stacionet e policisë për intervistik konfidencial të personave të cilët kanë përjetuar dhunën. Derisa i marrin deklaratat, policët duhet të kenë parasysh mirëqenien emocionale të viktimateve.

Për MPMS, DMS dhe QPS-të:

- Të krijohet një grup punues për të qartësuar sigurimin e një financimi të qëndrueshëm së paku në baza dyvjeçare për OJQ-të në pajtim me Ligjin mbi familjen dhe shërbimet sociale.
- Të vazhdohet të shfrytëzohen shërbimet profesionale dhe strehimoret e ofruara nga OJQ-të për viktimat e dhunës në familje. Të rishqyrtohen rregullisht profesionaliteti dhe kualiteti i shërbimeve të siguruara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin mbi familjen dhe shërbimet sociale.
- Të mbështetet themelimi i grupeve të lartpërmendura të vetëndihmës për keqtrajtuesit.
- Të sigurohet informacion lehtësish i kuptueshëm lidhur me dhunën në familje dhe vendet ku të merret ndihma konfidenciale në QPS-të, si dhe për të gjithë qytetarët të cilët janë në asistencë sociale.
- Të rritet shuma mujore e asistencës sociale.
- Të bëhet këshillimi psikologjik nga profesionistët e trajnuar për viktimat, kryerësit e dhunës, çiftet dhe familjet që janë financiarisht dhe gjeografikisht në dispozicion dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Për Sistemin e Drejtësisë, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Të zbatojë ligjin ekzistues lidhur me pronën, barazinë gjinore dhe dhunën në familje.
- Të sigurojë se ndahen fonde adekuate nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me qëllim të rritjes së numrit të gjykatësve, të rris kompensimet për gjykatësit si dhe të rris numrin e personelit.
- T'i vë në dispozicion shanset për rishqyrtim emergjent të rasteve në rrezik të madh dhe t'i ketë prioritet rastet e dhunës në familje. Të ketë parasysh krijimin e gjykatave familjare të cilat do të merreshin me të gjitha rastet e lidhura me dhunën në familje dhe mosmarrëveshjet familjare.
- Të ofrojë, së paku, trajnim vjetor për gjykatësit dhe prokurorët nga Instituti Gjyqësor i Kosovës mbi legjisacionin lidhur me dhunën në familje dhe barazinë gjinore. Të aftësojë personelin i cili merret me rastet e dhunës në familje për të shfrytëzuar qasjen psikosociale gjatë procedurave ligjore.
- Të rrënjos procedurat e lehta të dokumentacionit posaçërisht për rastet e dhunës seksuale me qëllim që të shmanget rivictimizimi dhe/ose margjinalizimi i viktimateve.
- Të hetojë në mënyrën e duhur dhe të ndjek penalisht krimet e kryera në kuadër të marrëdhënieve familjare, duke përfshirë dënimë më të larta në pajtim me ligjin në fuqi.
- Të sigurojë qasjen për ndihmë ligjore për viktimat. Këshilluesit ligjorë, sipas projektit të ndihmës ligjore, duhet t'i ndihmojnë Avokatët e Viktimateve në obligimin e tyre të ruajtjes së të drejtave të viktimateve.
- Të përmirësojnë efikasitetin e sistemit juridik përmes zvogëlimit të nepotizmit, rritjes së profesionalizmit dhe sigurimit të ndjekjes penale më të shpejtë të rasteve.

Për strehimoret:

- Të zhvillojnë strategji financiare afatgjata dhe afatmesme për mbrojtjen, për reintegrimin efikas si dhe për planet e përcjelljes së viktimateve. Duhet të eksplorohet financimi nga komuniteti.
- Të sigurohet se i gjithë personeli i strehimoreve, i cili merret me klientët, të ketë kryer me sukses aftësimin e avancuar mbi krijimin e besimit me klientët, identifikimin e traumës, këshillimin profesional, fuqizimin e klientëve dhe integrimin e traumës. Aftësimet duhet të janë të vazdueshme dhe profesionale dhe jo afatshkurtar.
- Të bashkëpunojnë ngushtësisht me institucionet e tjera për të krijuar programe të reintegrimit dhe të monitorimit për viktimat e dhunës në familje.

Për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave:

- Të krijojë linjë buxhetore specifike në të cilën të gjitha ministritë mund të kontribuojnë për linja specifike të zërave të lidhura me funksionimin e strehimoreve (pra, Ministria e Shëndetësisë me shpenzimet mjekësore, MPMS me ushqimin dhe veshmbathjen, MASHT me arsimimin dhe trajnimin etj.)
- Të ofrojë lehtësira tatimore dhe programe të veçanta të kredive për të inkurajuar punëdhënësit për të punësuar personat që janë më së shumti të rrezikuar nga dhuna, të identifikuar përmes kërkimit.

Për Ministrinë e Shëndetësisë:

- Të krijojë një ekip multidisiplinar për trajtim mjekësor, rehabilitim dhe kujdes psikologjik për të gjitha viktimat e dhunës në familje. Të ofrojë këshillimin për kujdesin shëndetësor dhe ate psikologjik pa pagesë për personat në strehimore.
- Të edukojë profesionistët shëndetësorë në identifikimin e shenjave të dhunës në familje (pra, përmes anamnezës psikosociale), të raportojnë dhunën në pajtim me ligjin, dhe të përdorin qasjen sensitive kur trajtojnë viktimat me qëllim të parandalimit të ritraumatizimit.
- Të bëhet pjesë e një mekanizmi të koordinuar të referimit me qëllim të identifikimit të dhunës në familje, t'iu ndihmojë viktimate dhe t'i referojë ato në shërbimet kur procedurat e veprimit të jenë të hartuara.

Për Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë:

- Të sigurojë për të gjithë qytetarët qasje të barabartë ndaj shanseve të shkollimit, posaçërisht ndaj grave, të varfërve, minoriteteve (RAE), njerëzve me nevoja të veçanta dhe njerëzve të zonave rurale.
- Të siguroj bursa të shkollimit për grupet e rrezikuara të lartpërmendura me qëllim që të rris nivelin e tyre të shkollimit dhe, së këndejmi, të shanseve të punësimit.
- Të shqyrtojë planet dhe programet e shkollimit fillor dhe të mesëm lidhur me sigurimin se ato në mënyrë adekuate përfshijnë informacione për dhunën në familje, edukatën seksuale dhe edukatën familjare. Revidimi është i nevojshëm.
- Gjatë projekteve të informimit t'i ketë në shenjestër prindërit dhe informimin e tyre lidhur me atë se si arsimimi i lartë për gratë dhe meshkujt mund të përmirësojë gjendjen ekonomike të familjes në shtigje kohore afatgjata. Duke përcjellur praktikat e mira të fushatave të përparshme, spotet e mediave mund të përfshijnë mesazhe nga pjesëtarë të njojur të komunitetit, ikonat kulturore dhe rrëfimet e suksesshme vendore lidhur me rëndësinë e shkollimit.

Rekomandime për qeverinë lidhur me kërkimin dhe monitorimin:

- Të zhvillojë analiza të rregullta dhe konsistente të të dhënave dhe të monitorojë raportet mbi dhunën në familje. Të gjitha ministritë përkatëse duhet të përdorin formularët e standardizuar të raportimit. Ekzistenca e të dhënave me zbërthim sociodemografik, analiza e rrënijëve të shkaqeve të dhunës dhe e efekteve të saj mbi shoqërinë mund të shpie tek intervenimet dhe politikat e duhura.
- Të emërojë një Raportues të dhunës në familje si një organ i pavarur i monitorimit përgjegjës për mbledhjen e informacionit, identifikimin e zbrazëtive institucionale dhe bërjen e rekomandimeve për përmirësimin e qasjes së qeverisë. Përgjegjësi e tij do të ishte krijimi i një raporti vjetor mbi dhunën në familje me informacionin që lidhet me parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen penale.
- Të mbështes finanziarisht dhe teknikisht kërkimin nga OJQ-të në përputhje me punën e cila është duke u zhvilluar në nivel kombëtar.
- Të udhëheq analiza të rregullta në shtrirje të Kosovës, siç janë ato prej pesë deri në dhjetë vite, në mënyrë që institucionet dhe organizatat të mund të monitorojnë ndryshimet në percepionin e njerëzve dhe në prevalencën e dhunës në familje. Të sigurojë se organizatave ose institucioneve, që udhëheqin kërkimin, iu është ndarë kohë e mjaftueshme për të kryer kërkimin në mënyrën e duhur.

PUNIMET E CITUARA

(Në kuadër të fusnotave, kahas teksteve të fusnotave me karakter eksplikativ, janë përkthyer, për lehtësim të komunikimit të drejtpërdrejtë me tekstin, të gjitha veprat e cituara. Po ashtu, sipas praktikës standarde të përkthimit, në kuadër të literaturës, titujt e veprave në origjinal nuk përkthehen. V.e P.)

- Assembly of Kosovo. Constitution. Available at <http://www.kushtetutaekosoves.info>.
- _____. *Kosovo National Action Plan on the Achievement of Gender Equality*. Prishtina: 2003. At <http://www.unmikonline.org/civpol/gender/doc/Kosovo-Action-Plan-for-gender-Equality.pdf>.
- Basha, Vlora and Hutter, Inge for UNFPA, Population Research Centre of Groningen, and Index Kosova. *Pregnancy and Family Planning in Kosovo: A Qualitative Study*. Prishtina: December 2006.
- Centre for Protection Women and Children (CPWC). *Annual Report 2002*. Prishtina: CPWC, 2003.
- _____. *Annual Report 2003*. Prishtina: CPWC, 2004.
- _____. *Social Map on Women of Kosova 1995-2000: Sociological Interpretation*. Prishtina: CPWC, 2004.
- Charlesworth, H. and Chinkin, C. *The Boundaries of International Law: A Feminist Analysis*. Chapter 7. Manchester University Press, 2000.
- Clark, Cari. "Gender-based Violence Research Initiatives in Refugee, IDP, and Post-Conflict Settings: Lessons Learned" (Working Paper No. 17, Reproductive Health for Refugees Consortium (RHRC), 2003.
- Corrin, Chris. "Post-conflict Situation in Kosovo," *International Feminist Journal of Politics* 3(1). Routledge, 2000.
- Council of Europe. "Summary Action Plan Proposal on Violence Against Women." 1998.
- Danilda and Leander. "The Worst Scars are on the Inside." *Methods for counteracting violence against women*. Operation Kvinnofrid. 1999.
- Ellsberg., M. "Violence against women and the Millennium Development Goals: Facilitating women's access to support." *International Journal of Gynecology and Obstetrics*. 2006.
- Evans, Tony. *Introduction: power, hegemony and the universalisation of human rights, in Human Rights Fifty Years on: A reappraisal*. Edited by Tony Evans. Manchester; New York: Manchester University Press, 1998.
- Government of Portugal. "Resolution on the National Plan Against Domestic Violence 2003-2006," approved by the Council of Ministers on May 13th, 2003.
- Haiman, Peter. "Protecting a Child's Emotional Development When Parents Divorce." *The Natural Child Project*. 2007. Available at: www.naturalchild.org/guest/peter_haiman3.html.
- Heise, L., Ellsberg, M., and Gottmoeller, M. "A Global Overview of Gender-Based Violence." *International Journal of Gynecology and Obstetrics*. 2002 Sep; 78 Suppl 1:S5-14.
- Heise, L., Ellsberg, M and Gottemoeller, M. "Ending Violence against Women." *Population Reports. Series L: Issues in World Health*. 1999 December. (11):1-43.

- Heise, Lori. "Gender-based abuse: the global epidemic." *Cad. Saúde Pública*. Vol. 10 suppl. 1. Rio de Janeiro, 1994.
- Humphrey, James H. *Helping Children Manage Stress: A Guide for Adults*.
- Hynes, M. and Cardozo, B.L. "Sexual Violence against Women in Refugee Settings." *Journal of Women's Health and Gender-based Medicine*. 9. no. 8. 2000.
- Inter-American Development Bank. "Too close to home: Domestic Violence in the Americas." Loerto Biehl, Andrew Morrison eds. Johns Hopkins University Press. 1999.
- Jaffe, P. and Sudermann, M., "Child Witness of Women Abuse: Research and Community Responses," in Stith, S. and Straus, M., Understanding Partner Violence: Prevalence, Causes, Consequences, and Solutions. Families in Focus Services, Vol. II. Minneapolis, MN: National Council on Family Relations, 1995.
- Kosova Women's Network (KWN). By Nicole Farnsworth. *Exploratory Research on the Extent of Gender-Based Violence in Kosova and Its Impact on Women's Reproductive Health*. Prishtina, Kosova: KWN. 2008.
- _____. "Needs Assessment of Shelters." Internal Report. 2007.
- _____. By Lynne Alice. *Monitoring Implementation of United Nations Security Council Resolution 1325 in Kosovo*. Prishtina: KWN, 2007.
- KWN, KWI, and UN Country Team in Kosovo. *Voice of Women*. Prishtina: December 2004.
- Kosovo Police Service. "Paraqitja tabelore e punës në gjashtë mujorin e pare / 2007."
- Krug, E., Mercy, J., Dahlberg, L., and Zwi, A. "The world report on violence and health," *The Lancet*, Vol. 360, Iss. 9339, pp. 1083 – 1088.
- Liebert, Mary Ann "Women, war and violence: Surviving the Experience," *Journal of Women's Health*, Vol. 17, Nr. 5 (2008), 793.
- Medica Mondiale Kosova. *Stop Violence against Women*.
- Murray, S. and Graham, L. Practice based health needs assessment: use of four methods in a small neighbourhood." *BMJ*. 1995. 310:1443-1448.
- National Advisory Council on Violence against Women, Violence against Women Office, U.S. Department of Justice "Ending Violence Against Women: An Agenda for the Nation."
- National Crime Prevention Council. *Safety and Savings: Crime Prevention Through Social Development*. Canada, March 1996.
- Newton, C.J. "Domestic Violence: An Overview." *Mental Health Journal*. February, 2001.
- Official Gazette of the Socialist Autonomous Province of Kosovo (SAP) of Kosovo. No.13/81. Law on Public Peace and Order.
- Ollett, B. "Alcohol and crime: a Women's Aid Perspective: Causes of Domestic Violence" From *Problems to Solutions*, Alcohol and Crime conference proceedings, Alcohol Action Wales. 1994.
- Ombudsperson Institution. "Acting Ombudsperson's Annual Report to the Kosovo Assembly (2006-2007)." Available at <http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/raporti/20parafinal/20anglisht.pdf>.
- _____. "Ombudsperson Institution in Kosovo Report concerning the Implementation of Section 7 and 9 of UNMIK Regulation 2003/12 on Protection Against Domestic Violence, *Ex Officio*" Registration No. 1/06 (November 2006).

- OSCE Mission in Kosovo. "Assessment Report on the Establishment of Referral Mechanisms for Victims of Trafficking in Human Beings." October 2007.
- _____. Department of Human Rights and Rule of Law Monthly Reports. August 2005.
- _____. "Report on Cases of Domestic Violence in Kosovo." July 2007.
- _____. "Report on the Centres for Social Work: Social Services." February 2003.
- _____. "A review of the Criminal Justice System in Kosovo." 1 September 2000-28 February 2001. Department of Human Rights and Rule of Law, OSCE Mission in Kosovo.
- OSCE and the Ministry for Labour and Social Welfare (MLSW). *Responding to Incidents of Domestic Violence: Manual for Social Services Officers*. Prishtina: January 2006.
- Osofsky, J. "The Impact of Violence on Children." *The Future of Children: Domestic Violence and Children* (1999) 9(3):33-49 in C. J. Newton, "Domestic Violence: An Overview" Find Counseling.com (formerly TherapistFinder.net) Mental Health Journal in February, 2001. At: <http://www.findcounseling.com/journal/domestic-violence/domestic-violence-effects.html>.
- Parliamentary Assembly of Council of Europe Recommendation 1450 (2000), Violence against women in Europe at <http://assembly.coe.int>
- _____. Recommendation 1582 (2002), Domestic violence against women at <http://assembly.coe.int>.
- Philipps, Anne. "Multiculturalism, Universalism and the Claims of Democracy." in M Molyneux and S Razavi (eds). OUP, 2002.
- Phillips, Janet. Parliament of Australia. "Domestic Violence in Australia – an overview of the issues." E-brief: Online only, 7 August 2003. At http://www.aph.gov.au/library/intguide/SP/Dom_Violence.htm.
- Quigley, B.M. and Leonard, K.E. "Alcohol and the Continuation of Early Marital Aggression," *Alcoholism: Clinical and Experimental Research*, Vol. 24(7) (Research Society on Alcoholism, 2000), 1003-1010.
- Reitzel, D. and Gough, R., "Strategies to Address Violence in the Lives of High Risk Youth." In Peled, E., Jaffe, P.G. and Edleson, J.L. eds. *Ending the Cycle of Violence: Community Responses to Children of Battered*.
- Rizvanolli, I., Bean, L. and Farnsworth, N. "Kosovar Civil Society Report to the United Nations on Violence against Women." KGSC: 2005.
- Roth, D. L. and Coles, E. M. "Battered woman syndrome: a conceptual analysis of its status vis a vis DSM-IV mental disorders," *Medicine and Law*. Vol. 14(7-8) (1995), 641-658.
- Schuler, Margaret. "Put our World to Rights' in Institute for Women, Law and Development." *Claiming Our Place: Working the Human Rights System to Women's Advantage*. Washington: Institute for Women, Law and Development. 1993.
- Statistical Office of Kosovo (SOK). *Labour Market Statistics*. Prishtina: SOK, 2004.
- _____. *Demographic Changes of the Kosovo Population, 1948-2006*.
- Straus, M. Understanding Partner Violence: Prevalence, Causes, Consequences, and Solutions. Families in Focus Services, Vol. II. Minneapolis, MN: National Council on Family Relations. 1995.
- Tickner, J. Ann. *Gender in International Relations*. New York: Columbia University Press, 1992.

- United Nations. Beijing Platform of Action from the Fourth World Conference for Women. 1995.
- _____. Committee on the Elimination of Discrimination Against Women. "Report of the Committee on the Elimination of Discrimination Against Women," 22nd and 23rd Session, UN doc. A/55/38, 17 August 2000, paragraph 102 at <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/committee.htm>.
- _____. Convention on Elimination of All Forms of Discrimination Against Women. 1979. Available at <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>.
- _____. Convention on the Rights of the Child. 1989. At <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>.
- _____. Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power adopted by the General Assembly Resolution 40/34 of 29. November 1985. At <http://www2.ohchr.org/english/law/victims.htm>.
- _____. Security Council Resolution 1325 on Women, Peace and Security at <http://www.peacewomen.org/un/sc/1325.html>.
- United Nations Children's Fund (UNICEF). Innocenti Research Centre. "Domestic Violence against Women and Girls." Florence, Italy. June 2000.
- _____. *Situation Analysis on Women and Children in Kosovo*. Prishtina: UNICEF, June 2008.
- United Nations Development Programme (UNDP). Human Development Report. *Youth – A New Generation for a New Kosovo*. Prishtina: UNDP Office in Kosovo, 2006. Available at http://www.ks.undp.org/repository/docs/hdr_eng.pdf.
- United Nations Fund for Women (UNIFEM). Rachel Wareham. *No Safe Place*.
- United Nations Mission in Kosovo (UNMIK). UNMIK Regulation 2001/36 on the Kosovo Civil Service.
- _____. UNMIK Regulation 2003/01 Amending the applicable law on Criminal Offences related to Sexual Violence.
- _____. UNMIK Regulation 2003/12 on Protection Against Domestic Violence.
- _____. UNMIK Regulation 2003/25 on the Provisional Criminal Code of Kosovo.
- _____. UNMIK Regulation 2003/26 on the Provisional Criminal Procedure Code of Kosovo.
- _____. UNMIK Regulation 2004/18 promulgating the Kosovo Assembly Law on Gender Equality, No 2004/02 at <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/>.
- _____. UNMIK Regulation 2004/32 promulgating the Kosovo Law on Anti-discrimination 2004/03.
- _____. UNMIK Regulation 2005/46 on the Promulgation of Kosovo Assembly Law on Social and Family Services No.02/I-17.
- _____. UNMIK Regulation 2006/6 on the Ombudsperson Institution in Kosovo.
- _____. UNMIK Regulation 2006/7 on the promulgation of the Kosovo Assembly Law on Family, No 2004/32 at <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/>.
- _____. UNMIK Regulation 2006/36 on Legal Aid in Kosovo, Section 10. 7 June 2006.
- _____. and OGA. *Women and Men in Kosovo*. 2003.
- United Nations Population Fund (UNFPA) "A Case Study of Gender-Based Violence in Kosovo." 2005.
- United Nations team. Millennium Development Goals Baseline Report for Kosovo. "Where will we be in 2015?" March 2004.

- Vienna Declaration on Human Rights. 1993. Available at
[http://www.unhchr.ch/huridocda/huridoca.nsf/\(Symbol\)/A.CONF.157.23.En](http://www.unhchr.ch/huridocda/huridoca.nsf/(Symbol)/A.CONF.157.23.En)
- Weber, Renate and Watson, Nicole eds. *Women 2000: An Investigation into the Status of Women's Rights in Central and South-Eastern Europe and the Newly Independent States.* Vienna: International Helsinki Federation. 2000.
- Wolfe, D.A., Wekerle, C., Reitzel, D. and Gough, R., "Strategies to Address Violence in the Lives of High Risk Youth." In Peled, E., Jaffe, P.G. and Edleson, J.L. (eds.), *Ending the Cycle of Violence: Community Responses to Children of Battered Women.* New York: Sage Publications. 1995.
- White, H.R. and Chen, P-H "Problems drinking and intimate partner violence," *Journal of Studies on Alcohol*, 63 (2002), 205–214.
- World Health Organization. "Addressing violence against women and achieving the Millennium Development Goals." Geneva, Switzerland, Department of Gender, Women and Health, World Health Organization. 2005.
- Women's Wellness Centre et al. *Prevalence of Gender-based Violence: Preliminary Findings from a Field Assessment in Nine Villages in the Peja Region, Kosovo.* Peja: WWC, 2006.
- Zuckerman, Elaine and Greenberg, Marcia E. "The Gender Dimensions of Post-conflict Reconstruction."

Shtojca 1

Përbledhja e kërkimit paraprak mbi dhunën në familje në Kosovë¹

Qëllimi i kësaj përbledhjeje të shkurtër është të identifikojë dhe shqyrtojë shkurtimisht kërkimin paraprak lidhur me dhunën në familje në Kosovë. Kërkimi i kohëve më të fundit lidhur me dhunën kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, është kryer nga RRGGK-ja me mbështetjen e UNFPA-së, i titulluar si *Hulumtim kërkimor mbi shkallën e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi i saj në shëndetin reprodukues të grave*. RRGGK-ja ka zbatuar metodologjinë e metodave të përziera që përfshijnë intervistat e hollësishme me 51 gra të cilat kanë përjetuar dhunën dhe 96 profesionistë (pra, ZSHS-të, zyrtarë të SHGPK-së, AV-ët, përfaqësuesit e strehimoreve dhe gjinekologët). Bazuar në të dhënat ekzistuese statistikore në dispozicion nga institucionet dhe raportet paraprake, kjo rezyme përbledh shkallën e formave të ndryshme të dhunës mbi baza gjinore në Kosovë, grupet demografike potencialisht në rrezik më të madh dhe pastaj analizon ndikimin e dhunës në shëndetin riprodhues të grave. Raporti përfundon me rekomandimet për institucionet dhe organizatat e caktuara.

Në korrik të vitit 2007, Misioni i OSBE-së në Kosovë i mandatuar me monitorimin gjyqësor përbrenda administratës së UNMIK-ut, ka nxjerrë një raport të gjithëmbarshëm mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë dhe zhvillimin e drejtësisë në këtë drejtim. Raporti i mëhershëm zyrtar i Ombudspersonit lidhur me zbatimin e nenit 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje ka monitoruar profesionalitetin e gjykatësve në përpunimin e rasteve të dhunës në familje (Nëntor 2006).

Në vitin 2006, duke shfrytëzuar kërkimet e bëra në komunën e Pejës, Qendra e Mirëgenies së Grave, Përgjigjja Shëndetësore Riprodhuese në Partneritetin ndaj Konfliktit, dhe Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë publikuar *Prevalencën e dhunës në baza gjinore: Rezultatet preliminare nga një vlerësim në terren në nëntë fshatra në Rajonin e Pejës, Kosovë*. Metodologjia ka përfshirë intervistat me 332 gra të moshave prej 18 deri 49 lidhur me dhunën e përjetuar nga duart e anëtarëve të familjes si dhe “faktorët e armatosur” të jashtëm gjatë luftës (1988-1999), zhvendosjet (1998-1999), dhe periudhat pas luftës (1999-Gusht 2002). Kërkimi ka shqyrtaur llojet e dhunës së kryer, lëndimet, dhunën që ka rezultuar në shtatëzani, burimet e ndihmës, dhe shëndetin emocional të të anketuarve.²

Në vitin 2005, Qendra për Studime Gjinore e Kosovës (QSGJK) ka kërkuar dhe përpiluar një Raport të shkurtër të shoqërisë civile kosovare drejtuar mbi dhunën kundër grave drejtuar Kombeve të Bashkuara “që ka përbledhur të gjitha të dhënat statistikore në dispozicion lidhur me dhunën kundër grave në atë kohë si dhe ka diskutuar punën e organizatave të grave lidhur me adresimin e dhunës.³ Në vitin pasues, QSGJK ka përpiluar

¹ Nxjerrur nga shqyyrimi i literaturës paraprake në RRGGK, *Hulumtrim kërkimor*.

² QMG et al., 4.

³ Ilire Rizvanolli, Lauren Bean & Nicole Farnsworth, “Raport i shoqërisë Civile në Kosovë për Kombet e Bashkuara mbi dhunën kundër grave,” QSGJK: 2005. Shih faqen e Internetit të QSGJL për raportet e tjera: www.kgscenter.org.

një dokument të papublikuar të titulluar “Indikatorët për monitorimin e gjendjes së vërtetë të vendeve lidhur me dhunën kundër grave” si pjesë e projektit *Ndal dhunën kundër grave* të Institutit për Shoqëri të Hapur. Raporti i QSGHK-së *Monitorimi i sigurisë në Kosovë vështruar nga perspektiva gjinore*, poashtu përfshin një pjesë të dhunës në familje.

Në vitin 2005, FPKB ka publikuar *Dhunën në baza gjinore në Kosovë: Një rast studimi*, i cili shqyrton format e ndryshme të dhunës mbi baza gjinore që ndikojnë mbi gratë në Kosovë, përpjekjet qeveritare dhe joqeveritare ndaj dhunës dhe mungesat në programet e asistencës. Raporti bënë rekondimet tek institucionet qeveritare, OJQ-të dhe donatorët për përmirësimin e përgjigjes ndaj dhunës kundër grave.

Shqyrtimi i parë gjithëpërfshirës i dhunës kundër grave i realizuar nga Rachel Wareham për UNIFEM-in në vitin 2000, është titulluar *Pa një vend të sigurt: Një vlerësim mbi Dhunën kundër Grave në Kosovë*. Studiuesit kanë filluar me ushtrime të krijimit të besimit me grupe të grave rurale dhe urbane anë e kënd Kosovës. Rezultatet e kërkimit janë nxjerrë nga diskutimet e grupeve, intervistat e hollësishme dhe anketat e plotësuara në mënyrë anonime nga 213 gra të cilat i kanë vijuar këto grupe. Më tej, studiuesit i kanë intervistuar aktivistët, pjesëtarët e komunitetit, burrat dhe disa gra serbe.⁴

Po ashtu në vitin 2000, Medica Mondiale Kosova ka publikuar studimin *Ndal dhunës kundër grave:rezultatet e një ankete të ndërmarrë në Gjakovë*. Studiuesit kanë intervistuar 500 njerëz (440 femra dhe 60 meshkuj) të moshave dhe etniciteteve të ndryshme (pra, shqiptarë, boshnjak, romë, turq), të niveleve të ndryshme shkolllore dhe feve lidhur me percepcionin që kanë për dhunën në familje. Metoda e përzgjedhjes së mostrave të zbatuara nuk ka qenë e qartë.⁵

⁴ UNIFEM, *Pa një vend të sigurtë (No Safe Place)*, 15, 20-21.

⁵ Medica Mondiale Kosova, *Ndal dhunën kundër grave (Stop Violence against Women)*, 6.

SHTOJCA 2

PYETËSOR

Vetëm për studiuesit para intervistës. Koha e fillimit : __ : __

1. Numri identifikues _____ 2. Komuna _____

3. Rural/urban:

3.1. Fshati (pa stacion policor ose QPS) 3.2. Qyteti (ambient rural, por me stacion policie, QPS) 3.3. Qyteti (ambienti urban)

4. Gjinia: 4.1. Femër 4.2. Mashkull

(Fillojeni intervistën këtu pas leximit të formularët të pajtimit. Ju lutem, lexojeni vetëm tekstin në bold.)

Së pari, do të doja të dijë më shumë për ty dhe për familjen tënde.

5. Sa vjet i keni?

5.1 18-25 5.3 36-45 5.5 56-65
5.2 26-35 5.4 46-55 5.6 66+

6. Cili është etnicitetit juaj?

6.1 Shqiptar 6.3 Romë, Ashkanli ose 6.5 Goran
6.2 Serb Egjiptian 6.6 Turk
6.4 Boshnjak
6.7 I shumëfishtë (ju lutem shkruani) _____

6.8 Tjetër (ju lutem shkruani) _____

7. Cili është niveli më i lartë i shkollimit të cilin e keni PËRFUNDUAR?

1.1 Pa shkollim (0 vite)	1.4 Shkolla e mesme e pakryer	1.6 Universitet i papërfunduar
1.2 Shkolla fillore e pakryer	1.5 Shkolla e mesme e kryer	1.7 Universiteti i kryer
1.3 Shkolla fillore e kryer		1.8 Studimet pasuniversitare

2. (Nëse është ndërprerë para diplomës universitare) **cila ka qenë arsyea KRYESORE pse ju e keni ndërprerë shkollimin (rrethojeni)?**

- 2.1 Nuk keni dëshiruar të vazhdoni
2.2 Nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare në familje
2.3 Është dashur të punoni për të fituar para
2.4 Shkolla ka qenë tepër larg
2.5 Udhëtimi në shkollë nuk ka qenë i sigurt
2.6 Familja ime nuk ka menduar se ka qenë e rëndësishme për mua të vazhdojë shkollimin
2.7 Dhuna në familje
2.8 Nën trysninë ose detyrimin e nënës për ta ndërprerë
2.9 Nën trysninë ose detyrimin e babait për ta ndërprerë
2.10 Nën trysninë ose detyrimin e partnerit për ta ndërprerë
2.11 Nën trysninë ose detyrimin e anëtarëve të tjerë të familjes për ta ndërprerë
2.12 Të tjera _____
-

3. Cili është statusi juaj martesor TASH?

- | | | | | | |
|-----|---------------|---------|-----|------------------|---------|
| 3.1 | I/e pamartuar | → Q. 12 | 3.3 | I/e shkurorëzuar | → Q. 10 |
| 3.2 | I/e martuar | → Q. 10 | 3.4 | I/e ve | → Q. 10 |

4. Sa vite keni ka që jeni i/e martuar (a keni qenë) (Në martesën e tashme, nëse jeni martuar dy herë)?

- | | | | | | | | |
|------|------|------|-------|------|-------|-------|------|
| 10.1 | ≤1 | 10.4 | 11-15 | 10.7 | 26-30 | 10.10 | ≥ 41 |
| 10.2 | 2-5 | 10.5 | 16-20 | 10.8 | 31-35 | | |
| 10.3 | 6-10 | 10.6 | 21-25 | 10.9 | 36-40 | | |

5. Çfarë moshe keni pasur kur jeni martuar për herë të parë?

- | | | | | | |
|-----|-------|-----|-------|-----|------|
| 5.1 | ≤15 | 5.3 | 19-25 | 5.5 | ≥ 31 |
| 5.2 | 16-18 | 5.4 | 26-30 | | |

6. Me kënd jetoni në shtëpi?

- 6.1 Me të afërmit e familjes nga gjaku (prindërit, vëllezërit, motrat)
6.2 Me të afërmit e familje nga martesa (burri/gruaja dhe/ose fëmijët)
6.3 Familja e gjerë e partnerit (vjeħħra, vjeħħri, kunati, kunata etj.)
6.4 Familja ime e gjerë (prindërit, vëllezërit, motrat dhe prindërit e tyre)
6.5 Miqtë
6.6 Partneri (i/e pamartuar)
6.7 I/e vetëm
6.8 Të tjera _____
-

7. Të gjithë së bashku, sa njerëz jetojnë tash në bashkësinë tuaj familjare?

8. Sa fëmijë keni, nëse keni ndonjë?

8.1	0	8.4	3	8.7	6	8.10	9
8.2	1	8.5	4	8.8	7	8.11	10+
8.3	2	8.6	5	8.9	8		

9. A iu është thënë ndonjëherë të keni më shumë fëmijë se sa keni dëshiruar?

- 9.1 Po
- 9.2 Jo
- 9.3 Nuk e di/ Pa përgjigje

10.(Nëse po) kush ka ushtruar trysni?

- 10.1 Partneri
- 10.2 Prindërit
- 10.3 Vjehrrit
- 10.4 Anëtarët e tjerë të familjes
- 10.5 Tjetër _____
- 10.6 Kombinim (shkruajë): _____

11.(nëse keni fëmijët) Si do t'i dënonit fëmijët tuaj? (rrethojeni)

(nëse nuk keni fëmijë) **Sipas mendimit tuaj, si mendoni se fëmijët duhet të dënohen?**

- 11.1 Atyre nuk iu lejohet të luajnë me shokët (të nxjerrën jashtë)
- 11.2 Ata duhet bërë më shumë punë në shtëpi
- 11.3 Ata duhet të rrinë dhomën e tyre të gjumit ose në shtëpi
- 11.4 Bërtisni në atë
- 11.5 E godet atë me dorë
- 11.6 E godet atë me rrip ose me shkop
- 11.7 Tjetër _____
- 11.8 Zakonisht nuk i dënoj fëmijët e mi

12.A është dënim i njëjtë për vajzat dhe për djemtë?

- 12.1 Po
- 12.2 Jo → Si dënohen vajzat? _____

Si dënohen djemtë? _____

Siguria fillon në shtëpi

13. Cili është statusi i juaj i punësimit tash?

- 13.1 Punoj në një vend pune që paguhet jashtë shtëpisë → Q21
- 13.2 Bëjë punë të papagesë jashtë shtëpisë (në bujqësi, kujdesi për kafshët siç janë lopët, pulat etj.)
- 13.3 Bëjë punë të papagesë në shtëpi (kujdesi për fëmijët, kopshtaria, kujdesi për punët shtëpiake etj.)
- 13.4 Punoj herë pas here (këshillues)
- 13.5 Aktualisht i papunë, por i interesuar për punë
- 13.6 I papunë, i painteresuar për punë
- 13.7 Ende student / nxënës
- 13.8 I pensionuar
- 13.9 I paaftë për të punuar

14. (Nëse nuk punon për para) Cila është arsyaja KRYESORE pse nuk punoni për para?

- 14.1 Puna që e bëjë brenda shëtisë (kujdesi për fëmijët, puna në kopsht dhe punët shtëpiake, etj.)
- 14.2 Puna që bëjë jashtë shtëpisë (në bujqësi, kujdesi për kafshët siç janë lopët, pulat etj.)
- 14.3 Nuk kam qenë në gjendje të gjejë një punë
- 14.4 Familja nuk më lejon të punojë
- 14.5 Jam ende nxënës / student
- 14.6 Nuk ia vlen (për një pagë të vogël)
- 14.7 I pensionuar
- 14.8 I paaftë për të punuar
- 14.9 Tjetër _____
- 14.10 Nuk e di / pa përgjigje

15. (Nëse punon) Cila është paga juaj mujore?

15.1	1-100 euro	15.3 15.4	201-300 301-400	15.6 15.7	501-600 601-700	15.9 15.10	801-900 901-1000
15.2	101-200	15.5	401-500	15.8	701-800	15.11	1000+

16. (Nëse i/e martuar) A është partneri juaj i punësuar me pagë?

- 16.1 Po
- 16.2 Jo

17. Së bashku, sa anëtarë të familjes suaj janë të punësuar? _____

18. A mund të vlerësoni të hyrat e bashkësisë suaj familjare të TRE MUAJVE TË FUNDIT nga të gjithë anëtarët dhe të gjitha burimet?

18.1	0 - 40	18.4	201-300	18.7	501-600	18.10	801-1000
18.2	41-100	18.5	301-400	18.8	601-700	18.11	1000+
18.3	101-200	18.6	401-500	18.9	701-800		

19. A merr asistencën sociale familja juaj?

19.1 Po → 26

19.2 Jo → 28

20. (Nëse po) A është ajo e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e familjes suaj?

20.1 Po → 28

20.2 Jo → 27

21. (Nëse jo) Për sa para do të kishte nevojë familja juaj për mbulimin e shpenzimeve themelore? _____

22. Kush do të thoshit se merr shumicën e vendimeve lidhur me atë se si duhet të shpenzohen paratë në familjen tuaj për blerjet e mëdha, siç është makina ose orenditë?

22.1 Unë

22.5 Vjehrri im

22.2 Partneri im

22.6 Vjehrra ime

22.3 Babai im

22.7 Kunati im

22.4 Nëna ime

22.8 Është vendim i përbashkët midis (shkruaj) _____

22.9 Tjetër _____

23. Kush do të thoshit ju se zakonisht vendos për shkollimin e fëmijëve (për shembull, nëse fëmijët do të vazhdojnë shkollimin ose çka do të studiojnë)?

23.1 Unë

23.5 Vjehrri im

23.2 Partneri im

23.6 Vjehrra ime

23.3 Babai im

23.7 Kunati im

23.4 Nëna ime

23.8 Është vendim i përbashkët midis (shkruaj) _____

23.9 Tjetër _____

24. Kush do të thoshit në familjen tuaj ka fjalën vendimtare kur duhet të merret një vendim i rëndësishëm?

24.1 Unë

24.5 Vjehrri im

24.2 Partneri im

24.6 Vjehrra ime

24.3 Babai im

24.7 Kunati im

24.4 Nëna ime

24.8 Është vendim i përbashkët midis (shkruaj) _____

24.9 Tjetër _____

25. Çka ndodh nëse dikush nuk pajtohet ose diskuton me atë person lidhur me vendimin?

- 25.1 Asgjë
- 25.2 Ai person (vendimmarrësi) hidhërohet
- 25.3 Personi (vendimmarrësi) bërtet e bënë shamatë me personin i cili diskuton
- 25.4 Atë person (vendimmarrësi) mundet fizikisht ta dëmtojë personi i cili diskuton
- 25.5 Diskutimi e, pastaj, vendimi merret së bashku
- 25.6 Tjetër _____

Unë do të lexoj disa deklarime. Ju lutem, më thoni nëse pajtoheni, pajtoheni deri diku, deri diku nuk pajtoheni, ose nuk pajtoheni.

	1	2	3	4	8	9
26. Ndonjëherë është në rregull që burri të godas gruan e tij	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
27. Fëmijët kanë nevojë të disiplinohen	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
28. Ndonjëherë fëmija ka nevojë të rrihet me shuplaka	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
29. Djemtë duhet të kenë disciplinë më të reptë se sa vajzat për arsy se kjo i bënë më të fortë	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
30. Vajzat kanë nevojë për më shumë disciplinë se sa djemtë në mënyrë që ato të jenë moralisht korrekte	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
31. Personat me aftësi të kufizuara duhet të rrinë brenda shtëpisë të tyre për arsy se ata e turpërojnë familjen	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
32. Është e natyrshme që dhuna fizike ndodh midis çifteve kur ata diskutojnë	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
33. Është e natyrshme që dhuna në familje të ndodh pasi dikush të pijë alkool	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
34. Njerëzit e moshuar janë barrë e familjes	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
35. Marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë e dhunshme nëse ndodh midis dy të rriturve të cilët janë të martuar	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
36. Nëse një burrë është i papunë, ndonjëherë duhet të ndodh dhuna	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK

37. Nga nuset pritet të kenë më shumë përgjegjësi për pastrimin dhe përgatitjen e ushqimit se sa nga anëtarët e tjerë të familjes	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
38. Në Kosovë ekziston një rregullore kundër dhunës në familje	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
39. Nëse fqinjët do ta dinin se një familje ka dhunë brenda saj, ata do ta konsideronin atë të turpshme	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
40. Cilido burrë i cili godet gruan e tij duhet të turpërohet nga vvetjetra	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
41. Dhuna është pjesë normale e cilësdo marrëdhënie, dhe shoqëria në përgjithësi e pranon se dhuna ndodh ndonjëherë	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
42. Kryerësit e dhunës në familje janë fajtorë dhe duhet të dënohen sipas ligjit.	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK
43. Nëse ka dhunë në një familje, gruaja duhet të shkojë në strehimore ose te familja e saj, ndërsa burri duhet të qëndrojë në shtëpi derisa çështja të mos jetë zgjidhur	Pajtohem	Pajtohem deri diku	Deri diku nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Refuzoj	DK

Tash do të lexoj një listë të veprimeve që mund të ndodhin në familje. Ju lutem, sipas mendimit tuaj, më thoni nëse secili veprim mund të konsiderohet një formë e dhunës në familje.

Lloji	1	2	8	9
44. Të kritikuarit e anëtarit të familje gjatë gjithë kohës	Po	Jo	Refuzoj	DK
45. Fyerja e anëtarit të familjes ose poshtërimi i tij	Po	Jo	Refuzoj	DK
46. Dërgimi i fëmijës për të blerë bukë	Po	Jo	Refuzoj	DK
47. Dënim i fëmijës përmes rrahjes së tij ose të saj me shuplaka	Po	Jo	Refuzoj	DK
48. Dënim i fëmijës përmes rrahjes së tij ose të saj me rrip ose me shkop	Po	Jo	Refuzoj	DK
49. Moslejimi i anëtarit të familje të shoh shokët ose të afërmit	Po	Jo	Refuzoj	DK
50. Kontrollimi se ku mundet ose nuk mundet të shkojë anëtarët i familjes	Po	Jo	Refuzoj	DK
51. Marrja e vendimeve për anëtarin tjetër të rritur të familjes pa e pyetur atë	Po	Jo	Refuzoj	DK
52. Të ndihmuarit personit me aftësi të kufizuara se me kënd të martohet	Po	Jo	Refuzoj	DK
53. Refuzimi i anëtarit të familjes, i cili ka para, t'i jap anëtarit tjetër të familjes i cili ka nevojë për to	Po	Jo	Refuzoj	DK
54. Moslejimi i anëtarit të familje të punojë jashtë shtëpisë	Po	Jo	Refuzoj	DK
55. Të qenët i pabesë ose mashtrues ndaj partnerit të tij ose të saj	Po	Jo	Refuzoj	DK
56. Partneri i cili është së tepërtmi xheloz	Po	Jo	Refuzoj	DK
57. Kërcënimi se do të lëndohet anëtarët tjetër i familjes	Po	Jo	Refuzoj	DK
58. Shkatërrimi i mobileve ose thyerja e enëve me qëllim	Po	Jo	Refuzoj	DK

59. Shuplakosja, grushtimi ose shqelmosja e anëtarit të familjes kur ata janë duke diskutuar	Po	Jo	Refuzoj	DK
60. Prekja e anëtarit të familjes në mënyrë seksuale pa pëlqimin e atij personi	Po	Jo	Refuzoj	DK
61. Detyrimi i partnerit për të kryer veprime seksuale të cilat ai ose ajo nuk dëshiron t'i bëjë	Po	Jo	Refuzoj	DK

62. Sipas mendimit tuaj, cila është arsyja kryesore ose arsyet kryesore pse ndodh dhuna në familje (rrethojini të gjithë ato që vlejnë)?

- | | |
|---|--|
| 62.1 Papunësia në familje | 62.7 Për shkak të traumës së luftës |
| 62.2 Situata e dobët ekonomike në familje | 62.8 Për arsy se njerëzit janë martuar kundër vullnetit të tyre |
| 62.3 Mentaliteti | 62.9 Familjet e mëdha jetojnë së bashku pa hapësirë të mjaftueshme |
| 62.4 Mungesa e shkollimit | 62.10 Tjetër _____ |
| 62.5 Pasi dikush ka pi alkool | |
| 62.6 Gjatë diskutimeve që bëhen tepër intensive | |

63. Sipas mendimit tuaj, sa është e përhapur dhuna në familje në fshatin/qytetin tuaj? (Kontrolloje) Në kuptimin që njerëzit brenda familjes godasin njëri-tjetrin?

- 63.1 Kjo nuk ndodh në fshatin/qytetin tim (0%)
- 63.2 ajo ndodh vetëm në disa familje (1-25%)
- 63.3 Ndodh diku midis një të katërtës dhe gjysmës së familjeve (26%-50%)
- 63.4 Ndodh diku midis gjysmës dhe tri të katërtave të familjeve (51%-75%)
- 63.5 Ndodh diku midis tri të katërtat dhe pothuajse të gjitha familjeve (75%-99%)
- 63.6 Ndodh në secilën familje (100%)
- 63.7 Nuk e di / Pa përgjigje

Në vitin e kaluar, ju personalisht, sa herë keni parë ose dëgjuar njerëzit në të njëjtën mënyrë duke vepruar si më poshtë: çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, 5-11 herë, 1- 4 herë, asnjëherë. Nëse nuk jeni të sigurt, ju lutem thoni vlerësimin tuaj më të mirë.

1 Çdo ditë	2 Çdo javë	3 Çdo muaj	4 5-11 herë në vit	5 1-4 herë në vit	6 Asnjëherë	9 DK/ NA
------------------	------------------	------------------	-----------------------------	----------------------------	----------------	----------------

- 64. Anëtarët e familjes duke bërtitur në njëri-tjetrin
- 65. Zëra të zhurmshëm, thuajse dy anëtarë të familjes të ishin duke goditur njëri-tjetrin
- 66. Prindërit duke i rrahir me shuplaka fëmijët e tyre
- 67. Një grua e cila ka shenja thuajse dikush e ka goditur

68. Vitin e kaluar, a mund të vlerësoni se në sa familje, të cilat ju i njihni personalisht, ka ndodhur dhuna?

- | | | |
|-------------------|--------------------|-----------------------------|
| 68.1 0 familje | 68.4 11-20 familje | 68.7 Nuk e di/ Pa përgjigje |
| 68.2 1-5 familje | 68.5 21-30 familje | |
| 68.3 6-10 familje | 68.6 31+ familje | |

Ju lutem mendoni për një person të cilin ju e njihni dhe i cili ka qenë viktimë e dhunës në familje. Mos më thuaj mua se kush është personi, por a mund të më thoni lidhur me ata...A është ai person...

Nr.	1	2	3	4	9
69.	Mashkull,	Femër	X	X	ND/PP
70.	Fëmijë (0-12)	I mitur (tinejxher) (13-18)	I rritur (19-50)	I moshuar (51+)	ND/PP
71.	Me arsimim më të pakët ose me shkollim fillor	Shkollim fillor të përfunduar	Me disa vite ose krejt shkollën e mesme	Disa vite ose krejt universitetin të kryer	ND/PP
72.	I punësuar për me pagë	Bujk (pa pagë)	I papunësuar	X	ND/PP

73. Çfarë lloji i dhunës i ndodh atij personi (lexojini pyetjet 1-4)?

- 73.1 Dhuna psikologjike, siç është të drejtuarit në mënyrë fyese, xhelozia, të gënjerit gjatë gjithë kohës
- 73.2 Dhuna fizike, siç është shqelmosja, grushtimi, goditja
- 73.3 Dhuna seksuale, siç është detyrimi i personit të ketë seks kur ai ose ajo nuk dëshiron ose që të kryej veprime seksuale të cilat ai ose ajo nuk i dëshiron
- 73.4 Dhuna ekonomike, siç është mosdhënia e parave personit kur ai ose ajo ka nevojë për to
- 73.5 Ose diçka tjeter
- 73.6 Kombinim (shkruaj numrat) _____
- 73.7 Nuk e di

74. Cili është personi i cili më së shpeshti e keqtrajton atë?

- | | | |
|---------------|--------------|---------------------|
| 74.1 Partneri | 74.5 Motra | 74.9 Vjehrra |
| 74.2 Babai | 74.6 Djali | 74.10 Tjetër: _____ |
| 74.3 Nëna | 74.7 Vajza | 74.11 Nuk e di |
| 74.4 Vëllai | 74.8 Vjehrri | |

Siguria fillon në shtëpi

75. Cili ka qenë rezultati negativ i dhunës mbi atë person (rrethoje gjithçka që i përgjigjet)?

- | | |
|--|---|
| 75.1 Lëndimet | 75.6 Përpjekje për vetëvrasje |
| 75.2 Problemet psikologjike | 75.7 Ndërprerje e shkollimit |
| 75.3 I paftë për t'u kujdesur për fëmijët | 75.8 Nuk mund të punojë, gjë që ndikon mbi situatën ekonomike |
| 75.4 I paftë për t'u kujdesur për vetveten | 75.9 Të tjera _____ |
| 75.5 Mendime mbi vetëvrasjen | 75.10 Të tjera _____ |

76. Si e ka trajtuar ai person dhunën ose si e ka zvogëluar dhembjen që ajo i ka shkaktuar atij ose asaj (rrethojeni)?

- | | |
|---|--|
| 76.1 Bisedon me shokët | 76.7 Shkurorëzohet |
| 76.2 Bisedon me anëtarët e familjes | 76.8 E braktis shtëpinë për një kohë për të jetuar diku tjetër |
| 76.3 Bisedon me këshilluesin ose psikologun | 76.9 Tjetër |
| 76.4 Shkon te mjeku | 76.10 Tjetër |
| 76.5 E thërrret policinë | _____ |
| 76.6 Shkon në strehimore | _____ |

77. A e dini se ku mund të shkojë personi për të kërkuar ndihmë nëse atyre iu ndodh dhuna (rrethojeni)?

- | | |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| 77.1 Një shok | 77.5 Avokati i viktimave |
| 77.2 Një anëtar tjetër i familjes | 77.6 Organizatat lokale ose OJQ-të |
| 77.3 Polici | 77.7 Tjetër _____ |
| 77.4 Qendër për Punë Sociale | 77.8 Nuk e di / Pa përgjigje |

78. A e njihni ndonjë person i cili ndonjëherë e ka raportuar rastin e ndodhjes së dhunës në familje?

- 78.1 Po → 85
78.2 Jo → 94

(Nëse po) Pasi ata e kanë raportuar rastin...

	1	2	9
79. A ka ardhur policia?	Po	Jo	PP/ND
80. A e ka lëshuar shtëpinë personi i cili ka përjetuar dhunën për të qëndruar diku tjetër?	Po	Jo	PP/ND
81. A i është dhënë ndihmë personit nga Qendra për Punë Sociale?	Po	Jo	PP/ND
82. A i është dhënë ndihmë personit nga ndonjë OJQ e grave ose strehimore?	Po	Jo	PP/ND
83. A i është dhënë ndihmë personit nga Avokatët e Viktimës?	Po	Jo	PP/ND
84. A i është dhënë personit ndonjë formë e ndihmës ligjore?	Po	Jo	PP/ND
85. A është arrestuar kryerësi i dhunës?	Po	Jo	PP/ND
86. A ka shkuar rasti në gjykatë?	Po	Jo	PP/ND
87. A është dënuar kryerësi i dhunës?	Po	Jo	PP/ND

(Studiuesi: shkruani hollësitë lidhur me atë se çfarë ka ndodhur më poshtë)

88. Nëse do t'iu ndodhët juve dhuna në familje, a mendoni se do të shfrytëzonit ligjin për t'i ndihmuar gjendjes suaj?

- 88.1 Po
88.2 Jo → Përse jo? _____
88.3 Nuk e di / Pa përgjigje

Tash do t'ju pyes disa pyetje shumë personale. Dëshiroj prapë t'iu them se nuk do t'ia jap askujt informacionin që ma jepni mua. Unë po ashtu dëshiroj ju të dini se nëse nuk ndjeheni mirë ose rehat në çdo kohë derisa ne bisedojmë, ju lutem më thoni se dëshironi të keni një pushim, t'i kalojmë pyetjet e caktuara ose të ndalojmë diskutimin tonë.

89. Nëse mund të rikujtoni, kur keni qenë fëmijë, si ju kanë dënuar zakonisht prindërit tuaj nëse keni qenë i pabindur?

- | | |
|--|--|
| 89.1 Nuk më është lejuar të luajë me shokët | 89.5 Ata më kanë rrahur me duart e tyre |
| 89.2 Është dashur të bëjë punë më shumë në shtëpi | 89.6 Ata më kanë rrahur me rrip ose me shkop |
| 89.3 Është dashur të rri në dhomën e fjetjes ose brenda shtëpisë | 89.7 Tjetër |
| 89.4 Ata më kanë bërtitur | 89.8 Zakonisht nuk më kanë dënuar |

90. Sipas mendimit tuaj, kur ju keni qenë fëmijë, si mendoni se ju kanë trajtuar prindërit tuaj dhe anëtarët e tjerë të rritur të familjes? (Lexojini opsonet)

- 90.1 **Shumë mirë**
90.2 **Mirë**
90.3 **As mirë as keq** → Përse? _____
90.4 **Keq** → Përse?
90.5 **Shumë keq** → Përse?
90.6 Nuk e di / pa përgjigje

91. (Nëse jeni i/e martuar/ jetoni me dikë) A e keni të vështirë që tani të bisedoni me PARTNERIN tuaj lidhur me gjërat të cilat janë të rëndësishme për ju? (Lexojini opsonet)

- | | | | | | |
|------|--------------------|------|-----------------------|------|----------------------|
| 91.1 | Shumë lehtë | 91.4 | Vështirë | 91.6 | Nuk e di / pa |
| 91.2 | Lehtë | 91.5 | Shumë vështirë | | përgjigje |
| 91.3 | Mesatarisht | | | | |

92. A e keni lehtë ose vështirë për të biseduar me anëtarët e FAMILJES suaj lidhur me gjërat të cilat janë të rëndësishme për ju? (Lexoji opsonet)

- | | | | | | |
|------|--------------------|------|-----------------------|------|----------------------|
| 92.1 | Shumë lehtë | 92.4 | Vështirë | 92.6 | Nuk e di / pa |
| 92.2 | Lehtë | 92.5 | Shumë vështirë | | përgjigje |
| 92.3 | Mesatarisht | | | | |

93. VITIN e kaluar, sa shpesh do të vlerësonit ju se anëtarët e familjes iu kanë bërtitur, fyer ose iu kanë bërë të ndjeheni shumë keq?

- | | | | | | |
|------|---------------|------|----------|------|--------------|
| 93.1 | 1 deri 5 herë | 93.4 | Çdo javë | 93.7 | Refuzim |
| 93.2 | 6-11 herë | 93.5 | Çdo ditë | 93.8 | Pa përgjigje |
| 93.3 | Çdo muaj | 93.6 | Kurrë | | |

94. VITIN e kaluar, sa shpesh do të vlerësonit ju se anëtarët e familjes iu kanë lënduar fizikisht?

- | | | | | | |
|------|---------------|------|----------|------|--------------|
| 94.1 | 1 deri 5 herë | 94.4 | Çdo javë | 94.7 | Refuzim |
| 94.2 | 6-11 herë | 94.5 | Çdo ditë | 94.8 | Pa përgjigje |
| 94.3 | Çdo muaj | 94.6 | Kurrë | | |

95. A ju ka goditur dikush ndonjëherë me objekt siç është shkopi, rripi ose thika?

- 95.1 Po → Me çka? _____ Kush? _____
95.2 Jo
95.3 Refuzon të përgjigjet

Unë do të lexoj një listë gjérash që mund të ndodhin në familje. A mund të më thoni, nëse ndonjëra prej këtyre gjérave ndonjëherë iu ka ndodhur juve në jetën tuaj? Nëse ato iu kanë ndodhur, a mund të më thoni se në çfarë kohe iu kanë ndodhur në jetën tuaj: kur keni qenë fëmijë, i mitur (tinejxher), i rritur, (nëse i vlen) gjatë shtatzënisë, (nëse vlen) në pleqëri ose më shumë se njëherë në jetën tuaj? (Studiuesi: kontrolloni gjithçka që i përgjigjet)

	0	1	2	3	4	5	9	8
	Kurrë	Fëmijëri	Tinejxher	I rritur	Shtatzënë	I/e moshuar	ND	Refuzon
96. Dikush nga famili ja juaj ju éshjté drejuar me emra fyes								
97. Anëtari i familjes iu éshjté drejuar me sharje								
98. Anëtari i familjes iu ka urdhëruar gjithë kohën								
99. Dikush nga famili ja juaj nuk iu ka lejuar t'i shihni shokët ose të afërmët								
100. Anëtari i famili ja ka kontrolluar se ku mund të shkonie ku nuk mundeni								
101. Anëtari i famili ja ka bërë të ndjeheni fajtor gjatë gjithë kohës								
102. Anëtari i famili ja marrë vendime të rëndësishme për ju pa ju pyetur juve								
103. Anëtari i famili ja cili ka pasur para ka refuzuar t'ua jep juve ato ose diçka që ju keni pasur nevojë								
104. Famili ja juaj nuk do t'i lejonë të punoni për para joشتë shtëpisë								
105. Famili ja juaj nuk do t'i lejonë për të vizituar mjekun kur ju keni qenë i sémurë								
106. Anëtari i famili ja kërcënuar se do t'i lëndoje juve ose dikë të afërt me ju								
107. Anëtari i famili ja pasur armë dhe ka kërcënuar për ta përdorur ate kundër juve								
108. Anëtari i famili ja shkatëruar orenditë ose ka thyer enët me qëllim								
109. Anëtari i famili ja shuplakuar								
110. Anëtari i famili ja goditur, grushtuar ose shqelmosur								
111. Anëtari i famili ja prekur pjesët intime të trupit në një mënyrë të cilën iu nuk e keni dëshiruar të preken								
112. Partneri juaj ka ushtruar tryjni për të pasur marrëdhënie seksuale kurju nuk keni dëshiruar								
113. Anëtari i famili ja detyruar për të bëtë vepprime seksuale të cilat nuk i keni dëshiruar								

Nëse éshjtë përgjigjur kurrë në të GJITHA pyetjet prej 102 deri 119 → III Parandimali

114. Cili nga anëtarët e familjes suaj e ka përdorur më së shpeshti dhunën kundër juve?

114.1 Partneri (burri/gruaja)	114.7 Vjehrri	114.13 Vajza_____
114.2 Nëna	114.8 Njerka	114.14 Kombinime
114.3 Babai	114.9 Njerku	114.15 Të githë
114.4 Vëllau	114.10 Kunati	114.16 Tjetër_____
114.5 Motra	114.11 Kunati	
114.6 Vjehrra	114.12 Djali	

115. Kush tjetër (rrethojeni)?

115.1 Partneri (burri/gruaja)	115.8 Kunati	
115.2 Nëna	115.9 Kunata	
115.3 Babai	115.10 Djali	
115.4 Vëllai	115.11 Vajza	
115.5 Motra	115.12 Kombinime _____	
115.6 Vjehrra	115.13 Të gjithë	
115.7 Vjehrri	115.14 Tjetër_____	

116. Sa shpesh iu kanë lënduar anëtarët e familjes?

116.1 Çdo pesë vjet	116.5 Çdo muaj	
116.2 Çdo vit	116.6 Çdo javë	
116.3 1 deri 5 herë në vit	116.7 Çdo ditë	
116.4 6 deri 11 herë në vit	116.8 Nuk e di / Pa përgjigje	

117. A e ka parë ose dëgjuar ndonjë fëmijë në familje dhunën duke ndodhur?

117.1 Po	117.3 Nuk e di	117.5 Pa përgjigje
117.2 Jo	117.4 Nuk më kujtohet	

118. Cilat kanë qenë rezultatet negative të dhunës në familje në jetën tuaj (rrethojeni)?

118.1 Asfare	118.6 Mendime mbi vetëvrasjen
118.2 Lëndimet	118.7 Përpjekja për vetëvrasje
118.3 Problemet psikologjike	118.8 Tjera
118.4 I paaftë për t'u kujdesur për fëmijët	
118.5 I paaftë për t'u kujdesur për vetveten	118.9 Refuzon përgjigjen

119. A keni pasur probleme shëndetësore për shkak të dhunës në familje?

119.1 Po	119.3 Refuzon
119.2 Jo → 128	përgjigjen

120. (Nëse po), çfarë problemesh shëndetësore keni pasur për shkak të dhunës në familje? (rrethojeni)

- | | |
|----------------------------------|------------------------------|
| 120.1 Depresion | 120.7 Gjymtyrë të thyera |
| 120.2 Kokëdhembjet | 120.8 Lëndime të tjera |
| 120.3 Shtypje të lartë të gjakut | 120.9 Tjetër _____ |
| 120.4 Nervozitet | |
| 120.5 Frikë të përhershme | 120.10 Tjetër _____ |
| 120.6 Mavijosje | 120.11 Refuzon të përgjigjet |

121. (Nëse po), Nëse keni qenë të lënduar si rezultat i dhunës, a keni shkuar ndonjëherë te mjeku ose a i keni treguar mjekut se çfarë ka ndodhur?

- | | |
|------------------------------|--------------------------------------|
| 121.1 Po | → Sa ka qenë i dobishëm mjeku? _____ |
| 121.2 Jo | → Përse? _____ |
| 121.3 Nuk kam qenë i lënduar | |

122. Kur e keni përjetuar dhunën, a i keni treguar dikujt lidhur me të? (nëse po) kujt?

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 122.1 Anëtarit të familjes | 122.6 Punëtorit social në Qendrën për Punë Sociale |
| 122.2 Policisë | 122.7 Mjekut |
| 122.3 Shokut | 122.8 Psikologut ose psikiatrit |
| 122.4 Përfaqësuesit të strehimores | 122.9 Tjetër _____ |
| 122.5 Një OJQ-je ose gruaje aktiviste | 122.10 Askujt |

123. Kur e keni përjetuar dhunën, çfarë iu ka bërë të ndjeheni më mirë?

- | | |
|--|---|
| 123.1 Asgjë | 123.6 Të fjeturit |
| 123.2 Biseda me shokët | 123.7 Të jetuarit diku tjetër për një kohë |
| 123.3 Biseda me anëtarin e familjes | 123.8 Dërgimi i kryerësit të dhunës në burg |
| 123.4 Biseda me këshilluesin ose me psikologun | 123.9 Shkurorëzimi |
| 123.5 Puna me duart e mia (siç është qepja) | 123.10 Tjetër _____ |

III. Parandalimi

Tash dua ta kem mendimin tuaj lidhur me atë se si shoqëria dhe qeveria mund të ndalin dhunën ose ta zvogëlojnë shkallën e dëmit që rezulton nga dhuna. Idetë të cilat ju i parashtroni do t'iu ndihmojnë organizatave, institucioneve dhe qeverisë që punojnë në këtë çështje të krijojnë një plan për trajtimin e dhunës në Kosovë.

Siguria fillon në shtëpi

124. Çka mendoni se janë problemet kryesore në shoqërinë kosovare, që e shkaktojnë dhunën në familje?

125. Çka mund të bënin organizatat, institucionet dhe qeveria për të parandaluar dhunën në familje?

126. Sipas mendimit tuaj, çfarë lloji i ndihmës do të ishte më i dobishëm për një person i cili ka përjetuar dhunën në familje (*rrethojeni*)?

- 126.1 Ndihma profesionale nga psikologët, psikiatrit ose këshilluesit
 - 126.2 Këshillimi familjar
 - 126.3 Vendosja e sigurt (Strehimorja)
 - 126.4 Qasja ndaj kujdesit shëndetësor pa pagesë
 - 126.5 Qasja më e madhe ndaj shkollimit
 - 126.6 Qasja ndaj ndihmës ligjore pa pagesë
 - 126.7 Ndihma në të gjeturit e punësimit
 - 126.8 Tjetër _____
-

127. Çka mund të bëjë qeveria që më mirë të trajtoj dhunën në familje?

128. A ka diçka tjetër që ju dëshironi të thoni ose të bisedoni me mua?

(Studiuesi: të plotësohet nga intervistuesi vetëm pas intervistës)

129. Data e vizitës: ___ / ___ / ___
D D M M V V V V

130. Koha e fillimit: ___ : ___

131. Koha e përfundimit: ___ : ___

132. A është përfunduar pyetësori?

132.1 Po → 140

132.2 Jo

133. (Nëse jo,) **cila është arsyja për mosërfundimin e pyetësorit?**

- 133.1 I intervistuari nuk ka qenë në gjendje të përfundojë (pra, i sëmurë, tepër i moshuar, dikush tjetër i pranishëm)
- 133.2 I intervistuari ka refuzuar vazhdimin
- 133.3 I intervistuari nuk ka pasur kohë të vazhdojë
- 133.4 I intervistuari nuk ka qenë psikologjikisht i gatshëm për të vazhduar intervistën
- 133.5 Tjetër _____

134. Sa ka qenë kohëzgjatja e intervistës?

134.1 0-30 min

134.2 31-60 min

134.3 61-89 min

134.4 90-119 min

134.5 120+ min

135. Ju lutem shkruani çfarëdo komenti tjetër të mëtejmë lidhur me intervistën, duke përfshirë përshtypjen tuaj si një intervistues dhe çfarëdo shpjegimi (si është zhvilluar intervista, shpjegimin e mëtejmë të komenteve të të anketuarit, shpjegimin e gjesteve trupore të të anketuarit gjatë intervistës, çfarëdo rrëfimesh të tjera relevante ilustrative gjatë pyetjeve të veçanta etj.)

136. Si intervistues, ju lutem certifikoni, përmes nënshkrimit më poshtë, se ky pyetësor është plotësuar në përputhje me përpjekjet tuaja më të mira.

Emri i intervistuesit: _____ Nënshkrimi i intervistuesit: _____

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

305-055.2(496.51)(048)
305-055.1(496.51)(048)

Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për
hartimin e strategjisë së parë nationale dhe të
planit të veprimit kundër dhunës në familje /
Shkruar nga Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-
Mustafa. - Prishtinë: Agjencinë për Barazi Gjinore
pranë Zyrës së Kryeministrat të Qeverisë së
Kosovës, 2008. - 147 f.; 28 cm.

1. Farnsworth, Nicole, 2. Mustafa Qosaj, Ariana

ISBN 978-9951-545-01-3

Siguria fillon në shtëpi

Fjala "siguri" zakonisht nënkupton sigurinë kombëtare dhe pamje të konfliktit ndërkombe. Siguria brenda shtetit, familjes dhe sidomos në nivel individual shpërfillet pasi që fusha private supozohet si vend i sigurt. Veprimet e paligjshme që do të ndiqeshin penalisht po të kryheshin kundër të personit të panjohur, fqinjitet apo në vendin publik kanë tendenca të shpërfillen kur kryhen në hapësirat private kundër anëtarit të familjes. Mirëpo, me shtimin e vëmendjes ndërkombe ndaj sigurisë njerëzore, ekziston një pajtueshmëri në rritje se pasiguria në mesin e individëve kontribuon në pabarazitë më të gjëra institucionale që ndikojnë negativisht në qeverisjen demokratike dhe në sigurinë e përgjithshme.

Dhuna në familje, që më parë është konsideruar si çështje private, është burim i pasigurisë për shumë njerëz në mbarë botën, duke përfshirë edhe ata nga Kosova, siç ilustrohet edhe në këtë Raport. Ekzistojnë dëshmi të shumta se dhuna në familje i kontribon një vistri të gjerë të problemeve shëndetësore, çështjeve psikologjike, paaftësisë për t'u përkujdesur ndaj fëmijëve dhe, madje, edhe vetëvrasjes apo vdekjes. Gjithashtu, dhuna i shkakton shoqërisë shpenzime domethënëse që ndërlidhen me kujdesin shëndetësor, policinë, drejtësinë, arsimin, punësimin dhe prodhimtarinë. Andaj,

Qeveria e Kosovës ka interes legjitim në zvogëlimin e dhunës në familje në vazhdën e aktiviteteve të saj të tanishme për arritjen e Objektivave zhvillimore të mijëvjeçarit dhe drejt përparimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në këtë raport trajtohet mungesa e informatave për dhunën në familje në Kosovë, dhe vihen themelë e fortë për Planin e parë të veprimit të Kosovës kundër dhunës në familje. Në raport po ashtu shqyrtohen format e dhunës që zakonisht ndodhin në familje; perceptimet e qytetarëve për dhunën në familje dhe për keqtrajtuesit; kufizimet shoqërore që i privojnë grupet e caktuara demografike dhe që i kontribuojnë dhunës; pasojat e dhunës ndaj femrave, meshkujve, fëmijëve familjes dhe shoqërisë, duke përfshirë institucionet publike; metodat që qytetarët i përdorin për trajtimin e dhunës, si dhe mangësitë e ndërlidhura ligjore dhe institucionale.

Në raport jepen informacione dhe rekomandime shumë të vlefshme për qeverinë e Kosovës, politkbërësit, organizatat joqeveritare, hulumtuesit, donatorët dhe për të interesuarit e tjerë në organizimin e fushatave apo programeve të synuara për parandalimin e dhunës në të ardhmen, për mbrojtjen më të mirë të viktimateve dhe për ndjekjen penale të kryerësve.